



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

KUPTIMI PËRGJITHËSUES KONTEKSTOR NË GJUHËN SHQIPE

**Tezë për mbrojtjen e gradës “Doktor” në Albanologji,
profili Gjuhësi**

Kandidati
Msc. Merita Balliçi

Udhëheqës shkencor
Prof. dr. Mehmet Çeliku

Elbasan, qershor 2018

DOKTORATË

Përgatitur nga: Msc. Merita Balliçi

Për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”

Profili: Gjuhësi

KUPTIMI PËRGJITHËSUES KONTEKSTOR NË GJUHËN SHQIPE

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Mehmet Çeliku

Mbrohet, më ____ . ____ . 2021, para jurisë:

- | | |
|----------|-----------|
| 1. _____ | (Kryetar) |
| 2. _____ | (Anëtar) |
| 3. _____ | (Anëtar) |
| 4. _____ | (Anëtar) |
| 5. _____ | (Anëtar) |

Deklaratë për vërtetësinë e punimit

Deklaroj në përgjegjësinë time të plotë se ky punim është hartuar nga unë dhe për çdo ide që nuk është imja janë respektuar të gjitha rregullat e citimit dhe referimit.

Në këtë punim nuk ka vend plagjiatura.

Merita Balliçi

Abstrakt

Monografia jonë ka objekt studimi *kuptimin përgjithësues*, një kategori e njohur në gjuhësinë shqiptare, por që deri më sot i është kushtuar pak vëmendje (disa nga gjuhëtarët tanë, në gramatika shkollore apo artikuj shkencorë, në mënyrë të fragmentuar, konstatojnë dhe analizojnë kuptimin përgjithësues te njësi të veçanta leksiko-gramatikore).

Njësia leksiko-gramatikore që shërben për të emërtuar tërë llojin, ose veprime, gjendje a ide që i takojnë llojit është njësi me *kuptim përgjithësues*. Ajo mund të referojë: a) një anëtar, përfaqësues të llojit, që bëhet i tillë bazuar në një ose më shumë karakteristika të përbashkëta të tij me llojin të cilit i përket. Ai bart vlerat e tipareve të klasës dhe njëkohësisht përfaqëson çdo individ të saj. Ky anëtar, përfaqësues i çdo individi të llojit, është i ndryshëm nga një element i veçantë i llojit, është i ndryshëm nga një element specifik, individual dhe i kundërvihet një individi konkret të klasës që gëzon disa tipare të veçanta, dalluese; b) veprime, gjendje a ide në përgjithësi që i referohen individëve/sendeve që përfaqësojnë llojin, klasën, në kundërvënien këto me një gjendje, veprim a ide të veçantë, referuar individëve/sendeve specifikë.

Përgjithësimi në gjuhën shqipe nuk mbështetet dukshëm në kritere formale gramatikore, nuk ekzistojnë forma të specializuara që të na japin *kuptimin përgjithësues*, ndaj, në punimin e pranishëm, *kuptimi përgjithësues* është hetuar e analizuar përmes një qasjeje tridisiplinore: gramatikore, semantike e pragmatike. Konteksti gjuhësor luan rol mjaft të rëndësishëm në shmangien e ambiguitetit *kuptim përgjithësues/kuptim i individualizuar* në një përdorim të caktuar. Vetëm në strukturën përdorimore mund të përcaktohet nëse një njësi leksikore a ndërtim i caktuar përdoret me *kuptim përgjithësues* a *kuptim të individualizuar*. Konteksti lejon ose përjashton interpretimin përgjithësues. Disiplinat gjuhësore të lartpërmendura kanë ndihmuar njëra-tjetrën për analizimin e fakteve gjuhësore dhe arritjen e konkluzioneve.

Mirënjohje

Për realizimin e këtij punimi ka lindur nevoja të konsultohemi me specialistë të fushave të ndryshme të gjuhës, të cilët kanë ofruar ndihmesën e tyre të çmuar.

Falënderime e mirënjohje për udhëheqësin shkencor, Prof. dr. Mehmet Çeliku, i cili më ka orientuar në organizimin e punës, në hulumtimin e kategorisë në gjuhën shqipe, evidentimin e çështjeve problemore, duke treguar kurdoherë profesionalizëm të lartë e rigorozitet në diskutimin e çdo qasjeje dhe këndvështrimi. I jam shumë mirënjohëse udhëheqësit shkencor për të gjitha vërejtjet e sugjerimet të cilat e kanë rritur cilësisht punimin.

Një falënderim i veçantë është për Prof. dr. Tomorr Plangaricën dhe Prof. dr. Emine Teichmann të cilët më kanë ndihmuar në përzgjedhjen e literaturës së huaj dhe janë treguar kurdoherë të gatshëm për të diskutuar rreth paqartësive dhe problematikave të hasura, duke ofruar mendimet e tyre me shumë vlerë. I jam mirënjohëse Prof. dr. Emine Teichmann edhe për ndihmesën e çmuar në përkthimin e disa çështjeve nga gjuha gjermane.

Falënderoj gjithashtu Prof. Dr. Rami Memushaj për literaturën e ofruar, Prof. asoc. Mustafa Karapinjallin për dashamirësinë e vazhdueshme dhe besimin e shfaqur që herët, si dhe Departamentin e Gjuhësisë në universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan për rrahjen e mendimeve, vërejtjet dhe të gjitha sugjerimet e dhëna.

Së fundi, një falënderim e mirënjohje e thellë për familjen time që ka nxitur dhe mbështetur realizimin e këtij punimi.

PASQYRA E LËNDËS

ABSTRAKT	iii
MIRËNJOHJE	iv
PARATHËNIE	x-xiii
KREU I: MBI KONCEPTIN KUPTIM PËRGJITHËSUES NË GJUHËSI	1
1.1 Sfondi teorik i punimit.....	1
1.2 Mbi konceptin kuptim përgjithësues në gjuhësi.....	14
KREU II: TRAJTIMI I KUPTIMIT PËRGJITHËSUES NË GJUHËSINË SHQIPTARE	
2.1. Emri	16
2.2. Nyja	17
2.2.1. Nyja zero	19
2.3. Fjalitë njëkryepërbërëse	20
2.4. Veta	21
2.5. Sifjalitë ndërtuar me lidhore	23
2.6. Fjalitë dykryepërbërëse	24
2.7. Kundrinori	25
2.8. Fjalitë pavetore	26
2.9. Fjalitë e ndërmjetme	27
2.10. Mënyrat e foljes dhe stilet e gjuhës	28
KREU III: NJËSITË LEKSIKO-GRAMATIKORE TË SHQIPES ME KUPTIM PËRGJITHËSUES. FAKTORËT GJUHËSORË DHE RRETHANAT LIGJËRIMORE NË TË CILAT REALIZOHET KUPTIMI PËRGJITHËSUES NË GJUHËN SHQIPE	
3.1. Emri me kuptim përgjithësues.....	29
3.1.1 Emra që referojnë dhe emra që nuk referojnë (emra të llojit)	29

3.1.1.1. Përdorime të emrave që nuk referojnë (emrave të llojit)	35
3.1.2. Emrat e përgjithshëm me kuptim përgjithësues	40
3.1.2.1. Emri i përgjithshëm i shquar me kuptim përgjithësues	40
3.1.2.2. Emri i përgjithshëm i pashquar me kuptim përgjithësues	45
3.1.2.3. Paradigma e emrit të përgjithshëm me kuptim përgjithësues	48
3.1.2.4. Trajta e shumësit në raport me kuptimin përgjithësues	49
3.1.2.5. Funkcioni i emrave me kuptim përgjithësues	51
3.1.2.6. Zëvendësimi i një trajte të emrit me kuptim përgjithësues me një trajtë tjetër	54
3.1.2.7. Nënlloji me kuptim përgjithësues	60
3.1.2.8. Emrat e përgjithshëm konkretë / abstraktë me kuptim përgjithësues	61
3.1.3. Emrat e përveçëm me kuptim përgjithësues	62
3.1.4. Emrat e lëndës me kuptim përgjithësues	65
3.1.5. Raporti kuptim përgjithësues – kuptim i caktuar/i pacaktuar	66
3.2. Përemrat me kuptim përgjithësues	71
3.2.1. Përemrat vetorë me kuptim përgjithësues	71
3.2.1.1. veta e parë (unë, ne)	72
3.2.1.2. veta e dytë (ti, ju)	74
3.2.1.3. veta e tretë (ai/ajo, ata/ato)	77
3.2.1.4. Pronori i emërzuar me kuptim përgjithësues	78
3.2.1.5. Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë (caktuesorët)	79
3.2.1.6. Dhanorja etike	82

3.2.2. Përemrat vetvetorë me kuptim përgjithësues	85
3.2.3. Përemrat pronorë me kuptim përgjithësues	86
3.2.4. Përemrat e pacaktuar me kuptim përgjithësues	86
3.2.5. Përemrat dëftorë me kuptim përgjithësues	88
3.2.6. Përemrat lidhorë me kuptim përgjithësues	89
3.3. Mbiemri me kuptim përgjithësues	90
3.4. Folja me kuptim përgjithësues	94
3.4.1. Veta dhe numri i foljes	96
3.4.2. Koha e foljes.....	98
3.4.3. Mënyra e foljes	102
3.4.3.1. mënyra lidhore	102
3.4.3.2. mënyra habitore	105
3.4.3.3. mënyra dëshirore	105
3.4.3.4. mënyra urdhërore	105
3.4.4. Forma joveprore e foljes me kuptim përgjithësues	106
3.4.4.1. Foljet vetore të formës joveprore me kuptim përgjithësues	108
3.4.4.2. Foljet pavetore me kuptim përgjithësues	109
3.4.5. Format e pashtjelluara me kuptim përgjithësues	110
3.4.5.1. Forma e pashtjelluar e gerundit (të bërë/së bëri)	112
3.4.5.2. Paskajorja	113
3.4.5.3. Forma e pashtjelluar e përcjellores (duke bërë/pa bërë)	113
3.4.5.4. Forma e pashtjelluar e pjesores (bërë/i bërë)	114
3.5. Fjalitë me kuptim përgjithësues	115

3.5.1. Fjalitë e thjeshta	116
3.5.2. Fjalitë dykryepërbërëse	117
3.5.3. Fjalitë njëkryepërbërëse	119
3.5.4. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje (sindetike, asindetike)	120
3.5.5. Fjalitë e përbëra me nënrenditje	120
3.5.5.1. sifjalia kryefjalore	120
3.5.5.2. sifjalia përcaktore	121
3.5.5.3. sifjalia kundrinore	122
3.5.5.4. sifjalia kallëzuesore	123
3.5.5.5. sifjalia kohore	123
3.5.5.6. sifjalia vendore	124
3.5.5.7. sifjalia kushtore	124
3.5.5.8. sifjalia shkakore.....	125
3.5.5.9. sifjalia qëllimore.....	126
3.5.5.10. sifjalia krahasore	126
3.5.5.11. sifjalia lejore.....	127
3.5.5.12. sifjalia rrjedhimore.....	127
3.5.5.13.sifjali të përziera (të përbëra komplekse)	128
3.5.6. Struktura sintaksore me kuptim përgjithësues.....	128
3.6. Fjali e togje gramatikisht të palidhura	131
3.6.1. Fjali të ndërmjetme me kuptim përgjithësues.....	131
3.6.2. Fjali të ndërkallura me kuptim përgjithësues.....	133

3.6.3. Togje të ndërmjetme me kuptim përgjithësues.....	134
3.6.4. Shprehje me kuptim përgjithësues.....	135
3.7. Fushat e përdorimit të kuptimit përgjithësues.....	136
3.7.1. Përdorimi i kuptimit përgjithësues sipas stileve.....	136
3.7.2. Sentencat popullore me kuptim përgjithësues.....	139
3.7.3. Fjalë të mençura të personaliteteve të fushave të ndryshme me kuptim përgjithësues ...	140
3.7.4. Tekste udhëzuese me kuptim përgjithësues.....	141
3.7.4.1. Manuale përdorimi.....	141
3.7.4.2. Receta gatimi	142
3.7.4.3. Eksperimente.....	143
3.7.5. Shenjat e horoskopit	143
3.7.6. Lojëra, sudokë.....	144
3.7.7. Këshilla, ide.....	144
3.7.8. Në reklama	144
3.7.9. Në sondazhe.....	145
3.7.10. Në titujt e librave, përrallave, tregimeve, artikujve etj.	146
3.7.11. Në gjuhën e folur	146
KREU IV: PËRFUNDIME.....	148
BIBLIOGRAFI.....	167
SHTOJCA.....	174

PARATHËNIE

Kuptimi përgjithësues është kategori e njohur në gjuhësinë shqiptare, por shqyrtimi i saj është i fragmentuar, jo e parë si një e tërë. *Kuptimin përgjithësues* e kemi ndeshur në studime, artikuj shkencorë a gramatika të shqipes, por, pavarësisht këtij fakti, termi *kuptim përgjithësues*¹ mungon në “Fjalorin e termave të gjuhësisë” (shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht), Tiranë 1975 dhe kjo ndoshta shpjegohet me vëmendjen jo të madhe që ka pasur kjo kategori në gjuhësinë tonë.

Monografia e pranishme është studimi i parë për *kuptimin përgjithësues* në letërsinë gjuhësore shqiptare ku kategoria studiohet e plotë, në sistem, duke synuar njohje të thelluar të saj dhe paraqitje të të gjitha njësive leksiko-gramatikore që gëzojnë kuptim përgjithësues. Ne kemi marrë në shqyrtim format e fjalëve, rolin e tyre përgjithësues ose jo në strukturën e përbërësit sintaksor apo fjalisë, duke ndalur në kategoritë gramatikore dhe përdorime të tyre në një kontekst të dhënë. Përgjithësimi është parë nga ne si një kategori gramatikore-semantike. Për shqyrtimin e saj ka lindur nevoja e analizave gramatikore, semantike e pragmatike, ku një rol të rëndësishëm për shmangien e ambiguitetit *kuptim përgjithësues/kuptim i individualizuar* zë konteksti gjuhësor. Njësia leksiko-gramatikore që lejon *interpretim përgjithësues a të individualizuar* del qartë vetëm në përdorimin kontekstual.

Në këtë punim do të paraqiten ide, do të evidentohen problematika të cilat ndonjëherë mund të mbeten në stadin e hipotezave të debatueshme për vetë natyrën e kategorisë që kemi marrë në shqyrtim. Michel Galliche, gramatikan e specialist i semantikës, është i mendimit se

¹ Gjejmë vetëm këto kuptime: absolute, abstrakt, anësor ose dytësor, frazeologjik, gramatikor, i bartur, i drejtpërdrejtë, i figurshëm ose i fytyruar, i fjalëpërfjalshëm, i parmë, i prejardhur, i rastit, ose rastësor, i rëndomtë, keqësues, konkret, leksikor ose lëndor (i fjalës), relative, themelor, kuptimbartës dhe kuptim dallues. (f. 123-124) Nuk gjendet në fjalor as termi *kuptim individualizues*.

keqinterpretimet rreth përgjithësimit e kanë pikënisjen e tyre në një pështjellim i cili shfaqet madje edhe në “intuitën gjuhësore”.²

Kuptimi përgjithësues në këtë punim trajtohet kryesisht në këto çështje të natyrës teorike:

- Cili është koncepti mbi kuptimin përgjithësues dhe raporti i tij me kuptime të tjera (kuptimin e caktuar/pacaktuar)? Është kuptimi i individualizuar e kundërta e kuptimit përgjithësues?
- Cili është kuptimi mbi referentin (përgjithësues/të individualizuar) dhe jo-referentin?
- Cilat njësi leksiko-gramatikore të shqipes mund të përdoren me kuptim përgjithësues?
- Ç’faktorë gjuhësorë mundësojnë kuptimin përgjithësues?
- Në ç’raport qëndron shqipja me gjuhët e tjera lidhur me dukurinë (anglishten, frëngjishten)?
- Cila është përhapja dhe denduria e përdorimit të kuptimit përgjithësues në gjuhën shqipe (stile të gjuhës)?

Për trajtimin teorik të punimit të pranishëm dhe analizën e shtjellimit të çështjeve problemore të parashtruara më lart, jemi mbështetur te këto burime kryesore: *Gramatika e Akademisë* (G.A., 1995, 2002); *Grammaire du sens et de l’expression* (Gramatika e kuptimit dhe e shprehjes), Patrick Charaudeau Paris, 1992; *English Grammar*, COLLINS Publishers; *A student’s grammar of the English language*, Sidney Greenbaum, Randolph Quirk, England, 1990; R. Jackendoff, *Foundations of language*, USA 2002; Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987 etj.; artikujt Michel Galmiche, “Phrases, syntagmes et articles generiques” në *Langages*, 1985/79, Georges Kleiber, “Qu’est-ce qui est (in)défini?”, *Faits de langues*, 1994/4, Georges Kleiber, “Remarques sur la denomination” 2001 etj.

Punimi ynë është strukturuar në katër krerë dhe paraprihet nga parathënia. Në kreun I, *Mbi konceptin kuptim përgjithësues në gjuhësi*, bëhet një parashtrim teorik i punimit duke ndalur në paraqitjen gramatikore, semantike e pragmatike të kategorisë së përgjithësimit, parë kjo në kuadrin

² “Ces divers malentendus trouvent, à notre avis, leur origine dans une confusion qui se manifeste au niveau même de l’intuition linguistique. On est ainsi amené à dégager deux types d’intuition grâce auxquels on se trouve en mesure de tenter un réexamen des concepts de syntagmes et de phrases génériques. Pour des raisons méthodologiques, on laissera en suspens quelques-uns des problèmes spécifiques posés par la généricité dite « verbale », sans toutefois éviter d’aborder la question plus générale de la part relative des facteurs sémantiques et des facteurs pragmatiques qui entrent dans le phénomène de la généricité.” Galmiche Michel, *Phrases, syntagmes et articles génériques*, In: *Langages*, 20^e année, n°79, 1985, pp. 2;

e gjuhësisë së përgjithshme. Për këtë është shfrytëzuar literatura e sipërpërmendur nga autorët francezë, anglezë e amerikanë dhe është synuar një konceptualizim i përgjithësimi, i cili edhe në gjuhësinë botërore është parë si një dukuri marginale e gjuhës dhe nuk ka marrë vëmendjen e duhur. Në këtë kapitull, mbështetur dhe në formulime e përkufizime të gjuhëtarëve të huaj për përgjithësimin, japim dhe ne konceptin tonë për kategorinë, duke synuar evidentimin e karakteristikave thelbësore të saj.

Në kreun II, *Trajtimi i kuptimit përgjithësues në gjuhësinë shqiptare*, bëhet një prezantim i trajtimit të kategorisë në gjuhësinë shqiptare. Sillen të gjitha çështjet, artikujt, studimet a gramatikat që lidhen me kuptimin përgjithësues dhe përmenden gjuhëtarë, si K. Cipo, M. Domi, Sh. Demiraj, S. Prifti, L. Buxheli etj. që kanë konstatuar dhe analizuar dukurinë. Kontribut më i madh në analizën e kuptimit përgjithësues në gjuhën shqipe i njihet M. Çelikut i cili vëren kuptimin përgjithësues në disa njësi leksikore-gramatikore, ku, padyshim, trajtimi më i plotë i takon fjalive njëkryepërbërse me vetë të përgjithësuar.

Kreu III i punimit të pranishëm, *Njësitë leksiko-gramatikore të shqipes me kuptim përgjithësues. Faktorët gjuhësorë dhe rrethanat ligjërimore në të cilat realizohet kuptimi përgjithësues në gjuhën shqipe*, është kreu që zë hapësirën më të madhe në punim. Në këtë krye shqyrtohen dhe analizohen njëra pas tjetrës të gjitha klasat e fjalëve që gëzojnë kuptim përgjithësues: emrat, përemrat, foljet e disa mbiemra. Gjithashtu, është trajtuar kuptimi përgjithësues edhe në tipat e fjalive dhe stilet e gjuhës. Në klasën e emrave është parë fillimisht e nevojshme të ndahen nga njëri-tjetri emërtimi abstrakt i një klase me cilësitë e karakteristikat e veta, përfaqësuese të tërësisë së tipareve të sendeve të një klase, ndryshe, *emrat që nuk referojnë apo emrat e llojit* (e kemi gjetur këtë emërtim te R. Jackendoff (2002) dhe Oda Buchholz & Wilfried Fiedler (1987)), nga emrat që referojnë individë ose grupe në përgjithësi apo në mënyrë të individualizuar. Për secilën prej klasave të fjalëve me kuptim përgjithësues analizohen shembuj, synohet evidentimi dhe shpjegimi i faktorëve gjuhësorë që mundësojnë shfaqjen e kategorisë, ngrihen teza, mbështeten argumentet me material teorik, si dhe sillen shembuj ilustrues. Në këtë krye bëhen dhe krahasime të shqipes me gjuhën angleze dhe franceze, aty ku gjehen përkime apo dallime.

Kreun IV të punimit e zënë *Përfundimet*, të cilat ndiqen nga *Bibliografia* dhe *Shtojcat*. Në rubrikën *Shtojca* përfshihen grafikë që tregojnë denduri e raporte të caktuara të kuptimit përgjithësues për njësi të caktuara gjuhësore që vihen në krahasim.

KREU I

MBI KONCEPTIN KUPTIM PËRGJITHËSUES NË GJUHËSI

1.1 Sfondi teorik i punimit

Kuptimi përgjithësues është një çështje komplekse, e gjerë dhe problemore dhe kufijtë e një disipline gjuhësore kanë qenë tepër të ngushtë për të arritur në shpjegime të kënaqshme të saj. Studime e botime gjuhësore më të fundit tregojnë se dukuritë gjuhësore analizohen më mirë nën dritën e disa disiplinave. Michel Galmiche, në artikullin e tij “Fjali, sintagma dhe nyje përgjithësuese” (*Phrases, syntagmes et articles génériques*), sheh si pjesë të kategorisë së përgjithësimit faktorët semantikë e pragmatikë³, ndërsa në punimin tonë qasja është tridisciplinore: gramatikore, semantike e pragmatike. Këto tri disiplina gjuhësore ndihmojnë njëra-tjetrën për analizimin e fakteve gjuhësore dhe arritjen e konkluzioneve rreth kuptimit përgjithësues.

Emine Sadiku, në përmbledhjen e saj *Midis gramatikës dhe pragmatikës* (analiza dhe pozicione), veçon këtë fakt: “Autonomia e komponenteve gramatikore nuk e përjashton kategorikisht një lloj motivimi pragmatik. Nëse pragmatika vështrohet si një grumbull rregullash përdorimore, ajo do të realizonte një komunikim të suksesshëm vetëm duke përfshirë në lojën gjuhësore gramatikën. Ndërsa gramatika, nga ana e saj, u përshtatet nevojave pragmatike-përdorimore.”⁴

³“Pour des raisons méthodologiques, on laissera en suspens quelques-uns des problèmes spécifiques posés par la généricité dite « verbale », sans toutefois éviter d'aborder la question plus générale de la part relative des facteurs sémantiques et des facteurs pragmatiques qui entrent dans le phénomène de la généricité.”, Michel Galmiche, *Phrases, syntagmes et articles génériques*, In: *Langages*, 20^e année, n°79, 1985. Générique et généricité. pp. 2. (Për arsye metodologjike, do të lëmë mënjanë disa prej prej problemeve të veçanta të shtruara prej përgjithësimit, të cilësuar si «verbale»; këtu nuk do të shmangim trajtimin e çështjes më të përgjithshme të pjesës që lidhet me faktorët semantikë dhe faktorëve pragmatikë të cilët përfshihen dhe janë pjesë e dukurisë së përgjithësimit.)

⁴ E. Sadiku, “Midis gramatikës dhe pragmatikës”, Botime 2L-2P, (mungon viti i botimit), f. 9

Patrick Charaudeau (1992) sjell *Grammaire du sens et de l'expression* (Gramatikë të kuptimit e të shprehjes)⁵ dhe e justifikon një gramatikë të tillë me shpjegimin e tij për gjuhën, të cilën e sheh si një material që i lejon njeriut të ndërtojë kuptimin teksa hyn në komunikim me të tjerët. Për të *gjuha është në të njëjtën kohë kuptim, shprehje dhe komunikim (sens, expression et communication)*.

Në parathënie të veprës së tij Charaudeau pohon faktin e njohur që nuk ka vetëm një gramatikë. Sipas tij, *ka aq gramatika sa dhe teori gjuhësore*⁶. Charaudeau thekson se *një gramatikë e kuptimit dhe e shprehjes* duhet të interesohet në përshkrimin e fakteve të gjuhës në funksion:

a) të qëllimeve të subjektit folës, gjë që kërkon që kategoritë e gjuhës të jenë rigrupuar rreth qëllimeve të tyre; b) çështjeve komunikuese që zbulohen, gjë që kërkon që sistemet e ndryshme të gjuhës të jenë trajtuar nga këndvështrimi i kuptimit; c) efektet e të folurit që mund të prodhojnë, gjë që kërkon shqyrtimin e llojeve të ndryshme të përdorimit të gjallë të gjuhës, jo vetëm të përdorimeve letrare.⁷

Për një gramatikë të tillë Charaudeau vë dy kushte: të jetë zgjidhje e problemit të diversitetit të teorive gjuhësore dhe të marrë parasysh ekzistencën e një tradite gramatikore, sado e kritikueshme qoftë ajo.⁸

⁵ *Grammaire du sens et de l'expression* (Gramatikë e kuptimit dhe e shprehjes) është strukturuar si vijon: nis me një pamje të përgjithshme (Généralités) të nocioneve të trajtuara nga pikëpamja e gramatikës tradicionale, përshkruhet secila kategori gramatikore, vazhdohet me paraqitje të formës (Marques et Formes), e cila përbën mjetet e shprehjes. Veçantitë semantike (Particularités sémantiques) janë një tjetër përbërës i trajtimit të kategorive gramatikore në *Gramatikën e kuptimit e të shprehjes*. Në këtë rubrikë përshkruhen *vlerat themelore të kuptimit* dhe *qasja* janë të orientuar drejt saj, kryesisht drejt *vlerës kontekstuale* (një njësi më vete në këtë gramatikë), ku gjejmë rëndom përdorime me kuptim përgjithësues.

⁶ "On le sait maintenant il n'existe pas une grammaire, ni a fortiori la grammaire d'une langue, mais autant de grammaires que de théories sur la langue. Il ne faut pas oublier que c'est le point de vue théorique qui détermine la description d'un objet, et non l'inverse." Patrick Charaudeau, *Grammaire du sens et de l'expression*, Paris, 1992, f. 3

⁷ "Une 'grammaire du sens et de l'expression' doit donc s'intéresser à décrire les faits de langage en fonction:

- des *intentions du sujet parlant* qu'il sont susceptible d'exprimer, ce qui exige que les catégories de la langue soient regroupées autour de ces intentions,
- des *enjeux communicatifs* qu'ils révèlent, ce qui exige que les différents systèmes de la langue soient traités du point de vue du sens,
- des *effets de discours* qu'ils peuvent produire, ce qui exige que soient passés en revue les différents types d'usage vivant de la langue, et pas seulement les usages littéraires." Poaty, f. 4

⁸ "D'une part une telle grammaire n'est possible que si elle résout le problème de la diversité des théories linguistiques.

Por, në ç'marrëdhënie vendosen *gramatika* dhe *kuptimi*?

Disa prej gjuhëtarëve kanë supozuar se kategoritë gramatikore janë thelbësisht semantike, ndërkohë që shumë të tjerë argumentojnë se semantika e gramatika duhet të jenë të dallueshme. Blumfeld (Bloomfield) është i mendimit se si pikënisje e një diskutimi gjuhësor duhet të jenë tiparet formale dhe jo kuptimi, pasi e konsideron semantikën një pikë të dobët në teorinë gjuhësore. Shumica e gramatikanëve tradicionalë argumentojnë se kategoritë gramatikore duhet të përcaktohen në terma të formës së gjuhës.

F. R. Palmer, në librin e tij *Semantics (a new outline)*, Cambridge University Press, 1976, veçon dy argumente që përjashtojnë kuptimin nga gramatika:

Së pari, kuptimi është shpesh shumë i vagët dhe kategoritë kuptimore nuk përvijohen lehtësisht dhe për këtë arsye çfarë mund të duket të jetë kategori e dukshme semantike shpesh është në të vërtetë e definueshme vetëm në aspektin e veçorive formale të një gjuhe.

Argumenti i dytë për gramatikën formale është ai që edhe kur ne vendosim kategoritë semantike e gramatikore në mënyrë të pavarur, ato shpesh nuk përputhen dhe si një nga shembujt më të njohur Palmer sjell krahasimin e kategorisë gramatikore të numrit, njëjës e shumës në sasi të numërueshme, p.sh *hair* është në njëjës në anglisht, por italishtja, frëngjishtja dhe shqipja ka emrin në shumës: *cheveux*, *capelli*, *flokët*, shembuj që tregojnë qartë që thelbi i kategorive gramatikore të një gjuhe duhet të jetë i pavarur nga kuptimi i tyre.

Pavarësisht kësaj, Palmer e sheh marrëdhënien semantikë-gramatikë shumë të ngushtë, deri në atë pikë që bëhet e pamundur të deklarojmë nëse kategoritë janë formale a semantike. Ai veçon forma

Or, il existe une tradition des études linguistiques qui, au-delà des différences de points de vue, a établi un consensus autour de certains concepts et procédés de description des systèmes de la langue, surtout dans ce qu'il est convenu d'appeler l'approche *sémantique* du langage.

D'autre part une telle grammaire n'est possible qu'à condition de tenir compte de l'existence d'une *tradition grammaticale*...

Il faut donc tenir compte de ce patrimoine, même si on veut le critiquer, car il constitue un langage de reconnaissance, le seul langage dont disposent ces usagers pour parler de la langue.

C'est en tenant compte de cette double condition que nous avons écrit cet ouvrage. Nous nous sommes efforcé de proposer des explications sémantiques de chacune des questions grammaticales traitées, tout en conservant, autant que faire se pouvait, la nomenclature traditionnelle, quitte à critiquer celle-ci et, parfois, à proposer un terme différent, chaque fois que l'explication l'exigeait." Poaty, f. 4-5

gramatikore që identifikojnë, ashtu si deiktikët, objektet në kontekst. Për këtë sjell rastin e nyjës së shquar *the* e cila bën të njohur objektin si për folësin, dhe për dëgjuesin (*the book*). Palmer është i mendimit se nuk mund të studiojmë kuptimin pa pasur bashkëpunimin e gramatikës dhe aspektet e tjera të strukturës së gjuhës. (Palmer, 1976, 9)

Palmer e sheh semantikën si një rrafsh të gjuhësisë, njësoj si fonetika ose gramatika (Palmer, 1976, 9) dhe nuk ndan të njëjtin mendim me Robins (2007), i cili e sheh semantikën si anën më pak të trajtueshme shkencërisht të gjuhësisë, *sipas vijave rreptësisht empirike*. Palmer e sheh semantikën jo më pak shkencore se gjuhësia, pjesë e së cilës ajo është. Një kërkesë thelbësore është se ajo duhet të jetë empirike. Për të mos i hyrë çështjes ç’është empirike apo shkencore, Palmer thekson se *kërkesa thelbësore e një studimi shkencor është se deklaratat e bëra brenda tij duhet, në parim të paktën, të jenë të verifikueshme me anë të vëzhgimit*.⁹

Ndonëse termi *semantikë* (nga greq., *kuptoj*), u krijua vonë, në shekullin XIX, studimet për kuptimin mund të shënohen ndër studimet e para të gjuhës nga njeriu. Që kur njeriu filloi të hetojë fenomenin e komunikimi gjuhësor, semantika zë një vend qendror në atë përpjekje dhe në një shekull e më shumë ekzistencë të gjuhësisë si disiplinë autonome, semantika ka patur role të ndryshme në analizën gjuhësore.

Për Zufferey & Moeschler¹⁰ origjina e semantikës duhet gjetur në logjikë, në filozofinë e gjuhës dhe në psikologji. Të njëjtën qasje ndaj semantikës ka dhe L. Tesniere. Duke analizuar sintaksën strukturore, L. Tesniere (1959) vë në vëmendje dhe dallimin e saj nga semantika: “Tjetër gjë është struktura e një fjalie, tjetër gjë ideja që ajo shpreh dhe që ka kuptim. Prandaj duhet dalluar plani strukturor dhe ai semantik.” Këtë dallim Tesniere e sheh si shumë të rëndësishëm dhe për të kuptuarin saktë të sintaksës strukturore. Për Tesniere plani strukturor është ai në të cilin zhvillohet shprehja gjuhësore e mendimit. Ai i përket gramatikës dhe është thelbësor për të, ndërsa plani

⁹ “I have suggested that linguistics is the scientific study of language. One essential requirement is that it should be empirical. If semantics is part of linguistic it too must be no less scientific. ... one essential requirement of a scientific study is that statements made within it must, in principle at least, be verifiable by observation.” F. R. Palmer, *Semantics, A new outline*, CAMBRIDGE UNIVERSITY PRESS, 1976, f. 6

¹⁰ Zufferey S. & Moeschler J. (2012), *Initiation à l’étude du sens. Sémantique et pragmatique*, Auxerre, Sciences Humaines Editions.

semantik, në të kundërt, është fusha e duhur e mendimit, duke shpërfillur çdo shprehje gjuhësore. Ai nuk i përket gramatikës, por vetëm psikologjisë dhe logjikës.¹¹

Njihen dy mënyra për t'iu qasur semantikës: *semantika formale* dhe *semantika konjitive* (njohëse). *Semantika formale* lidhet me semantikën filozofike klasike, domethënë logjikën. Ajo përpiket të përshkruajë kuptimin e gjuhës duke përdorur aparatën përshkruar të logjikës formale. Qëllimi është të përshkruajë gjuhën natyrore saktë dhe qartë. *Semantika formale* shqetësohet si fjalët janë të lidhura me objektet në botë dhe se si kombinimet e fjalëve ruajnë apo jo kushtet e vërtetësisë së përbërësve të tyre. *Semantika formale* ndjek parimin e përbërjes së Frege-s: kuptimi i tërësisë është një funksion i kuptimit të pjesëve. Kështu që, sintaksa është qartazi shumë e rëndësishme për këtë lloj analize; në fakt, kjo qasje lidhet me gjuhësinë çomskiane, në të cilën sintaksa është në fakt forca shtytëse në gjuhë.¹²

Qasja tjetër ndaj semantikës quhet semantikë psikologjike dhe e orientuar ose *semantikë konjitive* (njohëse). Kjo qasje nuk e konsideron strukturën logjike të gjuhës si të rëndësishme për përshkrimin e kuptimit të gjuhës, dhe ka tendencë të shpërfillë nocione të tilla, si vlerat e së vërtetës ose kompozicioni strikt. *Semantika konjitive* përpiket të shpjegojë fenomenet semantike, duke tërhequr vëmendjen ndaj faktorëve biologjikë, psikologjikë dhe kulturorë. Ata janë më pak të shqetësuar për nocionet e referencës dhe përpiqen të propozojnë shpjegime që do të përshtaten me çdo gjë që ne dimë rreth njohjes, duke përfshirë perceptimin dhe rolin e trupit në strukturimin e strukturave kuptimore.¹³

Për Palmer (1976) “semantika nuk është një disiplinë e vetme e mirëintegruar. Ajo nuk është një nivel i përcaktuar qartë i lingistikës, as i krahasueshëm me fonologjinë apo gramatikën. Përkundrazi, është një grup studimesh për përdorimin e gjuhës në lidhje me shumë aspekte të

¹¹ “Autre chose est la structure d’une phrase, autre chose l’idée qu’elle exprime et qui en constitue le sens. Il y a donc lieu de distinguer entre le plan structural et le plan sémantique.... La distinction entre le plan structural et le plan sémantique est d’importance capitale pour la bonne compréhension de la syntaxe structural.

Le plan structural est celui dans lequel s’élabore l’expression linguistique de la pensée. Il relève de la grammaire et lui est intrinsèque. Le plan sémantique au contraire est le domaine propre de la pensée, abstraction faite de toute expression linguistique. Il ne relève pas de la grammaire, à laquelle il est extrinsèque, mais seulement de la psychologie et de la logique.” Lucien Tesnière, *Elements de syntaxe structural*, Paris, Librairie C. Klincksieck, 1959 f. 40-41



¹² <https://www.um.es/lincoing/jv/UNIT1>, f. 2-4

¹³ <https://www.um.es/lincoing/jv/UNIT1>, f. 2-4

ndryshme të përvojës, kontekstit gjuhësor dhe jogjuhësor, pjesëmarrësve në diskurs, njohurisë dhe përvojës së tyre, të kushteve nën të cilat një pjesë e caktuar e gjuhës është e përshtatshme. Me të vërtetë ekziston një ide në të cilën, semantika ka të bëjë me shumën totale të njohurive njerëzore, megjithëse duhet të jetë detyrë e gjuhëtarit që të kufizojë fushën e studimit të tij dhe të sjellë rend në konfuzionin dhe kompleksitetin e dukshëm. ... gjuhëtarët kanë filluar të pranojnë edhe një herë se semantika nuk duhet thjesht të jetë e shqetësuar me sistemet formale dhe semiologjike brenda gjuhës, por është më shumë çështje e lidhjes së gjuhës me botën e përvojës.”¹⁴ Për Palmer, kompleksiteti i semantikës është thjesht një aspekt i kompleksitetit të gjuhës njerëzore.

Semantika përkufizohet si shkenca që studion kuptimin. Memushaj këtë përcaktim e quan *tautologji*, pasi një e panjohur shpjegohet me një të panjohur tjetër. Ai mendon se për të shpjeguar ç’është semantika, më parë duhet shpjeguar ç’është kuptimi. Por të shpjegosh kuptimin nuk është aq e lehtë. Memushaj e sheh atë si një *dukuri shumëfaqëshe e tepër të ndërlikuar*. (Memushaj, 2008, 146)

Në ndihmë për konceptimin e kuptimit, me gjithë kufizimet e veta, na vjen trekëndëshi semantik i C. K. Ogden dhe I. A. Richards (*The Meaning of Meaning*, Londër, 1923):



Matematicieni dhe logjicieni Gottlob Frege (1892) ishte i pari që solli një dallim qendror mes kuptimit dhe referencës. Duke përdorur në analizën e tij shembullin e mirënjohur tashmë: *Ylli i*

¹⁴ “... semantics is not a single, well-integrated discipline. It is not a clearly defined level of linguistics, not even comparable to phonology or grammar. Rather it is a set of studies of the use of language in relation to many different aspects of experience, to linguistic and non-linguistic context, to participants in discourse, to their knowledge and experience, to the conditions under which a particular bit of language is appropriate. Indeed there is a sense in which, as we have seen, semantics relates to the sum total of human knowledge, though it must be the task of linguist to limit the field of his study and bring order to the apparent confusion and complexity.

... linguists are beginning to accept once again that semantics should not simply be concerned with formal, semiological systems within language, but is more a matter of relating language to the world of experience.” Palmer, vepër e cituar.

mëngjesit është ylli i mbrëmjes, arrihet në përfundimin se dy kuptimet lidhen me të njëjtin referent. Frege mënjanon idetë vetjake nga semantika. Ai sjell një teori të kuptimit, nocionet qendrore të të cilave ishin referenca e një shprehjeje dhe kuptimi i saj, i pavarur nga folësit. Prandaj, Frege dhe shumica e traditës që ndjek atë, shohin gjuhën të pavarur nga përdoruesit e saj, ajo lidhet drejtpërdrejt me botën.

Për Palmer (1976, 31), referenca është më themelore sesa kuptimi. Referenca lidhet me marrëdhënien mes elementeve gjuhësore (fjalëve, fjalive etj.) dhe botës, ato jashtëgjuhësore; ndërsa kuptimi lidhet me sistemin kompleks të marrëdhënies mes vetë elementeve gjuhësore.

Për të përshkruar domethënien duhet të njohim referentin dhe konceptin. Referenti lidh ligjërimin me botën, realitetin, ndërsa koncepti, sipas T. Plangaricës (2013), *përmbledh tërësinë e vetive e karakteristikave abstrakte që përcaktojnë kategorinë e referentëve. Ai është njësi e konservimit a grumbullimit të informacioneve gjenerike a të përbashkëta që një person zotëron në lidhje me të dhënat a tematikën e një fjale*.¹⁵

Për shembull, në fjalinë *Puna e bën njeriun njeri* kemi dy raste të përdorimit të emrit **njeri**.

Emri i shquar **njeriun** shënon referentin, një individ që lidhet me realitetin, botën, ndërsa emri në të pashquar me një zero **njeri** shënon konceptin, tërësinë e tipareve që folësit zotërojnë për të bërë të mundur komunikimin mes tyre.¹⁶

Por, a mund të tregojmë drejtpërdrejtë referentët, pa ndërmjetësimin e koncepteve? Këtu vjen i qartë rasti i emrave të përveçëm: **Flora** u çua për të ndihmuar të sapoardhurën. (F. Kongoli, *Kufoma*, 1994, 59)

Emri **Flora** shërben për të dhënë një person, një referent të caktuar, jo një koncept të lidhur me të.

Nga ana tjetër, sipas Plangaricës, ekzistojnë fjalë që kanë kuptim vetëm brenda referentit që ato tregojnë në një kontekst të caktuar (*këtu, unë, tani...*): - *Erdha të të marr*, - *tha xhaxhai*. – *Mjaft! Do të jetosh tek unë*. Pikë. (D. Agolli, *Zurma e erërave të dikurshme*, 2006, 263)

¹⁵ T. Plangarica, *Hyrje në studimin e kuptimit, Semantikë dhe pragmatikë*, cikël leksionesh, Elbasan, 2013, f. 22.

¹⁶ Një shpjegim dhe analizë më të detajuar të shembullit do ta japim në vazhdim.

Vetori **unë** shërben për të dhënë një person, një referent të caktuar në një kontekst të caktuar që në këtë rast është *xhaxhai*. *Unë* në një tjetër kontekst gjuhësor do të shënonte një tjetër referent: - *Oi!... – ia bëri Stela. – Unë mezi po pres të ngrihet kati i dashurisë, ti më rrëzove edhe atë të miqësisë.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 62) (**Unë** = Stela)

Plangarica (2013) veçon një sistem të referencës të sofistikuar dhe kompleks. Duke iu referuar gjuhëtarit francez Jean-Claude Milner (1982), ai sjell dy tipa shprehjesh referenciale: ato që mundësojnë të arrihet të kapet referenti i tyre me anë të domethënies së tyre leksikore (referenca e tyre virtuale) dhe ato që kanë nevojë për kontekstin që të arrihet të kapet një referent (referenca e tyre aktuale). Në të parat, të quajtura *shprehje referenciale autonome* përllogariten përshkrimet e përcaktuara (shprehur me trajtë të shquar: studenti), të papërcaktuara (shprehur me trajtë të pashquar: një student), dëftueset e demonstrativet (ky student) dhe emrat e përveçëm (Agimi); ndërsa të dytat, *shprehjet referenciale joautonome*, kanë nevojë për kontekst, si përemrat vetorë, ndërsa L. Dauti (2017, 68) mendon se burimet e informacionit të nevojshme për identifikimin e referentit janë: *njohja e tekstit, njohja e kontekstit dhe situatës së komunikimit, njohja mbi botën*.

P. Charaudeau (1992, 11-12) e sheh shenjën në qendër të një konceptualizimi të trefishtë: referencial, strukturor e kontekstor dhe situacional. Konceptualizimi referencial lidhet me të kuptuarin e realitetit përmes filtrave të eksperiencës njerëzore; ai strukturor dhe kontekstor lidhet me integrimin e marrëdhënieve të opozicionit (paradigmatike) dhe të kombinimit (sintagmatike) që shenjat kanë mes tyre, për të siguruar koherencën sintaksore e semantike të mesazhit. Këto marrëdhënie dhe rregullat e tyre përbëjnë kontekstin gjuhësor; konceptualizimi situacional lidhet me pozicionin e subjektit folës në aktin e komunikimit. Të gjitha shenjat varen nga kushtet e përdorimit.

Semantika është e lidhur ngushtë me pragmatikën, ato plotësojnë njëra-tjetrën. Ndërsa semantika studion kuptimin jashtë kontekstit, pragmatika studion kuptimin në kontekst, “... për çdo fjali të ndërtuar drejt dhe me një kuptim të caktuar (sintaksë + semantikë), pragmatika duhet të parashikojë kompleksin e konteksteve, në të cilat ajo do të ishte e përshtatshme dhe do të kishte kuptimin a kuptimet e saj.”¹⁷

¹⁷ Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f. 295

Edhe T. Plangarica (2013) sheh semantikën dhe pragmatikën si disiplina të përafërta: të dyja studiojnë kuptimin që përfitohet përmes ligjërimit/gjuhës. “Ndërsa semantika studion kuptimin, të pavarur prej kontekstit të përdorimit të fjalëve dhe të frazave, pragmatika studion kuptimin që është i përftuar dhe komunikuar në një kontekst të caktuar, domethënë kur një fjali është e shqiptuar nga një folës i veçantë, në një çast të caktuar.” (Plangarica, 2013, 10) Pragmatika studion marrëdhëniet mes gjuhës dhe përdoruesve të saj. Xh. Lloshi pohon se *bota e përdoruesve është kushti i ekzistencës së pragmatikës*, “... ata janë motorët e parë të gjithë sipërmarrjes gjuhësore, si në anën teorike (orientimi gramatikor), edhe në atë praktike (lidhja me përdorimin). Shkurt, kemi këtë vargëzim: kuptimi – përdorimi – konteksti – përdoruesi.” (Lloshi, 2005, 291)

George Yule (1996) është i mendimit se analiza gjuhësore përmes pragmatikës ka avantazhet e disavantazhet e veta. “Avantazhi i studimit të gjuhës nëpërmjet pragmatikës është se mund të flitet për kuptimet e parashikuara të njerëzve, supozimet ose qëllimet e tyre dhe llojin e veprimeve (për shembull, kërkesat) që ata kryejnë kur flasin. Disavantazhi i madh është se të gjitha këto koncepte njerëzore janë shumë të vështira për t'u analizuar në një mënyrë të qëndrueshme dhe objektive.”¹⁸ Por, nga ana tjetër, veçon Yule “Për fat të mirë, njerëzit priren të sillen në mënyra mjaft të rregullta kur bëhet fjalë për përdorimin e gjuhës. Disa nga këto rregullsi rrjedhin nga fakti se njerëzit janë anëtarë të grupeve shoqërore dhe ndjekin modelet e përgjithshme të sjelljes që priten brenda grupit. ... shumica e njerëzve brenda një komuniteti gjuhësor kanë përvoja të ngjashme themelore të botës dhe ndajnë shumë njohuri jogjuhësore.”¹⁹

Galmiche (1985), referuar studimeve mbi përgjithësimin, sjell qasje semantike e pragmatike në shqyrtimin e dukurisë së përgjithësimit dhe nocionin e pragmatikës e sheh të lidhur thelbësisht me rolin mbizotërues të kontekstit. Ai sjell tezën: *Nuk ka fjali përgjithësuese “në vetvete”, vetëm disa situata, në disa kontekste, mund të lejojnë një interpretim përgjithësues... Kjo tezë, sigurisht,*

¹⁸ “The advantage of studying language via pragmatics is that one can talk about people’s intended meanings, their assumptions, their purposes or goals and the kind of actions (for example, requests) that they are performing when they speak. The big disadvantage is that all this very human concepts are extremely difficult to analyze in a consistent and objective way.” George Yule, *Pragmatics*, George Yule, Oxford University Press, 1996, f. 4

¹⁹ Luckily, people tend to behave in fairly regular ways when it comes to using language. Some of that regularity derives from the fact that people are members of social groups and follow general patterns of behavior expected within the group. ...most people within a linguistic community have similar basic experiences of the world and share a lot of non-linguistic knowledge. (po aty) f. 4-5

bazohet në një vëzhgim empirik që është vështirë të kontestohet. Është me të vërtetë e mundur të prodhohet një numër i konsiderueshëm frazash (d.m.th. objekte jashtë kontekstit, lloje) të cilat janë sistematikisht ambigje (ato mund të interpretohen si përgjithësuese ose specifike) dhe, vetëm, ndodhja e tyre në një kontekst të dhënë, lejon të zgjedhësh një nga dy leximet.²⁰

E njëjta fjali në kontekste të ndryshme merr vlera të ndryshme kuptimore: kuptim përgjithësues ose kuptim të individualizuar, specifik: *Atëherë greku i vogël ma dha dorën. Dora e tij ishte njëlloj si imja! Ç'thoshte kjo gjyshja që greku ka dorë tjetër?* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 80)

Emri **greku** është emër me kuptim të individualizuar në kontekstin gjuhësor *Atëherë greku i vogël ma dha dorë* dhe emër me kuptim përgjithësues në kontekstin gjuhësor *Ç'thoshte kjo gjyshja që greku ka dorë tjetër?*

Është e qartë që në rastin e parë referenti është një individ i veçantë, specifik dhe në të dytin një individ që përfaqëson llojin (**greku** = **çdo grek**).

Jean Mark Gawron dhe Stanley Peters²¹ shtjellojnë idenë që rrethana kontribuon në interpretimin i cili nuk është përcaktuar vetëm nga struktura gjuhësore. Ambiguiteti semantik shpjegohet nga ambiguiteti i kontekstit. Madje dhe emrat e përveçëm nuk përcaktojnë se kujt individ i referohen. Për t'i përcaktuar ata i referohemi kontekstit, përdorimit, rrethanave. Për një referim sa më të saktë ata janë të mendimit se nevojitet teoria e kontekstit (për të paktën emrat e përveçëm, përemrat).

Palmer është i mendimit se ne mund të dallojmë nëse dy fjali janë të njëjta për nga kuptimi nëse ato përdoren në kontekste të ngjashme. Ai krahason një fjali jashtë kontekstit me përshkrimin e të gjitha ekuivalencave në një sistem të njësive matëse. Për Palmer deklarimi i ekuivalencës së

²⁰ "... il n'y a pas de phrases génériques «en soi», seuls certains emplois, dans certains contextes, sont à même de permettre une interprétation générique.... Cette thèse s'appuie, bien entendu, sur une observation empirique difficilement contestable. Il est, en effet, possible de produire un nombre considérable de phrases (i.e. des objets hors contexte, des types) qui sont systématiquement ambiguës (elles peuvent être interprétées comme génériques ou spécifiques) et, seule, leur occurrence dans un contexte donné, permet d'opter pour l'une des deux lectures." Galmiche, artikull i cituar, f. 23-24

²¹ Jean Mark Gawron, Stanley Peters, "Anaphora and quantification in situation semantics", 1990, CSLI, Lecture Notes Number 19

kuptimit nuk është deklarimi i kuptimit dhe "...nuk ka asnjë provë se njohja e kuptimit të një fjalie nuk sjell njohjen e kontekstit në të cilin përdoret."²²

Palmer sjell një tjetër argument, edhe më bindës: bota e eksperiencës duhet patjetër të përfshijë njohjen njerëzore. Për të shquar ambiguitetin a anomalinë e një fjalie duhet të kemi informacione të nevojshme rreth tyre. Dhe kjo mund të vijë përmes zgjerimit të fjalisë, për shembull, dhe dhënies së një informacioni të vlefshëm që shuan ambiguitetin.

Krahas disiplinave e teorive që kemi përmendur deri tani, në analizimin e qartësimin e kuptimit përgjithësues na vjen në ndihmë edhe *teoria e të thënit*²³. Sipas R. Përnaskës, teoria e të thënit "studion edhe mënyrën me të cilën bën referimin akti i të thënit, si futet vetjakja në ndërtimet e gjuhës. Që një thënie të thotë diçka, duhet të ngërthejë skaje që referojnë në kundrana²⁴ të veçanta. Pra, thëniesi duhet të përdorë shprehje të caktuara për të veçuar, njëjtësuar (identifikuar) një kundranë ose një grup kundranash nga të tjerat. Për këtë përdoren jo vetëm mbrehësit²⁵, por edhe shquarësia dhe emrat e përveçëm. Përdorimi i nyjës shquese parakupton që ndërfolësi është në gjendje të njëjtësojë kundranën për të cilën bëhet fjalë në thënie, kurse përdorimi i nyjës joshquese parakupton futjen në ligjëratë të një referenti të ri, të panjohur nga ndërfolësi, si thuhet zakonisht. Megjithatë, siç dihet, asgjë nuk e pengon thënësin t'i shtojë nyjën shquese një emri për të referuar në kundrana që ai e di fort mirë që nuk gjallojnë ose që ai vetë nuk është në gjendje t'i identifikojë qartë. Për sa u përket emrave të përveçëm, ata nuk mund të përdoren veçse kur ndërfolësi është në gjendje të kuptojë së paku edhe pjesërisht se në ç'kundranë referojnë ato, sepse, si dihet, emrat e përveçëm kanë vlerë vetëm për një referent të vetëm.

Si del nga ç'u tha më lart, referenca nuk shkëputet dot nga lidhja midis thënësit dhe ndërthënësit, nuk mund të jetë e abstraktuar nga kjo lidhje. Pikërisht ky këndvështrim ka përshkruar analizat tradicionale shquarësi/pashquarësi që janë bërë si kudo edhe te ne. Gjuhësia e ligjëritimit, e në

²² "In that case, to set up a set of abstract relationships between sentences without even considering what it is that they refer to, is rather like describing all the equivalences in a measuring system, e.g. that there are twelve inches in a foot, three feet in a yard, 1760 yards in a mile, without even indicating how long an inch, a foot, a yard or a mile actually is. Stating meaning equivalence is not stating meaning, and there is no proof that knowing the meaning of a sentence does not entail knowing the context in which it is used." *vepër e cituar*, p. 44

²³ Remzi Përnaska, në *Gjuhësi... gjuhësore* (f. 148) sqaron përdorimin e këtij skaji në vend të skajit *pragmatikë*.

²⁴ Kundranë përdoret nga Përnaska si skaj jashtëgjuhësor.

²⁵ Përnaska zëvendëson me skajin gjuhësor *shifter* me *mbrehësit*. Ai saktëson se *shifter* është përdorur së pari nga Roman Jakobson për të shënuar operatorët që e ndryshojnë referimin njëherazi me ndryshimin e vetë thënësit...

mënyrë të veçantë teoria e të thënit, mund ta sqarojë edhe më mirë se deri më sot këtë mjet të fuqishëm aktualizimi në gjuhën shqipe, sigurisht duke pasur gjithmonë parasysh edhe përndarjen (distribucionin) në këtë pikë.” (Gjuhësi.. ... gjuhësore, Remzi Përnaska, f. 166)

Analizojmë shembujt:

(1) *Hetimi i dosjes së operacioneve të dy doktorëve, më saktë, i listës së plotë të njerëzve të operuar nuk ngjalli shqetësim, përkundrazi, u shoqërua me një ndjesi lehtësimi në krejt spitalin e madh. Ishte hera e parë që një rreze drite po dilte nga e panjohura. E bashkë me të, shpresa. Po hetoheshin rastet e vdekjeve gjatë operacionit, e kjo ishte diçka që ndodhte kudo në botë. Familjet ankoheshin për doktorët, këta mbroheshin, çështja përfundonte në gjyq. (I. Kadare, Darka e gabuar, 2009, 122-123)*

Në shembullin (1), emri **doktorët** është përdorur dy herë: si emër me kuptim të individualizuar, që shënon individë të caktuar, të individualizuar (bëhet fjalë për dy Gurametot), dhe si emër me kuptim përgjithësues, që shënon individë në përgjithësi (çdo doktor). Ky emër rimerret prej përemrit dëftor **këta**.

Në rastin e parë, individualizimi i emrit **doktorët** realizohet prej përdorimit të numërorit **dy**. Në rastin e dytë, nëse fjalinë *Familjet ankoheshin për doktorët*, do ta kishim të shkëputur nga konteksti gjuhësor që kemi sjellë në (1a), atëhere nuk do të mund të përcaktonim nëse bëhet fjalë për referentë të caktuar, të individualizuar apo referentë përgjithësues. Ambiguiteti i fjalisë shmanget në (1a), duket qartë që referenca është përgjithësuese, emri shënon një referent përgjithësues, cilindo që ka profesionin e mjekut, ndërsa përemri dëftor **këta**, duke qenë një përdorim anaforik, shënon referentin përgjithësues, sikurse emri që zëvendëson.

(2) *Hetimi i doktorëve, ashtu siç ndodh shpesh me ta, vazhdonte dy mënyrash. Të fshehtë, atë çka ndodhte në Guvën e Shanishasë, s’e dinte kurrkush. Tjetra zhvillohej në vende të ndryshme, spital, morg, shtëpi familjarësh, disa herë në varreza. (I. Kadare, Darka e gabuar, 2009, 123)*

Në shembullin (2) emri në gjinore shumës (**i doktorëve**) ka referencë të njohur, të caktuar. Për këtë na vjen në ndihmë konteksti gjuhësor. Kuptohet që hetimi lidhet me doktorë të veçantë, emri ka

kuptim të individualizuar. Përemri vetor²⁶ vendos lidhje anaforike me emrin dhe në shembullin tonë kemi një rast të një përdorimi të tillë, të vetorit **ta**. Po a shënon anafora të njëjtën referencë të individualizuar sikurse emri që rimerr, **doktorëve**, domethënë, a është fjala për *dy Gurametot*? Jemi të mendimit se, në këtë rast, referenca nuk është *e individualizuar*, por është *përgjithësuese*: cilido që kryen profesionin e mjekut.

Duke qenë se deiktiku, përemri vetor, nuk na vjen në ndihmë, le t'i referohemi një tjetër deiktiku: kohës së foljeve. Anafora **ta** është përdorur në një fjali me folje në kohën e tashme. Koha e tashme e foljes shpreh veprim që lidhet me çastin e ligjërimit, por ne e dimë që ky nuk është kuptimi i vetëm i saj. Koha e tashme e foljes shpreh, ndër të tjera, dhe veprime që nuk lidhen me një kohë të caktuar, veprime me kuptim mbarëkohor. “Një përdorim i tillë i së tashmes vihet re sidomos në fjalët e urta popullore (proverbat) dhe në aksiomat shkencore, në të vërtetat e përgjithshme, ku bëhen pohime, që kanë vlerë për çdo kohë, pra, edhe për çastin e ligjërimit.” (G.A., 1995, 307) Kështu, përdorimi i kohës së tashme lejon interpretimin përgjithësues në fjali. Krahas kohës së tashme, një tjetër e dhënë gjuhësore në fjali është përdorimi i ndajfoljes *shpesh*. Fjalitë me kuptim përgjithësues shprehin ide që lidhen me gjëra në përgjithësi që ndodhin shpesh ose janë të përhershme. Dhe për sa kohë të vërtetat janë mbarëkohore (kështu ndodh në çdo kohë me mjekët), përemri vetor **ta** nuk shënon referentin e individualizuar, sikurse emri doktorët që rimerr, por referentin përgjithësues: cilido që kryen profesionin e mjekut. Kësaj analize duam t'i shtojmë dhe shpjegimin njohës dhe pragmatik²⁷. Në ndërtimin *ashtu siç ndodh shpesh me ta*, folësi i drejtohet dhe njohjes së botës prej receptuesit, dijes së tij rreth çështjes së hetimit të mjekëve.

²⁶Rimarrja anaforike është mjet që siguron koherencën tekstore. “Përemrat vetorë si referues vendosin lidhje anaforike me emrin.” Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, 2005, f. 308.

²⁷ Dauti e koncepton referencën si rezultat të një *procesi semantiko-konjitiv në një situatë të caktuar komunikimi*. Vepër e cituar, f. 59.

1.2 Mbi konceptin “kuptim përgjithësues”

Kuptimi përgjithësues i një fjale është të përfaqësohet e llojit prej saj, në kontekste gjuhësore e forma të caktuara gramatikore. Kuptimi përgjithësues i kundërvihet kuptimit të individualizuar, të veçuarit të një sendi unik të llojit, të dallueshëm nga të tjerët.²⁸

Njësia leksiko-gramatikore që shërben për të emërtuar tërë llojin, ose veprime, gjendje a ide që i takojnë llojit, është njësi me kuptim përgjithësues. Ajo mund të referojë:

a) një anëtar si përfaqësues i llojit, që bëhet i tillë bazuar në një ose më shumë karakteristika të përbashkëta të tij me llojin të cilit i përket. Ai bart vlerat e tiparet e klasës dhe njëkohësisht përfaqëson çdo individ të saj. Ky anëtar, përfaqësues i çdo individi të llojit, është i ndryshëm nga një element i veçantë i llojit, është i ndryshëm nga një element specifik, individual dhe i kundërvihet një individi konkret të klasës që gëzon disa tipare të veçanta, dalluese: *Kur dolëm nga biruca e tij, Islami nuk e mbylli derën me lloz. Për pak minuta erdhën tre shokë të fortë, të stërvitur për të rrahur **spiunët*** (çdo spiun - kuptim përgjithësues) (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 19); *Do të kishte kaluar mesnata, kur u shtriva në shtrojen time, aty nën dritaren e birucës nr. 8. Edhe Iloja u shtri: - Peshk e bënë **spiunin***). *Vajta dhe e pashë. Mezi merrte frymë.* (një individ i caktuar - kuptim i individualizuar (P. Marko, po aty).

b) veprime, gjendje a ide në përgjithësi që i referohen individëve/sendeve që përfaqësojnë llojin, klasën, në kundërvënje këto me një gjendje, veprim a ide të veçantë, referuar individëve/sendeve specifike: *Kur **arritëm** aty, **pamë** se po bëhej pazar dhe ngado që **të hidhje sytë** shiteshin dardha, kumbulla, fiq, simite dhe gjëra të tjera për të ngrënë.*

²⁸ G. Belluscio, Sh. Rrokaj, në “Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë” (shqip – italisht – frëngjisht – anglisht), Tiranë 2011 sjellin këtë përkatësi termash për gjuhët e lartpërmendura: *PËRGJITHËSUAR* (i, e -) *generalizzato*, *généralisé*; *generalized*. (f. 265)

Në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 1980, 1436 jepet ky shpjegim: *PËRGJITHËSUAR* (i,e) *mb.* Që ka dalë si përgjithësim i vrojtimeve të një shumice rastesh a dukurish të veçanta. *Kuptim i përgjithësuar. Njohje (paraqitje) e përgjithësuar e realitetit.*

Në gjuhën frënge, kuptimi i termit është:

GÉNÉRAL, ALE, AUX – Qui s’applique, se réfère à un ensemble de cas ou d’individus. *Contr. Individuel, particulier.* (I referohet një tërësie rastesh, individësh. E kundërta: Individual, i veçantë.)

GÉNÉRIQUE – Qui appartient au genre (opposé à spécifique). (Që i takon llojit (në opozicion me të veçantin) (Micro Robert, Paris, 1977,487)

(*arritëm, pamë* – referentë të individualizuar, një *ne* e caktuar; *të hidhje sytë* – referent përgjithësues, çdo njeri) (K. Trebeshina, *Legjenda e asaj që iku*, 1992, 13)

Një përdorim konsiderohet përdorim me kuptim përgjithësues nëse në të gjejmë tipare, veprime, ide e karakteristika që i përkasin një lloji të dhënë.²⁹

Y. Kuroda (1973) sjell përkufizimin për fjalinë me kuptim përgjithësues: "E quaj një fjalë përgjithësuese, nëse ideja që shpreh ajo ka të bëjë me një gjendje të caktuar të gjërave në përgjithësi, të zakonshme apo të gjërave që ndodhin shpesh, dhe "specifike", në qoftë se ideja e shprehur i referohet një rrethane të veçantë të një ngjarjeje apo të një gjendjeje të gjërave."³⁰

Kështu, *kuptimi përgjithësues* është në marrëdhënie kundërvënies me *kuptimin e individualizuar*. *Kuptimi përgjithësues* është i dallueshëm, ai lind në çastin kur shfaqet një individ/send që bëhet përfaqësues i tërë klasës ose veprime, gjendje a ide që i referohen individëve/sendëve që përfaqësojnë llojin, klasën. Në të kundërt, në rastin kur individ/i sendi është i përcaktuar e mund të shërbejë për të treguar dikë/diçka të veçantë, të dalluar nga të tjerët të po asaj klase ose një gjendje, veprim a ide të veçantë, referuar individëve/sendëve specifikë, atëherë kemi të bëjmë me përdorime me *kuptim të individualizuar*.

Por, vetëm përdorimi mund të shmangë ambiguitetin e mund të përcaktojë nëse një njësi gjuhësore e caktuar ka *kuptim përgjithësues* a *të individualizuar*. Konteksti luan një rol të rëndësishëm për këtë dallim. Për këtë arsye, që në titull të punimit, *kuptimin përgjithësues* e kemi quajtur *kuptim përgjithësues kontekstor*.

²⁹ «Faire une phrase générique c'est énoncer une propriété qui appartient à un genre donné» M. Galmiche, *Phrases, syntagmes et articles génériques*. In: *Langages*, 20^e année, n°79, 1985. Générique et généricité, f. 14

³⁰ Y. Kuroda (1973): «J'appelle une phrase «générique», si le jugement qu'elle exprime concerne un certain état de chose général, habituel ou courant, et «spécifique» si le jugement qu'elle exprime se réfère à une occurrence particulière d'un événement ou d'un état de choses» (p. 188)

KREU II

TRAJTIMI I KUPTIMIT PËRGJITHËSUES NË GJUHËSINË SHQIPTARE

Siç e kemi thënë edhe në parathënie të punimit, *kuptimi përgjithësues* është një kategori e njohur në letërsinë gjuhësore shqiptare, por e trajtuar në mënyrë të fragmentuar. Po sjellim në këtë krye të gjitha çështjet e ndeshura që lidhen me kuptimin përgjithësues.

2.1 Emri

Gramatika e Akademisë (1995) njihet përdorime të emrit me *kuptim përgjithësues*. Kuptimi përgjithësues shihet në G.A., madje edhe si një syth më vete: *Trajta e shquar me kuptim përgjithësues*.³¹ Gjithashtu, njihen këtu dhe raste të përdorimit të trajtës së pashquar me kuptim përgjithësues: “Po emri i shoqëruar me një mund të përdoret nganjëherë edhe me kuptim përgjithësues, çka është tipike, siç e thamë, për trajtën e shquar..” (f. 130). G.A. e sheh kuptimin përgjithësues si një vlerë të veçantë që merr emri, jashtë caqeve të kategorisë së shquarsisë.

Shaban Demiraj në artikullin “Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe”, Studime Filologjike, 1969/4, bën fjalë ndër të tjera dhe për përdorimin e emrit të

³¹ Emri i përgjithshëm në numrin njëjës mund të përdoret në trajtën e shquar edhe me një kuptim tjetër, të ndryshëm nga kuptimi themelor i shquarsisë për të cilin u fol deri këtu. Është fjala për përdorimin e tij me kuptim përgjithësues. Në këtë përdorim trajta e shquar e karakterizon sendin si diçka që simbolizon klasën së cilës i përket. Nëpërmjet një frymori ose sendi të caktuar përfaqësohet tërë klasa e frymorëve ose sendeve që kanë tipare të përbashkëta me të.

Trajta e shquar me kuptim përgjithësues përdoret mjaft në gjuhën shqipe dhe jo vetëm në emra që tregojnë lloje ose klasa sendesh, por edhe në emrat e lëndës, emrat abstraktë etj...” f. 127

përgjithshëm me kuptim të përgjithësuar. Duke folur për kuptimin e caktuar/e pacaktuar Demiraj shpjegon: "... kjo kundërvënie kuptimore nuk mund të përftohet atëhere kur një emër i përgjithshëm përdoret për të emërtuar mbarë klasën përkatëse, dmth, kur përdoret me një kuptim të përgjithësuar (kategorial). Një emër me kuptim të përgjithësuar, qoftë në trajtë të pashquar ose në të shquarën, është kuptimisht i caktuar;" (f. 27)

E kemi ndeshur kuptimin përgjithësues të emrave dhe në Gramatikën Praktike (Çeliku, Karapinjalli, Stringa, 2007). (Bëhet e qartë përmes shembujsh, si *Një mësues i kulturuar nxjerr nxënës të kulturuar. Qeni (çdo qen) është kafshë shtëpiake* etj. (f. 24, 31) që emrat si të shquar, si të pashquar njohin këtë përdorim.)

2.2. Nyja

Kostaq Cipo në "Sintaksa" 1952, në kapitullin *Vërejtje rreth pjesëve të ligjëratës*, në sythin *Nyjët* shpjegon përdorime të nyjës së shquar dhe nyjës së pashquar (*nyjë, ca*). Nyjës së shquar Cipo i njeh faktin që paraqet një individ a gjë të njohur, të përcaktuar dhe nyjës së pashquar i njeh paraqitjen në përgjithësi, "si një midis shumë tjerësh". Mes fjalëve që shquhen Cipo përmend: "Marrin nyjë edhe tër' emrat që tregojnë gjini a farë në tërsin' e tyre. P.sh. *Njeriu* (= tërë njerëzit) ka mënt e shqisë; *peshku* rron n'ujë (d.m.th tërë peshqit); *poeti* këndon me zë të bukur fitoret e popullit të vet (çdo poet); *libri* është miku më i mirë i punëtorit (d.m.th. tërë librat e mirë) etj. Marrin nyjë të çquar edhe tërë shumësit kur tregojnë një tërësi. P.sh. *Filosofët* dhe *shkencëtarët* rrahin të gjejnë të vërtetën; (d.m.th. sa filosofë e shkencëtarë që ka bota.)" (f. 22)

Ndërsa Çeliku, në artikullin *Kontribut për dy probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Studime filologjike, 1971/1, pasi bën një pamje të përgjithshme të shkurtër mbi trajtimin e nyjave nga Kristoforidhi, S. Frashëri, A. Xhuvani etj., veçanërisht të nyjave të prapme, veçon edhe funksionin e nyjave të shqipes: "funksioni shques e joshques, kufizues (i quajtur edhe veçues, individualizues), përgjithësues, formëformues, funksion lidhës, funksioni fjalëformues, funksioni i një pronori, funksioni i të shprehurit të një tërësie të përcaktuar etj." (f. 46)

Në këtë artikull Çeliku ndalet edhe në funksionin e mbaresave të lakimit të shquar në gjuhën shqipe, duke dhënë përdorimet kryesore të trajtës së shquar.

“Përsa u përket funksioneve të së ashtuquajturës nyja të përparme (funksion individualizues, kufizues, veçues etj.) duhet thënë se këto në thelb nuk janë funksionet e nyjës. Nyja shquese ka vetëm një funksion kryesor: *të shquajë emrin*. Ato që janë parë gjer tani si funksione të veçanta (funksion individualizues etj.) përbëjnë *përmbajtjen e kuptimit* e këtij funksioni, ato tregojnë si e shquan nyja emrin. Emri në gjuhën shqipe është i shquar atëherë kur sendi që tregon ai është i vetëm ose në një situatë të caktuar mendohet si i vetëm në ndërgjegjen e folësit e të bashkëbiseduesit e në këtë rast ai merr mbaresë shquese.” (Çeliku, 1971/1, 52)

Më tej Çeliku vazhdon duke theksuar dhe kuptimin përgjithësues të trajtës së shquar. “Pra, mbaresa shquese nuk ka vetëm aftësinë të shprehë shquarjen e një sendi të veçantë, ajo ka edhe aftësinë të përgjithësojë nëpërmjet një sendi të veçantë gjithë llojin, d.m.th të nënkuptojë gjithë tërësinë e sendeve të tilla. Në këtë rast mbaresa shquese nuk kufizon kuptimin e përgjithshëm të një sendi, pra nuk e ngushton kuptimin e një sendi deri në kufijtë e një sendi konkret (si në fjalinë *Kali* i ri ushqehet me jonxhë), por zotëron cilësinë e kufizimit të një klase sendesh kundrejt klasave të tjera. Në këtë rast funksioni i mbaresës shquese është *funksion përgjithësues*.” (Çeliku, 1971/1, 53)

Pasi bën një paraqitje të rasteve më tipike të përdorimeve të trajtës së shquar, raste që, sipas nesh, tregojnë funksionin individualizues të mbaresës shquese, Çeliku i rikthehet kuptimit përgjithësues duke konkluduar: “Emrat në këtë kuptim përdoren gjerësisht. Si të tillë dalin jo vetëm emrat që kanë kuptimin e gjinisë, llojit (kafshë, lule, bimë, metale etj.), por edhe fjalë abstrakte.” (Çeliku, 1971/1, 57)

Përsa i takon nyjave *një* dhe *ca (disa)* Çeliku veçon: “Në letërsinë e huaj gjuhësore dhe në atë shqipe nyjës joshquese përgjithësisht i njihen dy funksione, e pikërisht funksioni dallues dhe funksioni përgjithësues. Siç dihet, nyja joshquese *një* ka funksion dallues kur shërben për të dalluar një send të vetëm nga gjithë klasa e tij e përbërë nga sende të njëjta, të ngjashme, pra, nga shumë sende të njëjta dallohet një send.... Emri i pashquar i prirë nga

nyja *një* ka edhe kuptim përgjithësues, një emër në njëjës përfaqëson të gjithë klasën (por jo një send të veçantë).” (Çeliku, 1971/1, 57-58)

Sipas Çelikut “emri i pashquar me *një* mund të zëvendësohet nga emri në trajtë të shquar, përkundrazi emri i shquar nuk mund të zëvendësohet nga emri i pashquar me *një*,” (Çeliku, 1971/1, 58)

Çeliku, duke qenë një nga njohësit e parë të nyjës së shumës *ca*, nuk tregon funksionin e saj. Ai i njeh shpesh formë zero nyjës joshquese të shumës dhe këtë e shpjegon me faktin e vetë treguesve të qartë morfologjikë (mbaresa ose mjete flektive) që ka emri në numrin shumë.

2.2.1. Nyja zero

“Mungesa e nyjave është po aq e rëndësishme sa edhe prania e tyre. për këtë arsye mungesa e rëndësishme e nyjës në letërsinë e huaj gjuhësore është quajtur nyjë zero.”³²

Çeliku është i mendimit se edhe nyja zero duhej të ishte parë si element i sistemit të nyjave të shqipes. Ajo i kundërvihet si nyjës shquese e joshquese. Për emërtimin *nyjë shquese* Çeliku mendon zëvendësimin me *mbaresë shquese*. “Në emrin vajzë të fjalisë Unë nuk kam vajzë tregohet një person (në kuptimin e gjerë një send) i menduar në mënyrë abstrakte, në kuptimin e tij më të përgjithshëm. Në këtë fjali emri vajzë përfaqëson tërësinë e tipareve të klasës së vajzave të marrë në mënyrë abstrakte. Ky kuptim i emrit jepet jo me mbaresë shquese, as me nyjë joshquese, por me nyjë zero dhe me mbaresën joshquese (që në rastin e dhënë është zero). Në këtë rast mungesa e mbaresës shquese dhe e nyjës joshquese është e rëndësishme dhe nuk shpjegohet dot me stilin konciz.

Futja në përdorim e nyjës joshquese ose e mbaresës shquese në emrin *vajzë* (në fjalinë Unë nuk kam *vajzë*) është e pamundur, në raste të tjera futja e tyre do të ndryshonte kuptimin.” (Çeliku, 1971/1, 68)

³² M. Çeliku, artikull i cituar, f. 67

Çeliku jep në vazhdim rastet më kryesore të përdorimit të emrit me një zero në gjuhën shqipe. Ai dallon emrin me një zero nga emri me mbaresë shquese (*Agimi u emërua mësues. Mësuesi nderohet nga të gjithë.*) Sipas Çelikut në rastin e parë “emri mësues përfaqëson tërësinë e tipareve të klasës së mësuesve; folësi në këtë rast do të thotë se Agimi u emërua mësues e jo gjë tjetër, pra në plan të parë del profesioni që do të ushtrojë Agimi. Në rastin e dytë emri mësuesi përfaqëson jo një mësues të veçantë, por gjithë klasën e mësuesve, të gjithë mësuesit dhe folësi kërkon të vërë në dukje se çdo mësues (të gjithë mësuesit) nderohen.” (Çeliku, 1971/1, 69-70)

2.3. Fjalitë njëkryepërbërëse³³

Çeliku është gjuhëtari që i ka trajtuar gjerësisht e sistematikisht fjalitë njëkryepërbërëse³⁴. Fjalitë njëkryepërbërëse i takojmë në gjuhësinë shqiptare me emërtimin *fjali njëkryegjymtyrëshe*, por M. Çeliku (2012) e ka zëvendësuar këtë term me *fjali*

³³ Si kategori e veçantë sintaksore fjalitë njëkryepërbërëse trajtohen për herë të parë në “Librin e gjuhës shqipe për klasën VII”, 1971, tekst me bashkautorë, hartuar nën drejtimin e M. Totonit. Më herët, këto fjali janë parë si fjali eliptike, mungesore nga K. Cipo në “Sintaksa”, Tiranë 1952, si dhe M. Domi, te “Gramatika e gjuhës shqipe”, sintaksa (pjesa e dytë), Tiranë 1954.

³⁴ M. Çeliku në artikullin “Tipat kryesorë të fjalive njëkryegjymtyrëshe në gjuhën shqipe”, në “Lëndët e shkencave shoqërore në shkollë”, Tiranë 1974/10, sjell larinë strukturore e kuptimore të *fjalive njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar*. Po kaq të zgjeruar do ta gjejmë këtë tip fjalie edhe në dispensën e M. Çelikut “Sintaksa e gjuhës së sotme shqipe”, (leksione), shaptilografim i vitit 1977 dhe një tjetër kopje e njëjtë me të e vitit 1980, si dhe në Sintaksën e Akademisë (kapitulli i fjalive njëkryegjymtyrëshe në Gramatikën e Akademisë është hartuar nga M. Çeliku). I gjejmë këto lloje fjalish edhe në: Çeliku, Karapinjalli & Stringa, “Gramatika praktike e gjuhës shqipe”, 1998, vepër me bashkautorë; Mehmet Çeliku, “Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde” (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura), Tiranë 2007, 2008, 2016; M. Çeliku, “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)” (vështrim i ri teorik), Tiranë 2012.

Çeliku, në to, saktëson ç’është fjalia njëkryepërbërëse, paraqet rëndësinë e njohjes së saj si një pasuri e strukturës gramatikore të shqipes, por edhe si një mjet i posaçëm kuptimor e stilistik, e aftë të na përcjellë nuancime që fjalia dykryepërbërëse nuk mund të na i përcjellë, bën një trajtim të plotë për të gjitha ndarjet e nëndarjet e saj, dallimet strukturore e kuptimore dhe nuancimet stilistike. Autori ndal edhe në rastet e mospërdorimit të fjalisë dykryepërbërëse në vend të asaj njëkryepërbërëse, si dhe rolin e rëndësishëm të kontekstit për të përcaktuar drejt llojet e fjalisë njëkryepërbërëse. Çeliku sjell një larmi tipash strukturore për tipa të caktuara fjalish, “të paktën 15 tipa fjalish njëkryepërbërëse foljore” (Çeliku, 2012, 14) dhe të gjitha këto shoqëruar me një material të bollshëm ilustrues që i takon sferave të ndryshme të përdorimit të gjuhës.

njëkryepërbërëse në kundërvënje me termin *fjali dykryepërbërëse*: “Termi *fjali njëkryepërbërëse* rezulton më i përshtatshëm sesa ‘njëkryegjymtyrëshe’, që kemi përdorur më parë sepse në këtë strukturë nuk bëhet fjalë për gjymtyrë kryesore, as për kryefjalë, as për kallëzues.” (Çeliku, 2012, 13)

Kuptimin përgjithësues e kemi ndeshur te fjalitë *njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar*, të cilat shihen si fjali që shprehin veprime që u përkasin të gjithëve dhe foljen e kanë zakonisht në vetën II njëjës. Këto fjali takohen shpesh në fjalët e urta, proverba, thëniet e njerëzve të shquar etj. Çeliku bën dhe një krahasim të *fjalive njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar me fjalitë njëkryepërbërëse me vetë të papërcaktuar* duke pohuar afrimin “... deri-diku nga kuptimi. Megjithatë në fjalitë me vetë të përgjithësuar veprimi i shprehur nga folja merr një karakter të ndjeshëm përgjithësues. Në fjalitë me vetë të papërcaktuar personat veprues janë më të kufizuar: nga ata duhet përjashtuar të paktën folësi, ndërsa te fjalitë me vetë të përgjithësuar nuk përjashtohet as folësi.”³⁵

Në përfundim, Çeliku është i mendimit se “në se kemi apo jo fjali me vetë të përgjithësuar në shumë raste kërkohet të kihet parasysh një kontekst relativisht i gjerë”.³⁶

2.4. Veta

Për *fjalitë njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar* Çeliku jep shpjegimin: “*Fjali me vetë të përgjithësuar* quhen ato fjali njëkryegjymtyrëshe që shprehin veprime që u përkasin të gjithë njerëzve e që foljen e kanë zakonisht në vetën e dytë numër njëjës. Në këto fjali folësi nuk i drejtohet një personi të caktuar, veprimi i shprehur nga folja e vetës II kryhet nga një vetë e përgjithësuar, ku mund të përfshihet edhe vetë folësi.”³⁷ Autori flet më tej

³⁵ Çeliku, po aty, f. 300

³⁶ Po aty, f. 34

³⁷ M. Çeliku, “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980, (leksione), f. 33.

Në Gramatikën e Akademisë (sintaksa) shpjegohet se veta dytë “nuk tregon bashkëfolësin, po njerëz në përgjithësi, ku mund të përfshihet bashkëbiseduesi, por edhe vetë folësi.”

për vetat që bartin kuptim përgjithësues, ku krahas vetës së dytë njëjës gjen përdorim me kuptim përgjithësues edhe në “vetën e parë shumës të dëftores e lidhores së tashme”³⁸, në “vetën e dytë shumës në mënyrën urdhërore”³⁹ të cilën e takojmë në tekstet mësimore. Për këto raste Çeliku shprehet: “Kuptimi përgjithësues i këtyre fjalive nuk del aq qartë sa në rastin e fjalive njëkryegjymtyrëshe me kallëzues në vetën II njëjës.”⁴⁰ Evidentohet veta e dytë numër njëjës si vetë e përgjithësuar dhe në “Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (Morfologjia)”, Tiranë 1995, “Veta e dytë njëjës përdoret edhe me kuptim vetor të përgjithësuar:” (f. 267) dhe në “Gramatika praktike e gjuhës shqipe”, M. Çeliku, M. Karapinjalli, R. Stringa, (1998, 394).

Veçon këtë përdorim dhe Ludmila Buxheli në “Foljet njëvetore në gjuhën shqipe”, Tiranë 2011. Përmes shembujsh Buxheli argumenton se folësi përmes përdorimit të vetës së dytë njëjës me kuptim përgjithësues “nuk ka parasysh vetëm bashkëbiseduesin, por njerëzit në përgjithësi, shprehja e kryefjalës me përemrin e vetës së dytë njëjës në rasën emërore është e pamundur. Futja e kryefjalës do ta ndryshonte kuptimin e vetës së dytë, si në (3b): *Nëse ti punon sot, do të shplodhesh mot.* (Kuptim vetor i papërgjithësuar).” (2011, 18-19)⁴¹

Ndërsa Remzi Përnaska, në “Gjuhësi... .. gjuhësore” I, Maluka (mungon viti i botimit), pohon: “TI përgjithësuese “personalizon” thënie pavetore (impersonale) me vlerë të përgjithshme. Në këtë rast, lidhja me situatën e të thënit mbetet e gjallë, bashkëthënësi i përfaqësuar nga “TI përgjithësuese” jepet sikur të merrte pjesë në proces, si viktimë, përfitues, etj. Për të mos u zgjatur në këtë pikë, le të analizohet një thënie e dykuptimshme

³⁸ G.A. (sintaksa), f. 385

³⁹ Po aty

⁴⁰ G.A. (sintaksa), f. 385

⁴¹ Vë në dukje Buxheli këtu dhe përdorimin e vetës së tretë shumës që përveç kuptimit të mirëfilltë, në struktura të veçanta përdoret dhe me kuptim *vetor të papërcaktuar*. Për këtë sjell shembujt: “4. a) *Thonë* se do të ketë shira gjatë verës, por nuk e besoj. (*thonë* = kuptim vetor i papërcaktuar) 4. b) Ata *thonë* se do të ketë shira gjatë verës, por nuk e besoj. (*thonë* = kuptim vetor i përcaktuar). Periudha në (4a) gjithashtu nuk ka kryefjalë as në fjalinë drejtuese, as në fjalinë e varur. Në (4a) folja *thonë* nuk mund të ketë kryefjalë të shprehur me një emër ose përemër të vetës së tretë shumës, sepse veta së cilës i referohet kjo folje vërtet përfaqëson persona jo të pranishëm gjatë ligjërimit, për të cilët bën fjalë folësi, por ata janë të papërcaktuar, nuk dihet konkretisht se cilët e kryejnë veprimin e emërtuar nga folja. Futja e kryefjalës në fjalinë drejtuese, do të ndryshonte kuptimin e vetës së foljes *thonë* dhe të fjalisë në përgjithësi, si në (4b).” Vepër e cituar, f. 29

si kjo: *Me njerëz të tillë ti çan malet*. Në njërin kuptim, TI do të thotë bashkëbiseduesi, në tjetrin merr vlerën *kushdo, gjithsecili*, etj., ndër ta edhe bashkëbiseduesi.” (f. 208)

2.5. Sifjalitë ndërtuar me lidhore

Në Gramatikën e Akademisë, 2⁴² (1997, 2002) dhe te M. Domi (1970) gjejmë sifjalinë e varur *lejore përgjithësuese*, ndërtuar kryesisht me mënyrën lidhore (*Gënjeshitari, sado mjeshtëri të ketë, mbetet gënjeshhtar.*) Takojmë gjithashtu dhe sifjalinë kryefjalore për të cilën Domi shpjegon: “Fjalitë kryefjalore lidhore dalin në gjithë stilet e gjuhës; përdorim veçanërisht të dendur kanë ato në të folmen popullore; kjo është mjaft e pasur në fjalë të urta e maksima, që, nga përmbajtja e tyre, kërkojnë një shprehje abstrakte, të përgjithësuar, pa kryefjalë vetore të caktuar, prandaj u vinë mjaft për shtat fjalitë kryefjalore lidhore.” (f. 58)

Ndërsa Çeliku (2008, 70) sheh të përdoret gjerësisht *lidhorja me kuptim përgjithësues*. Po ashtu dhe G.A.: “sidomos në disa lloje fjalish të varura si: a) fjali të varura kryefjalore (folja është më tepër në të tashmen, më rrallë në të pakryerën): fjalia kryesore e periudhës ka zakonisht kallëzues emëror të tipave: *është e vështirë, është e kotë, nuk është mirë, është një gjë e domosdoshme* etj., një kallëzues të shprehur me folje pësore:... b) fjali të varura kushtore.”⁴³. Sheh Çeliku përdorim të lidhore me vetë të përgjithësuar “edhe në fjalitë që kanë karakterin e pyetjeve retorike.”⁴⁴, apo fjalitë pyetëse me kuptim mohues. Sipas tij “Një përdorim jashtëzakonisht të madh ka fjalia “ku ta dish” duke qenë kuptimisht

⁴² “Periudhat me fjali të varur lejore përgjithësuese tregojnë se, me gjithë shfaqjen e skajshme të veprimit, të gjendjes a të tiparit të shprehur në fjalinë e varur, nuk pengohet realizimi i veprimit a i gjendjes së shprehur në fjalinë drejtuese. Pra, pengesa shfaqet a supozohet të shfaqet me shkallën, a masën e skajshme të një veprimi, ose të një tipari, me natyrën e përgjithësuar të një rrethane, me karakterin e pacaktuar të një vete a sendi.

Veçoritë e fjalive lejore përgjithësuese është se lidhen me fjalinë nga e cila varen, me ndajfolje me kuptim të përgjithshëm, të pacaktuar, të pasuar pandërmjetshëm ose në largësi nga një *që* ekspletive, ose dhe pa *që*: *sado që, sado... (që), sido që, sido... (që), kurdo (që), kudo (që)*: me përemra lidhorë të pacaktuar; *kushdo që, cilido që, çfarëdo që*.

Veçori tjetër e këtyre fjalive është se ndërtohen kryesisht me mënyrën lidhore dhe, më rrallë, me mënyrën dëshirore, të cilat, bashkë me mjetin lidhës, i japin fjalisë kuptimin e përgjithshëm, të pacaktuar. Fjalitë lejore përgjithësuese më të shumtën nuk e kanë kryefjalën të shprehur. Kur ajo shprehet, vihet pas kallëzuesit.” G.A., 2, f. 598-599.

⁴³ Gramatika e Akademisë, sintaksa, f. 385

⁴⁴ “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980, f. 34

sinonimike me fjalitë “nuk dihet” “nuk mund ta dish” “ku i dihet”. Fjalja ku ta dish, funksionon si e pavarur si pjesë kryesore ose e varur dhe si fjali e ndërmjetme.”⁴⁵

2.6. Fjalitë dykryepërbërëse

M. Çeliku pranon dhe shfaqjen e vetës së përgjithësuar në fjalitë dykryepërbërëse, ndonëse rrallë, kur kemi kryefjalë një përemër vetor të vetës së dytë njëjës, i cili, sipas tij, humbet disi karakterin përgjithësues të fjalisë.⁴⁶ Kryefjala me kuptim përgjithësues e shprehur në fjalitë dykryepërbërëse zgjerohet nga Çeliku (1980) dhe me emrin e shquar *njeriu*. Sipas Çelikut “Këtu kemi një kryefjalë formale, sepse ajo nuk tregon një person konkret, por përdoret për të treguar një person të përgjithësuar. Në krahasim me disa gjuhë të tjera, në gjuhën shqipe ky tip është më i rrallë.”⁴⁷ Idenë e kryefjalës me kuptim përgjithësues e gjejmë sërish në Gramatikën e Akademisë (sintaksa), në kapitullin për kryefjalën: “Përemri vetor i vetës II njëjës si kryefjalë mund të ketë dhe kuptim të përgjithësuar:” (f. 169)

Kostaq Cipo në “Sintaksa” 1952, në kapitullin *Fjalja (Pjesët kryesore të fjalisë)* në sythin *Trajta pavetësore e subjektit*⁴⁸ sjell dhe shembullin e vetës së dytë njëjës si një subjekt të pacaktuar (*ta shikoje sy nër sy, të zinte data.*)

⁴⁵ Po aty, f. 36

⁴⁶ Moderon këtu qëndrimin e tij shfaqur në “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, (leksione), 1980, sipas të cilit: “Vënia e kryefjalës në fjalitë njëkryegjymtyrëshe vetore me vetë të përgjithësuar shkel natyrën e tyre dhe i kthen ato në fjali të zakonshme dykryegjymtyrëshe; në këtë mënyrë karakteri përgjithësues i tyre humbet.” (f. 34)

⁴⁷ Po aty, f. 37

⁴⁸ “Kur kemi për të shprehur një subjekt të pacaktuar si atë që Gjermanët e kanë me “man”, Frëngjtë me “on”, dhe Italianët me “si” ne shqiptarët, një subjekt të tillë, munt ta shprehim me gjithfarë mënyrash. Këto mënyra të ndryshme të foluri janë: a) *përemri pyetës: kush? cili? cila?* P. sh Kush munt të shtjerë në duart e harresës një ditë kaqë të shënuar si dita e çlirimit të Shqipërisë? Cili ju nga të pranishmit munt të mburret se di të flasë e të shkruaj çpënguar dhjetë gjuhëra? a) *emërorët: një, kush, nonjë, ndokush, njerës:* p. sh Atë që kërkon ti s’ka dhjetë minuta që qe këtu, po të nxitojë nonjë munt ta zërë rrugës pa sosur akoma në shtëpi; harron kush një të tillë dëfrim? Ka akoma njerës që bëjnë të tilla marrëzira? c) me anë të vetës së dytë të njëjës: P. sh *ta shikoje sy nër sy, të zinte data*; ç) me anë të vetës së tretë shumës të foljeve veprorë, kur nënkuptohen *shumë vetë, botë, popull, shumicë, rrëmet*, shkurt kur nënkuptohet një kolektivitet. P.sh. vanë ta urojnë se kish fejuar të birin; deshnë ta marrin me vet, po nuk dëgjo; d) me anë të vetës së tretë njëjës të foljeve pësore. P.sh. thuhet se ka ardhur një mjek i çquar nga Bashkimi Sovjetik; flitet për rrethet mjekësore se ka rënë sëmundja e lisë; pëshpëritet posht’ e lartë se sivjet do të kemi një eklips të diellit, d.m.th. do të zihet dielli.” (f. 61)

Stefan Prifti në “Sintaksa e gjuhës shqipe”, Prishtinë 1958, në kapitullin IV, Gjymtyrët kryesore të fjalisë, në përkufizimin e kryefjalës (subjektit) sjell shembuj dhe arsyeton mbi dallimin që ka një kryefjalë në përgjithësi (*Lulet u çelën. Njeriu arsyeton. Kafsha s’gjykon. Dituria është forcë. Padija është errësirë. Lufta është mjerim.*) nga një e përcaktuar (*Lulet e kopshtit tim çelën*). Për kryefjalën e përcaktuar Prifti sjell idenë se përcaktimi vjen përmes pranisë së fjalëve të tjera rreth kryefjalës. (Prifti, 1958, 51) Më tej, në çështjen se me se shprehet kryefjala, Prifti njeh sërish kryefjalën si një emër i përgjithshëm, kolektiv apo i veçantë. Ai na njeh dhe me rastet e mungesës së kryefjalës, ndër të tjera me rastin kur brendia e kryefjalës është e papërcaktuar dhe si kryefjalë nënkuptohet: njerëzit, bota etj. (Thonë në Mars ka jetë. (1958, 58))⁴⁹.

2.7. Kundrinori

Takojmë kuptimin përgjithësues edhe te Remzi Përnaska në artikullin “Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe”, botuar në Studime Filologjike, 1983/4. “Në gramatikat e gjuhës shqipe, të botuara pas vitit 1970, flitet edhe për fjali njëkryegjymtyrëshe. Lloji më i rëndomtë i fjalive njëkryegjymtyrëshe është ai gjymtyra kryesore e të cilit është shprehur me folje vetore. Fjalitë me një gjymtyrë kryesore të shprehur me folje në trajtë vetore, vetën mund ta ketë të përcaktuar, të papërcaktuar, të përgjithësuar. Veta të tilla, sigurisht ndonjëherë me largime jo të parëndësishme, njeh dhe kundranori. Nuk është vendi të ndalemi këtu te veçantitë e kategorisë gramatikore të vetës te kundranori, vetëm se do të japim një ndërtim të pavënë nga studiuesit. Kështu, p.sh. kur kushtet ligjërimore plotësohen, “trajta e shkurtër e përemrit vetor të vetës së dytë njëjës” shenjon një kundranor me vetë të përgjithësuar⁵⁰, si te shembujt e mëposhtëm: *Urtësia e popullit gjithnjë të befason*, Drita, 12 dhjetor, 1982, f. 1; *Atij që nuk të do, po t’i japësh majëzën e thoit, të*

⁴⁹ Gjejmë të njëjtin qëndrim dhe te M. Domi Gramatika e gjuhës shqipe (pjesa e dytë, sintaksa), Tiranë, 1954, f. 26.

⁵⁰ I referohet kësaj çështjeje dhe prof. Thoma Dhima në artikullin “Kundrinori në sintaksën e Cipos dhe disa probleme që lidhen me të.”, mbajtur në Konferencën Gjuhësore Elbasan për veprimtarinë e Kostaq Cipos, më qershor 2012.

rrëmben gishtin, në i dhënsh gishtin **të** merr dorën; po i dhe dorën, **të** merr trupin dhe po **të** kapi trupin, **të** mori shpirtin.(N. Bulka, Legjenda e një fisi, Tiranë, 1966, f. 6)”⁵¹

2.8. Fjalitë pavetore

Stefan Prifti (1958) qëndron në raste të mungesës së kryefjalës në përdorime të foljeve njëvetore: “Një numër foljesh intranzitive, në formë pësore si: *rrihet, shkohet, vihet, iket, flihet, jetohet* etj., si dhe folje të tjera tranzitive, që merren në trajtën pësore të vetës së tretë njëjës, si: *hahet, këndohet, punohet* etj.” (Prifti, 1958, 59) Prifti shpjegon për këto raste se kryefjalë mund të merret dhanorja, të cilën nuk e konsideron kundrinë, por *plotësor kufizimi* (S’më rrihet) dhe e quan gjithashtu edhe *kryefjalë logjike*. Krahas tyre Prifti njih rastin kur këto folje “mund të shprehen edhe në mënyrë absolute pa *kryefjalë logjike* apo pa *plotës kufizimi të vetës*. P.sh. S’rrihet vetëm në majë të malit. – S’punohet kështu, si bëni ju. Në këto raste kryefjala logjike ose plotësori i kufizimit mungon, sepse folja thuhet me kuptim *të përgjithshëm*, prandaj këtu nënkuptohet dhanorja e një fjale të përgjithshme, si: njeriu, robi, kush etj. p.sh. S’i rrihet njeriut (kujt) vetëm në majë të malit.” (Prifti, 1958, 59)

Përdorime të disa foljeve jokalistare në formë joveprorë të shoqëruara ose jo me një pjesëz mohimi, si: *s’skohet, s’rrihet, s’lyhet, s’rrohet, s’flitet* etj. i njeh dhe Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (1995): “Këto folje pavetore mund të përdoren edhe pa pjesëzën e mohimit, sidomos në fjali pyetëse. Foljet pavetore të këtij tipi jo vetëm që emërtojnë veprime në mënyrë të përgjithësuar, pa vetë të caktuar, por shprehin edhe ngjyrimin modal të mundësisë, ndonjëherë atë të detyrimit. Kështu, *Këtej s’kalohet* është e barazvlershme me fjalinë *Këtej s’**mund** (a s’**duhet**) të kalojë njeri.*” (G.A, 1995, 269)

⁵¹ Përnaska, artikull i cituar, f. 194. Më tej, në të njëjtin artikull të cituar, R. Përnaska, duke dashur të rishikohet statusi sintaksor i kundrinorit tregon dhe për përdorimin e trajtës së shkurtër të përemrit vetor. “Është me interes të vihet re se “trajta e shkurtër e përemrit vetor” në përdorime të tilla (në përdorime si kundrinor i përgjithësuar – shënimi ynë), nuk mund as të “përsëritet” ndonjë “trajtë të plotë të përemrit vetor”, as të “përsëritet” nga ndonjë “trajtë e plotë e përemrit vetor”, pra nuk mund të kemi kursesi përdorim të njëkohshëm të kundrinorit me vetë të përgjithësuar, e të shenjuesit të vet “trajtë e shkurtër e përemrit vetor të vetës së dytë njëjës”. (f. 194)

Ludmila Buxheli (2011), në kreun *Tipat e foljeve njëvetore të strukturës sipërfaqësore*, shpjegon se këto folje, të cilat kanë përgjegjëset e tyre trevetore, janë pa argument të jashtëm, por vetëm në strukturën sipërfaqësore. Ndonëse ai nuk shprehet fonetakisht, ai ekziston dhe është një *veprues me kuptim të përgjithshëm ose gjenerik*. “Që argument i jashtëm i foljeve njëvetore të tipit *flihet, rrohet, jetohet* etj. ekziston, por është mënjeluar nga struktura sipërfaqësore, e provon fakti që ai është i pranishëm si një veprues me kuptim të përgjithshëm ose gjenerik, i cili mund të përcaktohet ose si një njeri i vetëm ose si një grup njerëzish, por i nënkuptueshëm në strukturën sipërfaqësore. Për pasojë, struktura argumentore e foljeve të tipit *punoj/punohet, rri/rrihet* nuk ka pësuar asnjë ndryshim. Në të dy nivelet strukturore kemi të bëjmë me të njëjtën strukturë argument, me folje me një argument të jashtëm, i cili te foljet e tipit *punohet, rrihet* ekziston, por i **mungon** strukturës sipërfaqësore...” (Buxheli, 2011, 147) Këto folje Buxheli i sheh me tiparin [+HUMAN] ku kryefjala “bart rolin semantik të një vepruesi [+HUMAN] me kuptim gjenerik, i cili nuk mund të realizohet fonetakisht as me një SE në rasën emërore, as si plotës i shprehur me një sintagmë parafjalore.” (f. 190)

Buxheli, referuar dhe *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II* Tiranë, 1976 dhe Gramatikës së Akademisë veçon dhe rastet kur forma pavetore e foljes në lidhore mund të zëvendësohet nga lidhori veprorë e vetës së dytë njëjës me kuptim përgjithësues: *Vetëm me ujin nuk mund të jetohet; vetëm me ujin nuk mund të jetosh.* (f. 201)

Edhe Çeliku përmend vetën e përgjithësuar në ndërtimet e mësipërme në të gjitha veprat e cituara më lart: “Ndërtimi mund + lidhore veta II njëjës me vlerë të përgjithësuar herë-herë përdoret në gjuhën letrare shqipe paralelisht me ndërtimin pavetor mund + lidhore veta III njëjës veprorë. Nuk *mund të luftoje* me sukses dhe të arrijë fitore kundër nazistëve gjermanë... Ky ndërtim përdoret paralelisht me ndërtimin: *Nuk mund të luftohet* me sukses dhe të arrihet fitorja kundër nazistëve gjermanë, pa luftuar njëkohësisht edhe kundër shërbëtorëve të tyre.” (Çeliku, 1980, 35)

2.9. Fjalitë e ndërmjetme

Krahas fjalive pavetore Çeliku gjen përdorime me kuptim përgjithësues dhe në fjalitë e ndërmjetme, duke menduar se ato “kanë shërbyer herë-herë si burim për përfundimin e

disa konstrakteve të qëndrueshme predikative e jopredikative.”⁵², që shprehim mohim apo pamundësi apo “që funksionojnë si rrethanorë, si edhe ndonjë pjesëz etj.”⁵³
Përdorime me kuptim përgjithësues vë re dhe M. Domi (1970).⁵⁴

2.10. Mënyrat e foljes dhe stilet e gjuhës

Folja me kuptim përgjithësues shpesh është në mënyrën urdhërore.”⁵⁵ Krahas mënyrës urdhërore, Çeliku njeh dhe mënyra të tjera të foljes së fjalive njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar si: dëftore dhe lidhore (si më të përdorshme) shoqëruar nga foljet modale *mund* e *duhet*. Për secilën nga mënyrat autori jep dhe përdorimin në stilet e gjuhës. “Fjalitë me foljen në mënyrën urdhërore i gjejmë kryesisht në stilin e letërsisë artistike; fjalitë me folje në mënyrën lidhore përdoren gjerësisht në stilin publicistik; ato me folje në mënyrën dëftore në të gjitha stilet.”⁵⁶ Çeliku mendon se *fjalitë njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar* i ndeshim më së shumti në thëniet e njerëzve të shquar, në fjalë të urta, në proverba, në sentenca, në formulimin e të vërtetave të përgjithshme etj.

⁵² M. Çeliku, “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980, f. 36

⁵³ Po aty, f. 37

⁵⁴ “Fjalitë e ndërmjetme të mirëfillta ngërthejnë një rreth pak a shumë të përcaktuar tipesh strukturore e semantike. Ato mund të dalin në formën e një fjalie dyshe (dykryegjymtyrëshe) të thjeshtë e të zgjeruar ose të një fjalie njëshe, me vetë të caktuar, me vetë të pacaktuar, me vetë përgjithësuese ose pavetore.” f.152

⁵⁵ Gramatika e Akademisë, sintaksa, f. 384.

⁵⁶ Po aty, f. 385

KREU III

NJËSITË LEKSIKO-GRAMATIKORE TË SHQIPES ME KUPTIM PËRGJITHËSUES. FAKTORËT GJUHËSORË DHE RRETHANAT LIGJËRIMORE NË TË CILAT REALIZOHET KUPTIMI PËRGJITHËSUES NË GJUHËN SHQIPE

3.1. Emri me kuptim përgjithësues

Për të hetuar përdorime të emrit me kuptim përgjithësues kemi marrë në shqyrtim të gjitha grupet leksiko-gramatikore të emrave: emrat e përgjithshëm e të përveçëm; emrat (e përgjithshëm) konkretë e abstraktë; emrat përmbledhës dhe ato të lëndës.

Studimi i kuptimit përgjithësues tek emrat është parë i lidhur ngushtësisht dhe me kategoritë e tjera të emrit, siç janë: shquarsia/pashquarsia, numri dhe rasa, të cilat do të na vijnë në ndihmë për përcaktimin e trajtave të emrit me kuptim përgjithësues.

Shqyrtimi formal, semantik dhe pragmatik bën të mundur që të paraqiten të gjitha vëzhgimet dhe konstatimet tona lidhur me përdorimet dhe kontekstet e përdorimit që lejojnë apo përjashtojnë interpretime përgjithësuese.

3.1.1. Emrat që referojnë dhe emrat që nuk referojnë (emra të llojit)⁵⁷

Para se të nisim shqyrtimin e rasteve të përdorimit të emrit me kuptim përgjithësues, bazuar në atë se çfarë emri emërton, ne kemi parë të nevojshme të bëjmë një grupim të emrave sipas titullit të mësipërm: *emra që referojnë – emra që nuk referojnë (emra të llojit)*.

⁵⁷ Për termat e dhëna jemi mbështetur në *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987, Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler ku emrat janë cilësuar si *emra që referojnë* një send/qenie ose *emra që nuk referojnë*.

Sipas G.A. (1995) emrat e përgjithshëm emërtojnë një klasë të tërë qeniesh të gjalla dhe sendesh sipas tipareve të përbashkëta të tyre, pra emërtojnë në mënyrë të përgjithësuar qeniet e gjalla dhe sendet e së njëjtës klasë, ose secilën prej këtyre qenieve e sendeve. (f. 82-83)

Në sythin *Kuptimi dhe përdorimi i trajtës së pashquar* vjen përcaktimi: “Në trajtën e pashquar emri përdoret kryesisht me kuptimin e tij më të përgjithshëm, abstrakt, si përfaqësues i një klase të tërë sendesh që formojnë një tip të vetëm në bazë të tipareve të tyre të përbashkëta. Atëherë emri paraqitet thjesht si një emërtim abstrakt, si veshje materiale e një nocioni të gjerë e të papërcaktuar. Në fjalinë *Unë nuk kam vëlla* emri *vëlla* emërton një klasë të tërë frymorësh si një tip abstrakt. Në fjalinë *Bisedova me vëllanë* i njëjti emër, i përdorur tashmë në trajtën e shquar, emërton një frymor të caktuar, të dalluar nga të tjerët.” (1995, 127)

Nisur nga sa më lart, mund të themi se emri në trajtë të pashquar *vëlla*, si emër me kuptimin e tij abstrakt, të përgjithshëm, si emër që tregon llojin, nuk referon në botën, realitetin jashtë një individ të caktuar, ndaj themi se është *emër i llojit*, ndërsa emri në trajtë të shquar *vëllanë* referon në botën, realitetin jashtë një frymor të caktuar, të dalluar nga të tjerët. Për këtë arsye themi se emri *vëllanë* është *emër që referon (i individualizuar)*.

Më tej, në G.A. vazhdohet: “Midis trajtës së pashquar dhe trajtës së shquar të një emri të përdorur me kuptim të përgjithësuar ka afri. Ndryshimi qëndron në këtë që në trajtën e shquar me vlerë përgjithësuese emri i përgjithshëm, nëpërmjet një frymori ose sendi të caktuar, që mbart në vetvete tiparet e tërë sendeve të klasës ku bën pjesë, përfaqëson gjithë këto sende. Në trajtën e pashquar, përkundrazi, emri i përgjithshëm del thjesht si emërtim i mbarë klasës së sendeve, të cilat bashkohen nga tiparet e tyre të përbashkëta.” (G.A., 1995, 127) dhe për të sqaruar më tej këtë sillet shembulli: *Puna e bën njeriun njeri*.

Siç vihet re, të dyja rastet e përdorimit të emrit *njeri* shihen si raste të përdorimit të emrit me kuptim përgjithësues, por me dallimet e tyre kuptimore. Emri i trajtës së shquar *njeriun* është emër me *kuptim përgjithësues* dhe përmes tij jo vetëm emërtohet tërësia e sendeve të njëjta të një klase, por edhe përfaqësohet ajo, çdo element i saj: *çdo njeri, secili prej nesh*,

njeriu në përgjithësi, çdo qenie njerëzore etj. Zëvendësimi është i mundshëm: Puna e bën çdo njeri njeri. Puna e bën secilin prej nesh njeri. etj. Ndaj, themi se është emër që referon (përgjithësues).

Ndërsa në rastin e dytë, emri i pashquar **njeri**, shihet si emërtim abstrakt i një klase me cilësitë e karakteristikat e veta, ka kuptimin e llojit të veçantë në përfaqje me klasat e tjera, por që nuk merr përsipër të përfaqësojë çdo individ të klasës. Përmes tij përfaqësohet tërësia e tipareve të sendeve të njëjta të një klase. Emri në të pashquar, me një zero nuk emërton një referent të caktuar, por karakteristika që i takojnë kategorisë së cilës i përket. Zëvendësimi që bëjmë më sipër është i pamundur: *Puna e bën **njeriun** çdo njeri. ??? Për këtë arsye emrin e pashquar *njeri* e konsiderojmë *emër që nuk referon*, emër që bart kuptim të llojit⁵⁸.

Këtë dallim e vë re dhe Çeliku: “... emrat me një zero shprehin përgjithësisht nocione ose sende në një kuptim të përgjithshëm, të menduar në mënyrë abstrakte, që përfaqësojnë tërësinë e tipareve të klasave të tyre. Duke u mbështetur në këtë gjë, na duket se ekziston një farë dallimi midis emrit me një zero në fjalinë “Agimi u emërua mësues” dhe emrit me mbaresë shquese me kuptim të përgjithësuar në fjalinë *Mësuesi* nderohet nga të gjithë. Në rastin e parë emri *mësues* përfaqëson tërësinë e tipareve të klasës së mësuesve; folësi në këtë rast do të thotë se Agimi u emërua mësues e jo gjë tjetër, pra në plan të parë del profesioni që do të ushtrojë Agimi. Në rastin e dytë emri *mësuesi* përfaqëson jo një mësues të veçantë, por gjithë klasën e mësuesve, të gjithë mësuesit dhe folësi kërkon të vërë në dukje se çdo mësues (të gjithë mësuesit) nderohen.” (f. 69-70)

Çeliku e zgjeron më tej idenë e tij me rastet: “Puna është *nder*. Agimi doli *mësues*. Atë e emëruan *mësues*. Në Shqipëri prodhohet shumë vaj *ulliri*. Ajo ishte e shkathët si *sorkadhe*” (Çeliku, 1997, 69) të cilat nuk i sheh si shembulli *Mësuesi nderohet në Shqipëri*. Për Çelikun në rastin e parë emri duhet parë si tërësia e tipareve të sendeve të njëjta të një klase, në rastin e dytë emri duhet parë si tërësia e sendeve të njëjta të një klase.

⁵⁸ Këtë rast të përdorimit të emrit *njeri* do ta shihnim në kundërvënien dhe me rastin e emrit të shquar njëjës *njeri* kur përdoret si emër me kuptim të individualizuar: - *Besoj nuk ma merrni për të keq po t’ju pyes e ç’natyre ishte lidhja, - tha njeriu i hetuesisë.* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 15)

Ray Jackendoff në “Foundations of language”, USA 2002, ndalet në dallimin midis një *referenti të individualizuar* dhe *llojit*, duke e parë këtë të fundit si më pak specifik në tiparet e tij përshkruese. Për Jackendoff-in nga *lloji* mund të formohet një *referent i individualizuar*, thjeshtë, duke shtuar një veçori indeksore. Për të konkretizuar këtë ide Jackendoff-i sjell shembullin e një emri të përgjithshëm si *penny (peni)*, i cili nënkupton një lloj, dhe një deiktiku si *that (ai)* ose *this (ky)* që shpreh një tipar indeksor. Përbërësi emëror *that penny (ai peni)* tregon në mënyrë specifike llojin e shprehur me qindarkë - semantikisht është unifikimi i tipareve përshkruese të *penny-it* dhe tiparet treguese të *that*. Nga ana tjetër, sipas Jackendoff-it, nga një *referent i individualizuar* mund të formohet *lloji*, thjeshtë duke fshirë indeksin.⁵⁹

Jackendoff-i e sheh gjuhën jo gjithmonë strikte në dallimin *lloji - referent i individualizuar* (type-token) dhe kjo zgjedhje duket se i lihet pragmatikës:

(a) John wore the same hat he always wears, [probably token-identity] (*Xhoni veshi të njëjtën kapele që vesh gjithmonë. (mbase referent i individualizuar)*)

b) John ate the same sandwich he always eats, [probably type-identity] (*Xhoni hëngri të njëjtin sanduiç që ha gjithmonë. (mbase tipi, lloji)*)

Jo gjithmonë veçantia indeksore mund të bëjë dallimin *lloj - referent i individualizuar*. Një PE (përbërës emëror) mund të shënojë një *lloj* ose një *referent të individualizuar* në varësi të kontekstit në fjali. Veçanërisht një PE predikat nuk është shoqëruar me veçanti indeksore.

⁵⁹ “Now consider the possibility of a cognitive structure that has descriptive features (including modality and ontological category), but lacks an indexical and a valuation suggest that this is just the structure we need for kinds or types.

To see the virtues of this approach, consider first the alternative possibility that the difference between an individual (or token) and a kind is that the latter is less specific in its descriptive features.....

... one can form an instance from a kind simply by adding an indexical features. This is paralleled in linguistic expression. Suppose that (as most semanticists think) a common noun such as *penny* denotes a kind, and that, as we have seen above, a demonstrative such as *this* or *that* expresses an indexical features. Then it is no surprise that the full NP *that penny* denotes an individual that instantiates the type expressed by *penny* - semantically it is the unification of the descriptive features of *penny* and the indexical feature of *that*. Conversely, given an individual, one can form a kind of which it is an instance, simply by deleting the indexical.” Ray Jackendoff, “Foundations of language”, USA 2002, p. 319

Jackendoff-i (2002, 320) sjell shembujt:

a) A professor walked in. [a professor = individual] (*Një profesor hyri brenda. – individual*)

b) John has become a professor. [a professor = kind]. (*Xhoni është bërë profesor – lloji*)

Rasti b (John dhe professor) nuk emërton dy individë të ndryshëm. Veçantitë përshkruese të profesorit shoqërohen me *referentin e individualizuar* John. Rasti që sapo pamë nuk përputhet me idenë se referenca e një fjalie duhet të ndërtohet nga referenca e fjalëve të saj. Jackendoff-i për këtë rast mendon se kemi të bëjmë me *një kuptim pa një referent*⁶⁰.

Çeliku sjell një tjetër shembull për të dhënë dallimet kuptimore që ka emri në trajta të ndryshme: “Në emrin *vajza* të fjalisë *Vajza mbaroi shkollën e lartë* ekziston ideja se një vajzë e caktuar ka mbaruar shkollën, kjo është ideja e një mundësie të vetme. Kjo shprehet me anë të mbaresës shquese –a. Në emrin *një vajzë* të fjalisë *Një vajzë mbaroi shkollën e lartë* ekziston ideja se një vajzë ndër vajza të ngjashme ka mbaruar shkollën e lartë. Kjo ide jepet me anë të nyjës joshquese *një* dhe mbaresës joshquese të lakimit të pashquar (që në rastin e dhënë është zero). Në emrin *vajzë* të fjalisë *Unë nuk kam vajzë* tregohet një person në kuptimin e gjerë (një send) i menduar në mënyrë abstrakte, në kuptimin e tij më të përgjithshëm. Në këtë fjali emri *vajzë* përfaqëson tërësinë e tipareve të klasës së vajzave të marrë në mënyrë abstrakte. Ky kuptim i emrit jepet jo me mbaresë shquese, as me një joshquese, por me një zero dhe me mbaresën joshquese (që në rastin e dhënë është zero). Në këtë rast mungesa e mbaresës shquese dhe nyjës joshquese është e rëndësishme dhe nuk shpjegohet dot me stilin konciz. Futja në përdorim e nyjës joshquese ose e mbaresës shquese në emrin *vajzë* (në fjalinë *Unë nuk kam vajzë*) është e pamundur, në raste të tjera futja e tyre do të ndryshonte kuptimin.” (Çeliku, 1997, 68)

Analizojmë shembujt e mëposhtëm:

⁶⁰ “... *professor* simply has a *sense* without reference. The sense of a phrase is built up compositionally, and if the composition happens to provide an indexical feature, then we get a referring phrase. I don't see any particular harm in this stance, as long as the indubitably referential phrases are taken care of.” po aty, p. 322

(1)

(a) - *Eh, moj bijë, ke hak ti, se je nuse...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 61) - **emër që nuk referon**: (nuse = bart tipare të klasës, nocion abstrakt, nuk i referohet një/çdo individ të saj)

(b) - *Për të mira, moj nuse, dhe sa flokë në majë të kresë, aq gostira në tryezë, se shyqyr që na vijnë miqtë, që të njom një çikë gojën edhe unë plaka....* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 60) – **emër që referon, i individualizuar**: (nuse = një individ i përcaktuar, i veçuar nga klasa, individ që bart tiparet e klasës dhe tiparet e veta individuale, vjehrra i drejtohet nuses së saj)

(c) *Nuset i qahen prindit, pleqtë i qahen fqinjit...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 61) - **emër që referon, përgjithësues**: (nuset = çdo nuse, ajo që bart tiparet e klasës, shënon individë të saj dhe përfaqëson secilin prej tyre)

(2)

(a) *Burrave s'u mbetej gjë tjetër veç të kthenin kryet mënjanë, për të mos ia plasur vajit bashkë me gratë, që, si gra që ishin, qanin ndërkaq.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 22)

(b) *Graria flisnin me gëzim dhe lajmi shkonte portë më portë.*

Emri i shquar në shumës **gratë** është **emër që referon, i individualizuar**. Ai emërton një grup të caktuar që përfaqëson individë me tipare të përbashkëta me klasën që i përket, të dalluara nga klasa, ndërsa emri i pashquar në shumës, krahasimi **si gra** tregon veçori, tipare të llojit, shënon klasën në kuptimin abstrakt, pra, është **emër i llojit**. Në shembullin (2b) kemi rastin e një emri përmbledhës: **graria**, i cili shënon një tërësi individësh. Ato “emërtojnë një tërësi vetash, kafshësh ose sendesh të një fare, në formën e numrit njëjës. Ndryshe nga emri i numrit shumës, emri përmbledhës emërton një shumicë sendesh të njëllajta si një tërësi të pandarë dhe, nga pikëpamja sasiore, të panumërueshme.” (G.A., 1995, 85) Si rezultat, emrat përmbledhës janë **emra që referojnë** dhe, duke qenë se emrat

përmbledhës emërtojnë një tërësi, kanë kuptim të tërësisë, ata do t'i cilësojmë *emra që referojnë, të tërësisë*:

(2b) **Graria** (të gjitha gratë e qytetit, në këtë rast) flisin me gëzim dhe lajmi shkonte portë më portë.

Në bazë të asaj që u tha më lart, mendojmë se mund të arrijmë në këto përkufizime:

Emra që nuk referojnë (të llojit) janë ata emra që përdoren thjeshtë si emërtim i mbarë klasës, në kuptimin abstrakt të saj, për të dhënë një tërësi që bashkohet nga tiparet e tyre të përbashkëta. *Emrat që nuk referojnë (të llojit)* kanë paraqitjen e tyre formale: ata janë vetëm në trajtë të pashquar, nyjë zero⁶¹.

Emrit që nuk referon (të llojit) i kundërvihet *emri që referon*. Ai emërton një tërësi ose një individ të caktuar që përfaqëson veten ose tërë klasën. Ai bart *kuptim të tërësisë, të individualizuar ose përgjithësues*.

3.1.1.1. Përdorime të emrave që nuk referojnë (emrave të llojit)

Emrat që nuk referojnë janë përgjithësisht emrat në trajtë të pashquar, pa nyja joshqese⁶². *Nyja zero* tregon një frymor/objekt në mënyrë abstrakte, që ka tiparet e klasës ku bën pjesë, por që nuk është dalluar nga ajo. Në gjuhën shqipe, koncepti i *nyjës zero* trajtohet për herë të parë nga M. Çeliku në artikullin e përmendur dhe më parë, *Kontribut për dy probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, S.F. 1971/1.⁶³

Aty, Çeliku, ndër të tjera, trajton dhe problemin e konceptit të *nyjës zero*: “Mungesa e *nyjave* është po aq e rëndësishme sa edhe prania e tyre. Për këtë arsye mungesa e rëndësishme e *nyjës* në letërsinë e huaj gjuhësore është quajtur *nyjë zero*. *Nyja zero* u

⁶¹ Jo çdo shfaqje e një trajte të tillë është *emër i llojit*. Kjo çështje do të trajtohet në vazhdim.

⁶² Disa grupe emrash që nuk marrin *nyjë* radhit dhe K. Cipo në Gramatikë e gjuhës shqipe (shih fq 103-104, ribotim, Tiranë 2015)

⁶³ Ky artikull është ribotuar edhe në përmbledhjen *Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, M. Çeliku, Tiranë 1997 dhe ne i jemi referuar kësaj të fundit.

kundërvihet si nyjës shquese ashtu edhe nyjës joshquese dhe emrat me nyjë zero kanë rregullsinë e vet të përdorimit, sikurse edhe emrat me nyjat shquese e joshquese. Në trajtimin e gjertanishëm tradicional të nyjës, sistemi i nyjave të shqipes, nga njëra anë, është zgjeruar me nyjat e përparme, nga ana tjetër, është i paplotë, sepse mungesa e domosdoshme e nyjës shquese dhe joshquese nuk është trajtuar si nyjë zero. Ne mendojmë se edhe nyja zero duhet të ishte parë si element i sistemit të nyjave. Duke lënë mënjanë nyjën e përparme dhe duke përfshirë edhe nyjën zero, mund të thuhet (sipas trajtimit tradicional të tyre) se elementet e sistemit të nyjave të gjuhë shqipe hyjnë në këto lidhje të mundshme: 1) nyjë zero + emër njëjës (*djalë*); 2) nyjë joshquese + emër njëjës (*një djalë*); 3) emër njëjës + nyjë shquese (*djali*); 4) nyjë zero + emër shumës (*djem*); 5) nyjë joshquese + emër shumës (*disa ose ca djem*); 6) emër shumës + nyjë shquese (*djemtë*)⁶⁴. Ky do të ishte sistemi më i plotë i nyjave në vështtrimin tradicional.” (Çeliku, 1997, 67)

Mendojmë se *emrat që nuk referojnë* janë emrat që i takojnë rastit (1) dhe (4) të sistemit të nyjave që sjell Çeliku, d.m.th. raste të emrave me nyjë zero.

Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler (1987) veçojnë *emrin që nuk referon* në këto përdorime:

“- Në emrat e përveçëm, që dalin si plotësa të foljeve që shënojnë të quajtur.

Emrat e përveçëm, që nuk referojnë, e plotësojnë një bartës të referencës me një etiketë: *Djalin e Agimit e quajnë Arben*.

- Në emrat përbërës të gjymtyrëve predikative me funksion kualifikues.

Gjymtyra predikative lidhet me bartësin e referencës që jepet me subjektin ose objektin dhe shënon një veçori, një funksion që karakterizon këta referentë: *Agimi është mësues*. *Agimin e zgjodhën kryetar* ...

- Në përkufizimet, ku teksti shpjegues nuk lidhet me ndonjë referent, por me një fjalë (Lautgebilde): *Fjali quhet ai bashkim fjalësh*...

⁶⁴ Çeliku, po aty, për termin *nyjë shquese* propozon termin *mbaresë shquese*.

- Në thëniet për emrat, që lidhen me njëLautgebilde: **Arben** është emër i bukur...

- Në situatat komunikative, në të cilat emërtohen objekte, si në rastet kur tregohet diçka e vizatuar dhe pyetet: ç'është kjo? *Kjo është mace...*⁶⁵

Në G.A. (1995) dhe te Çeliku (1997, 68-69) renditen rastet më kryesore të përdorimit të emrit me një zero⁶⁶. Një pjesë të mirë të atyre rasteve ne i konsiderojmë si raste të përdorimit të *emrit të llojit*.

Kemi *emër të llojit* kur emri me një zero përdoret:

- si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror: *Fol, thirri prapë. Gur je, kalë je, që nuk flet?* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 58)

- si përcaktor kallëzuesor: *Ky, mendonte Agushi, komandant brigade do të bëhet, gjeneral do të bëhet.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 66)

⁶⁵ Auch Substantive, die nicht referieren, repräsentieren eine indeterminierte NG und erscheinen ohne BZ (sofern nicht zusätzliche Bedingungen gelten), das ist u. a. der Fall

-bei Eigennamen, die als Komplement von Verben des Benennens fungieren. Die nichtreferierenden Eigennamen versehen einen Referenzträger mit einem Etikett:

Djali i Agimit quhet Arben/djalin e Agimit e quajnë Arben. 'Agims Sohn heißt Arben.'

-bei Substantiven in prädikativen Satzgliedern mit qualifizierender Funktion. Das prädikative SG bezieht sich auf den durch das Subjekt oder Objekt bezeichneten Referenzträger und drückt eine Eigenschaft, Funktion oder dgl., die diesen Referenten charakterisiert, aus: *Agimi është mësues.* 'Agim ist Lehrer.'

Agimin e zgjodhën kryetar. 'Man hat A. als Vorsitzenden gewählt.' *Agimi u zgjodh deputet.* 'A. wurde als Abgeordneter gewählt.'

-in Definitionen, wenn sich der erklärende Text auf ein Lautgebilde (nicht auf einen Referenten) bezieht: *Fjali quhet ai bashkim fjalësh, në të cilin përmbahet një kumtim.* 'Satz heißt die Wortverbindung, die eine Mitteilung zum Inhalt hat.'

-in Aussagen über Namen, die sich auf das Lautgebilde beziehen: *Arben është (një) emër i bukur.* 'Arben ist ein schöner Name.'

-in Kommunikationssituationen, in denen Gegenstände benannt werden. Wenn z.B. auf Abbildungen gezeigt und gefragt wird: was ist das / wie heißt der abgebildete Gegenstand?, sind die folg. Sätze mögliche Antworten: *Ky është telefon.* 'Dies ist ein Telefon.' *{Kjo/ajo} është mace.* '{Dies/das} ist eine Katze.' *Albanische Grammatik*, Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler, Leipzig, 1987, fq. 234

⁶⁶ Në G.A. (1995) këto shihen si raste të përdorimit të emrit të pashquar (f. 127-131)

- si përcaktor pa përshtatje, në rasën rrjedhore, i një emri të pashquar, në togfjalësja të tipit: mish **viçi**, këngë **dasme**, vaj **ulliri** etj.
- në fjali mohore: *Tëmthat po i rrihnin, me siguri, nga kafeja e porsapirë. **Kafe** më të fortë, s'mbante mend.* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 48)
- në funksionin e ndajshtimit: *Keni përdorur fjalën "**spiune**", apo jo?* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 15)
- kur tregon një sasi të pacaktuar lënde/sendesh: *pi **ujë**, blej **djathë**, vriste **lepuj**, pinte **cigare*** etj.
- kur tregojnë llojin, klasën, në ndërtime me kundërvënie: *... vetë ndërtesa e moçme, ashtu ngjante, **jo shtëpi, po katedrale**.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 37)
- kur paraprihen zakonisht nga folja jam dhe tregojnë profesion: *Ata ishin **mjekë**, ata kishin bërë betimin e Hipokratit.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 130),
- kur kanë varësi të dyfishtë në fjali: *Burrin e quanin **August**.* (F. Kongoli, *Kufoma*, 1994, 15)
- në ndërtimet me krahasim, kryesisht në njëjës: *I kërkonin gjithkund te përroi, te gremina, te stanet e barinjve, gjersa kohë më pas, një pëshpërimë e lehtë **si shushurimë mëndafshi** ngulte këmbë se ato kishin përfunduar brenda shtëpive të larta të qytetit.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 18)

Emri i llojit është edhe:

- emri përfaqësues në fjalorë: **VAJZ/Ë, ~A** f. sh. **~A, ~AT**. 1. Fëmijë femër; njeri i seksit femëror deri në moshën e pjekurisë; femër që s'është martuar; çupë;... (1980, 2106)
- emri i përveçëm në rastin kur shfaqet si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror apo si përcaktor kallëzuesor: *Që s'ishte **Krisht** doktor Gurametoja e, aq më pak mysafirët gjermanë, kjo dukej që larg, por edhe **Judë** t'i quaje, ishte e tepërt.* (I. Kadare,

Darka e gabuar, 2009, 34) (Krisht e Judë nuk referojnë individët e njohur, por shënojnë tiparet që bartin këta individë, ndaj i konsiderojmë *emra joreferues*.)

Shënim 1: Emri i pashquar paraprirë nga disa fjalë përcaktuese⁶⁷, si: numërorë, përemra dëftorë e pyetës është *emër që referon*, i individualizuar sepse fjalët përcaktuese luajnë rol individualizues të ngjashëm me atë të nyjës shquese⁶⁸: *Por nj' ajo llasticë çka ka me gjetë, kur s'ka hupë gjë, se nuk paska asgjë me hupë?* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 53) Nga kjo tekë komike po i dukeshin qesharakë të gjithë këta banorë të kripores, që po vinin drejt saj të ngjitur shpinë më shpinë, si motrat siameze, për shkak të bankave të tramit të puthitura kurriz më kurriz. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 42)

Shënim 2: Nyja zero përdoret edhe në situata thirrmore, por emri në funksionin e thirrorit është *emër që referon*, i individualizuar, sepse personi të cilit i drejtohem i njohur.

⁶⁷ “Në disa raste emri mund të jetë i vetëm dhe në trajtë të pashquar, në raste të tjera ai nuk është më vetëm, por është në trajtë të pashquar, sepse shoqërohet nga përemri i pacaktuar një, përemrat dëftorë, përemrat pyetës, përemrat e pacaktuar, të pandryshueshëm etj., të cilët së bashku me përemrin e pacaktuar një, mund të emërtohen me termin e përbashkët fjalë përcaktuese, ose caktuesor (determinativ), d.m.th. fjalë që nuk funksionojnë dot vetëm si gjymtyrë fjalie, por i bashkëngjiten një emri për të funksionuar së bashku me të si një gjymtyrë e vetme e fjalisë...” Gramatika e gjuhës shqipe, 2, Tiranë, 2002, f. 83–84

⁶⁸ E. Sadiku, në “Midis gramatikës dhe pragmatikës”, Botime 2L-2P (mungon viti i botimit) paraqet kriterin mbi të cilin Engel mbështetet për klasifikimin e pjesëve të ligjëratës dhe sjell sistemin e pjesëve të ligjëratës sipas tij. Përsa i takon emrit, veçon: “Emrat mund të shoqërohen nga satelitë të ndryshëm, kështu kuptimi i tyre bëhet gjithnjë e më i saktë: letër; letër e papritur; letër e papritur nga Efurti etj. Sateliti më i rëndësishëm i emrit është determinativi. Në bashkëvajtje me emrin ai formon frazën emërore. Emri vetëm s’është gjë tjetër veçse një etiketë që mund t’u ngjitet sendeve. Bashkë me determinativin emri shënon një copë realitet.” (f. 90)

Për Engel, determinativët *shërbejnë për aktualizimin e grupit emëror (djalë - ky djalë)*. Nyja, si një prej determinativëve është shquese, joshquese dhe zero. Nyja shquese përcakton kuptimisht përbërësin emëror, i cili shënon një person a objekt të njohur, ndërsa nyja joshquese i jep karakter të pacaktuar përbërësit emëror. Engel e sheh nyjen zero kryesisht para emrave në numrin shumës.

Individualizimi bëhet me anë të situatës: *Në atë vorbull të thellë e që zien pa u mpiksur kurrë, siç është shpirti i robit të perëndisë, çdo njeri, moj **grua**, mund të zgjedhë e të marrë atë që do...; Po megjithatë ka një ndryshim, **vëlla**.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980)

Shënim 3: Por një emër i llojit mund të jetë edhe i markuar, paraprirë nga nyja joshqese një: *Unë nuk kam **një vëlla**: Ndryshe nga hera e parë, te xhadeja, vitin që shkoi, viktima ishte tani një ushtar flokëverdhë, i bukur si **një çupë**.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 76) Mund të themi se ky është një përdorim i veçantë i emrave paraprirë nga nyja shqese një. Nyja joshqese një mund të hiqet, pa cenuar aspak fjalinë. Emri i llojit në këtë rast fiton një vlerë shtesë, vlerë përforcuese, intesifikuese.

3.1.2 Emrat e përgjithshëm me kuptim përgjithësues

3.1.2.1 Emri i përgjithshëm i shquar me kuptim përgjithësues

Shquarsia/pashquarsia është një kategori gramatikore karakteristike e emrave dhe kuptimi themelor i shquarsisë është *kuptimi i individualizuar*. Nyja shqese te emri i jep atij vlerë të dyfishtë:

- veçantinë në raport me klasën që i përket: **Roja** kujton se punoj akoma në mol dhe më la. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 130);
- vlerën anaforike: *Ata të gjithë ishin ulur në pastiçerinë e Skelës dhe Paci ishte duke kafshuar **një amaretë**. Megjithëse nuk e kishte mendjen atje, ai po shpejtonte t'i jepte fund sa më parë, duke kujtuar se për shkak të saj po vonoheshin të ngriheshin për të vizituar molin numër Një... Pra, ai nuk po priste dot sa të mbaronte **amaretën**...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 127).

Krahas kuptimit themelor, kuptimit të individualizuar, G.A. (1995) i njeh emrit në të shquar edhe përdorime *me kuptim përgjithësues*. Në një syth më vete figuron: *Trajta e shquar me*

*kuptim përgjithësues*⁶⁹. Gramatika e Akademisë përdorimin e trajtës së shquar me kuptim përgjithësues e sheh si “një vlerë të veçantë të trajtës së shquar njëjës, që quhet zakonisht *vlerë përgjithësuese (gjenerike)*”. (f. 127)

Përdorime të emrit me kuptim përgjithësues gjejmë dhe te Kostaq Cipo, “Sintaksa” 1952 (në kapitullin *Vërejtje rreth pjesëve të ligjëratës*, në sythin *Nyjët*, ku shpjegon përdorime të nyjës së shquar dhe nyjës së pashquar *një/ca*). Mes fjalëve që shquhen Cipo përmend: “Marrin një edhe tër’ emrat që tregojnë gjini a farë në tërsin’ e tyre. P.sh. *Njeriu* (= tërë njerëzit) ka mënt e shqisë; *peshku* rron n’ujë (d.m.th tërë peshqit); *poeti* këndon me zë të bukur fitoret e popullit të vet (çdo poet); *libri* është miku më i mirë i punëtorit (d.m.th. tërë librat e mirë) etj. Marrin një të çquar edhe tërë shumësit kur tregojnë një tërësi. P.sh. *Filosofët* dhe *shkencëtarët* rrahin të gjejnë të vërtetën; (d.m.th. sa filosofë e shkencëtarë që ka bota.)” (Cipo, 1952, 22); Stefan Prifti, i cili e sheh *kuptimin përgjithësues* në raste të kryefjalës së shquar që shquan gjininë në tërësi, si një koncept i përgjithshëm, duke sjellë dhe shembullin *Ari është metal*, dhe si përdorim të njëjësit në vend të shumësit “kur brendia e kryefjalës mendohet si *gjini* apo *farë*, dhe në përgjithësi, në formë të një koncepti të përgjithshëm. P.sh., *Mësuesi* është shumë i nderuar në shoqërinë socialiste (në vend të *mësuesit* janë etj.).” (Prifti, 1958, 56) Këtë dukuri Prifti e sheh të shtrirë dhe te emrat e kombësisë dhe ata kolektivë dhe i barazon këto raste me përdorimin e metonimisë. Rastin kur emri përmban një shquese dhe referon në përgjithësi e veçon dhe Buccholz & Fiedler (1987): “*Mizat* bëjnë pjesë në klasën e insekteve. *Hekuri* është metal.”⁷⁰; Fatmir Agalliu, në artikullin *Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe*, S.F. 1970/4, flet për emrin me kuptim

⁶⁹ “Emri i përgjithshëm në numrin njëjës mund të përdoret në trajtën e shquar edhe me një kuptim tjetër, të ndryshëm nga kuptimi themelor i shquarsisë për të cilin u fol deri këtu. Është fjala për përdorimin e tij me kuptim përgjithësues. Në këtë përdorim trajta e shquar e karakterizon sendin si diçka që simbolizon klasën së cilës i përket. Nëpërmjet një frymori ose sendi të caktuar përfaqësohet tërë klasa e frymorëve ose sendeve që kanë tipare të përbashkëta me të. Trajta e shquar me kuptim përgjithësues përdoret mjaft në gjuhën shqipe dhe jo vetëm në emra që tregojnë lloje ose klasa sendesh, por edhe në emrat e lëndës, emrat abstraktë etj...” (f. 127)

⁷⁰ “...bei Substantiven, die generell referieren. Wenn das Subst Subjekt des Satzes ist, kommt im Alb. der ϕ -Artikel nicht in Frage: *Mizat* bëjnë pjesë në klasën e insekteve. (Die) Fliegen gehören zur Klasse der Insekten.’ *Hekuri* është një metal i fortë. (Das) Eisen ist ein festes Metall. *Në shoqërinë socialiste gruaja shkon drejt emancipimit të saj të plotë*. ‘In der sozialistischen Gesellschaft geht die Frau ihrer völligen Emanzipation entgegen.’ Buccholz & Fiedler, f. 235

përgjithësues e sjell shembullin e emrave me kuptim përgjithësues në rrjedhore të pashquar pa parafjalë që shpesh kanë marrë kuptimin e mbiemrave; Shaban Demiraj (1969/4), “Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa I)”, Tiranë 1973, i njeh funksionin individualizues nyjës shquese, madje është i mendimit se nyjat shquese në zanafillë kanë pasur vetëm funksion individualizues. Por, ai sqaron se nyja “gradualisht ka ardhur duke u përdorur me emrat e përgjithshëm, edhe kur këta përdoreshin me kuptim të përgjithësuar, si edhe me emrat e përveçëm.” (Demiraj, 1973, 75-76) Demiraj sqaron më tej se nyja në këto raste nuk ka asnjë rol kuptimor. Ai nuk i njeh asaj rolin e kuptimit përgjithësues. Mendon se kuptimin përgjithësues e ka vetë emri i përgjithshëm si *emërtues i mbarë klasës përkatëse* dhe jo nyja, e cila ka vetëm funksion individualizues; M. Çeliku (1971/1) trajton funksionin e nyjave të shqipes dhe i njeh mbaresës shquese krahas funksionit individualizues, edhe *funksion përgjithësues*; Rami Memushaj mendon se përdorimi i nyjës “shërben si mjet për shprehjen e shkallës së individualizimit të emrit, kurse mungesa e saj shpreh kuptimin e përgjithësuar të tij. (Memushaj, 2008, f. 211-212)

Në English grammar, COLLINS COBUILD (1990) njihet si përdorim me kuptim përgjithësues emri në trajtë të shquar, por si trajta më e zakonshme për të dhënë kuptimin përgjithësues shihet forma e shumësit e emrit pa nyjë shquese.⁷¹

P.Charaudeau (1992), në nënçështjen që trajton veçantitë semantike të nyjës shquese (l’article **le**) në vlerën e tyre kontekstore, ngre pyetjen: *Si shpjegohet vlera përgjithësuese e nyjës shquese kur ajo ka vlerë të specifikuar?* (Comment expliquer la valeur de généralité de l’article *le* puisque celui-ci est l’article de la *spécificité*? f. 172) Ai shpjegon se e veçanta e nyjës shquese në këtë rast është se ajo tregon faktin që janë gjithë elementët e klasës së bashku që duhen marrë në konsideratë dhe jo një shembull i saj dhe të gjithë këta elemente përbëjnë një entitet unik që përcakton klasën. Për këtë sjell shembujt: **Heroi** nuk vdes kurrë. (*Le héros ne meurt jamais.*) Ky rast shihet si entiteti që mbledh të gjithë heronjtë në

⁷¹ “The’ is sometimes used with other nouns in the singular to make a statement about all the members of a group. Too often these writings dwell on how to protect the therapist rather than on how to cure the patient. These uses are fairly formal. They are not common in ordinary speech. Usually, if you want to make a statement about all the things of a particular kind, you use the plural form of a noun without a determiner.” English grammar, COLLINS COBUILD, (f. 45)

opozicion me: *Një hero nuk vdes kurrë. (Un héros ne meurt jamais.)*, një shembull të klasës që vlen për të gjithë anëtarët e tjerë.⁷²

Nisur nga sa u tha më lart dhe duke u mbështetur në qëmtimet tona, mund të themi se *emri i trajtës së shquar*, si në numrin njëjës, edhe në numrin shumës mund të përdoret si *emër me kuptim përgjithësues*. Në këto raste emri del si përfaqësues i klasës së cilës i përket, nëpërmjet tij/tyre përfaqësohet tërë klasa:

(1) Kur **njerëzit** bëhen lapangjozë më dalin nga zemra. Dhe nuk i dua! (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 66) (**njerëzit** - çdo njeri)

(2) Çastet e mendimeve për vete janë çastet më melankolike. Më të rënda. Se, sado që të përpiqej **njeriu** të numërojë deri në një mijë ose dhjetë mijë, sa ta zërë gjumi, është e pamundur, skenat e ditës i dëbojnë të tjerat. (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 19) (**njeriu** - çdo njeri, secili prej nesh)

(3) Ky është një njeri i vdekurë; sado ta duamë **të vdekurin**, duhetë ta vëmë në dhjetë; (S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*, 1962, 61) (**të vdekurin** - çdo njeri të vdekur)

(4) **Gratë** (**gratë** - çdo grua) nuk përgojosen në tryezën e burrave... - tha arhondi i vogël. – **Burrin** (**burrin** - çdo burrë) përgojose, në je burrë... ” (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 2, 1980, 177)

(5) Dreq, mendoj. E vetmja gjë që **kamarierët** e kryenin shkëlqyeshëm ishte ndërprerja e mendimit. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, f. 69) (**kamarierët** - çdo kamarier)

(6) Trap i hetuesisë, kushedi ç'kujtonte, bashkë me ata karafilët e tjerë, se **shkrimtarët** ishin ca tuhafë, që një zogth të mbytnin, i vriste ndërgjegjja muaj me radhë. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, f. 68) (**shkrimtarët** - çdo shkrimtar)

⁷² “Dans un énoncé qui décrit une généralité, la *spécificité* de l'article le consiste à indiquer que c'est l'ensemble des éléments de la classe (et non un seul ayant valeur d'exemplaire) qui doit être pris en consideration. Les éléments de cet ensemble se fondent en une seule entité pour devenir une substance (une espèce) unique qui définit la classe.” Patrick Charaudeau, *Grammaire du Sens et de l'Expression*, Hachette, 1992, f. 172

(7) Dhe ti do të shkoje nëpër jalli, që të prishje me lesë sheqerin e egër, që të mos e mblidhte **fukarai**, ashtu siç ke prishur çdo behar kripën e egër. (Lulja e kripës, J. Xoxa, 1, f. 60) (**fukarai**- çdo individ që i takon kësaj shtrese)

(8) **Krujanët** i gjeti aq besnikë sa dhe **dibranët**. (F. Noli, Vepra 4, 1989, 207) (**krujanët** – çdo krujan; **dibranët** – çdo dibran)

(9) Gjyq do të thotë që, më e pakta, **i dënuari** të dijë pse dënohet. (I. Kadare, E penguar, 2009, f. 82) (**i dënuari** - çdo individ që është i dënuar)

Shënim 1: Emra të tillë si **njeriu**, **bota**, **njerëzia** i gjejmë përgjithësisht si emra me kuptim përgjithësues⁷³. Në këtë përdorim këta emra janë më së shumti në trajtën e shquar: *Disa gjëra, edhe pa i parë, njeriu arrin t'i njohë si janë.* (F. Noli, Vepra 4, 1989, 180); *Ishte shpresë të fitohej pa derdhur një pikë gjak, nga shkaku që tërë bota besonin që Skënderbeu do t'i binte Sfetigradit,...* (F. Noli, Vepra 4, 1989, 153); *Në këto çaste, si për t'u mbrojtur nga ulërima e vdekur e shkretëtirës, njeriu kërkon të kapet pas diçkaje: pas një libri, një mendimi, një fytyre të dashur.* (I. Kadare, Autobiografia e popullit në vargje, 2002, 9); *Por as pelikani im i rrallë dhe as një koleksion fluturash, që lënë botën pa gojë, nuk m'u duk t'u bënë përshtypje të vërtetë.* (Dh. Shuteriqi, Vepra letrare 4, 1982, 8); **Njeriu** mund të mësohet vetëm me dhembjen fizike të fëmijëve, se atë e ndesh vazhdimisht. (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1980, 415) Por, nuk mungon dhe trajta e pashquar: *Hej, ardhi pranvera! Këndon bilbili maleve. Lodrojnë fëmijët fushave. Ngjituni, njerëz, për verim bjeshkëve të larta, shpërtheu gjethëza e ahut!* (M. Kuteli, Tregime..., 2005, 114)

Shënim 2: Në gjuhën shqipe gjejmë dhe përdorime të mbiemrit të emëruar me kuptim përgjithësues: **I çmenduri** (çdo i çmendur) duhet shëruar. (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 157)

⁷³ Vë re këtë fakt dhe Çeliku në të gjitha veprat e tij të cituara në këtë punim.

Për ta bërë më të qartë, po sjellim në vazhdim një përdorim ku gjejmë pranë e pranë mbiemrin e emëruar me kuptim përgjithësues dhe mbiemrin e emëruar me kuptim të individualizuar: *Diçka në shpirt të tij qe thyer dhe mbi botë ishte derdhur një lëndë opake, që nuk linte të shihje më asgjë, as të mirin, as të ligun.*(me kuptim përgjithësues) Ai do ta mbante mend për tërë jetën zhgënjimin e parë që i kishte dhënë i ati, “më i miri, më i ëmbli, më i bukuri, më i ndershmi, më i drejti në botë”.(me kuptim të individualizuar) (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 188)

3.1.2.2. Emri i përgjithshëm i pashquar me kuptim përgjithësues

Në G.A. (1995) bëhet fjalë edhe për përdorime të trajtës së pashquar të emrit me kuptim përgjithësues: “Po emri i shoqëruar me *një* mund të përdoret nganjëherë edhe me kuptim përgjithësues, çka është tipike, siç e thamë, për trajtën e shquar..” (f. 130) Këtë përdorim e njeh dhe Çeliku (1971/1). Sipas tij, emrat e shoqëruar me nyjën *një* krahas funksionit *individualizues*, kanë edhe *funkcion përgjithësues*: “Në letërsinë e huaj gjuhësore dhe në atë shqipe nyjës joshquese përgjithësisht i njihen dy funksione, e pikërisht funksioni dallues dhe funksioni përgjithësues. Siç dihet, nyja joshquese *një* ka funksion dallues kur shërben për të dalluar një send të vetëm nga gjithë klasa e tij e përbërë nga sende të njëjta, të ngjashme, pra, nga shumë sende të njëjta dallohet një send.... Emri i pashquar i prirë nga nyja *një* ka edhe kuptim përgjithësues, një emër në njëjës përfaqëson të gjithë klasën (por jo një send të veçantë).” (f. 57-58) Përsa i takon ndërkëmbimit të emrit të shquar me emrin e pashquar me nyjë joshquese me kuptim përgjithësues, Çeliku sqaron: “emri i pashquar me *një* mund të zëvendësohet nga emri në trajtë të shquar, përkundrazi emri i shquar nuk mund të zëvendësohet nga emri i pashquar me *një*,” (po aty, f. 58), ndërsa për nyjën joshquese të shumësit *ca (disa)* Çeliku nuk tregon funksionin e saj. Ai i njeh shpesh formë zero nyjës joshquese të shumësit dhe këtë e shpjegon me faktin e vetë treguesëve të qartë morfologjikë (mbaresa ose mjete flektive) që ka emri në numrin shumë.

Ndërsa Demiraj veçon: “... ndonëse më rrallë se nyja shquese, me kalimin e kohës ajo (nyja e trajtës së pashquar – *M.B.*) ka fituar mundësinë të përdoret edhe para emrash të përgjithshëm me kuptim të përgjithësuar, si p.sh. *Një njeri, sado të mira të ketë për veten e tij, s’mund të jetë fatbardhë, po të ketë kombin e mëmëdhen’ e vet fati.*

Nëse emrin në të pashquar **një njeri**, do ta zëvendësojmë me të shquarën e tij: **Njeriu** (= çdo njeri, njeriu në përgjithësi), *sado të mira të ketë për veten e tij, s’mund të jetë fatbardhë, po të ketë kombin e mëmëdhenë e vet fati.*, kuptimi përgjithësues do të mbetet. ...në raste të tilla neutralizohet dallimi midis nyjes shquese dhe nyjes *një* të trajtës së pashquar. Këtë e vërteton edhe fakti se, po ta kthejmë në shumës emrin me kuptim të përgjithësuar të përdorur me nyjen *një*, ai mund të përdoret vetëm në trajtë të shquar, pa pësuar ndonjë ndryshim në përmbajtjen e tij kuptimore, sepse, siç dihet, kur një emër përdoret me kuptim të përgjithësuar, dallimi midis njëjësit dhe shumësit zhduket.” (Demiraj, 1973, 28)⁷⁴

Charaudeau, në vlerën kontekstuale të nyjes joshquese (*un, une*) veçon dhe vlerën përgjithësuese në një kontekst të caktuar (*valeur de généralité dans une contexte définitionnel*).⁷⁵ Edhe në COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR gjejmë përdorimin me kuptim përgjithësues të emrit në numrin njëjës të pashquar, me nyje të përparme (*A gun must be kept in a safe place. Një armë duhet të mbahet në një vend të sigurtë.*), por, siç e kemi vënë në dukje edhe më lart, forma më e përdorur në gjuhën angleze për të shprehur kuptimin përgjithësues është shumësi i pashquar⁷⁶.

⁷⁴ Demiraj më tej saktëson: “Por para gjymtyrës së dytë të togfjalëshavet të tipit *gur mulliri* nyja *një* nuk mund të përdoret, sepse atëherë emri i përdorur me kuptim të përgjithësuar do të merrte kuptim të individualizuar dhe, si rrjedhim, kuptimi i togfjalëshit do të ndryshonte. P.sh. të krahasohen: Ky është *gur mulliri*. Ky është *guri i një mulliri* (që është prishur). Në rastin e parë emërtohet një send i vetëm *guri*, kurse në rastin e dytë emërtohen dy sende, *guri* dhe *mulliri* (i prishur).” f. 90. Rastet e mësipërme nga ne nuk shihen si raste të emrit me kuptim përgjithësues. *Mulliri* në togun *gur mulliri* tregon llojin dhe për këtë arsye ne i shohim si *emra joreferues*.

⁷⁵ “... définition qui consiste à attribuer une *propriété de nature* à un concept considéré comme un *exemplaire* qui vaut pour tous les auteurs de la classe: *Un héros ne meurt jamais.*” (... përcaktim që konsiston në dhënien e *një karakteristike* një koncept që konsiderohet si *shembulli* që vlen për të gjithë klasën: **Një hero nuk vdes kurrë.**) Vepër e cituar, f. 167-168

⁷⁶ “You can use ‘a’ or ‘an’ with a noun when you are using one individual person or thing to make a general statement about all people or things of that type. For example, if you say ‘A gun must be kept in a safe place’, you are talking about an individual gun in order to make a general statement about all guns.

Edhe emri i pashquar me një joshquese, ndonëse me denduri më të vogël përdorimi se emri i shquar, njeh në shqipe përdorime me kuptim përgjithësues:

(1) *Për më të voglën vërejtje për personazhin e Stalinit a për ndalimin e fesë, a për Byronë Politike, **një oficer i ushtrisë, ose një komunist i devotshëm**, shkonte në burg, për të mos thënë në pushkatim.* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, f. 55)

(2) *Ç'e do **një libër** që s'flet për zemra, dashuri, të puthura?... – tha Petriti buzëprishur.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 417)

(3) *Po pikërisht kjo punë e kartvizitës është fyerja më e madhe që mund t'i bëhet **një vendi**.* *E, aq më tepër, një vendi heroik si yni.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 13)

(4) *... megjithatë, kur vinte puna tek emri a, së paku, te pullazi, të gjithë ngrinin supet, thua se ky turp, nëse do të quhej i tillë, ishte nga ata që s'mund të mbahej nga **një njeri** a nga **një pullaz i vetëm**.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 25)

(5) *Dukej se Xhuzepja tani merrte frymë lirisht. Buzëqeshi. Dhe sa dritë jep buzëqeshja e **një të mjeri**!* (P. Marko, *Qyteti i fundit*, 2000, 16)

3.1.2. 3. Paradigma e emrit të përgjithshëm me kuptim përgjithësues

A computer can only do what you program it to do.

A dog likes to eat far more meat than a human being.

An unemployed married farm-worker got parish relief.

This is not the usual way of referring to groups. Normally, if you want to make a statement about all the people or things of a particular kind, you use the plural form of a noun without a determiner." (*Ju mund të përdorni emrin me një joshquese **një** kur jeni duke përdorur një individ a send për të bërë përgjithësime për të gjithë njerëzit apo gjërat e atij lloji. Për shembull, nëse thoni Një armë duhet të mbahet në një vend të sigurtë, ju jeni duke folur për një armë të veçantë në mënyrë që të bëni një përgjithësim rreth të gjitha armëve... Kjo nuk është rruga e zakonshme që i referohemi grupit, klasës. Nëse doni një thënie për njerëz e sende të një lloji, atëherë përdorni formën e shumësit të emrit pa një.*) COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 55.

Nga sa u paraqit më lart, referuar dhe lidhjeve të mundshme të sistemit të nyjave në gjuhën shqipe paraqitur nga M. Çeliku⁷⁷, mund të themi se paradigma e emrit me kuptim përgjithësues për gjuhën shqipe është:

(1)

- a. (emër njëjës + mbaresë shquese) *Ja, mu në hundën tuaj unë po fejoj vajzën, pa e shtyrë datën, se **shqiptari**⁷⁸, sipas dokeve, s'e kthen kurrë as orën, pale pastaj ditën, pra, unë bëj sikur ju të mos ishit, madje, po të doni, mirë se të vini pas dokeve tona, miq apo armiq, porta është e hapur për gjithkënd.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 30)
- b. (nyjë joshquese + emër njëjës) ... ***një shqiptar**, sipas dokeve, s'e kthen kurrë as orën, pale pastaj ditën...*
- c. (emër shumës + mbaresë shquese) ... ***shqiptarët**, sipas dokeve, s'e kthejnë kurrë as orën, pale pastaj ditën...*

(2)

- a) *Kjo vinte, ndoshta, ngaqë në profesione të tilla **njerëzit**⁷⁹ e duronin me vështirësi barazinë e vlerave, ndaj mezi ç'prisnin ditën që ajo të prishej.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 8)

⁷⁷ "1) nyjë zero + emër njëjës (*djalë*); 2) nyjë joshquese + emër njëjës (*një djalë*); 3) emër njëjës + nyjë shquese (*djali*); 4) nyjë zero + emër shumës (*djem*); 5) nyjë joshquese + emër shumës (*disa* ose *ca djem*); 6) emër shumës + nyjë shquese (*djemtë*)", M. Çeliku, *artikull i cituar*, S.F. 1971/1, f. 67

⁷⁸ Emrat të kombësisë me kuptim përgjithësues i gjejmë dhe në gramatikën angleze: "Plural nouns used generically: *The Russians are a deeply patriotic people.*" *A student's grammar of the English language*, Sidney Greenbaum, Randolph Quirk, England, 1990, f. 91

⁷⁹ Emri *njeriu* mund të përdoret si emër:

me kuptim përgjithësues: *Nuk mund t'i shohë njeriu pa derdhur lotë këta refugjatë nëpër limanet e Italisë...* (Noli, *Vepra* 4, 1989, 202); *Disa gjëra, edhe pa i parë, njeriu arrin t'i njohë si janë.* (po aty, f. 180) *Në këto çaste, si për t'u mbrojtur nga ulërima e vdekur e shkretëtirës, njeriu kërkon të kapet pas diçkaje: pas një libri, një mendimi, një fytyre të dashur.* (I. Kadare, *Autobiografia...*, f. 9); *Njeriu mund të mësohet vetëm me dhembjen fizike të fëmijëve, se atë e ndesh vazhdimisht.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, vëll. 2, f. 415)

me kuptim të individualizuar: *Parandihet që kjo e fundit do të sqarohet shpejt, madje, shumë njerëz do të krenoheshin më pas për të, kurse njeriu i cohës së bardhë do të zhytej përherë e më fort në terr.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 24); *Katër ushtarë, hipur në dy trirrotës, me mitraloza në duar dhe me adresën e të kërkuarit, u nisën me rrapëllimë të gjenin njeriun.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 39)

me kuptim të përemrit të pacaktuar kush, askush. *Jemi të mendimit se kjo përgjithësisht lidhet me trajtën e pashquar pa nyjë të përparme të emrit: S'e lë njeri fëmijën, o Sadush, po kushedi se ç'gjë do t'u kish ngjarë dhe atyre.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 25) *Abdurahman Arbana, portieri ynë, rri në kabinën*

- b) *Kjo vinte, ndoshta, ngaqë në profesione të tilla **njeriu** e duron me vështirësi barazinë e vlerave, ndaj mezi ç'prisnin ditën që ajo të prishej*
- c) *Kjo vinte, ndoshta, ngaqë në profesione të tilla **një njeri** e duron me vështirësi barazinë e vlerave, ndaj mezi ç'prisnin ditën që ajo të prishej.*

Këtë paradigmë e gjejmë dhe në gjuhën frënge (Galmiche, 1985)⁸⁰.

Në gjuhën angleze paradigma nuk është e njëjtë: të tria tipet e nyjeve (e caktuar, e pacaktuar, zero)⁸¹ mund të përdoren për të dhënë referent përgjithësues; e caktuara (the) – zakonisht në shumës, në emra në njëjës është më formale, e pacaktuara (a/an) – gjithmonë me emra njëjës të numërueshëm, zero – me emra shumës të numërueshëm dhe me emra të panumërueshëm. Gjithsesi, veçohet nyja zero si nyja tipike për të dhënë referentin përgjithësues, krahasuar me dy tipat e tjerë, të cilat kanë një përdorim më të kufizuar.⁸²

3.1.2.4. Trajta e shumësit në raport me kuptimin përgjithësues

Stefan Prifti (1958) është i mendimit se, “kur brendia e kryefjalës mendohet si gjini apo farë, dhe në përgjithësi, në formë të një koncepti të përgjithshëm”⁸³, më shpesh përdoret numri njëjës, në vend të shumësit. Gjithsesi, trajta e shumësit të shquar është pjesë e paradigmes së emrit me kuptim përgjithësues, ndaj mendojmë se do të ishte me interes të zbulojmë si mund të dallojmë shumësin e shquar të emrit me kuptim përgjithësues nga shumësi i shquar i individualizuar.

*me një kamare të vogël, pi duhan dhe mendon. Nuk e di **njeri** se ç'mendon!* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 176)

⁸⁰ “...reprise pronominale par c'est ou par ça; ces formes ont pour particularité de ne permettre que l'interprétation générique du SN requis; elles permettent ainsi la désambiguïsation...”

a) **Le** lynx a une vue perçante

b) **Les** lynx ont une vue perçante

c) **Un** lynx a une vue perçante » (Parafrazat ku gjendet *c'est* apo *ça* shërbejnë në identifikimin e një sintagme emërore përgjithësuese, duke mos lejuar ambiguitetin.) f. 3

⁸¹ “All three types of article can be used to make a generic reference: the usually, and a/an always, with singular count nouns; zero with plural count nouns and with noncount nouns. “*A student's grammar of the English language*, Sidney Greenbaum, Randolph Quirk, England, 1990, f. 87

⁸² “... zero by far the most natural way of expressing the generic, irrespective of the function or position of the noun phrase in sentence structure:

Research is vital for human progress.

Many professors prefer research to teaching. ...” po aty, f. 87-88

⁸³ “Sintaksa e gjuhës shqipe”, S. Prifti, Prishtinë 1958, f. 56

G. Kleiber (1985, f. 81)⁸⁴ veçon shumësinë si origjinë natyrore të idesë së përgjithësimit dhe e sheh me interes vlefshmërinë e trajtimit universal ose thuajse-universal të shumësit përgjithësues dhe faktin si shihet shumësi specifik, më saktësisht, shumësi specifik i përcaktuar.

Mund të themi se:

Shumësi me kuptim përgjithësues:

- shënon sende/individë të klasës mbarë: ***Prindërit (çdo prind)*** janë model udhëheqës për fëmijët e vet, se ***fëmijët (çdo fëmijë)*** i mbajnë prindërit e tyre të mbaruar e të qëruar nga çdo pikëpamje. (J. Xoxa, Lulja e kripës, 1, 1980, 368)

- mund të ndërkëmbehet me trajtat e njëjësit me kuptim përgjithësues. Trajta e njëjësit mund të përdoret në vend të shumësit pa cenuar kuptimisht fjalinë, se në rastin e emrave me kuptim përgjithësues kuptimi mbi numrin zhduket: ***Prindi (një prind)*** është model udhëheqës për ***fëmijën*** e vet, se ***fëmija*** e mban ***prindin*** e tij të mbaruar e të qëruar nga çdo pikëpamje.

Shumësi i individualizuar:

⁸⁴ "On n'aura pas oublié que le recours à la quantification pour aborder le phénomène de la généricité a pour origine naturelle l'idée de pluralité, pluralité d'individus dans le cas de la généricité nominale, pluralité d'événements dans le cas de la généricité verbale ou habitualité. Il n'est donc pas inintéressant, pour jauger le bien-fondé du traitement universel ou quasi universel de la pluralité générique, de voir comment se présente le problème du côté de la pluralité spécifique, plus précisément de la pluralité définie spécifique." (Nuk duhet harruar se përdorimi i kuantifikimit për t'iu qasur fenomenit të përgjithësimit ka për origjinë natyrore idenë e shumësit, shumësin e individëve në rastin e përgjithësimit emëror, shumësin e ngjarjeve në rastin e përgjithësimit foljor. Prandaj, nuk është aspak interesante, për të vlerësuar vlefshmërinë e trajtimit universal ose thuajse-universal të shumësit përgjithësues, për të parë se si paraqitet problemi te shumësi specifik, më saktësisht te shumësi specifik i përcaktuar.) Kleiber Georges. *Du côté de la généricité verbale: les approches quantificationnelles*. In: *Langages*, 20^e année, n°79, 1985. Générique et généricité. pp. 61-88, fq 81

- tregon një shumicë që i referohet disa individëve/sendeve në mënyrë të individualizuar: *Pas gorricës u mbështeta edhe unë dhe fillova të ndjek me sy **ushtarët** që ecnin nëpër dëborë.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 92)

- nuk mund të ndërkëmbehen me trajtat e njëjësit sepse cenohet kuptimi i fjalisë: *?Pas gorricës u mbështeta edhe unë dhe fillova të ndjek me sy **ushtarin/ një ushtar** që ecte nëpër dëborë.*

3.1.2.5. Funksioni i emrave me kuptim përgjithësues

Siç e dimë, karakteristikë për emrin është përdorimi i tij në rolin e kryefjalës dhe të kundrinorit dhe kjo karakteristikë vlen edhe në raste të përdorimit të emrit me kuptim përgjithësues.

Kryefjalë me kuptim përgjithësues:

(1) **Snobi** është njeriu që kërkon të bëhet majmun ose **majmuni** që kërkon të bëhet njeri. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 198)

(2) Që **komunistët** s'kanë atdhe, këtë e dinim nga zoti Marks, por që të mos kishin emra, këtë po e mësojmë sonte, në mbrëmjen tonë të parë në Shqipëri. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 57-58)

(3) Zakonisht ashtu bëheshin **pushkatimet**. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 83)

(4) Vetullat i ranë poshtë dhe balli iu rrudh, siç rrudhet **një pellg me ujë të pastër** kur fryn **një erë e lehtë**. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 51)

(5) Si mund t'ia shpjegonte asaj se, në Shqipëri, **zyrat e hetuesisë** kullonin gjak ? (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 98)

(6) ... **romuzet politike** janë si ngjallat, s'ke nga t'i kapësh që t'u rrjepësh lëkurën. (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 352)

Kundrinorë me kuptim përgjithësues:

(6) *Ti e di, Fritz, që shqiptari nuk e dorëzon mikun. Hebreu është mik në këtë qytet. Ti e di që miku s'jepet.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 63)

(7) *Lulja ka qëllim farën, por ajo e stolis dhe e mbulon embrionin e vet me bukurinë e petaleve, që të gënjejë e të tërheqë insektet për polenizim.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 446)

(8) *Është rregull klasik i atentateve, viktimës i zihet pritë në itinerarin rutinë.* (F. Kongoli, *Kufoma*, 1994, 21)

(9) *Ju e dini më mirë se unë se këto janë të zakonshme te vajzat e reja.* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 52)

(10) – *Ushtarit i vjen keq, kur shkon të dorëzohet, - tha papritur Dauti, si gjithnjë me tonin e një shakaje të zakonshme.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 17)

(11) *Unë e njoh mirë turkun. Ai përpiqet t'ia shtrembërojë shpirtin njeriut, ta bëjë armik të vetes së vet, të fisit të vet, shtypës të dheut të vet.* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 264)

Në gramatikën angleze kemi raste të foljeve⁸⁵ që përshkruajnë ndjenja e qëndrime dhe që përdoren ndonjëherë pa një kundrinor të drejtë, veçanërisht në formën e infinitivit, sepse kundrinori i drejtë tregon njerëz në përgjithësi: *Ai pëlqen të trondisë.* (*He likes to shock.*); Raste që lidhen me shenjimin negativ të kundrinorit, apo “*trajtë të shkurtër*”⁸⁶, një dhe shqipja:

(12) *Paji Harambash është i fortë, shkel, shtyp, vret.* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 105)

⁸⁵ “Verbs which describe feelings and attitudes can sometimes be used without an object, particularly in the ‘to’-infinitive form. This is because the object is assumed to be people in general. For example, ‘please’ usually requires an object, but you can say ‘He likes to please’, meaning he likes to please people.” COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 145

⁸⁶ “Edhe “trajta e shkurtër” mund të mos jetë te folja dhe atëhere, për analogji me mbaresën vetore, duhet folur për shenjim negativisht të kundranorit, për “trajta të shkurtër”zero. ... Kështu, ndërsa për kundranorin e shprehur me përemër vetor shenjimi bëhet thujse gjithmonë pozitivisht, për kundranorin e shprehur me emër a pjesë të emëruar të ligjëratës shenjimi bëhet edhe negativisht, kur mbi kundranorin bie theksi logjik, pra kur në perspektivën funksionale, shpreh remën e thënies, të renë në komunikim.” “Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe”, Remzi Përnaska, S. F. 1983/4, f. 191.

(13) *Se heshta e Arnautit **shpon**, shpata e Arnautit **pret**...* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 182)

(14) *Theodjorat⁸⁷, që me hiret e tyre **vrasin**; patrikët, që me dogmat e tyre **helmatisin**; levantinët, që me arin e tyre **mbytin**...* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 268-269)

Emrin me kuptim përgjithësues e kemi ndeshur edhe në funksion të përcaktorit e rrethanorit.

Përcaktorë me kuptim përgjithësues:

(15) *Deshi ta pyeste, ç'ke kështu, por butësisht, pa kurrfarë alarmi, siç pyetet partnerja naive, kur e mundon shkelja e **një premtimi**.* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 31)

(16) *Atëhere Petriti ndjeu ngazëllimin e **hetuesit** kur pikas që fajtori është minoren.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 376)

(17) *Dukej se Xhuzepja tani merrte frymë lirisht. Buzëqeshi. Dhe sa dritë jep buzëqeshja e **një të mjeri**.* (P. Marko, *Qyteti i fundit*, 2000,16)

(18) *Ndëshkime **qytetesh** kishte pasur gjithkund, aq sa, po ta mendoje gjatë, dukej se bota që nga fillimet e saj xanxën numër një kishte pasur pikërisht këtë gjë. Qytetet rrethoheshin, u pritej ujët, u pritej buka, goditeshin me top, u shkallmoheshin portat, u binin muret, digjeshin shkrumb, rrafshoheshin, madje u shkonte sipër parmenda e mbilleshin me kripë, për të mos mbirë më as bari. Kështu binin qytetet, me dëshpërim, por burrërisht, kurse kjo hedhje në erë ishte tjetër gjë...* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 21-22)

(19) *Në gojën e **shqiptarit** fjala ngahera ka pasur peshë të madhe kuptimore dhe ngarkesa emocionale.* (N. Jorgaqi, *Antologji e mendimit estetik shqiptar*, 2000, 7)

Rrethanorë me kuptim përgjithësues:

(20) *Anija, ku do të shkojmë ne, e ka kapitenin. **Në një anije** dy kapitenë s'ka, - ia priti rrëfyesi i anekdotave.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 16)

⁸⁷ Emër i më se një perandoreshe bizantine.

(21) Që ta gjesh **në një roman artistik** këtë dialog, asgjë të çuditshme nuk ka. (Panorama, 17 korrik 2011)

(22) E rëndë dhe e trishtuar është nata **në burg**. (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 16)

3.1.2.6. Zëvendësimi i një trajte të emrit me kuptim përgjithësues me një trajtë tjetër

Më lart pamë paradigmen e emrit me kuptim përgjithësues. Duke qenë se në secilën prej trajtave paradigmatiche të emrit mund të gjejmë përdorime me kuptim përgjithësues, le të shohim në vazhdim a janë të ndërkëmbyeshme këto trajta me njëra-tjetrën dhe në cilat kushte mund të realizohet zëvendësimi i tyre.

Le të analizojmë shembullin:

(1)

Si u hedhkan **fjalët** në erë? **Fjalën** po e hodhe në erë ecë dhe pa nxirre pastaj! (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 56)

Emri në shumës **fjalët** në fjalinë pyetëse rimarret në fjalinë pasuese, por duke u vendosur në numrin njëjës **fjalën**. Trajta e njëjësit mund të përdoret në vend të shumës pa cenuar kuptimisht fjalinë dhe kjo shpjegohet vetëm me faktin se janë emra me kuptim përgjithësues ku kuptimi mbi numrin zhduket dhe ne mund të përdorim çdo herë një trajtë të shumës për njëjësin dhe anasjelltas, pa cenuar kuptimin e fjalisë.

(2)

a) Dhe **arrestimet**, siç kishte lexuar te disidentët rusë, ashtu ndodhnin, në mënyrë të pabesueshme, tek ishe në kinema, për shembull, dhe fqinji yt, ai që në mënyrë naive, qeshte me çdo fjalë të personazheve dhe **ti** mendoje ç'janë ca njerëz të lumtur në këtë botë, kënaqen me gjithçka, ai pra, pikërisht, naivi, befas nxirrte nga xhepi një palë pranga dhe ti e ndieje se dora jote e djathtë ishte lidhur ndërkaq. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 69-70)

b) Dhe **arrestimi (një arrestim)**, siç kishte lexuar te disidentët rusë, ashtu ndodhte, në mënyrë të pabesueshme...

(3)

a) *Lulja ka qëllim farën, por ajo e stolis dhe e mbulon embrionin e vet me bukurinë e petaleve, që të gënjejë e të tërheqë **insektet** për polenizim.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 446)

b) *Lulja ka qëllim farën, por ajo e stolis dhe e mbulon embrionin e vet me bukurinë e petaleve, që të gënjejë e të tërheqë **insektin (një insekt)** për polenizim.*

(4)

a) *Ju e dini më mirë se unë se këto janë të zakonshme **te vajzat e reja**.* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 52)

b) *Ju e dini më mirë se unë se këto janë të zakonshme **te një vajzë e re (te vajza e re)**.*

(5)

a) *Nëna tha se këto gjëra nuk duhen vënë re kur ke të bësh me **të afërmit**. Llogaritë janë për **të huajt**, se djali mirë bëri që punoi, sa të rrinte rrugëve;* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 367)

b) *Nëna tha se këto gjëra nuk duhen vënë re kur ke të bësh me **një të afërm (të afërmin)**. Llogaritë janë për **një të huaj (të huajin)**, se djali mirë bëri që punoi, sa të rrinte rrugëve;*

Po dy trajtat e njëjësit, a mund të zëvendësojnë kurdoherë njëra-tjetrën? Sipas Çelikut “emri i pashquar me *një* mund të zëvendësohet nga emri në trajtë të shquar, përkundrazi emri i shquar nuk mund të zëvendësohet nga emri i pashquar me *një*,” (1971/1, f. 58)

Nga rastet e vëzhguara, mund të themi se këmbimi i dy trajtave të njëjësit shfaq problematikat e veta. Le të studiojmë rastet e të përpiqemi të zbulojmë faktorët që kushtëzojnë përdorimin e një trajte të emrit në vend të një tjetre (trajta e shquar në vend të trajtës së pashquar me një joshqese dhe anasjelltas).

(6)

a) ***Fëmija** nuk di të bëjë, të ndërtojë, ai di vetëm të çbëjë, të prishë...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 368)

b) ***Një fëmijë** nuk di të bëjë, të ndërtojë, ai di vetëm të çbëjë, të prishë...*

Në fjalinë (6) emri **fëmija** është emër me kuptim përgjithësues, në *funksion kryefjalë*. Në këtë rast, këmbimi i një trajte të emrit (trajta e shquar) me një tjetër (trajta e pashquar me *një*) është i mundshëm.

Po ashtu dhe në rastin në vazhdim:

(7)

- a) *Ndonjëherë nga goditjet e gazetave dhe shtëpive botuese mund të bëhesh i çmendur, por unë mendoj se i dituri më mirë të kthehet në të çmendur se në budalla, pasi budallai nuk ka alternativa.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 8)
- b) *... por unë mendoj se një i ditur më mirë të kthehet në të çmendur se në budalla, pasi një budalla nuk ka alternativa.*

Të njëjtën gjë do të thonim edhe për rastin (8), ku emri kryen *funksionin e kundrinorit të drejtë*:

(8)

- a) *Mos u mundo ta vësh hardhucën në bisht. Hardhuca nuk rri në bisht, - tha rrëfyesi i anekdotave.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 17)
- b) *Mos u mundo ta vësh një hardhucë në bisht. Një hardhucë nuk rri në bisht, - tha rrëfyesi i anekdotave.*

Për shembujt (6b), (7b) e (8b) mund të themi se përdorimi i trajtës së pashquar me njëjshme në vend të trajtës së shquar i jep emrit vlerë veçuese e intensifikuese. Duket se përmes kësaj trajte të emrit theksohet një individ/send i klasës që është njëkohësisht dhe përfaqësues i saj.

Por Galmiche (1985) do të veçonte raste kur ndërkëmbimi i trajtave të emrit në funksion të kundrinorit të drejtë është i pamundur. Ai shpjegon se prania e foljeve stativë (folje që emërtojnë gjendje)⁸⁸ lejon interpretim përgjithësues të emrit të shquar njëjshme e shumës, por

⁸⁸ "Stative verbs (or state verbs) describe a status or quality of something... NOT an action. Verbs of perception, opinion, the senses, emotion, possession, and state of being are often stative verbs." (Foljet stativë përshkruajnë një status apo cilësi të diçkaje ... JO një veprim. Foljet e perceptimit, opinionit,

jo për njëjësin e pashquar, në pozicionin e kundrinorit të drejtë⁸⁹. Shembulli që sjell Galmiche mendojmë se vlen, në përgjithësi, edhe për shqipen:

- a) *Ai e do pandën.*
- b) *Ai i do pandat.*
- c) *? Ai e do një panda.*

Por, shembulli nga korpusi ynë flet dhe për një tjetër përdorim. Folja stativ *dua* lejon interpretim përgjithësues edhe të emrit në njëjësin e pashquar me *një* në funksion të kundrinorit të drejtë:

(9)

- a) *Ç'e do **një libër** që s'flet për zemra, dashuri, të puthura?... – tha Petriti buzëprishur.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 417)

Këtë rast mund ta shpjegojmë me faktin se emri ndiqet nga një sifjali përcaktore që përcakton llojin e librit, klasën së cilës i takon ai, me karakteristikat e veta. Nëse fjalia nuk do të ndiqej nga sifjalia përcaktore, mendojmë se shpjegimi i Galmiche-it do të ishte i mjaftueshëm dhe për shqipen:

- a) *Ç'i do **librat!***
- b) *Ç'e do **librin!***
- c) *? Ç'e do **një libër!***

Le të shohim rastin e kundërt të emrit në funksion të kundrinorit të drejtë: zëvendësimin e emrit të pashquar me një joshqese me emrin e shquar:

(10)

- a) *Prandaj të vrisje **një mace** nuk ishte ndonjë gjë kushedi se çfarë.* (F. Kongoli, *Kufoma*, 1994, 30)

shqisave, emocioneve, posedimit dhe gjendjes së qenies janë shpesh folje stativë.)

<https://www.espressoenglish.net/stative-verbs-action-verbs-and-verbs-that-are-both/>

⁸⁹ “De leur côté, les verbes statifs autorisent la lecture générique des compléments du type *le N* et *les N* mais la refusent pour les compléments du type *un N*:

(43) Il aime /a. le panda. [g; b. les pandas. [g; c. un panda. [~g /... ” Galmiche, artikull i cituar, f. 8

b) *Prandaj të vrisje **macen** nuk ishte ndonjë gjë kushedi se çfarë.*

Për (10b) themi se ndërkëmbimi i emrit të pashquar me një joshqese me emrin e shquar nuk mund të realizohet. Emri i shquar **macen** për ne shënon një frymor të caktuar, të njohur nga thënësi e bashkëthënësi, një emër me kuptim të individualizuar. Emri i pashquar **një mace** bart kuptimin e llojit dhe emërton një specie që përfaqëson tërë klasën, një shembull të klasës që vlen për të gjithë anëtarët e tjerë. Kuptimi i individualizuar në rastin (10b) duket qartë edhe po ta vëmë fjalinë në një kontekst më të gjerë gjuhësor: *Prandaj të vrisje **macen** nuk ishte ndonjë gjë kushedi se çfarë. Por mënyra se si e vrau Valmiri macen e zezë të bodrumit më lemerisi.*

Ndërsa zëvendësimi i trajtës së pashquar me një *një* me trajtën e shquar, në funksion kundrinori të zhdrejtë pa parafjalë sjell ambiguitet, ndaj lind nevoja e një konteksti më të gjerë gjuhësor:

(11)

- a) *Po pikërisht kjo punë e kartvizitës është fyerja më e madhe që mund t'i bëhet **një vendi**.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 13)
- b) *Po pikërisht kjo punë e kartvizitës është fyerja më e madhe që mund t'i bëhet **vendit**.*

Edhe për raste të kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë, ashtu si në raste të kundrinorit të drejtë dhe kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë, e kundërta, zëvendësimi i trajtës së shquar të emrit me trajtën e pashquar me një *një* është i mundur:

(12)

- a) *Është rregull klasik i atentateve, **viktimës** i zihet pritë në itinerarin rutinë.* (F. Kongoli, *Kufoma*, 1994, 21)
- b) *Është rregull klasik i atentateve, **një viktime** i zihet pritë në itinerarin rutinë.*

(13)

- a) ***Ushtarit** i vjen keq, kur shkon të dorëzohet, - tha papritur Dauti, si gjithnjë me tonin e një shakaje të zakonshme.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 17)
- b) ***Një ushtari** i vjen keq, kur shkon të dorëzohet, - tha papritur Dauti, si gjithnjë me tonin e një shakaje të zakonshme.*

(14)

- a) Vetëm **te nëna** e gjen një dashuri të tillë..., - tundi kokën Arta. (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 418)
- b) Vetëm **te një nënë** e gjen një dashuri të tillë..., - tundi kokën Arta.

Edhe në funksion përcaktori a rrethanori mendojmë se vlejnë çka u tha më lart për të mundësuar ndërkëmbimin:

(15)

- a) Deshi ta pyeste, ç'ke kështu, por butësisht, pa kurrfarë alarmi, siç pyetet partnerja naive, kur e mundon shkelja **e një premtimi**. (I. Kadare, E pengua, 2009, 31)
- b) Deshi ta pyeste, ç'ke kështu, por butësisht, pa kurrfarë alarmi, siç pyetet partnerja naive, kur e mundon shkelja **e premtimit**.

(16)

- a) Atëhere Petriti ndjeu ngazëllimin **e hetuesit** kur pikas që fajtori është minoren. (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 376)
- b) Atëhere Petriti ndjeu ngazëllimin **e një hetuesi** kur pikas që fajtori është minoren.

(17)

- a) Nderin e **gruas dhe të vajzave** nuk e ruan çelësi i derës së shtëpisë, por tapanxha e portës së avllisë. (J. Xoxa, Lulja e kripës, 1, 1980 57)
- b) Nderin **e një gruaje dhe të një vajze / të vajzës** nuk e ruan çelësi i derës së shtëpisë, por tapanxha e portës së avllisë.

(18)

- a) Anija, ku do të shkojmë ne, e ka kapitenin. Në **një anije** dy kapitenë s'ka, - ia priti rrëfyesi i anekdotave. (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 16)
- b) Anija, ku do të shkojmë ne, e ka kapitenin. Në **anije** dy kapitenë s'ka, - ia priti rrëfyesi i anekdotave.

Nga analiza e shembujve dalim në përfundimin se janë faktorë të ndryshëm që mundësojnë ose pengojnë ndërkëmbimin e një trajte të emrit me kuptim përgjithësues me një tjetër, por, gjithsesi, më lehtë e këmbyeshme është trajta e shumësit me njëjtesin e anasjelltas, ndërsa

ndërkëmbimi i trajtës së shquar të emrit me trajtën e pashquar me nyjën *një* dhe e anasjellta janë në varësi të disa rrethanave e kushteve ligjërimore.

3.1.2.7. Nënlloji me kuptim përgjithësues

Raste të shoqërimit të emrit me kuptim përgjithësues me një përcaktor a sifjali përcaktore na çojnë te koncepti i nënklasës apo nënllojit të emrit me kuptim përgjithësues (Galmiche, 1985).

Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler (1987) veçojnë e shpjegojnë këtë përdorim: “Një emër në trajtë të pashquar, që shoqërohet me një joshquese ose me një atribut, mund të referojë në përgjithësi, kur është subjekt në një fjali me kuptim të përgjithshëm; atributi specifikon sfondin kuptimor të emrit-bërthamë; forma e pashquar, duke i hequr *një* mund të zëvendësohet me trajtën e shquar: *Një njeri/ njeriu i ndërgjegjshëm nuk e lë punën e sotme për nesër. Një fshat/fshati, që duket, s’do kallauz.*”⁹⁰

Çeliku (1971) e sheh si kuptim përgjithësues më të ngushtë të emrit dhe sjell shembullin: “*Një fëmijë që s’do nënën, që nuk e nderon atë, por sillet ashpër kundrejt saj, nuk është njeri, dhe do treguar me gisht përpara shoqërisë.*”

Interpretimet e mësipërme të çojnë te grupimi brenda klasës, në të cilin mund të gjejmë një individ/send që bart tipare të grupimit dhe e përfaqëson atë:

(1) *Një baba të tillë, pa dyshim, edhe unë do ta urreja. Kështu më duket i thashë, një baba të cilit nuk i dridhet dora të të rrahë në sy të të tjerëve, do ta urreja.* (F. Kongoli, *Kufoma*, 1994, 29)

⁹⁰ “Ein Subst in der unbest. Form, das mit dem unbestimmten Artikel und einem Attribut versehen ist, kann auch generell referieren, wenn es in einem generellen Satz als Subjekt fungiert - das Attribut spezifiziert den Bezugsrahmen des Kernnomens; die unbest. Form kann - unter Tilgung von *një* - durch die best. Form ersetzt werden: {*Një njeri / njeriu*} i ndërgjegjshëm nuk e lë punën e sotme për nesër. (De) ‘{Ein bewußter Mensch / der bewußte Mensch} verschiebt die Arbeit von heute nicht auf morgen.’ {*Një fshat / fshati*} që duket s’do kallauz. (De) ‘{Ein Dorf / das Dorf}, das zu sehen ist, braucht keinen Wanderführer.” f. 240

Përcaktori **të tillë** tregon tipare të frymorit **një baba**, tipare që e bëjnë përbërësin emëror në tërësi të shënojë një individ në kuptimin e nënllojit. Tiparet e dëftorit **të tillë** shpjegohen edhe në sifjalinë përcaktore që pason **të cilit nuk i dridhet dora të të rrahë në sy të të tjerëve**. Përbërësi **Një baba të tillë** është përbërës emëror me kuptim përgjithësues, i ndërtuar nga:

Një baba

+

të tillë

emër me kuptim përgjithësues (tregues i llojit) + përemër dëftor me kuptim përgjithësues (tregues i nënllojit)

Përcaktorët, me çfarëdo që të shprehen ato, të tipit të veçuar a të paveçuar, ngushtojnë kuptimin përgjithësues deri në nivelin e nënllojit. Këta përbërës, me *emra të nënklasës me kuptim përgjithësues*, i interpretojmë si përbërës me kuptim përgjithësues. Ato i takojmë në të njëjtat funksione sikurse paraqitëm edhe emrat me kuptim përgjithësues:

(2) **Një sy me përvojë**, sidoqoftë, nuk do ta kishte të vështirë të vinte re tek ai gjurmët e një nate pa gjumë. (F. Kongoli, Kufoma, 1994, 20)

(3) **Ai shkrimtar që ka frikë nga kritika**, dyshon për vlerën e veprës së tij. (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 7)

(4) *Agush Tomorrica donte ta thërriste Sefkën dhe ta vinte sy ndër sy me Tahirin, por kjo nuk iu duk e ndershme. Njerëzit e zakonit këtë nuk e bëjnë.* (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 66)

(5) *Pas një të ngrëni të mirë, e pas një të piri të mirë, i ziu njeri botën e sheh ndryshe. Edhe vetveten ndyshe e sheh.* (P. Marko, Nata e Ustikës, 1999, 81)

(6) **Njerëzit, të mefshtë dhe egoistë**, dobësi këto fatalisht të pandreqshme të racës së tyre, më të vështirë e gati të pamundur kanë futjen në përdorim të trurit. (F. Kongoli, Kufoma, 1994, 205)

3.1.2.8. Emrat e përgjithshëm konkretë / abstraktë me kuptim përgjithësues

Si emrat konkretë, edhe emrat abstraktë mund të përdoren si emra me kuptim përgjithësues:

(1) **A ngjitej dashuria si lëngata?** Me sa dukej, po. Ishte Linda B. Që e kishte sëmëmurur. (I. Kadare, E penguara, 2009, 142)

(2) **Tradhtitë** e mëdha s'kishin nevojë për të tillat, ngaqë ato shpikeshin. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 97)

(3) **Zinxhirët** janë të ftohtë, po e ndezin shumë **urrejtjen**. (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 53)

(4) Edhe kur mendoj për të djeshmen, them me vete: **e djeshmja** vërtet nuk nxiton, por ngacmon **të sotmen**. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 7)

(5) **Lufta** vërtet është e tmerrshme, ajo nuk i ngjet **një dasme**. Ndodhin në të ngjarje të tilla që e tronditin shumë **njeriun**. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 36)

3.1.3. Emrat e përveçëm⁹¹ me kuptim përgjithësues

«Emrat e përveçëm janë fjalë që emërtojnë veta, frymorë të tjerë dhe sende të veçanta, që bëjnë pjesë në një klasë sendesh të një fare, pa pasur në vetvete asnjë tregues të veçantë të klasës së cilës i përkasin.» (G.A., 1995, 83) Por emri i përveçëm mund të përdoret edhe për të emërtuar një kategori të caktuar njerëzish, një klasë frymorësh që bashkohen nga tiparet që karakterizojnë emrin e përveçëm, i cili e ka humbur tashmë funksionin për të treguar vetëm një frymor të veçantë:

(1) Ç'kërkojnë atje? Mos pandehin ata se këngët e tyre do të jenë më të bukura se ato të Naimit, të Çajupit?... *Literatura e Rilindjes sonë e arriu kulmin dhe e arriu për bukuri. Nuk kanë se si dalin më bukurira si "Historia e Skënderbeut". Nuk dalin sepse sot, që jemi të lirë, ndjenjën atdhetare e kemi më të vakët nga ç'e kishin Naimët.* (N. Jorgaqi, *Antologji e mendimit estetik shqiptar*, 2000, 330)

Në shembullin (1) është dhënë rasti i përdorimit të emrit të përveçëm **Naimit/Naimët** edhe me kuptim të individualizuar, për të shënuar një person të veçantë, rilindësin tonë të shquar (të Naimit), edhe me kuptim përgjithësues (**Naimët**), për të shënuar këdo që karakterizohet nga atdhetarizmi, përfshi edhe vetë Naimin.

⁹¹ "Shkruhen me shkronjën e parë të madhe emrat e mbiemrat e përveçëm, të cilët, megjithëse përdoren për të shënuar një kategori të caktuar njerëzish, nuk janë kthyer në emra të përgjithshëm..." *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973, 72.

(2) Në një rast tjetër hetuesi, me të dëgjuar se dëshmitari e merrte në telefon, do të ngrihej, natë a mesnatë qoftë, i vetëm a me grua në shtrat, për të rendur nëpër borë a shi, gjithë mirënjohje, gati t'i binte në gjunjë dëshmitarit, për shenjën e komplotit, të rebelimit, të **Jan Palashit**⁹² shqiptar, kurse ky këtu heshte si korb. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 50)

Emri i përveçëm **Jan Palashit** në këtë fjali e ka humbur funksionin e të treguarit një person të identifikueshëm, të veçantë. Ai ka fituar statusin e një emri që emërton një individ të një klase të caktuar që bart tiparet e klasës dhe e përfaqëson atë: pra, klasën e individëve që vetëflijohen për një kauz. Kështu, ai mund të interpretohet si *emër i përveçëm me kuptim përgjithësues*.

Mendimin se emri i përveçëm e ka humbur funksionin e tij si emër për të shënuar një individ të veçantë e mbështesim dhe me faktin se ne mund të vendosim para tij një joshqese *një* e cila, siç dihet, është karakteristikë e emrave të përgjithshëm dhe shërben për të veçuar një element nga klasa që i përket:

..*gati t'i binte në gjunjë dëshmitarit, për shenjën e një komploti, të një rebelimi, të një Jan Palashi* shqiptar, kurse ky këtu heshte si korb.

Gjithashtu, emri i përveçëm i përgjigjet paradigmës së emrit me kuptim përgjithësues:

(2)

a) *Në një rast tjetër hetuesi, me të dëgjuar se dëshmitari e merrte në telefon, do të ngrihej, natë a mesnatë qoftë, i vetëm a me grua në shtrat, për të rendur nëpër borë a shi, gjithë mirënjohje, gati t'i binte në gjunjë dëshmitarit, për shenjën e komplotit, të rebelimit, të Jan Palashit* shqiptar, kurse ky këtu heshte si korb.

b) *.. gati t'i binte në gjunjë dëshmitarit, për shenjën e një komploti, të një rebelimi, të një Jan Palashi* shqiptar, kurse ky këtu heshte si korb.

c) *.. gati t'i binte në gjunjë dëshmitarit, për shenjën e një komploti, të një rebelimi, të Jan Palashëve* shqiptarë, kurse ky këtu heshte si korb.

Siç shihet, emri i përveçëm mund të përdoret në të tria trajtat (e shquar njëjës e shumës, e pashquar njëjës me një joshqese *një*).

⁹² *Jan Palach*-i ishte një student çek i cili kreu vetëfljim duke i vënë flakën vetes në shenjë proteste kundër pushtimit të Çekoslovakisë nga Bashkimi Sovjetik, në gusht të vitit 1968.

Emrin e përveçëm me kuptim përgjithësues e gjejmë edhe te Charaudeau (1992), por jo në të gjitha trajtat sikurse emri i përgjithshëm me kuptim përgjithësues⁹³.

(3)

- a. *Një **Promete** i ditëve tona.* (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973, f. 72)
- b. ***Prometeu** i ditëve tona.*
- c. ***Prometetë** e ditëve tona.*

Ndryshe nga emri i përgjithshëm me kuptim përgjithësues, emri i përveçëm me kuptim përgjithësues duket se nuk këmben formën e tij të shumësit me formën e njëjësit:

(4)

- a) *Për më tepër të më vinin një emër të rëndomtë, Festim. Nuk kam gjë kundër këtij emri. **Festimët** ta gëzojnë. Por unë nuk arrij të gjej një lidhje midis meje dhe emrit Festim.* (F. Kongoli, Kufoma, 1994, 39)
- b) *? Për më tepër të më vinin një emër të rëndomtë, Festim. Nuk kam gjë kundër këtij emri. **Festimi** ta gëzojë.*
- c) *? Për më tepër të më vinin një emër të rëndomtë, Festim. Nuk kam gjë kundër këtij emri. **Një Festim** ta gëzojë.*

(5)

- a) *Janë të rrallë në histori **Gjergj Kastriotët**.* (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973, 72)

⁹³ "zéro /le /un:

- devant un **nom propre** de personne

'Sartre n'aurait jamais écrit ça' (la personne même de Sartre. L'identification est absolue).

'Le Sartre militant n'aurait jamais dit ça' (la personne de Sartre spécifiée. L'identification est spécifiée).

'Un Sartre n'aurait jamais écrit ou dit ça' (toute personne appartenant à la classe Sartre, quelqu'un comme Sartre et donc Sartre lui-même. L'identification est posée à travers l'exemple)." (nyjat:

- përpara emrit të përveçëm

'Sartri nuk do ta kishte shkruar kurrë atë' (vetë personi i Sartrit, identifikimi është absolut).

'Sartri militant nuk do ta kishte thënë kurrë atë' (personi i Sartrit i specifikuar, identifikimi është i specifikuar).

"Një Sartrë kurrë nuk do ta kishte shkruar apo thënë atë" (të gjithë që i përkasin klasës Sartre, dikush si Sartri, edhe Sartri vetë, identifikimi është sjellë përmes shembullit.) Vepër e cituar, f. 182-183

- b) ? Është i rrallë në histori **Gjergj Kastrioti**.
- c) ? Është i rrallë në histori **një Gjergj Kastriot**.

(6)

- a) Kemi dhe ne **Homerët** tanë. (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973, 72)
- b) ? Kemi dhe ne **Homerin** tonë.
- c) ? Kemi dhe ne **një Homer** tonin.

3.1.4. Emrat e lëndës me kuptim përgjithësues

Emrat e lëndës emërtojnë një lëndë homogjene që mund të ndahet në pjesë dhe të peshohet, por që nuk mund të numërohet. G.A. (1995, 87) veçon: “Me kuptimin e lëndës në përgjithësi, pra me kuptim përgjithësues, emrat lëndorë, sidomos kur ka krahasime, mund të shoqërohen nga numërori *një* me vlerën e një përemri të pacaktuar: **Një ujë** si ky të kënaq. **Një duhan** i tillë s’ka të paguar.”

Siç shihet, G.A., ndër shembujt që sjell për rastet e veçanta të shoqërimit me numërorin *një* të emrave të lëndës, veçon dhe emrat me kuptim përgjithësues.

Le të analizojmë shembujt e dhënë më lart. Ç’faktorë mundësojnë, në këtë rast, interpretimin përgjithësues për emrat e lëndës: *ujë* dhe *duhan*?

Një **ujë** si ky të kënaq.

Një duhan i tillë s’ka të paguar.

Siç e kemi paraqitur dhe më lart, kemi të bëjmë me një përbërës emëror me kuptim përgjithësues të ngushtë, të kufizuar. Mendojmë se emrat *një ujë*, *një duhan* në këtë përdorim janë emra me kuptim përgjithësues. Trajta e pashquar e emrave është shoqëruar nga përcaktorët: emri *një ujë* nga krahasimi (*si ky*) dhe emri *duhan* nga përemri dëftor (*i tillë*), të cilët, ndonëse aktualizojnë, përfaqësojnë nënlojin (*si ky; i tillë*). Mendojmë se kuptimi përgjithësues lidhet dhe me foljen: koha, e tashmja gjithkohore (*kënaq, s’ka të paguar*), pse jo dhe kuptimi leksikor i foljes lejojnë interpretim përgjithësues. Nëse përdorim një tjetër folje për secilën nga fjalitë, p.sh.: **Më jep një duhan** apo **Bleva një ujë**,

është e qartë se përdorimi nuk lejon më interpretim përgjithësues. Si përfundim, emrat e lëndës në shembujt e mësipërm janë emra me kuptim përgjithësues dhe kuptimin përgjithësues e mundësojnë të gjitha elementet të marra së bashku.

Emrat e lëndës me kuptim përgjithësues mund të jenë dhe në trajtë të shquar:

(1) - *He-he, - qeshi rrëfyeti i anekdotave, - he-he, **gjalpi** me **ujë** nuk përzihet, he-he.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 16-17)

(2) *Kishte nga ata që mendonin se, sado nazikë të ishin, mund t'i kishin marrë të dyja, emra e nofka, siç blihej nganjëherë **gruri** bashkë me **kashtën**.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 59)

(3) *Ungji vazhdonte të mbante vesh rrëfimin e nipit rreth shpirtit të vet të çuditshëm e të ngatërruar dhe mendonte se nuk ka gjë më të bukur, sesa kur nxjerr ujë nga një pus i thellë. Andej **ujët** s' del kurrë i turbullt dhe rrekja një kohë të gjatë me litarët e kovës ndër duar i jep më vlerë punës që bën.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 317)

3.1.5. Raporti kuptim përgjithësues – kuptim i caktuar/i pacaktuar

Kuptim i caktuar i emrit quhet përgjithësisht kuptimi i emrit në trajtë të shquar dhe kuptim i pacaktuar ai i emrit të pashquar. Cipo (1949) dhe Gramatika e Akademisë (1995) njeh trajtën e shquar të emrit në opozicion me trajtën e pashquar të tij, pasi i përgjigjet kuptimit gramatikor të caktuesisë e pacaktuesisë.

Shaban Demiraj (1972) saktëson: “Termet i shquar/i pashquar janë përdorur sipas traditës gramatikore shqiptare, për të vënë në dukje nëse emri në shqyrtim është i pajisur me nyje shquese apo jo. Kurse termet i caktuar/i pacaktuar janë përdorur për të vënë në dukje nëse emri në shqyrtim është kuptimisht i caktuar apo i pacaktuar. Një emër është kuptimisht i caktuar, kur shenjon një a disa sende, që folësi i paraqit si të njohura jo vetëm prej tij, por edhe prej bashkëbiseduesit. Kurse kuptimisht i pacaktuar emri është atëherë kur shenjon një a disa sende, që folësi i paraqit si të njohura vetëm prej tij e, si rrjedhim, të panjohura prej bashkëbiseduesit.” (Demiraj, 1972, 25-26)

Rami Memushaj (2008)⁹⁴ sheh shquarsinë/pashquarsinë si kategori tipike të emrit (të përgjithshëm) që gjendet në disa gjuhë, e cila mund të shënojë ose mbarë klasën e sendeve, ose një nga sendet e klasës. Për të në rastin e parë emri përdoret me kuptim të përgjithësuar, në rastin tjetër me kuptim të individualizuar. “Pra, individualizmit, që është një koncept logjik, në gjuhë i përgjigjet kategoria semantike kuptim i pacaktuar/kuptim i caktuar, e cila shprehet formalisht me anën e nyjave joshquese përkatësisht shquese.” (Memushaj, 2008, 222)⁹⁵

Në gramatikën e Oda Buchholz-it dhe Wilfried Fiedler-it veçojmë: “Kategoria morfologjike *e caktuar/ e pacaktuar* manifestohet në ekzistencën e dy formave të emrit: formë e shquar/ formë e pashquar... Funkcioni kryesor i kategorisë shquarsi/pashquarsi ka të bëjë me shprehjen e kategorisë funksionale-semantike të caktueshmërisë/pacaktueshmërisë, të cilat përcaktohen (kryesisht) në procesin e komunikimit, në situatën komunikative ose në kontekst, po janë të lidhura dhe me kuptimin referencial të emrave. Për shprehjen e kategorisë i caktuar/ i pacaktuar gjuha shqipe shërbehet nga një sasi mjetesh që u përkasin shtresave të ndryshme gramatikore... Mjetet e ndryshme të shprehjes, që mund të dalin dhe të kombinuara, kundrejt kategorisë funksionale-semantike të caktueshmërisë/pacaktueshmërisë dhe midis tyre kanë lidhje të ndërsjella të komplikuar. Nga njëra anë zgjedhja e mjeteve shprehëse përcaktohet nga kategoria funksionale-semantike, nga ana tjetër refleksët morfologjike i caktuar/i pacaktuar varen në një masë të madhe nga struktura e grupit emëror, e cila ndikohet dhe nga zgjedhja e mjeteve leksikore dhe nga funksioni sintaksor i grupit emëror.”⁹⁶

⁹⁴ “Hyrje në gjuhësi”, Tiranë, 2008

⁹⁵ Memushaj e sheh përdorimin e nyjave si mjet për shprehjen e shkallës së individualizimit të emrit, ndërsa mungesën e tyre si tregues të kuptimit përgjithësues.

⁹⁶ “Die morphologische **Kategorie der Bestimmtheit/Unbestimmtheit** (i. folg. kurz: Kategorie der Bestimmtheit) manifestiert sich in der Existenz zweier Formens des Nomens, die sich aufgrund der Anwesenheit bzw. Abwesenheit des Bestimmtheitszeichens (BZ) unterscheiden: **bestimmte Form** (mit BZ) - **unbestimmte Form** (ohne BZ) ... Die Hauptfunktion der morphologischen Kategorie der Bestimmtheit besteht im Ausdruck der funktional-semantischen Kategorie der Determiniertheit/Indeterminiertheit, deren Unterkategorien Determiniertheit und Indeterminiertheit (i. folg. auch als Merkmale: determiniert/indeterminiert) im wesentlichen durch die Gegebenheiten des Kommunikationsprozesses, insbesondere durch den sprachlichen Kontext (kontextuelle Bedingungen) und die jeweilige Kommunikationssituation (konsituative Bedingungen), sowie durch die referentielle Bedeutung der Nomina

Georges Kleiber⁹⁷ e paraqet opozicionin i caktuar/i pacaktuar në tri nivele: planin morfologjik (nyja shquese/joshquese); planin sintaksor ose funksional (me determinantët); planin nocionor, ku ndryshimi i caktuar/i pacaktuar i korrespondon një opozicioni konceptual, semantik a pragmatik, në mënyrë të pavarur nga kategoritë morfologjike a sintaksore.

Kleiber i bashkon në një raport të dyfishtë tri planet e lartpërmendura: raporti i planit formal me atë nocionor dhe raporti hierarkik mes tri planeve. Raporti që vendoset mes këtyre planeve duket se sjell ekuivoke: *Nëse kemi një përbërës emëror, PE (SN) semantikisht të caktuar/të pacaktuar, ne ia japim vlerën e caktueshmërisë/pacaktueshmërisë nyjave, por kjo gjë mund të çojë në mospërputhje midis të caktuarit semantik dhe të caktuarit/të pacaktuarit morfologjik; mund të arrijmë në një PE (SN) të pacaktuar semantikisht, por që ka një nyjë shquese ose, anasjelltas, në PE (SN) të caktuar semantikisht, por me një joshquese.*⁹⁸

Për të zgjidhur këto raste, Kleiber rendit 4 arsye të ndryshme për të cilat një PE (SN) mund të jetë përcaktuar si e caktuar/e pacaktuar:

- “Sepse përmban një nyjë të shquar/të pashquar (të caktuar/të pacaktuar);
- Sepse ka një determinant të caktuar/të pacaktuar;
- Sepse është vetë një kategori formale e veçantë e caktuar/e pacaktuar;

bestimmt

werden.

Zum Ausdruck der Kategorie der Determiniertheit/Indeterminiertheit verfügt das Alb. über eine Reihe von Mitteln, die verschiedenen Ebenen der Grammatik angehören.... Die verschiedenen Ausdrucksmittel, die auch kombiniert auftreten, stehen zur funktional-semantischen Kategorie der Determiniertheit/Indeterminiertheit und zueinander in komplizierten Wechselbeziehungen. Einerseits wird die Wahl der Ausdrucksmittel weitgehend durch die funktional-semantische Kategorie bestimmt, andererseits hängen die morphologischen Reflexe der Detminiertheit/Indeterminiertheit in besonderem Maße von der Struktur der NG, die auch durch die Wahl der lexikalischen Mittel beeinflusst wird, und von der syntaktischen Funktion der NG ab.” f. 233

⁹⁷ Georges Kleiber, “Çfarë është i (pa)caktuar?” (“Qu’est-ce qui est (in)défini?”, *Faits de langues*, 1994/4

⁹⁸ “... si un SN est considéré comme sémantiquement défini ou indéfini, on pourra porter au crédit du déterminant cette valeur définie ou indéfinie et donc parler de déterminant défini ou indéfini. Une telle ‘descente’ peut alors conduire à un discordance révélatrice entre la définitude sémantique et le défini/indéfini morphologique, puisqu’en plus des passages congruent l’opération peut aboutir sur un SN sémantiquement indéfini, mais qui possède un article défini ou, inversement, sur un SN sémantiquement défini, mais avec un article indéfini.” Poaty, f. 86

- Sepse i përgjigjet nocionit semantik i caktuar/i pacaktuar, pavarësisht një shprehjeje të veçantë.”⁹⁹

Siç mund ta vëmë re edhe nga shembujt, dallimi nuk mund të bëhet gjithmonë midis tyre. Ne kalojmë nga njëri nivel te tjetri sepse nivelet janë të ndërlidhura dhe raporti hierarkik dhe lidhja mes formës e përmbajtjes bëjnë që një përbërës sintaksor të jetë i caktuar/i pacaktuar. Dhe Klieber vetë nuk është shumë i kënaqur me të, sepse nocioni i caktuar/i pacaktuar, edhe pse ka lidhje evidente, nuk mund të jetë i njëjti në të katër nivelet, por të vlefshme ai quan së paku tri nivelet formale të nyjës, determinantit dhe të përbërësit emëror (SN). Përcaktimi i caktuar/i pacaktuar duhet të ketë parasysh marrëdhënien që ekziston mes tri niveleve dhe të mund të shpjegojë rolin e nyjës në karakterin të caktuar/të pacaktuar të determinantit dhe rolin e këtij të fundit në statusin e caktuar/e pacaktuar të përbërësit.

Le të shqyrtojmë rastet:

Njoh **një tip** që e bën këtë punë. dhe

Njoh **tipin** që e bën këtë punë.

Si do t'i shpjegojmë këta dy shembuj kuptimisht të pacaktuar? Janë të dyja raste ku **tipi** njihet nga folësi dhe jo nga dëgjuesi. Por, nga ana tjetër, vetëm rasti i parë, emri me një të pashquar është morfologjikisht e semantikisht i pacaktuar, në rastin e dytë emri është në të shquar, morfologjikisht i caktuar e semantikisht i pacaktuar.

Siç vihet re, një prej planeve, p.sh. ai morfologjik apo sintaksor është i pamjaftueshëm në raste të caktuar për përcaktimin e emrit si kuptimisht të caktuar/të pacaktuar. Prandaj, ne

⁹⁹ “i. parce qu’il comporte un défini ou un indéfini morphologique (article défini ou article indéfini ou autre morphème dit *indéfini*).

ii. parce qu’il a pour déterminant un déterminant dit *défini* ou *indéfini*.

iii. parce qu’il est lui-même, c’est-à-dire en tant que catégorie formelle particulière, défini ou indéfini.

iv. parce qu’il répond à la notion sémantique de *défini* ou *indéfini* déterminée indépendamment d’une expression particulière.” Po aty, f. 87

mund t'i referohemi zgjidhjes së Kleiber, të shohim secilin prej niveleve që të japim një përcaktim sa më të saktë.

Pra, caktuesia nuk lidhet gjithmonë me trajtën e shquar të emrit dhe pacaktuesia me trajtën e pashquar të tij. Dhe Demiraj vëren se termat i shquar/i pashquar nuk përputhen plotësisht me termat kuptimisht i caktuar/i pacaktuar.

Duket se këtë situatë e ndërlikojnë më tepër emrat me kuptim përgjithësues që janë sa në formën e shquar e aq në të pashquarën. Si do t'i përcaktonim ata?

Demiraj është i mendimit se opozicioni i caktuar/i pacaktuar mund të përftohet te të gjithë emrat që emërtojnë sende konkrete ose gjëra abstrakte të numërueshme, të individualizueshme, që emërtojnë një a disa ekzemplarë të një klase, jo tërë klasën. "... kjo kundërvënie kuptimore nuk mund të përftohet atëhere kur një emër i përgjithshëm përdoret për të emërtuar mbarë klasën përkatëse, dmth, kur përdoret me një kuptim të përgjithësuar (kategorial). Një emër me kuptim të përgjithësuar, qoftë në trajtë të pashquar ose në të shquarën, është kuptimisht i caktuar; në cilëndo trajtë qoftë, ai shërben për të dalluar një klasë sendesh homogjene nga klasët e sendeve të tjera. Në të tilla rrethana nuk mund të flitet për kategori shquarësie dhe pashquarësie, përderisa kundërvënies formale nuk i përgjigjet dhe kundërvënia kuptimore përgjegjëse." (Demiraj, 1972, 27)

Për Demirajn, në rastin e emrave me *kuptim përgjithësues* përdorimi i trajtës së shquar apo të pashquar *ka karakter thjesht formal dhe kushtëzohet nga funksioni sintaksor*, ndërsa *kuptimi përgjithësues*, sipas tij, nuk i atribuohet nyjës shquese, por vetë *emrit të përgjithshëm si emërtues i mbarë klasës përkatëse*. Siç vihet re, Demiraj i sheh emrat me kuptim përgjithësues kuptimisht të caktuar.

Për Kleiber një SN e pacaktuar përgjithësuese (*Un chien*) është semantikisht e caktuar, sepse ka objekt klasën e qenve, por morfologjikisht e pacaktuar (nyja e pashquar).

Teza e Demirajt dhe e Kleiber-it se emrat me *kuptim përgjithësues*, qoftë në trajtë të pashquar, qoftë në trajtë të shquar janë *kuptimisht të caktuar*, na duket e drejtë. Si nga folësi, edhe nga dëgjuesi njihet klasa të cilën shenjon emri përgjithësues. Pavarësisht

pacaktueshmërisë/caktueshmërisë formale, emrat me kuptim përgjithësues janë semantikisht të caktuar.¹⁰⁰

3.2. Përemrat me kuptim përgjithësues

Si karakteristikë e përemrave është funksioni i tyre joemërtues, por tregues.

Në Gramatikën e Akademisë (1995, 215), kreu VI, përemri cilësohet si “një pjesë e ligjëratës që tregon në mënyrë të përgjithshme, pa i emërtuar, frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuara. Kuptim konkret përemri merr në kontekst, në kushtet e ligjëritimit të lidhur.”

Në shqyrtimin e çështjes sonë në vëmendje do të jenë përemrat vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronorë, lidhorë e të pacaktuar.

3.2.1. Përemrat vetorë me kuptim përgjithësues

Përemrat vetorë¹⁰¹ përshkruhen si një sistem me tri veta, njëjës e shumës: veta e parë (*unë, ne*), personi folës është në opozicion me vetën e dytë (*ti, ju*), personin të cilit i flet folësi. Veta e tretë nuk është pjesë e këtij sistemi opozicional. Si vetorë të vetës së tretë përdoren dëftorët (*ai/ajo, ata/ato*)¹⁰².

¹⁰⁰ Në gjuhën angleze shohim se caktueshmëria lidhet me diçka të identifikueshme në një kontekst të dhënë ose në dijen e përgjithshme që zotëron folësi e dëgjuesi e cila mund të konsiderohet *referencë e situatës*. *Referenca e situatës* është *immediate* (e menjëhershme) ose më e *gjërë*, e cila (kjo e fundit) shpesh përputhet me përdorime me kuptim përgjithësues (*larger situational reference often overlaps ëith generic use*). (Sidney Greenbaum, Randolph Quirk, 1990, 78)

¹⁰¹ “Dans la tradition grammaticale, les pronoms personnels sont traités comme une *partie du discours* à part, hors du groupe nominal et du groupe verbal, et la plupart du temps dans une chapitre qui regroupe toutes les sortes de pronoms...” (Në traditën gramatikore, përemrat vetorë janë trajtuar si pjesë e komunikimit, përtej grupit emëror dhe grupit foljor, dhe në pjesën më të madhe të kohës në një kapitull që përfshin të gjitha llojet e përemrave...) Charaudeau, vepër e cituar, f. 119

¹⁰² E. Benveniste, raportin që ekziston mes tri vetave, e sjell përmes përcaktimeve të gramatikanëve arabë:
veta I – ai që flet (*celui qui parle*);
veta II – kujt i drejtohet (*celui à qui on s’adresse*);

Është e njohur se funksioni parësor i përemrave vetorë (veta I dhe II) është shenjimi i roleve që kanë ata në komunikim, por janë të njohura dhe rastet (G.A., 1995) kur përdoret shumësi *ju* për njëjës in e politesës, apo shumësi *ne* i modestisë për njëjës in shkencor¹⁰³: *Pa mohuar kontributin e çdo populli ballkanik në krijimin e variantit kombëtar të këtyre dy legjendave me nënshtrat universal (secili popull e ka përpunuar variantin sipas traditave të strukturës së vet shpirtërore), duhet thënë, megjithatë, fjala jonë për autorsinë e tyre. Dhe ne kemi arsye të mjafta për ta bërë këtë.* (I. Kadare, *Autobiografia*, 2002, 24)

Këto përdorime varen nga konteksti dhe situata. Por, përemrat vetorë, në rolin e një kryefjale a kundrinori, në një kontekst a situatë të caktuar, gjithashtu, njohin dhe përdorime me kuptim përgjithësues.

3.2.1.1. veta e parë (unë, ne)

Vetori **unë/ne** me kuptim përgjithësues realizohet në ato kushte kur thënësi vendoset në vend të një vepruesi abstrakt që shpreh një veprim të përgjithshëm. Vetori **unë/ne** e merr këtë përgjithësim si të vetin si për të dhënë një shembull që i lejon ta personalizojë përgjithësimin.

veta III – ai që nuk është i pranishëm (*celui qui est absent*).

Benveniste e sheh vetën e 3-të si një tregues të thënies mbi dikë ose diçka, por nuk paraqet një person specifik. Benveniste e sheh si një invariant të qenësishëm për të gjitha format e zgjedhimit. ("La forme dite de 3^e personne comporte bien une indication d'énoncé sur quelqu'un ou quelque chose, mais non rapporté à une "personne" spécifique. L'élément variable et proprement "personnel" de ces dénominations fait ici défaut. C'est bien l'"absent" des grammairiens arabes. Il ne présente que l'invariant inherent à tout forme d'une conjugaison. La conséquence doit être formulée nettement: La "3^e personne" n'est pas une "personne"; c'est même la forme verbale qui a pour fonction d'exprimer la *non-personne*." *Problèmes de linguistique générale*, 1, Emil Benveniste, Gallimard, 1996, f. 227-228

¹⁰³ R. Përnaska në "Gjuhësi... gjuhësore", Maluka 1, f. 198-214 trajton vetat. Ndër të tjera ai paraqet dhe kuptime të vetorit *ne*: "NE jeh edhe një përdorim të quajtur "të autorit", sidomos në vepra shkencore, politike, etj. Ky përdorim lejon që fjalët të merren përsipër nga një UNË, veçse: 1. Thënësi nuk flet në emër të vet, por në emër të shkencës vetë, në emër të të gjithë shkencëtarëve, politikanëve, etj., që kanë të njëjtën ide. Thënësi në këto raste është, si të thuash, "dorëzanës, delegat" i një kolektivi shkencor, politik, etj. 2. NE lejon që edhe bashkëthënësi të shtihet në kumtim e të dy së bashku, por gjithnjë nën udhëheqjen e thënësit shkencor a politikan që është fshehur pas NE, të arrijnë në të njëjtin përfundim."

Në gjuhën frënge gjejmë përdorime të një **unë** si një individ që vlen për të gjithë, konsideruar si procedeja e shembullit që duhet ndjekur: *Nesër, unë votoj (= votoni)*¹⁰⁴, por edhe një **unë** për një vetë të tretë, kolektive (**on**) në eksperimente shkencore: *Nëse unë shtoj nitratin argjendi në këto pak pika klorur natriumi, përftoj klorur argjendi. (Si j'ajoute à ces quelques gouttes de chlorure de sodium du nitrate d'argent, j'obtiens un précipité de chlorure d'argent.)*; në artikuj polemikë, maksima etj. (Charaudaou, 1992, 142)

Në letërsinë gjuhësore shqipe nuk kemi hasur përdorime të tilla për vetën e parë njëjës. Veta e parë njëjës njihet përdorim të individualizuar: **Unë** jam një murg i vetmuar dhe ti me motrën tënde jeni murgesha. **Mua** të gjithë njerëzit më kanë ikur. Dhe **unë** kam mall. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, f. 129)

Njihet dy përmbajtje të ndryshme të shumësit **ne**:

- forma inkluzive **ne** = *unë + ju (ti)*: - **Ne** miq kemi qenë dhe miq mbetemi, or Osman Mejdani! Vetëm thuajti të dalin ata të tre që ke brenda! – thirri Kalem Gashi me një zë të trashë si nëpër hundë. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 137)
- forma ekskluzive **ne** = *unë + ata (ai)*: - Po të të zbojnë ty, bëjmë grevë **ne**..., - tha Peri i Këputur. (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 393)

Por shumësit **ne** i njihet dhe një tjetër përmbajtje: **ne** me kuptim përgjithësues.

(3) - **Ne** shpesh mbrojmë atë që s'është për t'u mbrojtur, se kështu mbrojmë veten tonë. Unë do të thosha se edhe ti je i po asaj kategorie ku bën pjesë edhe ajo... – tha babai me ton të rëndë. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 206)

(4) Mijëra shkencëtarë po studiojnë atë sesi sjellja reale ndryshon nga mënyra sesi **ne** hamendësojmë se sillen njerëzit. (“Mapo”, 19 korrik 2011)

¹⁰⁴ “Demain, **je** vote (voterez).... *Procédé d'exemplarité* Mise en scène d'un locuteur qui décrit ce qu'il fait sur le mode du constat ou de l'évidence. Celui-ci se présente comme un exemple à suivre. Du même coup, l'interlocuteur est appelé à suivre cet exemple; en s'appropriant la parole du **je**, il deviendra lui-même un modèle pour les autres.

Remarque: L'interlocuteur-récepteur est *multiple* de par la situation de communication. Mais il est appelé à devenir unique à travers le **je**. Un unique qui vaut pour **tous**.” f. 142

(5) *Ka turp! Mendova unë me sarkazëm. E dimë ne, e dimë sa turp kini ju infermieret!* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 303)

Edhe gjuha angleze dhe frënge njih raste të përdorimit të vetës I shumës me kuptim përgjithësues.¹⁰⁵

3.2.1.2. veta e dytë (ti, ju)

ti

Remzi Përnaska, në "Gjuhësi... .. gjuhësore" I, Maluka, pohon: "TI përgjithësuese "personalizon" thënie pavetore (impersonale) me vlerë të përgjithshme. Në këtë rast, lidhja me situatën e të thënit mbetet e gjallë, bashkëthënësi i përfaqësuar nga "TI përgjithësuese" jepet sikur të merrte pjesë në proces, si viktimë, përfitues, etj. Për të mos u zgjatur në këtë pikë, le të analizohet një thënie e dykuptimshme si kjo: *Me njerëz të tillë ti çan malet*. Në njërin kuptim, TI do të thotë bashkëbiseduesi, në tjetrin merr vlerën *kushdo, gjithsecili*, etj., ndër ta edhe bashkëbiseduesi." (f. 208)

Kemi parë se veta e dytë numër njëjës si vetë me kuptim përgjithësues është evidentuar edhe nga M. Çeliku në "Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe", Elbasan, 1980, (leksione), nga Gramatika e Akademisë (1995), (2002)"¹⁰⁶, "Gramatika praktike e gjuhës shqipe", M. Çeliku, M. Karapinjalli, R. Stringa, 1998, si dhe Ludmila Buxheli në "Foljet njëvetore në gjuhën shqipe" (2011).

Duhet thënë se vetori i vetës së dytë njëjës është vetori më i përdorur me kuptim përgjithësues.

¹⁰⁵ "... any group which you fell yourself to be part of, such as a school, your local community, or even mankind as a whole.

we are in fact a multicultural society.

We all need money." (... çdo grup, pjesë e të cilit e ndieni veten, si: në shkollë, komunitet ose dhe në mbarë gjininë njerëzore: Ne të gjithë kemi nevojë për para.) COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 30

¹⁰⁶ Në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1980) nuk e gjejmë këtë kuptim të vetës së dytë njëjës.

(6) *Mendimet e hanë kohën shpejt. Ajo vrapon pa e kuptuar dhe ti vështron orën dhe çuditësh: “Kur shkoi nëntë?”* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 227)

Mendojmë se është i dallueshëm intuitivisht se në shembullin (6) **ti** tregon një referent përgjithësues, **ti** përfaqëson qenien njerëzore, përfaqëson *gjithkënd, secilin prej nesh*. Ndërsa në shembullin në vijim, **ti** shpreh dukshëm një person të individualizuar, bashkëfolësin: *Nuk e ke nga ai. – tha Petriti. – Edhe ti vetë e di që nuk e ke nga ai.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 382)

(7) **Ti** përpiqesh të ngresh kulturën tënde, ai tjetri vjen e ta rrafshon. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 230)

(8) – *Është e natyrshme, - tha ai.- Fundi i vitit. – Ti ecën rrugëve, shikon njerëzit që shpejtojnë me pako, shishe, fruta nëpër duar, të rikujtohen lloj-lloj gjërash, ke dëshirë të kesh pranë dikë, për të cilin ke kohë që nuk ke menduar.* (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 130).

(9) *Po ti më djeg dhe unë mbij sërishmi!* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 202)

(10) *Kështu në vende të tjera si Polonia e Franca të duhet të vesh kryqin mbi kuti nëse ti zgjedh të mos jesh një organdhures.* (Mapo, 19 korrik 2011)

Përemri vetor **ti**, për arsye stilistike, mund të shoqërohet edhe nga vetvetori **vetë**¹⁰⁷:

(11) *Që të dashurosh dikë në mes të kaq e kaq të tjerëve, duhet të kapesht nga diçka, por shpeshherë kjo diçka është kaq e vogël dhe e parëndësishme, sa ti vetë çuditësh më vonë se si mbështet mbi të një ndjenjë aq të madhe sa dashuria.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 44)

ju

¹⁰⁷“ **Vetë** përdoret shpesh pranë një emri a përemri me kuptim emfatik:...” , Gram. praktike, f. 125.

Edhe vetori i vetës së dytë shumës **ju**, në funksion kryefjale a kundrinori, njeh përdorime me kuptim përgjithësues. Ky përdorim njihet dhe në gramatikën angleze.¹⁰⁸ Vetori me kuptim përgjithësues **ju** është i dallueshëm nga vetori **ju** i individualizuar, bashkëfolësi:

Tjetri mori frymë thellë.

– *Nuk e besoj.*

– **Ju** vetë e thatë, kohë më parë, në Komitet të Partisë.

– *E di. Por pastaj, pas hetimit ...* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 72-73) (**Ju** = bashkëfolësi, kuptim i individualizuar i përemrit vetor)

Shembujt në vazhdim janë të vetorit të vetës II shumës me kuptim përgjithësues.

(12) **Ju** mund të na shkruani në lidhje me sugjerimet, vërejtjet apo këshillat tuaja...
(Shekulli, 18 korrik 2011)

(13) Është e mundur që **ju** të porosisni një menu të veçantë për fëmijë. Këtë gjë mund ta bëni 24 orë para nisjes. (Shekulli, 18 korrik 2011)

(14) Telefononi në 131 për të blerë paketën. **Ju** mund të bleni një paketë të dytë Vodafone..., pasi të keni konsumuar paketën e parë. Për më shumë info 140 ose.. (Mapo, 19 korrik 2011)

(15) Të gjitha veprat artistike “të ekspozuara” janë të padukshme, së bashku me to mund të merrni edhe përshkrimin me të cilin **ju** mund ta kuptoni botën paralele të pikturës e cila nuk duket fare, por ekziston. (Mapo, 23 korrik 2011)

¹⁰⁸ “You’ is also used, especially in spoken English, to refer to people in general, rather than to the person you are talking or writing to.

You can’t predict what these things are going to do.

You get some old people who are very difficult.” (Ti/Ju, përdoret, sidomos në gjuhën e folur, për të referuar njerëz në përgjithësi, në vend të dikujt me të cilin po flet ose po i shkruan...) COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 29

(16) *Duhet të provoni imazhin e ri, nëse keni dëshirë që i tërë plazhi ta kthejë kokën nga ju dhe të flasë për ju në tërë bregun. (Mapo, 23 korrik 2011)*

Në ndonjë rast mund të shoqërohet edhe nga ndonjë përcaktor, i veçuar ose jo, me kuptim përgjithësues:

(17) *Ju artistët, shkrimtarët e keni këtë fat te gratë. Madje, më ka shkuar mendja se ai mllëf që shpërthen herë pas here kundër jush, aty e ka shkakun, te smira. Më saktë, te smira për gratë. (I. Kadare, E penguara, 2009, 60-61)*

3.2.1.3. veta e tretë (ai/ajo, ata/ato)

Vetori i vetës së tretë, njëjës a shumës, njihet raste të rralla të përdorimit me kuptim përgjithësues edhe në gjuhën shqipe. E takojmë atë në raste të përdorimit anaforik, kur rimerr një emër me kuptim përgjithësues ose kur është i shoqëruar nga një ndajshim me kuptim përgjithësues, i veçuar ose jo:

(1) *Njerëzit, të mefshtë dhe egoistë, dobësi këto fatalisht të pandreqshme të racës së tyre, më të vështirë e gati të pamundur kanë futjen në përdorim të trurit. Për ta është shumë më komode dhe e pranueshme të mbeten në lëvizhjen e jashtme sesa të lodhen për ta thyer atë, për të shkuar përtej saj e të mbërrijnë thelbin. (F. Kongoli, Kufoma, 1994, 205) (për ta = për njerëzit e mefshtë dhe egoistë)*

(2) *E folura e hetuesit u bë befaz e zvargur, jo fort e qartë. Ata, hetuesit, nuk ishin engjëj, natyrisht. (I. Kadare, E penguara, 2009, 64)*

(3) *Kështu gjahtarit nuk i vjen keq kur qëllon mbi gjah dhe nuk e vret. Atij i vjen keq kur nuk qëllon fare nga mungesa e gjahut. (J. Xoxa, Lulja e kripës, 1, 1980, 184)*

Shembujt (1), (2), (3) dallojnë nga shembulli i mëposhtëm me kuptim të individualizuar, i cili shënon një referent të individualizuar: *Si nuk po më bën asnjë shenjë ky babai?! ... Nuk do me të vërtetë ai që të fitoj unë! (J. Xoxa, Lulja e kripës, 1, 1980, 194) (babai = ai)*

Në gramatikën angleze kemi ndeshur raste të kuptimit përgjithësues te:

- vetori i vetës III shumës¹⁰⁹ (*A nuk është kjo ajo çfarë ata quajnë dashuri? Isn't that what they call love?*),
- përemri *one*¹¹⁰ (*Duhet të mendojmë për anën praktike të gjërave. One has to think of practical side of things.*);

Ndërsa në gjuhën frënge i njihet përemrit **on**, ndër të tjera, dhe përdorimi me kuptim përgjithësues.¹¹¹

3.2.1.4. Pronori i emëruar

Raste të përdorimeve me kuptim përgjithësues kemi hasur edhe te pronorët e emëruar:

(1) - *E? Kush nga ne tha se më mirë të të rrahë **yt**, se sa të puthë i huaji?* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 45)

(2) *Ç'të ban i **tati**, s'ta ban i huji.* (Sh. Haxhihyseni, *Guri i randë n'vend të vet*, 2004, 107)

¹⁰⁹ "'They' is also often used to refer to people in general.
Isn't that what they call love?" (*Ata/Ato përdoret shpesh për të referuar njerëz në përgjithësi...*) COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 30

¹¹⁰ "'One' is used to make statements about people in general which also apply to yourself.
One has to think of practical side of things.
Going round Italy, one is struck by the number of opera houses there are.
This scene makes one realize how deeply this community has been afflicted." COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 32

¹¹¹ "**on** = tout le monde
on renvoie à un tiers collectif qui englobe une totalité. C'est l'effet de generalization que l'on trouve dans les maxims, dictons, proverbs et toute phraséologie à valeur de vérité générale.
On doit respecter ses parents.
On a souvent besoin de petits pois chez soi (publicité)..."
(**on** = gjithkush
on i referohet një të treti kolektiv që përfshin një tërësi. Ky është efekti i përgjithësimit që e gjejmë te maksimat, thëniet, proverbat dhe çdo frazeologji me vlerën e së vërtetës të përgjithshme.
Duhet të respektojmë prindërit.
Kemi nevojë shpesh për bizele në shtëpi (reklama).) P. Charaudeau, 1992, f. 130

3.2.1.5. Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë (caktuesorët)

A janë përemra ‘trajtat e shkurtra të përemrave vetorë’ në shqipen e sotme? Ky është dhe titulli që Remzi Përnaska i vë artikullit të tij në “Studime filologjike”, 1982/4.

Pas një sërë argumentesh rreth çështjes së ngritur (për Përnaskën përbën ballkanizëm), gjuhëtari arrin në përfundimin: “‘Trajtat e shkurtra’ që në lindje bjerrin në një farë mase kuptimin përemëror. Procesi i humbjes së kuptimit përemëror thellohet aq më tepër sa më tepër gramatikalizohen ato. Atëherë shtrohet natyrshëm pyetja: a janë gramatikalizuar plotësisht ato? Në rrafshin gjuhësor ende jo plotësisht, kurse në atë funksional ligjërë po. Pra, ne na duket se gabojmë më pak kur pranojmë se trajtat e shkurtra nuk janë përemra. Në qoftë se pranojmë se ato nuk janë përemra, atëherë detyrohem të pranojmë se ato nuk janë të afta të shprehin kundrinorë, për pasojë problem i përsëritjes, i rimarrjes, i dyfishimit të kundrinorit pushon së qeni.” (f. 210) “... kundrinori nuk shprehet asnjëherë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor, pra trajtat e shkurtra nuk janë të afta të shprehin gjymtyrë më vetë fjalie, kjo do të thotë se ato nuk kanë natyrë përemërore e aq më pak emërore si klasifikohen jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera të botës.” (f. 201)

Përnaska është i mendimit se kjo është shfaqja më tipike e desemantizimit të kategorisë së përemrave në përgjithësi dhe atyre vetorë në veçanti.

Pamundësi të përdorimit të trajtës së shkurtër të përemrit vetor si përsëritëse të një trajte të plotë apo bashkëpërdorim të saj me ndonjë kundrinë, Përnaska sheh dhe në rastin e përdorimit të trajtës së shkurtër të vetës së dytë njëjës me kuptim përgjithësues (*Shqiptari ta thotë bromp, ja ta bën bomp. Urtësia e popullit gjithënjë të befason.*).

Në një tjetër argument Përnaska sjell përdorimin e trajtave të shkurtra pranë foljes në rastin kur folja ka kuptim përgjithësues (gjenerik). Për këtë sjell shembujt: *Ariu ha mollë* (në kuptimin: e ka këtë veti) dhe *Ariu i ha mollët* (gjithnjë në kuptimin: e ka këtë veti). Përnaska mendon se është vështirë të flitet për natyrë përemërore të trajtave të shkurtra në këtë rast, duke shtuar gjithashtu edhe probleme të kategorisë gramatikore të shquarsisë e të pashquarsisë, të raportit të kësaj kategorie gramatikore me atë të aspektit, të kalimtarisë etj.

Përnaska shpjegon se s'ka trajtë të shkurtër pa folje, sheh në sintagmatikë lidhjen *trajtë e shkurtër + folje*, një tjetër fakt që e vë në mbështetjetë të idesë së tij të gramatikalizimit të trajtës së shkurtër përmrit vetor dhe shkëputjes nga kuptimi përemëror.

Duke vazhduar me të njëjtën ide Përnaska (1986/2) konkludon se *folja në gjuhën shqipe duhet parë në dyjarësinë e vet si folje pa trajtë të shkurtër (jokalimtare, jotejvajtëse) dhe me trajtë të shkurtër (kalimtare, tejvajtëse) të cilat ndahen më tej në folje me prani të trajtës së shkurtër dhe pa prani të trajtës së shkurtër*.

Çeliku (2012), duke u mbështetur në tezën e Përnaskës se trajtat e shkurtra nuk janë përemra, e shpie më tej mendimin: “Të ashtuquajturat ‘trajta të shkurtra të përemrave vetorë’ aktualisht funksionojnë në gjuhë si caktuesorë të foljes, duke shenjuar, në radhë të parë, kalimtarësinë e foljes, si rrjedhim, edhe kuptimin aktual të saj në thënien konkrete; ato shërbejnë edhe si mjete gramatikore referimi në tekst, duke shenjuar vetën e veprimit etj.” (f. 168-169) Çeliku është i mendimit se këtu kemi të bëjmë me dukurinë e kalimit të ish-përemrave në caktuesorë formal-gramatikorë dhe nuk i sheh ata si kundrinorë në fjali.

Sipas Çelikut, trajtat e shkurtra shprehin edhe kuptim përgjithësues. Edhe ne ndajmë të njëjtin mendim.¹¹²

Duke përdorur termin e Çelikut për *trajtat e shkurtra të përemrave vetorë*, termin **caktuesorë**, po sjellim në vazhdim shembuj të caktuesorëve me kuptim përgjithësues, në rasën dhanore e kallëzore, veta e dytë njëjës dhe veta e parë dhe e dytë shumës:

(1) *Pamja e tij të linte përshtypjen se në këtë vështrim spikasin mendime të thella, por unë e dija se në të nuk kishte asnjë mendim.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 191)

(2) *Ai ishte si poçja pa vegje: se s'ke nga ta kapësh, se të përvëlton.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 117)

¹¹² Së pari e përmend Remzi Përnaska në “Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe”, S. F. 1983/4, f. 194

(3) Nëse **na** duhet të gjejmë zgjidhje për problemet, **na** duhet të kuptojmë kontekstet sesi këto prirje shfaqen ose jo. (Mapo, 19 korrik 2011)

Në rastin e caktuesorëve me kuptim përgjithësues themi se mund të këmbëhet lehtësisht një vetë me tjetrën pa cenuar aspak domethënien e fjalisë, kjo është dhe karakteristikë e kuptimit përgjithësues në tërësi.

(4) Ndonjëherë shkëlqimi i jashtëm **të (na, ju)** gënjen, thashë unë me vete. (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 292)

(5) Është një ortodoksi kjo politike që **të (na, ju)** nervozon. Por jo vetëm. Edhe **të (na, ju)** merakos për faktin se mos vazhdon si e tillë dhe gjatë muajve që vijnë. (Mapo, 19 korrik 2011)

(6) Errësira **të (na, ju)** kallte datën. (Mapo, 27 korrik 2011)

(7) Oferta verore Bankës Emporiki **ju (na, të)** mundëson depozitat më të mira në treg me përfitim maksimal. (Mapo, 23 korrik 2011)

(8) Porse jeta, sa **na (të, ju)** bën kureshtarë për shumë gjëra, aq edhe **na (të, ju)** pengon që t'i njohim. (Dh. Shuteriqi, Vepra letrare 4, 1982, 227)

(9) Kërthiza që lidh nënën me fëmijën është si litari i gjemisë, që **na (të, ju)** mban të ngulur në limanin ku **na (të, ju)** hedh shqota dhe shorti i jetës... (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1981, 174)

Caktuesorët me kuptim përgjithësues i ndeshim gjerësisht te sentencat, frazeologjitë e fjalët e urta të popullit:

(10) Fmija, po **s'ta dha** me dorë, **ta jep** me kamë. (Sh. Haxhihyseni, Guri i randë n'vënd të vet, 2004, 107)

(11) Fjala **të nalton**, fjala **të poshtnon**. (Sh. Haxhihyseni, Guri i randë n'vënd të vet, 2004, 131)

(12) *T'çon në Shkumi e t'bi pa ujë.* (Sh. Haxhihyseni, *Guri i randë n'vënd të vet*, 2004, 148)

(13) *Kam xhaxhanë tim, që për nder, të merr gjak në vetull.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 336)

3.2.1.6. Dhanorja etike

Dhanorja etike, quajtur ndryshe **plotës etik** (Mahir Domi, 1954) tregon për një përdorim të veçantë të përemrit vetor të rasës dhanore. Mahir Domi (1954) dhe Gramatika e Akademisë (sintaksa) e shohin atë si *mjet për t'i dhënë më gjallëri tregimit*.

Remzi Përnaska (S.F., 1982/4) sjell përdorimin e trajtave të shkurtra si dhanore etike, duke treguar se “raporti midis fjalës dhe sendit jo vetëm që nuk është i drejtpërdrejtë, por as dhe i ndërmjetësuar.” Në këto raste s’ka vlera referuese për vetën në tërësi. Sipas Përnaskës “dhanoret etike e kanë bjerrë kuptimin etimologjik të parë. Për më tepër dhanoret etike as përsëritin, as shprehin ndonjë kundrinor të zhdrejtë, thënë ndryshe trajta e shkurtër e quajtur dhanore etike nuk bashkëshoqërohet me ndonjë trajtë të plotë.” (f. 200), ndërsa në “Gjuhësi... ..gjuhësore”, Maluka 1, Përnaska sqaron: “TI si *dhanore etike* shtie në thënie bashkëbiseduesin e individualizuar në një thënie si *dëshmitar fiktiv*, d.m.th., që nuk lot asnjë rol në proces, aq sa edhe mund të hiqet nga ndërtimi i saj, sigurisht duke dëmtuar diçka përmbajtjen e thënies,... Këto janë përdorime karakteristike të gjuhës së folur. Ndërtime të tilla përftojnë thënie emfatike:... TI si dhanore etike mund të hiqet nga thënia pa prishur rëndë ndërtimin e saj. Kjo gjë shfrytëzohet me dobi për të dalluar kuptimin e thënieve që shprehen me ndërtime fjalish që kanë në përbërjen e tyre një *dhanore etike*. Jashtë kontekstit, këto ndërtime mund të jenë të shumëkuptimshme. ... Në gjuhën shqipe, ndryshe nga gjuhë të tjera, ku veta e parë njëjës e shumës nuk përdoret si dhanore etike, ose përdoret shumë rrallë, kjo vetë përdoret si dhanore etike në po ato kushte, ose të ngjashme, si dhe veta e dytë. Gjithashtu, ky përdorim parakupton që midis thënësit dhe pjesëmarrësve të tjerë (aktantëve) në proces ka një farë lidhjeje afërie.” (f. 209-210)

Emine Teichmann saktëson se me anë të dhanores etike “shprehet pjesëmarrja emocionale e folësit në ligjërim:... Dhanorja etike realizohet me një trajtë të shkurtër dhe nuk është gjymtyrë e domosdoshme e fjalisë, nuk bën pjesë në planin ndërtimor të saj. Është karakteristik përdorimi i saj para foljeve në mënyrë habitore:... Kjo dhanore del në përrallat në formën e vetës së parë shumës *na*.”¹¹³

Kur trajta e shkurtër e dhanores shpreh thënësin e grupin që ai përfaqëson në mënyrë të përcaktuar, (*neve na*) si pësues i veprimit, atëherë do të thonim se nuk kemi dhanore etike, por *dhanore sintaksore*¹¹⁴: *Ai u zemërua dhe kur u nisa për udhë bashkë me Sofikën, nuk doli të na përcillte.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 321)

Mendojmë se dhanorja etike, përveç se raport afërie lejon dhe interpretim përgjithësues. Të gjitha rastet e dhanores etike ne do t’i konsiderojmë si përdorime me kuptim përgjithësues, krahas nuancimeve të përmendura e të njohura që dhanorja etike bart. Evidentohet ajo veçanërisht në rastet e vetës së parë numër shumës, më rrallë në vetën e dytë njëjës, para foljeve të mënyrës habitore, në të gjitha kohët e saj:

(1) *Kam thënë edhe unë gjer dje, që gjaku s’bëhet ujë, po ja që na qenka ndryshe:* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 204)

(2) *Kristoforidhi dinte se nja tetë a nëntë na i qenkëshin vënë punës për fjalorin e shqipes,...* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 297)

(3) *...njëfarë Sefer Kalaja, na i paskësh marrë këto dy emra se e kishte çuar jetën sefer më sefer (luftë më luftë)...* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 309)

(4) *Dhe ti tani, ja, hopa na marrke një grek,...* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 81)

(5) *“Na qenki trima në të parë, na paski gjerdanë palë-palë, po dardha e ka bishtin prapa, do t’ju shohim!”* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 18)

¹¹³ E. Teichmann, “Hapa në Universin e Ligjëritimit”, 2010, f. 22.

¹¹⁴ Të tillë e quan R. Përnaska në “Gjuhësi... ..gjuhësore”, Maluka 1

(6) Ashtu **na thënka** dhe kurani, thonë myslimanët me din e me iman... (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 449)

Dhanoren etike me kuptim përgjithësues e gjejmë edhe te veta e dytë njëjës e paskajores gege:

(7) *Mbas do kohe po nis katallani me vikatë në kupë të qiellit që **me t'u dridhë** shtati.* (Përralla shqiptare, f. 212)

Dhanorja etike me kuptim përgjithësues ka përdorim të gjerë në gjuhën shqipe, sidomos në gjuhën e folur. Vihet re dhe si formulë hyrëse, klishe në krijimet popullore, përrallat:

(8) *Na ishte mos **na** ishte, **na** ishte një mbret, **na** kishte një vajzë.* (Përralla shqiptare, f.14)

(9) *Qe një mbret; **na** kishte tre djem.* (Përralla shqiptare, f. 30)

(10) ***Na** ishte një herë një mbret. Ky **na** kishte një vajzë.* (Përralla shqiptare, f. 114)

Ndikimin e kësaj dukurie e shohim të shtrirë dhe në letërsinë e kultivuar:

(11) ***Na** ish ç '**na** ish. **Na** ish një herë një plak fort i motuar.* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 158)

(12) ***Na** rronin aty një burrë e një grua, veçuar nga bota.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 22)

(13) ***Na** ish qëmoti, andej lart, në Klladushën e Krahinës kreshnike, afër Jutbinës, një malësor që kish dy djem: Mujin dhe Halilin.* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 79)

3.2.2. Përemrat vetvetorë me kuptim përgjithësues

(1) *Por ai nuk mund ta përmbante **veten**. Ndonjëherë të përmbash **veten** duhet të kesh edhe shëndet të mirë dhe të jesh i fortë fizikisht.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 53)

Shembulli (1) bart dy raste të përemrit vetvetor **veten**. Rasti i parë është rasti i përemrit vetvetor me kuptim të individualizuar: **veten** i referohet kryefjalës **ai** (*Por ai nuk mund ta përmbante **veten**.*) Në rastin e dytë (*Ndonjëherë të përmbash **veten** duhet të kesh edhe shëndet të mirë dhe të jesh i fortë fizikisht.*), në mënyrë intuitive kuptojmë se është kaluar nga një referent i individualizuar në një referent përgjithësues. Idenë tonë, përveç shpjegimit logjik e intuitiv, e mbështesim dhe me këto të dhëna:

- Fjalja e dytë (*Ndonjëherë të përmbash **veten** duhet të kesh edhe shëndet të mirë dhe të jesh i fortë fizikisht.*) vjen në formën e një sentence (që janë dhe rastet më tipike ku gjejmë përdorime me kuptim përgjithësues);
- Folja-kallëzues është në kohën e tashme lidhore (*të përmbash*) (një tjetër veçanti që lidhet me kuptimin përgjithësues), përkundrajt përdorimit në të pakryerën në fjalinë e parë (*mund ta përmbante*);
- Ka përdorim të vetës së dytë të foljes (*të përmbash*) (një tjetër veçanti edhe kjo që lidhet me kuptimin përgjithësues), përkundrajt vetës së tretë në fjalinë e parë (*mund ta përmbante*).

Raste të tjera të përdorimit të përemrit vetvetor me kuptim përgjithësues:

(2) *Kapitull në të cilin fjalët kërcasin si kripa në zjarr, që të pëlçet sytë e nuk të lë të njohësh **veten** dhe shokët.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 319)

(3) *Këtu mjaft herë të mërzitet edhe **vetja** jote.* (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 64)

3.2.3. Përemrat pronorë me kuptim përgjithësues

Mendojmë se përdorime me kuptim përgjithësues takojmë edhe te përemrat pronorë të vetës së dytë numër njëjës e shumës, në një përdorim joanaforik, ose kur i referohen një vepruesi me kuptim përgjithësues: *Hapni tani një llogari kursimi Alpha Smart dhe maksimizoni me zgjuarsi përfitimet **tuaja!*** (Shekulli, 18 korrik 2011); dhe te përemrat pronorë e vetës së parë shumës: *Por në lufrat e shumta me dhunonjës të shumtë trimi **ynë** kish marrë nëntë plagë në shtat dhe tani kish nëntë vjet që dergjej në kullë.* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 58)

3.2.4. Përemrat e pacaktuar me kuptim përgjithësues

Në G.A. (1995), në kapitullin ku flitet për përemrin thuhet: “Veçoria themelore kuptimore e përemrave të pacaktuar është pacaktuesia. Ky kuptim shumë i përgjithshëm i përemrave të pacaktuar ruhet në çdo rrethanë ligjërimi. Këtu ata dallohen nga të gjithë përemrat e tjerë, kuptimi i të cilëve përcaktohet nga konteksti a situata e ligjëritimit. Kuptimi i përemrave *dikush, askush, gjithë, secili* etj. në çdo kontekst mbetet i pandryshuar, ...” (f. 249)

Por ne jemi të mendimit se, në varësi të kontekstit, përemrat e pacaktuar njohin përdorime me kuptim të individualizuar e përgjithësues. Interpretim përgjithësues lejojnë përemrat e pacaktuar: *kushdo*¹¹⁵, *secili/secila, askush, asnjëri, kurrkush, të gjithë*, përemrat që formohen prej këtij të fundit dhe tregojnë frymorë, etj. I takojmë këta përemra gjithmonë në rastet e një *përdorimi joanaforik* ose kur i referohen një vepruesi me kuptim përgjithësues.

Analizojmë shembullin e mëposhtëm:

(1) *Po njeriu po të jet’ i likë e i dobët, **gjith’** i hipinë siprë, jo vetëm anëmiqtë, po edhe miqtë.* (S. Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë...*, 1962, 53)

¹¹⁵ Në “Gramatikën praktike” (2007, 115) veçohen përemrat e pacaktuar *kushdo, gjithkush* dhe *gjithsekush* si përemra me kuptim përgjithësues që tregojnë tërësinë e njerëzve, pa përjashtuar asnjë. Edhe për këto përemra ne mendojmë se kanë vlerë ambige. Është konteksti ai që zgjidh ambiguitetin.

Përdorimi i përemrit të pacaktuar **gjith'** në këtë rast lejon interpretim përgjithësues. Bëhet fjalë për të gjithë, këdo, jo një grup të caktuar. Këtë fakt e shpjegon dhe saktësimi i mëtejshëm *jo vetëm anëmiqtë, po edhe miqtë*.

Ndërsa në fjalinë *Të gjithë ia krisën të qeshurit, përveç zonjës Ermion* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 61) përemri i pacaktuar *të gjithë* është me kuptim të individualizuar. *Të gjithë* emërton atë grup që është i pranishëm në bisedë.

Fjalja *Pastaj ne ecëm gjatë të heshtur, secili duke menduar më vete*. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 214) nuk lejon interpretim përgjithësues. **Secili** emërton individët e një *ne* të pranishme në fjali, ndërsa në rastin:

(2) **Secili** në këtë botë kaotike shikon atë që dëshiron, - tha Raq Kripiani, - se ka ç'të shikojë gjithsecili. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 57),

themi se kemi të bëjmë me përemërin e pacaktuar **secili** me kuptim përgjithësues. **Secili** emërton *këdo nga ne*. Mendojmë se dallimi i përemrit të pacaktuar të individualizuar nga ai me kuptim përgjithësues është i dukshëm dhe këtë fakt e përforcon përdorimi në vazhdim i përemrit *gjithsecili*.

Përdorimi i përemrit të pacaktuar **tjetri** në kuptimin e individualizuar: *Hm, ia bëri me vete. Në s'donte të fliste i pari, kurrë mos dashtë. Do ta bënte ai vetë, dhe aq i bënte nëse tjetri do ta merrte për të paduruar, madje më keq.*

- *Lidhur me atë që folëm në Komitetin e Partisë, s'kam gjetur asgjë të re, - tha, duke e vështruar drejt në sy. – Ndoshta po ju zhgënjej...*
- *- Aspak, - e ndërpreu tjetri. – Ju ma bëtë fare të qartë në telefon.* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 48)

Përdorimi i përemrit të pacaktuar **tjetri** me kuptim përgjithësues:

(3) *Po ja që, nuk të lënkan të lirë të tjerët, megjithëse ti i ke lënë ata të lirë.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 117)

Shembuj të tjerë të përemrave të pacaktuar me kuptim përgjithësues:

(4) Kur të ka shporta rrush e fiq, vriten **gjithë** të thuhet miq! (Përralla shqiptare, f. 298)

(5) Herë i dukej se i jepte të kuptonte se, natyrisht, do të kishte mëshirë për të, si për të vetin, e herë e kundërta, për **gjithkënd** mund të kishte dhembshuri, veç për të jo. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 49)

(6) Natyrisht, s' ishte i detyruar për një gjë të tillë, por, sidoqoftë, **e habitshme ishte për cilindo**, e aq më tepër për një hetues. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 59)

Nga rastet e mësipërme mund të themi se vetëm shembulli (4) është shembull i qartë i përdorimit të përemrit të pacaktuar **gjithë** me kuptim përgjithësues, ndërsa për shembujt (5) e (6) mendojmë se interpretimi përgjithësues kërkon një kontekst gjuhësor më të gjerë.

3.2.5. Përemrat dëftorë me kuptim përgjithësues

(1) .. mendonin se ishte vështirë të gjykohej dikush që gjendej brenda, nga të jashtmit, e po kështu **këta** (çdo i jashtëm, të gjithë të jashtmit), nga i brendshmi, e kështu me radhë, ... (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 59)

Përemri dëftor **këta** është anaforik; ai zëvendëson emrin të jashtmit, që është emër me kuptim përgjithësues. Për këtë arsye, mendojmë se edhe dëftori **këta**, duke bartur të gjitha domethëniet e emrit të jashtmit, është dëftor me kuptim përgjithësues.

Përdorime me kuptim përgjithësues të ngushtë, të kufizuar, takojmë edhe te dëftorët (ai, ajo) (ai = personi, njeriu):

(2) “Trim është **ai** që di të ruhet dhe di ta vërtitë armikun për ta mundur”, iu thoshte shpesh para ndonjë luftimi. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 47)

(3) E kishte thënë pa atë kuptimin e keq politik, përkundrazi e kishte nxjerrë në pezm e sipër, siç thuhej për **ata** që çonin e binin fjalë, në jetën e përditshme. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 15)

(4) Pastaj, **ai** që të dashuron, nuk të vret ... (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 139)

Përemri dëftor (ai, ajo), veçanërisht në rastin e proverbave, takohet dhe në gramatikën angleze: *Ai që heziton, është i humbur. (He who hesitates is lost.)*¹¹⁶

3.2.6. Përemrat lidhorë me kuptim përgjithësues

Gjejmë përdorime me kuptim përgjithësues të përemrit lidhor **që, i cili/e cila**, në rastet kur përcaktojnë referentë përgjithësues, dhe te përemrat lidhorë të pacaktuar **kush, cili, sa, çfarë**, të cilët janë të zbërthyeshëm në dy përemra (= **ai që**).

(1) *S'ka njeri në botë, i cili të mos dijë trimëritë që kini bërë, e të mos ju ngrerë me lëvdatat më të mëdha gjer në qiell, e të mos flasë për ju si për një kryemprojtës të vërtetë dhe kryefetar shpirtmadh të Krishtërimin.* (F. Noli, *Vepra 4*, 1989, 207)

(2) *Nuk ka njeri, që të jetë në dijeni të këtyre punëve dhe të të mos të ngrejë ty në qiell me lëvdatat më të mëdha...* (F. Noli, *Vepra 4*, 1989, 207)

(3)

- *Do të rrëzohet përtokë kapedani ynë, - tha Dauti.*
- **Kush** (ai, kushdo që) *nuk çalon, nuk bie., - ia prita unë.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006,19)

(4)

- **Ç'**(çfarëdo që) *të mbjellësh, do të korrësh.* (*Gramatika praktike*, 2007, f. 111)

(5)

- *Pyet cilin (këdo që) të duash.* (*Gramatika praktike*, 2007, f. 111)

Mendojmë se shembulli (5) shfaq ambiguitet. Për të saktësuar nëse është përdorim i përemrit lidhor të pacaktuar me kuptim të individualizuar a përgjithësues na duhet një kontekst gjuhësor më i gjerë.

Krahasojmë shembujt në tabelën e mëposhtme.¹¹⁷ Mendojmë se është e dukshme që përdorimi i përemrave lidhorë në fjali qartëson kuptimin e tyre përgjithësues e të individualizuar.

¹¹⁶ A student's grammar of the English language, Sidney Greenbaum, Randolph Quirk, England, 1990, f. 115

¹¹⁷ Shembujt në tabelë i kemi marrë nga "Gramatika praktike" (2007, f. 110-111). Këta shembuj nuk veçohen aty si raste të përdorimeve me kuptim përgjithësues, por ne mendojmë se janë të tilla. Për këtë

Përemra lidhorë me kuptim përgjithësues	Përemra lidhorë me kuptim të individualizuar
- Kush (<i>kushdo që</i>) <i>s'ka kokë, ka këmbë.</i> - Më <i>kërko çfarë</i> (<i>çfarëdo që</i>) <i>të duash.</i> - Sa (<i>të gjithë ata që, kushdo</i>) <i>lindin, vdesin.</i>	- Kush (<i>kushdo nga të pranishmit që</i>) <i>dëshiron të mbetet këtu, le të flasë.</i> - Mos <i>harroni çfarë</i> (<i>atë që</i>) <i>ju thashë.</i> - Sa (<i>ata, të pranishmit që</i>) <i>qenë aty, votuan kundër.</i>

3.3. Mbiemri me kuptim përgjithësues

Në gramatikën angleze njihet një grup i veçantë mbiemrash që lejojnë interpretim përgjithësues: “Një grup i mbiemrave me '-ing' përshkruajnë efektin që diçka ka në ndjenjat dhe idetë tuaja, ose në ndjenjat dhe idetë e njerëzve në përgjithësi.

... një rritje alarmante në armiqësinë racore.

Një numër i konsiderueshëm i burrave mbeten beqarë ...

Këto mbiemra janë zakonisht mbiemra cilësorë që kanë dhe shkallën krahasore dhe atë sipërore. Ato mund të përdoren në pozicion atributive ose predikative.

Ata ende mund të tregojnë besnikëri të mahnitshme ndaj prindërve të tyre.

Është e mahnitshme se çfarë mund të bëjnë ata

Këto mbiemra me '-ing' kanë një folje transitive që përdoret për të përshkruar mënyrën se si dikush ndikohet nga diçka. Për shembull, nëse flet për ‘një rritje alarmante’, do të thotë

qëllim, krahas tyre, kemi sjellë dhe shembujt që tregojnë qartë të kundërtën, pra, që kanë referim të individualizuar.

se rritja ju alarmon. Nëse flisni për 'një numër të konsiderueshëm' do të thotë se numri ju befason.”¹¹⁸

Këtë rast e kemi gjetur edhe në gramatikën franceze. Sipas Charaudeau –së (1992), “Mbiemri mund të mbulojë lloje të ndryshme të domeneve ...”. Nga kjo renditje ne veçojmë “... domene që kuptohen nga efekti që ato prodhojnë te të tjerët: **“një fjalim interesant, befasues dhe tërheqës** (= një fjalim që të zgjon interes, të befason, tërheq njerëzit).”¹¹⁹

Ne mendojmë se kjo dukuri lidhet edhe me shqipen.

Analizojmë shembullin e mëposhtëm:

(1) *Më i gjerë si varg, pa dyshim, është tetërrokëshi. Ai është **më i gjithëgjend-shmi** e më demokratiku.* (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 157)

Në fjalinë *Ai është **më i gjithëgjend-shmi** e më demokratiku* kemi dy mbiemra të emëruar të shkallës krahasore me vlerë sipërore, i pari me mbaresë të përparme dhe i dyti pa mbaresë të përparme (terma të Çelikut), që janë pjesa emërore homogjene e kallëzuesit emëror. Ndalim në vlerën kuptimore të mbiemrit të parë: *më i gjithëgjend-shmi = që gjendet nga të gjithë*. Mbiemri i emëruar na shfaqet sinonimik me një sifjali përcaktore

¹¹⁸ “One group of ‘-ing’ adjectives describe the effect that something has on your feelings and ideas, or on the feelings and ideas of people in general.

... *an alarming increase in racial hostility.*

A surprising number of men stay bachelors...

These adjectives are normally qualitative adjectives. This means that they can be used with a submodifier, and have comparatives and superlatives....

They can be used in attributive or predicative position.

They can still show amazing loyalty to their parents.

It’s amazing what they can do....

These ‘-ing’ adjectives have a related transitive verb which you use to describe the way someone is affected by something. For example, if you speak of ‘an alarming increase’, you mean that the increase alarms you. If you speak of ‘a surprising number’ you mean that the number surprises you.” COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f.76-77


¹¹⁹ “L’adjectif peut recouvrir différents types des propriétés... des propriétés qui se comprennent par l’effet qu’elles produisent auprès des autres: “un discours **intéressant, étonnant, fascinant** (=un discours qui intéresse, étonne, fascine les gens). f. 329

ku përemri i pacaktuar *nga të gjithë* është në rolin e një vepruesi përgjithësues = *nga kushdo*.

Të njëjtën gjë nuk mund ta themi për mbiemrin tjetër të emëruar (**më demokratiku**), ndonëse bart të njëjtin funksion dhe është në të njëjtin kontekst si mbiemri që morëm në shqyrtim. Por ky mbiemër gëzon veti të tjera, si: nuk është mbiemër prejfoljor, është mbiemër marrëdhënior etj. Ky fakt na shtyn të mendojmë për kushtet që duhet të plotësojë një mbiemër që të lejojë interpretim përgjithësues, për të cilat do të bëhet fjalë pak më poshtë.

Në Gramatikën e Akademisë (morfologjia), në kapitullin ku bëhet fjalë për mbiemrin, gjatë trajtimit të formimit prapashtesor të tij paraqiten dhe mbiemrat prejfoljorë formuar me prapashtesën (**-shëm**). “Një pjesë e këtyre mbiemrave prejfoljorë kanë kuptim veprues, tregojnë edhe aftësinë e mundësinë e sendit të karakterizuar nga mbiemri i dhënë për të kryer veprimin e emërtuar nga tema fjalëformuese e atij mbiemri..... Pjesa tjetër e tyre, më e madhja, tregon aftësinë, mundësinë, meritimin, domosdoshmërinë për t’iu nënshtruar sendi i dhënë veprimit të emërtuar nga tema fjalëformuese e mbiemrit,... Disa mbiemra prejfoljorë mund të kenë sipas rrethanave e kontekstit, kuptim vepror ose pësor, p. sh.: *i dëgjueshëm* (= që dëgjon ose që dëgjohej): *fëmijë i dëgjueshëm* dhe *tingull i dëgjueshëm*.” (f. 194)

Duke vazhduar më tej këtë arsyetim, shembujt e mësipërm *fëmijë i dëgjueshëm* dhe *tingull i dëgjueshëm* mund të themi se janë përdorime të mbiemrit me kuptim përgjithësues:



Në vështrimin tonë, mbiemrat me kuptim përgjithësues shfaqin këto veti. Ata janë:

1) mbiemra cilësorë: *një libër **interesant*** = *mund të tregojë një libër që u intereson njerëzve (çdo njeriu); një muzikë **argëtuese*** = *një muzikë që argëton njerëzit (çdo njeri);* mbiemri emërton cilësi të objektit që shpreh emri, përshkruan efektin që ka diçka (*libri, muzika*) në ndjenjat dhe idetë tona, në ndjenjat dhe idetë e njerëzve në përgjithësi.

2) mbiemra prejfoljorë me prapashtesën –**shëm**, të tipit *i kapshëm*, *i ngrënshëm*. Të tillë janë vetëm ato mbiemra që e ruajnë lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes përkatëse¹²⁰ dhe që mund të marrin një veprues përgjithësues *i kapshëm* (nga çdo njeri), *i ngrënshëm* (nga njerëzit, nga secili prej nesh).

3) sinonimikë me një sifjali përcaktore, ose me një folje të formës joveprore, p.sh.:

(2)

a) Kishte nofka **të kapshme** lehtë, me njëfarë kuptimi, si “Shoku vetëtimë” ose “Grushti”, ... (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 58)

b) Kishte nofka **që kapeshin** lehtë, me njëfarë kuptimi, si “Shoku vetëtimë” ose “Grushti”,...

(3)

a) Kjo është plotësisht **e kuptueshme**. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 32)

b) Kjo **kuptohet** plotësisht.

4) mbiemra që kanë kuptim jovepror dhe që në të gjitha rastet janë sinonimikë si në (3b) kërkojnë një veprues që, në një kontekst të caktuar, mund të jetë secili prej nesh, pra, një veprues përgjithësues.

(4) Ajo që i kërkonin njëri-tjetrit, ndonëse dukej **e rrokshme**, befaz bëhej **e pamundur**. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 55)

¹²⁰ Pavli Haxhillazi në “Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe”, S. F. 1969/2 ndër të tjera bën një klasifikim të mbiembiemrave në bazë të lidhjes që ekziston ose jo, ndërmjet kuptimit të mbiemrit foljor në –shëm, dhe kuptimit të foljes që përbën temën prodhuese të mbiemrit. Kështu kemi: I) Grupi i mbiemrave, që e ruajnë lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes përkatëse. Në bazë të kësaj lidhjeje përcaktohet përmbajtja e tiparit që shënon mbiemri dhe II) Grupi i mbiemrave që nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes që përbën temën prodhuese.

Nga ana strukturore duket qartë se në temën e tyre prodhuese këta mbiemra kanë një formë të pjesores së foljes, kurse nga ana semantike, kjo është zbehur nga kuptimi foljor. Këta mbiemra shprehin tipare të një gjendjeje të caktuar dhe nuk shprehin aftësinë e mundësinë e kryerjes së një veprimi ose të nënshtrimit ndaj një veprimi. (f. 145 – 164)

Për rastin (4) mund të themi se të dy mbiemrat **e rrokshme/e pamundur** bartin rolin semantik të një vepruesi [+HUMAN] me kuptim përgjithësues. Marrëdhënia vendoset mes efektit dhe njerëzve në përgjithësi (**e rrokshme/e pamundur – për njerëzit në përgjithësi, për çdo njeri**).

Por marrëdhënia mund të ishte edhe mes efektit dhe një individi në veçanti (**e rrokshme/e pamundur – për dikë në veçanti**) dhe këtë marrëdhënie do ta kushtëzonte prania e caktuesorit **u**: Ajo që i kërkonin njëri-tjetrit, ndonëse **u** dukej **e rrokshme**, befaz **u** bëhej **e pamundur**.

5) kryejnë në fjali funksion:

a) përcaktori: Pasi u siguruan për gjithçka, madje, pasi mosbesuesit thanë shprehjen **e njohur**: si do ta dinë ata lart se ç'mund të ndodhë këtu poshtë?... (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 12)

b) pjesën emërore të kallëzuesit emëror: Mendimi se një rast të tillë prita u voliste të tria palëve, s'ishte **e lehtë** të thuhej për cohën e bardhë, atë që besohej se u kishte dhënë gjermanëve shenjën e dorëzimit. Ishte **e lehtë** ta quaje vegulli, por vegulli e kujt? (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 70)

c) përcaktori kallëzuesor: Kishte pasur bindjen se e keqja niste nga gjysma e dytë e aktit, fill pas shfaqjes së fantazmës, por tani dyshonte se, qysh në krye, akti dukej **i kritikueshëm**. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 76)

3.4. Folja me kuptim përgjithësues

M. Galmiche (1985) veçon: “Pjesa më e madhe e gjuhëtarëve, të cilët kanë trajtuar problemin e përgjithësimit, kanë vlerësuar se sintagmat emërore përgjithësuese kanë si veçori që të jenë të përputhshme me një lloj kallëzuesi: kallëzuesit klasorë, të cilët nuk mund të zbatohen për një individ, dhe mund të quhen gjithashtu kallëzues kolektivë.». Ai sjell shembujt që lidhen me kallëzuesit që i takojnë klasës, llojit:

Lepuri (Le lapin)

{

 riprodhohet shpejt (se reproduit rapidement)

}

**Lepuri i fqinjit tim* *i pushton fushat (envahit les campagnes)*

* *Le lapin de mon voisin* *është duke u zhdukur (est en voie d'extinction.)*

Gjithsesi, kundërshton këtë fakt Galmiche (po aty), “pjesa më e madhe e kallëzuesëve që kanë një kuptim kolektiv mund të zbatohet për grupe të përdorur dendur; kjo është arsyeja pse testi në fjalë humbet shumë nga vlera dhe gjykimi i tij kur bëhet fjalë për sintagma emërore në numrin shumës...”, për më tepër, «përbërësit emëror (SN) të llojit *një emër (un N)* janë në fakt, të papërputhshme me kallëzuesët kolektive në përgjithësi»¹²¹

Edhe ne mendojmë se jo gjithmonë në fjalitë me kuptim përgjithësues kemi kallëzues klasorë (folje që tregojnë veprime, gjendje që lidhen me klasën, llojin dhe jo një individ të caktuar të tij), ndryshe si shpjegohet ambiguiteti në përdorime të caktuara nëse semantika e foljes, “kallëzuesi klasor” na tregon qartë që veprimi lidhet me klasën, llojin? Përdorimi i gjuhës na çon në raste më të komplikuar se *Lepuri riprodhohet shpejt*:

(1) - *Shoku kryetar, një njeri që merr rrugë të shtrembër duhet ndihmuar të vijë në binarë.*
(D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 156)

Galmiche arsyeton më tej në artikullin e tij: “... një sintagmë foljore mund të konsiderohet përgjithësuese vetëm kur ka një sintagmë emërore përgjithësuese. Duke qenë se sintagmat emërore përgjithësuese shfaqen si kryefjalë vetëm në fjalitë përgjithësuese, vetëm fjalitë përgjithësuese mund të përmbajnë një sintagmë foljore përgjithësuese. (... *un SV ne peut être considéré comme générique que s'il est appliqué à un SN générique. Or, comme les SN génériques n'apparaissent, comme sujets, que dans les phrases génériques, seules les phrases génériques peuvent comporter un SV générique.*) (f. 23)

Duke iu bashkuar këtij përfundimi, dhe ne do të konsiderojmë *kallëzues me kuptim përgjithësues* *kallëzuesit* e fjalive a sifjalive me kuptim përgjithësues:

¹²¹ «La plupart des linguistes ayant abordé le problème de la généricité ont fait valoir que les SN génériques ont pour propriété d'être compatibles avec un certain type de prédicats: les prédicats de classes; ne pouvant s'appliquer à un individu, on les appelle aussi prédicats «collectifs»... ... la plupart des prédicats ayant un sens collectif peuvent également s'appliquer à des groupes ou des ensembles référentiellement circonscrits ; c'est pourquoi le test en question perd beaucoup de sa pertinence lorsqu'il s'agit de SN pluriels.. ... les *SN* du type *un N* sont, en effet, incompatibles avec les prédicats collectifs en général.» Galmiche, 1985, f. 6

(2) E zgjati dorën për të përkëdhelur flokët e Ana-Marisë që flinte, po menjëherë e tërhoqi, si shoferi i mirë që **frenon** pranë ndonjë greminë. (P. Marko, *Qyteti i fundit*, 2000, 25)

(3) Ai erdhi e u ul në tryezën tonë, siç **ulet** njeriu në shtëpi të vet. (F. Kongoli, *Kufoma*, 1994, 56-57)

(4) A **tallet** shoku me shokun e tij? (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 25)

(5) Kishte diçka enigmatike ajo vajzë. Diçka që **të ikte**, s'e **kapje** dot... (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 60)

3.4.1. Veta dhe numri i foljes

Benveniste (1996) është i mendimit se kategoria e vetës te folja është një nocion thelbësor dhe i nevojshëm. Në gjuhësinë tonë, referuar studimeve për fjalitë njëkryepërbërëse (Totonit 1971; Çeliku, 1974/10, 1977, 2007, 2008, 2012; G.A. 2002)¹²², njihen këto veta të foljes-kallëzues:

- veta e caktuar (veta I, II, njëjës e shumës): - **Ndenja** shumë, - kishte thënë. – **Ndenja** tepër. Më **lejoni të shkoj**. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare*, 4, 1982, 210)
- veta e pacaktuar (veta III shumës): Por, a është një gjë e bukur, edhe në mos qoftë e padrejtë, kur një fëmijë qesh tek e **rrahin** dhe e **shembin** në dru? (J. Xoxa, *Lulja e kripës*, 1, 1980, 226)
- veta e përgjithësuar (kryesisht veta II njëjës): Ndonjëherë kur mërzia **të bren** shpirtin, **kthehesh** në snob dhe **zemërohesh** me çdo veprim të njerëzve të tu. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 190)

Në rastet e mësipërme vepruesi bëhet i njohur përmes formave eptimore të foljes.¹²³ Është thënë me të drejtë që në këto fjali ka rëndësi veprimi dhe jo vepruesi.¹²⁴ Në fjalitë

¹²² Më shumë flitet rreth tyre në sythin pasardhës.

¹²³ Remzi Përnaska në "Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe", S. F., 1983/4, f. 190, sqaron: "nënanori ka shenjuesin e vet te kallëzuesi": *Kryefjalë – folje – mbaresë vetore*. Pra, shprehja e kryefjalës te folja janë mbaresat vetore të saj. Përsa i takon kundrinorit, Përnaska mendon se "edhe ai vihet në pozicion të veçantë me kallëzuesin, më ngushtë, me foljen: edhe kundranori ka shenjuesin e vet te folja gati-gati si edhe nënanori." (*trajtë e shkurtër*) folje – *kundrinor* (f. 191).

¹²⁴ Spiro Floqi, në intervistën e tij "Puna shkencore t'u përgjigjet më mirë kërkesave të shkollës" në "Mësuesi", 13 nëntor 1964, mbështet mendimin se për shkak të fleksionit të zhvilluar foljor të shqipes

njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar folja (kryesisht në vetën II njëjës) shpreh veprime që u përkasin të gjithëve; ajo nuk tregon thjesht bashkëfolësin, por këdo, përfshirë edhe folësin.

(1) Ky raport i rrallë visual, pjesë qenësore e të bërit plazh në Ksamil, **të (na, ju)** jep nganjëherë përshtypjen se **je** pjesë e një tabloje pikturë, e jo në një realitet konkret. Por **zgjidhni e shijoni**: të arratisurit në një pikturë apo të qëndruarit në realitet?! Ksamili dhe këtë **ta (na e, jua)** ofron. (Shekulli, 18 korrik 2011)

Në rastin (1) foljet me kuptim përgjithësues (**je, zgjidhni e shijoni**) janë në vetën II njëjës e shumës. Caktuesorët e evidentuar (**të, ta**) mund të ndërkëmbehen pa cenuar aspak kuptimisht fjalinë dhe kjo gjë shpjegohet vetëm me faktin se kemi përdorime me kuptim përgjithësues, ku ndërkëmbehet lehtë si veta, edhe numri.

Folja-kallëzues e fjalive me kuptim përgjithësues, përjashtuar fjalitë njëkryepërbërëse, njih përdorime me kuptim përgjithësues në secilën prej vetave, në njëjës e shumës.

Shënim: Në gjuhën shqipe kemi përdorim me kuptim përgjithësues edhe në vetën e parë njëjës. E gjejmë këtë përdorim te sentencat popullore. Brenda e sentencave popullore shpreh konkluzione të një përvoje të gjatë shekullore dhe vlera përmbajtësore e tyre është jo vetëm gjithëkohore, por edhe gjithënjërzore: Sa **të fus** merak, ma mirë i **ve** kapak. (Sh. Haxhihyseni, *Gur i randë n'vënd të vet*, 2004, 130); Ku **futsha** kamët, **m'**rafshin dhamët. (po aty) Në këto shembuj kemi të bëjmë me një vetë të parë me kuptim përgjithësues, pasi nuk kemi të bëjmë me një individ të veçantë, specifik,

vetë trajta vetore tregon njëherazi edhe veprimin, edhe vepruesin (a pësuesin në trajtat pësore), ndaj e sheh si normë mospërdorimin e vetorëve të vetës I, II, njëjës e shumës. Prani e domosdoshme e tyre është vetëm në rastet e kundërvënies. Për Floqin, në rastin e parë fjalja ka vetëm një gjymtyrë kryesore (një kryegjymtyrë), në të dytin – të dy gjymtyrët kryesore, kryefjalën dhe kallëzuesin. Sipas tij në fjalitë njëkryegjymtyrëshe nuk mund të themi as që mungon diçka, as që nënkuptohet diçka, sepse të gjitha janë të pranishme, janë paraqitur me mjete gjuhësore të shqipes në të vetmen kryegjymtyrë të fjalisë.

por me një individ që vlen si shembull për të gjithë (*unë, ti, të tjerët, kushdo...*). Veta e parë *unë* mund të barazohet me *gjithsecilin prej nesh*.

3.4.2. Koha e foljes

E tashmja është koha më e përdorshme në ndërtimet me kuptim përgjithësues. Galmiche pohon: “Ndonëse koha e tashme është koha më e pëlqyeshme për ndërtimet me kuptim përgjithësues, përgjithësimin e takojmë edhe në të shkuarën e në të ardhmen...”¹²⁵

G.A. (2002, 175) dhe Çeliku (2012, 147) veçojnë të tashmen dhe të pakryerën e foljes të shoqëruara me pjesëzën *po (e tashmja dhe e pakryera e vazhdimësisë)*, sinonimike me *jam/isha duke punuar*, si kallëzues që tregojnë veprim konkret, të aktualizuar. Mendojmë se edhe përdorime të tilla të kallëzuesit lejojnë interpretime përgjithësuese. Shembullin në G.A. e shohim si rast ambig të përdorimit të foljes: *Ne jemi duke e ngritur edhe më lart qytetërimin tonë*. Nëse *ne* referon individë në përgjithësi, kallëzuesi ka kuptim përgjithësues; nëse *ne* referon individë të veçantë (*ne ekskluzive ose inkluzive*), kallëzuesi është me kuptim të individualizuar.

Pra, ndonëse koha e tashme është koha më tipike e ndërtimeve me kuptim përgjithësues, kjo dukuri gjen përdorim në të gjitha kohët e foljes.

¹²⁵ “Bien que le présent soit le temps de prédilection des jugements génériques, dans la mesure où il est le plus apte à perdre sa référence temporelle, rien n'interdit, a priori, que la généricité prenne place dans le passé ou dans le futur ; la lecture générique sera évidemment facilitée par la présence de compléments (adverbes ou SP temporels capables d'indiquer une durée... Ces compléments permettent même la lecture générique en présence des formes aspectuelles de l'achevé ou du progressif...) (Galmiche, 1985, 7)

E gjejmë të tashmen¹²⁶ dhe të ardhmen¹²⁷ me kuptim përgjithësues, në kuptimin e të vërteta të përgjithshme, edhe në gjuhën angleze: *Foshnjët normalisht humbin peshën në fillim.* (*Babies normally lose weight in the beginning.*); (*When peace is available, people will go for it.*);

Shembujt e kohës së foljes po i sjellim të mënyrës dëftore:

- koha e tashme e mënyrës dëftore

(1) *Pasqyra është një gjol i vogël që s'ka asnjë thellësi. Atje s'fut dot krahun dhe nuk kap dot asgjë.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 317)

(2) *Ai fyell nuk ishte për muze. Kënga, jeta nuk futen në muze, or shokë e vëllezër. Në muze hyjnë kujtimet.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1977, 39)

(3) *Ishte një erë që vinte rrotull, një erë e fortë. Piktori qeshi me ironi: "Hë, ti bëhesh gati me akualet në dorë të pikturosh, kurse era...".* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 284)

¹²⁶ "If you are using the simple present to talk about something that is always or generally true, you can reinforce or weaken your statement by using an adverb.
Babies normally lose weight in the beginning.
The official attitude is usually one of ridicule.
Traditionally, the Communist Party does well in local elections."

(Nëse jeni duke përdorur të tashmen për të folur për diçka që është gjithmonë ose përgjithësisht e vërtetë, mund të përforconi ose dobësoni deklaratën tuaj duke përdorur një ndajfolje.
Bebët zakonisht humbin peshën në fillim.
Qëndrimi zyrtar është zakonisht një tallje.
Tradicionalisht, Partia Komuniste del mirë në zgjedhjet lokale.) COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 249

¹²⁷ "If you want to talk about general truths and to say what can be expected to happen if a particular situation arises, you use the future tense.
When peace is available, people will go for it."
(Nëse doni të flisni për të vërtetat e përgjithshme dhe të thoni se çfarë mund të pritët të ndodhë nëse lind një situatë e caktuar, ju përdorni kohën e ardhshme.
Kur paqja është në dispozicion, njerëzit do të shkojnë për të.) COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 255

(4) Atje ku nuk ia **mban** dot trimërisë, i **falemi** dhelpërisë..., - i tha arhondi i madh në vesh priftit të Shëniedielës. (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1981, 152)

(5) Në rast se **keni** foto që shfaqin një ide, pasqyrojnë një ngjarje, kanë një mendim, **mund ta ndani** me ne. Ju falenderojmë. (Shekulli, 18 korrik 2011)

- koha e pakryer e mënyrës dëftore

(6) **Doje** të tillë, pra, **doje** edhe luftë, edhe paqe? Ja ku i **kishe**, atje te qilari....(I. Kadare, Darka e gabuar, 2009, 77)

(7) Me t'u futur në këtë vendbanim të madh, **hetoje e përjetoje** ankthin e rrezikut,... (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 175)

(8) Mësimin e tij nuk e **merrje vesh** mirë se ç'që, gjuhë frëngjishte apo histori e Francës. (Dh. Shuteriqi, Vepra letrare, 4, 1982, 271)

- koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore

(9) - E keqja është gjithmonë më e fortë se e mira..., - tha Miltoja. - Duhet të jesh me miliona sekonda vazhdimisht shëndoshë e mirë, që të qëndrosh i gjallë; një sekondë po **pësove** diçka, **mbarove**. (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 360)

(10) - Jo, kush shkon, nuk vjen prapë! Është si zogu i kuvlisë: posa ia **hape, iku**... (M. Kuteli, Tregime..., 2005, 77)

- koha e kryer e mënyrës dëftore

(11) Një ditë ai i kishte lënë të kuptonte të vëllait se, po ta bësh komunizmin profesion, atëherë ia **ke hequr** lëngun e jetës dhe e **ke lënë** eshkë të thatë,... (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 351-352)

(12) Balozi mbante satërin ndër dhëmbë, vriste, priste, gllabëronte. Thuaj baloz e i **ke thënë** të gjitha mynxyrat...(M. Kuteli, Tregime..., 2005, 159)

(13) Epo nëse i **kemi bërë** deri më parë pa ndonjë qëllim të caktuar, tani e tutje dijeni se lajthia është një element shumë i rëndësishëm ushqimi në një dietë të ekuilibruar. (Panorama, 24 korrik 2011)

- koha e ardhme e mënyrës dëftore

(14) Po përgatiteni për pushime? **Do të merrni** me vete dhe fëmijët? Po mendoni të shkoni me avion? Atëherë nuk do të jenë pushime, të paktën jo për ju! (Shekulli, 18 korrik 2011)

(15) Nëqoftëse ke blerë një makinë jashtë kufijve, e ke importuar atë në Shqipëri dhe ende nuk e ke prerë doganën, **do të lehtësohesh** nga kjo barrë pagese. (Mapo, 19 korrik 2011)

Shënim: Kohës së ardhme të foljes së mënyrës dëftore që ka një përdorim me kuptim përgjithësues i takon dhe konstrukti i mëposhtëm që emërtohet e ardhmja e sigurisë¹²⁸: Një herë **kemi për të vdekë!** (Përralla shqiptare, f. 225) kemi për të vdekë = do të vdesim

- koha e ardhme e së shkuarës e mënyrës dëftore

(16) Po **të afroheshe**, **do të shikoje** se dërrasat e moçme të gjoksit, të ijeve e të shpinës ishin plasaritur nga dielli dhe shiu dhe ngjanin si lëkura e një përbindëshi, ndërsa këmbët e tij të rënda, me kalimin e viteve, qenë fundosur në tokë gjer në gju. (I. Kadare, Përbindëshi, 1991, 17)

(17) Ajo qe ndryshuar aq shumë, sa **do të besojë** se i kishte ndodhur një tjetri. (I. Kadare, Përbindëshi, 1991, 32)

(18) Mos nxito për të pasur sukses. Për çfarë **do të jetoje** pas kësaj? Më mirë bëj horizontin qëllimin tënd. (Mapo, 19 korrik 2011)

¹²⁸ Në "Gramatika praktike e gjuhës shqipe", M. Çeliku, M. Karapinjalli, R. Stringa, togu i tipit kam për të punuar cilësohet si e ardhmja e sigurisë e mënyrës dëftore.

3.4.3. Mënyrat e foljes

Më lart sollëm raste të përdorimeve të foljes me kuptim përgjithësues në kohët e **mënyrës dëftore**. Kjo mënyrë njihet përdorim të dendur të foljes me kuptim përgjithësues¹²⁹, por foljet me kuptim përgjithësues i takojmë edhe në mënyrat e tjera: lidhore, habitore, dëshirore e urdhërore.¹³⁰

3.4.3.1. mënyra lidhore

Duhet thënë që mënyra lidhore është dhe mënyra më tepër e marrë në shqyrtim nga Çeliku në ciklin e leksioneve “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980 dhe në kapitullin e tij në Gramatikë e Akademisë (sintaksa), vepra të cituara më parë. Ai e sheh këtë mënyrë si më të përdorurën dhe bën dhe një klasifikim sipas të cilit mënyra lidhore “përdoret gjerësisht me vlerë të përgjithësuar në tre tipa strukturorë.”¹³¹ Shihet (po aty) nga Çeliku përdorimi i gjerë i kësaj mënyre në stilin publicistik. Ne konstatojmë përdorim të dendur të saj dhe në stilin e letërsisë artistike. Çeliku thekson përdorimin e gjerë të lidhore “në fjali të pavarura e kryesore të shoqëruara nga foljet modale *mund* e *duhet*”¹³². Edhe sipas nesh mënyra lidhore e foljes me kuptim përgjithësues është mënyra më e përdorur, pas mënyrës dëftore. E kemi hasur në vetën e dytë numër njëjës, jo vetëm në kohën e tashme, siç është bërë e njohur deri më sot, por po aq dendur edhe në kohën e pakryer të kësaj mënyre, fare rrallë në kohën e kryer të saj.¹³³

a) mënyra lidhore (koha e tashme dhe e pakryer, veta e dytë numër njëjës):

¹²⁹ Gramatika e Akademisë, sintaksa, f. 385; Çeliku, “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, (leksione), 1980, f. 36

¹³⁰ Në Gramatikën praktike (2007), ndryshe nga G.A. (1995) nuk njihet mënyra kushtore, foljes i takojnë 5 mënyra: dëftore, lidhore, habitore, dëshirore dhe urdhërore. 5 mënyra të foljes njihet dhe F. Agalliu në “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë 1988.

¹³¹ M. Çeliku, “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980, f. 34

¹³² Gram. e Akademisë, sintaksa, f. 384

¹³³ F. Agalliu në “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë 1988, e lidh përdorimin e dendur të kohës së tashme dhe të pakryer të mënyrës lidhore me faktin që “këto dy forma kohore plotësojnë disa funksione që në plan krahasues të jashtëm do t’i takonin paskajores.” f. 57

(1) Një diçka tjetër po dëgjohej ndërkaq. **Të thoshe** se ishte diçka që nuk pritej, ishte pak. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 28)

(2) Vdekja mbi det është nga më prekëset... se tani që pamë gjithë këto vende. Tani që pamë këtë ferrabot... këto sinjorina... e që hëngrëm e pimë... tani **të vdesësh** është marrëzi. (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 83)

(3) Është e frikshme **të mendosh** se autori i ka përgatitur veprimet e tij përgjatë dy viteve pa qenë i trazuar nga kurrkush. (Mapo, 27 korrik 2011)

(4) **Të jesh** në Myzeqe, pa **të shikosh**. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 195)

b) mënyra lidhore e paraprirë nga foljet modale mund e duhet (koha e tashme, e pakryer dhe e kryer, veta e dytë numër njëjës):

(5) Po ai drejgjoll nuk ishte si toka, ku **mund të përvidhesh** nëpër hendeqe e prapa gardhiqeve. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 318)

(6) Babi thotë se **duhet të kesh frikë** nga të gjallët dhe jo nga të vdekurit, ... (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 48)

(7) Që t'i nxirrje asaj gruajë nga goja jo mallkime, por ndonjë fjalë njerëzore, **duhet të ngjiteshe** gjer te burri i saj, duke ngritur sytë drejt fotografisë së tij. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 147)

(8) Për më keq, meqë parive u duhen mediat për ta përcjellë zërin e tyre prej megafoni deri te qytetarët, **mund të shohësh** dhe jo pak gazetarë që bredhin me makina të tilla. (Mapo, 19 korrik 2011)

(9) Unë po shkoj të shuaj motorin, se libra mund të lexosh me motor ndezur, por, **të flasësh** për libra, nuk flet dot, se nuk dëgjohej. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 418)

(10) Nuk kam kërkuar falje, por mësova se ndonjëherë kur e tejkalon kufirin pak, në një situatë vërtet serioze, me dikë që mund të mos ketë sens të njëjtë humori, atëherë **mund ta kesh kaluar** kufirin. (Mapo, 27 korrik 2011)

Shënime: 1. Të njëjtën vlerë modale të mundësisë, pamundësisë a domosdoshmërisë mendojmë se kanë dhe përdorimet e mëposhtme me kuptim përgjithësues: *Sa për ato që thoshte Petriti rreth parësisë që merrte në rrethanat e kohës lufta për çlirimin e Atdheut, Peri ishte në një mendje, se, domosdo, pa i rregulluar njëherë punët me të huajin, **nuk ke si t'i rregullosh** me kapitalistët “e tu”.* (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 304). *nuk ke si t'i rregullosh = nuk mund t'i rregullosh;* Dhe kur e thotë “patrioti” Pollo, **nuk të mbetet veç ta besosh.** (Shekulli, 18 korrik, 2011) *nuk të mbetet veç ta besosh = duhet ta besosh;* Nuk mjafton të blini vetëm kostum të ri, kapelë ose syze interesante, **keni nevojë të punoni** pak dhe me tenin e lëkurës suaj. (Mapo, 23 korrik 2011) *keni nevojë të punoni = duhet të punoni...*

2. I shtojmë shembujve të mësipërm dhe konstruktet tautologjike që vijojnë, konstrukte që shoqërohen dhe nga pjesëza **dot**.¹³⁴

Edhe në Gramatikën praktike (2007, 413) ky lloj kallëzuesi tregon një veprim të theksuar, të nënvizuar. I gjejmë këto nuancime kuptimore (theksimin e nënvizimin) dhe në shembujt tanë, por duam të shtojmë këtu si kuptimin e vlerën e mundësisë (për folje në pohore) dhe të pamundësisë (për folje në mohore), ashtu edhe kuptimin përgjithësues në konstruktet tautologjike në këto raste përdorimore: *Zjarri nuk mbahet me libra, ndonëse mund ta ndezësh me libra, por me librat e tyre as **për ta ndezur nuk e ndizje dot** zjarrin, se ishin akull të ftohtë.* (Lulja e kripës, 2, J. Xoxa, f. 23 *për ta ndezur nuk e ndizje dot = nuk mund ta ndizje;* Shqiptarin, arrë të fortë, **për të thyer s'e thyen dot**, po në gliko mund edhe

¹³⁴ Sipas S. Floqit, në artikullin “Konstrukte tautologjike në shqipen e sotme”, Studime Filologjike, 1968/3, “Konstruktet tautologjike shprehin kuptime e nuanca të ndryshme si theksim të një cilësie a të një procesi; në raste të tjera në konstruktin tautologjik theksohet karakteri i vërtetë, autentik i tiparit të gjymtyrës së parë, kurse ndonjëherë, në kushte të caktuara, me to mund të shprehim edhe karakterin ekskluziv të tiparit.” (f. 48)

*ta përtypësh, si kaçkë! (Vepra letrare 4, Dh. Shuteriqi, 1982, f. 227) për të
thyer s'e thyen dot = nuk mund ta thyesh*¹³⁵

3.4.3.2. mënyra habitore

Kemi gjetur raste të përdorimit të foljes me kuptim përgjithësues edhe në mënyrën habitore, koha e tashme, veta e dytë njëjës dhe veta e parë shumës: “*Me flori bleke edhe sëmundjen e fëlliqur të bukurisë...*”, - *po thoshte sot me vete i biri...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 528)

3.4.3.3. mënyra dëshirore

Raste të përdorimit të foljes me kuptim përgjithësues në mënyrën dëshirore, koha e tashme, veta e dytë njëjës e shumës dhe veta e parë shumës:

(1) *Edhe në mos zënc sot, zë nesër, se në peshkim shpresa është e përditshme, jo si në bujqësi, ku është e përvitshme.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 300)

(2) *Dy mësim të mëdha: me pashallarët s'fitohet përfundimisht liria; fqinjët i paçim miq, po besimin te vetja.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, f. 236)

3.4.3.4. mënyra urdhërore

Sipas M. Çelikut, fjalitë me vetë të përgjithësuar “me folje në mënyrën urdhërore i gjejmë kryesisht në stilin e letërsisë artistike”¹³⁶ dhe në tekstet mësimore. Mendojmë të zgjerojmë mendimin e mësipërm me faktin se mënyra urdhërore e foljes me kuptim të përgjithësuar ka një përdorim të dendur. Ajo takohet rëndom në sentencat popullore, në tekste udhëzuese, reklama, shenjat e horoskopit, etj. E gjejmë si në vetën e dytë njëjës, ashtu dhe në shumës:

¹³⁵ Nisur nga artikulli “Konstrukte tautologjike në shqipen e sotme”, Spiro Floqi, S. F., 1968/3, dhe klasifikimi që i bën autori këtyre konstrukteve në varësi të marrëdhënieve sintaksore të tyre, do të thonim se shembujt e dhënë më lart do t'i klasifikonim në grupin e tretë *si konstrukte tautologjike të përbërë prej një fjale me funksion kallëzuesi (foljor ose emëror) dhe prej përsëritjes së po asaj fjale, por me funksionin e një plotësori “të marrëdhënjes”....(f. 13)*

¹³⁶ “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980, f. 36

- (1) **Mos u gënjeni** nga dhuratat e armikut. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 137)
- (2) “Gratë nuk përgojosen në tryezën e burrave... - tha arhondi i vogël. - Burrin **përgojose**, në je burrë...” (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 177)
- (3) Ja, **shtyje** sa të duash me kujdes vozën ti, nuk shkon drejt, do të dredhohë patjetër sa andej-këtej, si një i pirë që i merren këmbët. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 304)
- (4) Ku s’ka provuar të ngrejë urë një romak, **mos provo**, se të shkon huq (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 169)
- (5) Robin e zotit kurr **mos e shaj!** (Përralla shqiptare, f.132)
- (6) **Merrni** paketën tuaj mujore Mix 1000, **kombinojini** si të dëshironi Minutat, SMS, MMS e MB3G dhe **komunikoni** me të gjithë. (Mapo, 19 korrik 2011)

3.4.4. Forma veprorë/joveprorë e foljes me kuptim përgjithësues

Përdorime të foljes me kuptim përgjithësues i takojmë si në formën veprorë të saj, edhe në formën joveprorë të saj. Shembulli i mëposhtëm (1a, b) tregon për struktura paralele.¹³⁷ Këto forma foljore mund të këmbehen lehtësisht me njëra-tjetrën pa dëmtuar semantikisht fjalitë (1b):

(1a) Poezinë popullore është e vështirë **ta quash** thjesht poezi. Do të ishte më e saktë **të quhej** sistem poetik popullor. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 11)

(1b) Poezia popullore është e vështirë **të quhet** thjesht poezi. Do të ishte më e saktë **ta quaje** sistem poetik popullor.

¹³⁷ Në “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, M. Çeliku, Elbasan, 1980, thuhet: “Ndërtimi mund + lidhore veta II njëjës me vlerë të përgjithësuar herë – herë përdoret në gjuhën letrare shqipe paralelisht me ndërtimin pavetor mund + lidhore veta III njëjës joveprorë.” Në vazhdim Çeliku sjell shembujt që i konsideron si përdorime paralele: “Nuk mund të luftojë me sukses dhe të arrijë fitore kundër nazistëve gjermanë... Nuk mund të luftohej me sukses dhe të arrihej fitorja kundër nazistëve gjermanë, pa luftuar njëkohësisht edhe kundër shërbëtorëve të tyre.” (f. 35)

Folja e formës veprorë **ta quash** (unë, ti, kushdo) është përdorur me kuptim përgjithësues, ka veprues përgjithësues, por edhe në formën joveprorë **të quhej** mendojmë se kemi të bëjmë me të njëjtin veprues¹³⁸, plotës vepronjës, apo kryefjalë logjike¹³⁹, rrjedhimisht të dyja fjalitë kanë kuptim përgjithësues.

Ky përdorim takohet edhe në gjuhën angleze: *Të dy librat mund të merren në bibliotekën publike.* (Both of these books can be obtained from the public library.)¹⁴⁰

3.4.4.1 Foljet vetore të formës joveprorë me kuptim përgjithësues

Rastet kur kemi përdorim të formës joveprorë të foljes vetore me kuptim përgjithësues janë jo të pakta në gjuhën shqipe. E kemi ndeshur më së shumti në foljet joveprorë (me mbaresë), mënyra dëftore apo lidhore, koha e tashme dhe e pakryer, veta e dytë njëjës, por edhe në vetën e parë shumës:

(1) *Po, sigurisht kur **piqesh** dhe i vlerëson më mirë gjërat edhe i shijon ato më shumë.* (Mapo, 19 korrik 2011)

(2) *Njerëzit ikin të gjithë dhe vetëm ti **mbetesh** përjashta, e trembur dhe e pafuqishme,...* (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 66)

¹³⁸ Përsa i përket çështjes së vepruesit të shprehur apo të pasqyruar, duhet thënë se rastet e shprehjes së tij në ndërtimin pësor të fjalisë janë të rralla në gjuhën shqipe, kjo sepse ose vepruesi është i njohur dhe nuk është e nevojshme të shprehet, ose sepse është i panjohur dhe nuk mund të përcaktohet lehtë. Ka një arsye të caktuar kur vepruesi është i shprehur. Shih për më tepër M. Karapinjalli, "Kërkime dhe studime në fushën e gjuhës shqipe", Sejko 2001, f. 22-24.

¹³⁹ E quan të tillë Mahir Domi në Sintaksa, 1954.

¹⁴⁰ "Using a passive form of a verb gives you the option of not mentioning the person or thing responsible for the action, often called the agent of the action.

You may want to do this for one of these reasons: ... because people in general are the agents.

Both of these books can be obtained from the public library.

It is very strange and has never been adequately explained." (Përdorimi i një forme pasive të një foljeje ju jep mundësinë të mos përmendni personin ose gjënë përgjegjëse për veprimin, shpesh të quajtur agjenti i veprimit. Ju mund të dëshironi ta bëni këtë për një nga arsyet:... sepse agjentët e veprimit janë njerëzit në përgjithësi...) COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 404

(3) **Futeshe** në një portë të madhe, nga futeshin njerëz e kafshë, **gjendeshe** në një ahur të gjerë me një zjarr në mes; (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 121)

(4) I dyshuar **nuk bëhesh**, je. (I Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 166)

Në raste të rralla kemi ndeshur kuptimin përgjithësues dhe në folje të formës joveprore formuar me pjesëzën **u**. Këtë rast e kemi takuar në të tashmen e mënyrës habitore: *Shokët më kanë ngjitur emrin “taraku i Kotorrit”, po mua më vjen keq që s’u lënka shpirti peng, se po të kish qenë e mundur do t’jua kisha lënë në log të kuvendit e do të kisha shkuar.* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 114)

Shënim: Duam të veçojmë këtu disa folje të formës joveprore, si: **dihet, njihet, besohet, merret me mend, kuptohet** etj. të cilat njohin përdorime vetëm me kuptim përgjithësues. Këto folje që dalin vetëm në formën e vetës së tretë njëjës, në mënyrën dëftore dhe lidhore, i gjejmë më shumë në stilin dituror dhe përgjithësisht si pjesë kryesore të fjalisë së përbërë kryefjalore: **Dihet** interesimi i Gëtes për folklorin e Ballkanit. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 20); **Dihet** ikja e madhe e arbëreshëve pas pushtimit otoman. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 53); *Dhe fataliteti i guximeve njihet, e dashura bija ime.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 230); *Po të jetë vërtet kështu, atëherë mund të besohet që pavdekshmëria e shpirtit s’është veçse kujtesa që kalon nga brezi në brez.* (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 162- 163); **Merret me mend** se si zjeu Kalaja nga ai libër. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 187); **Kuptohet** pështjellimi që duhet kapërcyer këtë vjeshtë. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 224);

Kemi hasur dhe në raste të shprehjes së vepruesit me përemrin e pacaktuar **të gjithë**:po, siç **dihet nga të gjithë**, ne ortodoksia dhe ata katoliqia nuk jemi marrë e nuk po merremi dot vesh, për të keqen tonë, se ky turku që përfshiu visetortodokse që kish pranë, u është

përveshur dhe viseve katolike. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 51).

3.4.4.2. Foljet pavetore me kuptim përgjithësues

G.A. (1995, 269) veçon: “disa folje jokallimtare në formë joveprorë të shoqëruara ose jo me një pjesëz mohimi, si: *s’shkohet, s’rrihet, s’lyhet, s’rrohet, s’flitet* etj. Këto folje pavetore mund të përdoren edhe pa pjesëzën e mohimit, sidomos në fjali pyetëse. Foljet pavetore të këtij tipi jo vetëm që emërtojnë veprime në mënyrë të përgjithësuar, pa vetë të caktuar, por shprehin edhe ngjyrimin modal të mundësisë, ndonjëherë atë të detyrimit. Kështu, *Këtej s’kalohet* është e barazvlershme me fjalinë *Këtej s’mund (a s’duhet) të kalojë njeri.*”

Të njëjtën qëndrim e gjejmë te Stefan Prifti (1958)¹⁴¹, Ludmila Buxheli (2011)¹⁴².

¹⁴¹ “... kryefjala logjike ose plotësori i kufizimit mungon, sepse folja thuhet me kuptim të përgjithshëm, prandaj këtu nënkuptohet dhanorja e një fjale të përgjithshme, si: njeriu, robi, kush etj. p.sh. S’i rrihet njeriut (kujt) vetëm në majë të malit.” (1958:59)

¹⁴² “Tipat e foljeve njëvetore të strukturës sipërfaqësore”, shpjegon se këto folje, të cilat kanë përgjegjëset e tyre trevetore, janë pa argument të jashtëm, por vetëm në strukturën sipërfaqësore. Ndonëse ai nuk shprehet fonetikisht, ai ekziston dhe është një *veprues me kuptim të përgjithshëm ose gjenerik*. “Që argument i jashtëm i foljeve njëvetore të tipit *flihet, rrohet, jetohet* etj. ekziston, por është mënjeluar nga struktura sipërfaqësore, e provon fakti që ai është i pranishëm si një veprues me kuptim të përgjithshëm ose gjenerik, i cili mund të përcaktohet ose si një njeri i vetëm ose si një grup njerëzish, por i nënkuptueshëm në strukturën sipërfaqësore. Për pasojë, struktura argumentore e foljeve të tipit *punoj/punohet, rri/rrihet* nuk ka pësuar asnjë ndryshim. Në të dy nivelet strukturore kemi të bëjmë me të njëjtën strukturë argument, me folje me një argument të jashtëm, i cili te foljet e tipit *punohet, rrihet* ekziston, por i **mungon** strukturës sipërfaqësore...” (2011:147) Këto folje Buxheli i sheh me tiparin [+HUMAN] ku kryefjala “bart rolin semantik të një vepruesi [+HUMAN] me kuptim gjenerik, i cili nuk mund të realizohet fonetikisht as me një SE në rasën emërore, as si plotës i shprehur me një sintagmë parafjalore.” (2011:190)

Buxheli, referuar dhe *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II Tiranë, 1976 dhe Gramatikës së Akademisë veçon dhe rastet kur forma pavetore e foljes në lidhore mund të zëvendësohet nga lidhori veprorë e vetës së dytë njëjës me kuptim përgjithësues: *Vetëm me ujin nuk mund të jetohet; vetëm me ujin nuk mund të jetosh.* [2011:201]

Edhe M. Çeliku përmend vetën e përgjithësuar në ndërtimet e mësipërme: “Ndërtimi mund + lidhore veta II njëjës me vlerë të përgjithësuar herë-herë përdoret në gjuhën letrare shqipe paralelisht me ndërtimin pavetor mund + lidhore veta III njëjës veprorë. Nuk *mund të luftoje* me sukses dhe të arrijë fitore kundër nazistëve gjermanë... Ky ndërtim përdoret paralelisht me ndërtimin: *Nuk mund të luftohet* me sukses dhe të arrijë fitorja kundër nazistëve gjermanë, pa luftuar njëkohësisht edhe kundër shërbëtorëve të tyre.” [Çeliku: 1980:35]

Analizojmë shembullin:

(1) *Murit me kokë **nuk i bihet**, - i thashë.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 13)

Këtë fjali e shohim sinonimike me: *Murit me kokë **nuk mund t'i bjerë** njeri (as unë, as ti, askush).* Është i dukshëm modaliteti i pamundësisë, si dhe kuptimi mohues përgjithësues¹⁴³. Ndonëse i pashprehur fonetikisht, në raste të tilla nënkuptojmë një veprues përgjithësues.

Shembuj të tjerë të foljeve pavetore me kuptim përgjithësues (pohore dhe mohore, mënyra dëftore dhe lidhore):

(2) *Dhe pse i **thuhet** nganjëherë derrit dajë!* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 113)

(3) *“Po ku **gjuhet** dot në det të hapët me fushnjera e ku **vozitet** dot në det të thellë me palluqe?!...”* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2 , 1981, 410)

(4) *Rinia e mirë sot **nuk gjendet** sheshit, ...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2 , 1981, 480)

(5) *Andej ishte vështirë **të kalohej**, por kapedan Kadri Gurra i dinte mirë këto vende...*
(D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 108)

(6) *Po a i **iket** mallkimit ndonjëherë?.. Me sa i **iket** rrufesë...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1 , 1980, 243)

3.4.5. Format e pashtjelluara me kuptim përgjithësues

Kuptimin përgjithësues e takojmë dhe në formën e pashtjelluar të foljes dhe kjo falë tipareve foljore të formave të pashtjelluara¹⁴⁴. Format e pashtjelluara të foljes shprehin një

¹⁴³ Mendojmë se përdorimet me kuptim përgjithësues pohojnë secilin prej nesh, d.m.th tregojnë një veprim që i takon kujtdo në fjalitë pohore, ndërsa në fjalitë mohore mohojnë secilin prej nesh, duke treguar një veprim që nuk i takon askujt.

¹⁴⁴ Në rrafshin teorik format e pashtjelluara të foljes janë kategori gjuhësore ndërmjetëse sepse gërshetojnë karakteristika të pjesëve të ndryshme të ligjëratës: nga njëra anë, çdo formë e pashtjelluar ka karakteristikat e foljes, që janë karakteristika të pamungueshme, të cilat lidhin atë me sistemin foljor; nga ana tjetër, çdo

veprim si proces e në vlerësimin tonë ky veprim lejon interpretim përgjithësues ose jo në varësi të kontekstit ku gjen përdorim. Format e pashtjelluara të foljes kanë një veprues (i njëjtë ose jo me formën e shtjelluar në fjali) që mund të jetë i individualizuar: *Në rrugë, tek ecte gati **duke rendur** (ai) drejt Degës së Brendshme, u bind se nuk ishte mort.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 178); apo përgjithësues: *Dhe kur i shkruan ndonjë shokut tënd, (ti, unë, kushdo) **duke radhitur** gërmat dhe fjalët, të del përpara gjithë fëminia, të kujtohen gjithë peripecitë, shkolla, mësuesit, vajzat....* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 322-323)

Analizojmë shembujt:

(1) *S'ishte nevoja **t'i dëgjoje** qartë, **për të marrë vesh** se ishte diçka e keqe.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 178)

(2) *Një erë e mirë të ndillte t'i vije zjarrit pranë, **të uleshe** në bisht dhe **të përgatiteshe për të lëpirë gishtat**.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 285)

Shembujt (1), (2) janë raste që shfaqin ambiguitet: vepruesi mund të jetë i individualizuar, folësi i drejtohet bashkëfolësit, por mund të jetë edhe një veprues përgjithësues, folësi i drejtohet kujtdo, edhe vetes.

Le ta vendosim shembullin (1) në një kontekst gjuhësor më të gjerë, për të parë nëse ambiguiteti do të shuhet:

*Ai brofi nga shtrati, u sul te dritarja dhe, pa i hapur mirë flegtrat, e kapi mynxyrën. Fjalët vinin nga fortafolësi i madh sipër kështjellës. S'ishte nevoja **t'i dëgjoje** qartë, **për të marrë vesh** se ishte diçka e keqe. Përderisa lajmi shpërndahej prej fortafolësit, nuk mund të ishte veçse i atillë.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 178)

formë e pashtjelluar ka dhe karakteristike të një pjese tjetër ligjërata e pikërisht ato të emrit, mbiemrit ose të ndajfoljes, të cilat e lidhin atë përkatësisht me sistemin emëror, mbiemëror, a ndajfoljor. M. Çeliku, "Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe", 2006, f. 219

Po paraqesim në sythët në vazhdim shembuj të formave të pashtjelluara në rastet kur mendojmë se kanë përdorim me kuptim përgjithësues.¹⁴⁵

3.4.5.1 Forma e pashtjelluar e gerundit (të bërë/së bëri):

a) gerund i qëllimit

(1) *Moli fillonte nga një cektinë.... dhe mbaronte te thellësitë e mëdha blu, që të kallnin datën e të merrnin mendtë kur ulje kryet për **t'i vështruar**.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 509)

(2) *Dhe kur s'ish e mundur të mblidhëshin ne kryeqytet të Skënderbeut, s'duhej mëndje e thellë për **të kuptuar** që do mos vinin as në kryeqytet të nonjë prince shqiptar tjetër.* (F. Noli, *Vepra* 4, 1989, 98 – 99)

b) gerundi i kohës

(3) *Ata janë pjekur tashmë dhe është spektakli më i bukur në botën bimore kur i shikon, me **t'i prekur** një fije, të injektojnë me përst-përst lëngun e vet dhe të spërkasin botën me farën e tyre...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 70)

(4) *Petritit herën e parë që kishte kaluar përmes fshatit i patën bërë përshtypje shtëpitë e ngucura shpinë më shpinë si delet kur ndiejnë rrezikun e bishës. **Me t'u futur** në këtë vendbanim të madh, hetoje e përjetoje ankthin e rrezikut...* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 175)

c) gerundi përcaktor

(5) *... lulja e kishte marrë tashmë trajtën e vet dhe çdo përpjekje për **ta drejtuar** ishte e pamundur.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 169)

¹⁴⁵Format e pashtjelluara po i rendisim sipas klasifikimit të bërë nga Çeliku në "Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe", Tiranë 2006.

d) gerundi përcaktor kallëzuesor

(6) Në këto raste, është e natyrshme ngatërresa për autorsinë dhe këtu s'ka ndonjë gjë për **t'u çuditur**. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 108)

e) gerundi kundrinor

(7) *Shumica mendonin se s'duhej ndonjë vramendje për t'u gjetur shkaku*: (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 117)

(8) *Po të hash bukë e ullinj, s'ngopesh së ngrëni*. (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 58)

3.4.5.2. Paskajorja¹⁴⁶

Duhet thënë se rastet e shfaqjes së paskajores së përgjithësuar janë të pakta në korpusin tonë. Ky fakt është i lidhur me vetë përdorimin e kufizuar të kësaj forme në gjuhën shqipe.¹⁴⁷

(1) *E mban vallë grepi një peshk kaq të madh? Duhet të jetë vështirë për ta tërhequr (ti, unë, secili nga ne)*. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 346)

Edhe në raste të paskajores geqe:

(2) *Sa lezet qenka me fjetë kështu!* (Përralla shqiptare, f. 74)

(3) - *S'asht gja me nxjerrë ujë prej gurit, por a je i zoti me nxjerrë tambël prej gurit?* (Përralla shqiptare, f. 141)

¹⁴⁶ “**Paskajorja** del në fjali në rolin e gjymtyrëve kryesore të fjalisë (të kryefjalës, të pjesës emërore të kallëzuesit), por edhe në rolin e kundrinorit të drejtë dhe në funksionin e një fjalie të mëvetësishme. Këto, sidomos funksioni kryefjalor, mbahen si funksione themelore të saj.” M. Çeliku, “Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe”, Tiranë 2006, f. 221.

¹⁴⁷ Shaban Demiraj në artikullin “Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe”, botuar në S. F., 171/1, flet për format e pashtjelluara të tipit me ba/për të bërë me vlerë paskajoreje dhe përmend ndër të tjera faktin gjuhësor që këto forma janë sinonime me mënyrën lidhore në shumë prej funksioneve të saj. Ndërsa sipas Mehmet Çelikut: “Funksionin e paskajores në gjuhën e sotme letrare shqipe e kryen mënyra lidhore (që herë-herë duket si paskajore e morfemëzuar), emrat foljorë prapashtesorë, emrat prejfoljorë asnjans. (vep. e cit., f.226)

(4) Larg shumë. Vështirë asht **me shkue**. (Përralla shqiptare, f. 250)

(5) I kam ndie tue folë se prej këtu **duhet me i çjerrë** një palë opinga e qatëherë dije se s'je shumë larg. (Përralla shqiptare, f. 252)

3.4.5.3. Forma e pashtjelluar e përcjellores (duke bërë/pa bërë)

Po i klasifikojmë shembujt e përcjellores me kuptim përgjithësues sipas trajtave të shfaqjes së saj:

a) trajta pohore duke bërë

(1) **Duke e parë** këtë njeri çuditëse se si mund të ecte dhe se si mund t'i shtynte këto kocka të mbështjella me lëkurë. (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 48)

(2) Mbas një viti i fali zoti një djalë të shëndoshë e të bukur, që me të kënaqë veç **tue e pa**; (Përralla shqiptare, f. 12)

b) trajta mohore pa bërë

(1) Asgjë e mirë nuk bëhet në këtë botë, **pa i larë** sytë njëherë nga bloza e natës... (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1981, 275)

(2) Peri ishte me një mendje, se, domosdo, **pa i rregulluar** njëherë punët me të huajin, nuk ke si t'i rregullosh me kapitalistët "e tu". (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 304)

(3) Thelbi i mendimit, sa ç'ishte i lehtë për t'u kapur, **pa vënë në punë arsyen**, aq i vështirë bëhej me të. (I. Kadare, Darka e gabuar, 2009, 22)

(4) Një mitraloz, që rrihte nga një majë shkëmbi, desh i korri dhe i nguloi, përmbys prapa një dushku të madh, midis një lëndine, ku s'kishe nga të tërhiqeshe **pa lënë kokën** në shesh. (Dh. Shuteriqi, Vepra letrare 4, 1982, 328)

3.4.5.4. Forma e pashtjelluar e pjesores (bërë/i bërë)

a) tipi bërë

Kemi ndeshur rëndom pjesoren e tipit bërë me kuptim përgjithësues të paraprirë nga foljet modale duhet/do dhe kjo më tepër në stilin shkencor, dituror. Rastet e tipit i bërë janë më të pakta.

(1) **Nuk duhen gjykuar** njerëzit nga pamja e jashtme! (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 48)

(2) Kjo dasmë **duhet mbajtur mënt**, se prej kësaj ruadhë lufta me Venetinë,... (F. Noli, *Vepra 4*, 1989,120)

(3) ... kur është fjala për vepra unike artistike të këtij lloji, **duhet pranuar** se dikush e ka marrë i pari lahutën për të ngritur këngën epike....(I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 108)

(4) Fati **do kapur** prej flokësh. (Përralla shqiptare, f. 114)

b) tipi i bërë

(5) **I parë** kështu, ky universalitet i muzës së tij, kjo politikë e jashtme poetike, tregon plotshmërinë e personalitetit të një populli. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 57)

(6) ... Mihali, kishte marrë përsipër jo vetëm të siguronte mjetin, por edhe të siguronte për shoqërues njërin prej njerëzve më të ditur të viseve rumune, Jon Eliade Raduleskun, **i njohur** shkurt si Eliade. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 211)

3.5. Fjalitë me kuptim përgjithësues

Për të shpjeguar se ç'kuptojmë me *fjali me kuptim përgjithësues* po i referohemi formulimit të Kurodas, formulim që i është referuar dhe Galmiche në artikullin e tij (1985): "E quaj një fjalë përgjithësuese, nëse ideja që shpreh ajo ka të bëjë me një gjendje të caktuar të gjërave të përgjithshme, të zakonshme apo të gjërave që ndodhin shpesh, dhe "specifike",

në qoftë se ideja e shprehur i referohet një rrethane të veçantë të një ngjarjeje apo të një gjendjeje të gjërave."¹⁴⁸ (Y. Kuroda, 1973,188)

Fjali që referojnë gjëra e veprime në përgjithësi, pra, fjali me kuptim përgjithësues gjen rëndom në gjuhën shqipe.

Përsa i takon trajtimit të këtyre fjalive në letërsinë gjuhësore shqiptare, duhet thënë se aty-këtu, në gramatika a artikuj përmendet ndonjë tip i këtij përdorimi, veçanërisht fjalitë njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar.

Referuar korpusit tonë, themi se kuptimin përgjithësues e takojmë në të gjitha llojet e fjalive: sa në fjalitë e thjeshta, aq dhe në fjalitë e përbëra, qofshin këto bashkërenditëse apo nënrenditëse, sa në sifjalitë kryesore të tyre, aq dhe në ato të varurat dhe kjo si për fjalitë me strukturë njëkryepërbërëse, ashtu edhe për fjalitë dykryepërbërëse. Le t'i shohim të gjitha këto me ilustrimet përkatëse.

3.5.1. Fjalitë e thjeshta

a) sipas modalitetit (pohore dhe mohore)

(1) ***Sendet bëjnë pa njeriun...***, - më thoshte shpesh zotnia. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 92)

(2) ***Te Donika mund të gjeje dhe verë të zgjedhur.*** (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 227)

(3) ***Disa herë jeta të duket e shkurtër***, - tha ajo. – ***Por disa herë, papritur, të duket e gjatë, e gjatë.*** (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 68)

(4) ***Mund të zbardhësh dhëmbët në një institucion shtetëror? Në këtë drejtim nuk mund të zbardhësh dhëmbët!*** (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 180)

¹⁴⁸ Y. Kuroda (1973): «J'appelle une phrase «générique», si le jugement qu'elle exprime concerne un certain état de chose général, habituel ou courant, et «spécifique» si le jugement qu'elle exprime se réfère à une occurrence particulière d'un événement ou d'un état de choses» Galmiche, 1985, p. 188

b) sipas kumtimit: dëftore, pyetëse, nxitëse e dëshirore

(5) ***Të folurit bukur të kredh gjithmonë në vorbullën e pasthirmave të admirimit të buzëve të hapura, të ngjyera me të kuq;*** (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 77-78)

(6) ***Nga një bisedë e tillë burrash shumë lehtë mund të kaloje në këngën epike e anasjelltas.*** (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 38)

(7) ***Do të shikosh thelbin e vërtetë të luftës civile? Shko në pavijonin e dy Gurametove.*** (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 79)

(8) ***Vdeksha po s'mora Tanushën e kralit! E kam parë kur kishim lidhur besë me Kralinë. Vashë më të bukur s'sheh njeriu nën këtë diell!*** (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 112)

(9) ***Po përgatiteni për pushime? Do të merrni me vete dhe fëmijët?*** (Shekulli, 18 korrik 2011)

(11) ***Prite Azem Galicën, prite-e-e-e!*** (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 341)

Shënim: Gjejmë raste të përdorimeve me kuptim përgjithësues dhe në pyetjet retorike: ***Po ku të lë Lekë Dukagjini të mbarohet puna me votë të mirë sa kohë kishte kordhën në dorë?*** (F. Noli, *Vepra* 4, 1989, 119) (*të lë* = *lë ty, mua, këdo...*); ***Sa e bukur është. E kush nuk e dashuron atë perri?*** (P. Marko, *Qyteti i fundit*, 2000, 11).

3.5.2. Fjalitë dykryepërbërëse

Kostaq Cipo (1952), G.A. (sintaksa), Çeliku (1980) shohin vetën II njëjës të përemrit vetor edhe si kryefjalë me kuptim përgjithësues. Në funksion kryefjale me kuptim përgjithësues Çeliku sheh dhe emrin e shquar *njeriu*, ndërsa Stefan Prifti (1958) e sheh atë të shprehur me emra të tjerë. Kryefjala përgjithësuese e fjalisë dykryepërbërëse mund të shprehet, krahas tyre, edhe me grupe emërore:

(1) Kur hyn **njeriu** në atë kullë, duket sikur ndërron krejt jetë. (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 119-120)

(2) Koha ecën, orët, dita, të gjitha ecin, kurse **ti** mbetesh në diçka që s'di si ta quash. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 93)

(3) “Nënë na bën **vetja jonë**, gjyshe na bëjnë **nipërit dhe mbesat tona...**”, - tha ajo nën zë... (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 155)

(4) Po puna mbeti në të errët, dhe **bota** kurrë nuk mundi të mësonte me shiguri cilët qenë ata princër shqiptarë që kurdinë pusinë në pyll të Krrabës; (F. Noli, *Vepra 4*, 1989, 152)

(5) **Njeriu** duhet të mbahet mend në jetë për të mirë. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 179)

Fjalitë dykryepërbërëse me kuptim përgjithësues jo gjithmonë kanë kryefjalë përgjithësuese. Një rast të pavënë re nga studiuesit e quan R. Përnaska (1983/4) rastin e pranisë së një trajte të shkurtër (kundrinor i drejtë) me kuptim përgjithësues.¹⁴⁹

Krahas tipit të mësipërm, fjalitë dykryepërbërëse me kuptim përgjithësues janë:

a) me kryefjalë përgjithësuese dhe një kundrinor apo caktuesor përgjithësues:

(6) “**Pasionet e rrëmbyera** nuk **të** lënë të gjykosh drejt”, - thoshte ai shpesh, kur binte rasti. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 29)

(7) Sepse kështu e kishte **turku**: rrëmbente këtej e hiqte andej, zhvatte andej e jepte këtej, gjersa e shtinte **njerinë** në kllapë. (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 227)

(8) Po edhe **vetmia të** ngushëlloka, se **të** bën të mendohesh. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 270)

¹⁴⁹ “... kur kushtet ligjërimore plotësohen, “trajta e shkurtër e përemrit vetor të vetës së dytë njëjës” shenjon një kundrinor me vetë të përgjithësuar, si te shembujt e mëposhtëm: *Urtësia e popullit gjithnjë të befason...*” Përnaska, artikull i cituar, f. 194

b) me kryefjalë të individualizuar dhe një kundrinor apo caktuesor përgjithësues:

(1) *Porta e dalë boje të kallte trishtim në shpirt.* (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 30)

(2) *Dhe hante veten me dhëmbë që nuk e kishte pikasur me kohë se kishte kasnecuar badjava para “farmaqios” së Pip Spicerit, ku, domosdo, s’**të** gostit njeri, në mos me helm.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 352)

(3) *Hëna mbi gjol **të** lëbyrte sytë.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 597)

(4) *Një “rrebesh shiu” **të** shoqëron gjatë zbritjes me ashensor.* (Panorama, 29 korrik 2011)

3.5.3. Fjalitë njëkryepërbërëse

Në kapitullin mbi fjalitë njëkryepërbërëse trajtohen si nëntip i veçantë fjalitë njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar (G.A., 20002, kapitulli XVIII), trajtim i cili përbën trajtimin më të gjerë në letërsinë gjuhësore shqiptare për fjalitë me kuptim përgjithësues. Çeliku (1980, 33) sjell përkufizimin: “*Fjali me vetë të përgjithësuar* quhen ato fjali njëkryegjymtyrëshe që shprehin veprime që u përkasin të gjithë njerëzve e që foljen e kanë zakonisht në vetën e dytë numër njëjës. Në këto fjali folësi nuk i drejtohet një personi të caktuar, veprimi i shprehur nga folja e vetës II kryhet nga një vetë e përgjithësuar, ku mund të përfshihet edhe vetë folësi.”

Në fjalitë njëkryepërbërëse me kuptim përgjithësues veta tipike e foljes është veta e dytë njëjës, por nuk mungon dhe veta e parë shumës¹⁵⁰:

(1) *Po ja që s’i njihte furtunat e fushës, **ku s’ke se ku të mbrohes**, ku era të mbështjell me tërë lagështinë e me tërë një shqotë, që ta bën shtatin pellg.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 95)

¹⁵⁰ G.A. nuk e sheh vetën I shumës të foljes si rastin që shpreh qartë kuptimin përgjithësues, sikurse e shpreh veta II njëjës.

(2) **Po sikur të marrësh guxim dhe t'ia shash ndonjë artikull**, ai ta mbyll gojën menjëherë, ... (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 363)

(3) Ai ishte i kapshëm e i pakapshëm njëkohësisht, brenda dhe jasht njerëzve, i keq dhe i mirë, i tillë **që zgjasje dorën ta godisje dhe befas e përkëdhelje**. (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 87)

(4) **Mbi gjol bie në sy që atje tutje** dhe të gjitha rrugët e tij të çonin te Penta. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 318)

(5) **Sot jemi shtrënguar të dëgjojmë legjenda, nesër do të shikojmë të vërteta**. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 342)

3.5.4. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje (sindetike, asindetike)

Kuptim përgjithësues kanë edhe fjalitë e përbëra me bashkërenditje:

(1) Me zotërinjtë ishte gjithmonë më lehtë. **I thërrisje në gjyq, i kapje në faj, u hidhje prangat**. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 110)

(2) **Për thashetheme të tilla më parë mund të dënoheshe rëndë, tani askush nuk shqetësohet**. (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 50)

(3) **Të hapësh dy varre dhe të jesh mirë?** (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 148)

(4) **S'ke bukë, por ke zemër. Ti, Milto, ke bukë me tepricë, por s'ke zemër fare...** (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 75-76)

3.5.5. Fjalitë e përbëra me nënrenditje

Kanë kuptim përgjithësues edhe sifjalitë e varura në fjalitë e përbëra me nënrenditje (kryefjalore, përcaktore, kundrinore, kohore, kushtore, shkakore, qëllimore, lejore, rrjedhimore, etj.). Disa prej tyre janë vënë re edhe më parë nga studiuesit tanë, disa të tjera

janë shtuar në punimin tonë të pranishëm. Kjo dukuri lidhet me kuptimin përgjithësues të foljes në sifjalinë e varur, sidomos kur shprehet me lidhore e dëftore.

3.5.5.1. *sifjalia kryefjalore*

GA (2002, 385) veçon faktin që në sifjalitë e varura kryefjalore¹⁵¹ folja është më tepër në të tashmen dhe më rrallë në të pakryerën. “... fjalia kryesore e periudhës ka zakonisht kallëzues emëror të tipave: *është e vështirë, është e kotë, nuk është mirë, është një gjë e domosdoshme* etj., një kallëzues të shprehur me folje pësore.”

Zakonisht sifjalitë kryefjalore me kuptim përgjithësues paraprihen nga ndërtime me kuptim leksikor të mundësisë, pamundësisë, domosdoshmërisë etj., me vlerë pohuese apo mohuese, si: *është bukur, është mirë, s’ ishte e lehtë, ishte e lehtë, është e vështirë, është e pamundur* etj., edhe mungesore, pa këpujën jam. Sifjalitë kryefjalore me kuptim përgjithësues e kanë foljen në kohën e tashme e të pakryer të mënyrës lidhore, të shumtën e herëve në vetën e dytë njëjës. Më tepër këto fjali i kemi të tipit jolidhëzor, në pak raste kemi ndeshur tipin lidhëzor:

S’ ishte ndonjë habi ta përfytyroje guvernator të ardhshëm, siç u kishte shkuar mendja atje te sheshi i bashkisë. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 55); *Elbasanasit e vjetër me nostalgji tregojnë që ishte fat të jetoje kohën e bollëkut e të ahengut.* (Shekulli, 18 korrik 2011); *Ishte një idiotësi ulëritëse të besojë një variant të tillë.* (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 38); *Po e mbufati kripa tubin e thithjes, atëherë është e pamundur të futesh brenda që ta hapësh, se pëlçet si qefulli në gjol gjatë verës.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 382); *Të vritesh në këtë ditë maji, kur ke bërë gjithë atë rrugë dhe kur ke menduar se ke shpëtuar nga ndonjë plumb, është diçka e kobshme dhe e tmerrshme.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave*

¹⁵¹ Domi shpjegon: “Fjalitë kryefjalore lidhore dalin në gjithë stilet e gjuhës; përdorim veçanërisht të dendur kanë ato në të folmen popullore; kjo është mjaft e pasur në fjalë të urta e maksima, që, nga përmbajtja e tyre, kërkojnë një shprehje abstrakte, të përgjithësuar, pa kryefjalë vetore të caktuar, prandaj u vinë mjaft për shtat fjalitë kryefjalore lidhore.” (1970, 58)

tw dikurshme, 2006, 136); Vështirë të mund ta marrim me mend sesi mund të ndihet ajo nga ky fakt, (Shekulli, 18 korrik, 2011).

3.5.5.2. *sifjalia përcaktore*

Kuptimin përgjithësues e takojmë dhe në fjalinë e përbërë me sifjali përcaktore. Në G.A. (2002, 169) thuhet: “Në një periudhë me fjali të varur përcaktore që përmban një thënie me karakter përgjithësues (proverba etj.), përemri dëftor në funksionin e kryefjalës mund të përsëritet.”.

Folja e sifjalisë përcaktore me kuptim përgjithësues është zakonisht e mënyrës dëftore a lidhore (paraprirë nga foljet modale *mund* e *duhet*), koha e tashme, veta II, III njëjës.

Sifjalia përcaktore me kuptim përgjithësues mund të përcaktojë:

a) një emër, përemër a përbërës emëror me kuptim përgjithësues në sifjalinë kryesore:

(1) Ustai që bën poçen, di t'i vërë edhe vegjën, që të mos i digjen duart..., - tha Pavlloja. (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1981, 375)

(2) Ai ishte e kundërta e të vëllait, Majit, që e kishte edhe ai, në natyrën e moshës së vet, apelin e kujtimeve, të cilave mund t'u përgjigjesh vetëm me oshëtimën e ëndërrimeve. (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 127)

(3) Ai që ta bën varrin, nuk mund të ta ngrejë varrin. (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1981, 446)

b) një emër, përemër a përbërës emëror me kuptim të individualizuar në sifjalinë kryesore:

(4) Cigaret u pinë gjer në fund dhe pastaj bishtat e tyre, që s'kishe se ku t'i zije, u shuan... (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1981, 381)

(5) ... s'mbeti vend në atë ishull të vogël, të rrethuar nga ujërat e kripura, **ku të ngrije banesë e varr të ri**. (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 13)

3.5.5.3. *sifjalia kundrinore*

Mendojmë se përdorime me kuptim përgjithësues mund të ketë dhe sifjalia kundrinore. Ajo është e tipit lidhëzor e jolidhëzor, me foljen zakonisht në mënyrën lidhore e dëftore, koha e tashme dhe e pakryer, veta e dytë njëjës e shumës.

Ke dëshirë të jetosh, të dashurosh, të lindësh fëmijë, të jesh nënë, të jesh atë, të jesh dhëndër, të shkosh në luftë, të kthehesh prej saj, madje të vdesësh si në këngë. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 12); *Po përgatiteni për pushime? Do të merrni me vete dhe fëmijët? Po mendoni të shkoni me avion? Atëherë nuk do të jenë pushime, të paktën jo për ju!* (Shekulli, 18 korrik 2011); *S'ka kumar më të shëndetshëm se ai ku e di që s'ke asgjë për të humbur dhe asgjë për të fituar.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 191); *Ajo që ndryshuar aq shumë, sa do të besojë se i kishte ndodhur një tjetri.* (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 32).

3.5.5.4. *sifjalia kallëzuesore*

Edhe sifjalia kallëzuesore ka përdorime me kuptim përgjithësues. Folja e sifjalisë kallëzuesore me kuptim përgjithësues është përgjithësisht në kohën e tashme dhe të pakryer të mënyrës lidhore, veta e dytë njëjës.

Çdo fjalë të thoshe, ishte njësoj sikur të ngrije zërin kundër botës kriminele. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 249); *Të përdorësh si argument Jutbinën e Kotorret e reja, për t'i hequr shqiptarësinë ciklit tonë Verior, është njëlloj sikur të marrësh si arsye Trojën, e cila ndodhet në trojet turke, për t'i mohuar grekësinë poemës homerike.* (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 52); *... të ndërtosh urë mbi Vjosë e tek derdhet Drinoja, në këtë vend kaq të gjerë, është si të zësh hënën në qiell e ta ulësh përmbi tokë.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 157).

3.5.5.5. *sifjalia kohore*

Kuptim përgjithësues gjejmë edhe te sifjalia kohore. Ajo e ka foljen më së shumti në mënyrën dëftore dhe në lidhore, koha e tashme, por nuk mungojnë dhe kohët e tjera të saj. Veta më e përdorur është veta e dytë njëjës.

Kur shfleton poezinë popullore provon një ndjenjë përjetësie, njëmendësie, hapësire. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 12); **Kur ke një qëllim të madh**, për hir të tij duhen bërë flijime. (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 165); *Po ç'e do kandilen ndezur, kur ke urim në zemër!* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 315); **Kur hyn njeriu në atë kullë**, duket sikur ndërron krejt jetë. (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 119-120); **Teksa i sheh së largu duke biseduar e duke bërë pak stretching**, të kuriozujnë. (*Panorama*, 17 korrik 2011).

3.5.5.6. *sifjalia vendore*

G.A. (2002) veçon: “Dalohen dy nëntipa semantiko-strukture të periudhës me fjali të varur vendore: te nëntipi i parë, marrëdhëniet hapësinore tregohen në mënyrë të papërgjithësuar; te nëntipi i dytë, këto marrëdhënie tregohen në mënyrë të përgjithësuar.... Te nëntipi i dytë me marrëdhënie hapësinore të përgjithësuar fjalia e varur lidhet me kryesoren me anën e lokucioneve lidhëzore vendore përgjithësuese *kudo që, ngado që, tekdo që*.” (f. 538-539)

Raste të sifjalisë vendore me kuptim përgjithësues kemi ndeshur dhe ne në korpusin tonë, me folje zakonisht të mënyrës dëftore e lidhore, koha e tashme, veta e dytë njëjës:

Do të dalë andej nga s'e pret. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 74); **Kudo që të ndodhesh, në kafene, në rrugë, në radhën e biletave e ndien këtë gjë.** (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 23); **Kudo që të shkosh**, partizanët i mbajnë në gojë: (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 13).

3.5.5.7. *sifjalia kushtore*

Në rastin e fjalive njëkryepërbërëse G.A (2002, 385) njeh dhe sifjalinë kushtore me kuptim përgjithësues.

Mendojmë se sifjalia kushtore me kuptim përgjithësues ka përdorim të gjerë në gjuhën shqipe. Folja e sifjalisë kushtore me kuptim përgjithësues është kryesisht e mënyrës

lidhore dhe dëftore, koha e tashme dhe e pakryer, veta e dytë njëjës. Sifjalia kushtore me kuptim përgjithësues mund të jetë sifjali:¹⁵²

a) e periudhës hipotetike të realitetit:

(1) *Njërin krah dhe njëren këmbë nuk e lëvizte fare. **Po t'i jepje hante, po ta lije** rrinte pa ngrënë. Ushqimin ia jepte me lugë e ëma.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 148)

(2) *Që të hysh në këtë botë, **duhet të hysh në uniformën tënde**.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 192)

(3) ***Në doni ta gjeni fajin**, hetoni te Kadarenjtë e tjerë, ata të Palortosë.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 122)

(4) ***Duhet të hipje mbi diçka** që të vështroje përtej saj.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 139)

b) e periudhës hipotetike të mundësisë:

(5) ***Nëse kërkon sot për etimologjinë e fjalës bunker**, do të hasësh jo vetëm në shembujt shqiptar, por edhe në shembujt amerikanë...* (Shekulli, 18 korrik, 2011)

(6) *Xhamat ishin veshur me avull dhe **po të vështroje nga jashtë**, brenda kafesë të dukej se gjithë grumbullin e klientëve atje e lidhte diçka intime.* (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 56)

c) e periudhës hipotetike të pamundësisë:

(7) ***Po të mos e dinim në ç'kohë ka jetuar**, do të besonim se rapsodi plak e ka bërë disa herë linjën Romë-Athinë-Stamboll.* (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 157)

¹⁵² Këto sifjali po i klasifikojmë sipas përcaktimit të Mahir Domit për fjalinë e përbërë kushtore në *Sintaksa*, 1954.

(8) **Duhet të ishe shumë i dëlirë që t'u qëndroje atyre syve zhbirues.** (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 137)

3.5.5.8. *sifjalia shkakore*

Sifjalia shkakore me kuptim përgjithësues njihet përdorim jo të gjerë në gjuhën shqipe. Folja e sifjalisë shkakore është përgjithësisht në kohën e tashme, mënyra dëftore.

Ne shpesh mbrojmë atë që s'është për t'u mbrojtur, se kështu mbrojmë veten tonë. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 206); *Me dhembjen e fëmijës njeriu nuk mësohet lehtë, se e ndesh rrallë.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 415); *Me njerëz të tillë ndodhesh ndonjëherë në vështirësi, pasi nuk shkëputesh dot.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 271); *Mos kërko, se s'të jep, merrja vetë, se s'të nget.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 367)

3.5.5.9. *sifjalia qëllimore*

Edhe sifjalia qëllimore mund të përdoret me kuptim përgjithësues. E kemi takuar më shumë në tipin lidhëzor; folja e saj është në kohën e tashme të mënyrës lidhore, veta e dytë njëjës:

Në qoftë se ke vendosur të mbash të fshehtë një mënyrë pushtimi, përse duhet që trillimi që krijove me qëllim që të mbulosh të vërtetën, të ketë megjithatë një farë ngjashmërie me të? (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 39); *Po ai nuk pyeste, duke shkuar pas asaj fjalës së tij: në rini bëj qejf, që të gëzosh këtë botë, në pleqëri bëj të mira, që të gëzosh edhe botën tjetër.* (J. Xoxa, *Lulja e kripës 2*, 1981, 230); *Përdorni shqisën e gjashtë, që të shijoni 5 të tjerat...* (*Panorama*, 24 korrik 2011); *Në mënyrë që të nxjerrim maksimumin e përfitimeve të lajthisë, është e rekomandueshme që të konsumoni të paktën 25 gram lajthi të freskëta çdo ditë.* (*Panorama*, 24 korrik 2011).

3.5.5.10. *sifjalia krahasore*

Gjejmë përdorime me kuptim përgjithësues edhe te sifjali krahasore. Kjo sifjali e ka zakonisht foljen në kohën e tashme të mënyrës dëftore e lidhore, veta e dytë numër njëjës:

*“Më sa gjen qefull plak, aq gjen dhe naforiot plak”, - thoshin peshkatarët. (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1981, 304); Është e lejueshme të merrni në bagazhin e dorës aq sasi ushqimi **sa është e nevojshme për ushqyerjen e fëmijës gjatë udhëtimit.** (Shekulli, 18 korrik, 2011); Nëna thotë për kodrat se janë aq të buta, **sa mund t’i hash me lugë.** (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 244); Është babai yt dhe nga babai nuk mund të ndahemi, **ashtu siç mund të ndahemi nga burri apo nga gruaja...** (J. Xoxa, Lulja e kripës 2, 1981, 538)*

3.5.5.11. *sifjalia lejore*

Ndër tipat e sifjalive të varura me kuptim përgjithësues, gjejmë dhe sifjalinë *lejore*. Veçori e fjalisë së përbërë me sifjali të varur lejore përgjithësuese, sipas G.A. (20029, është se ato lidhen me fjalinë drejtuese me ndajfolje me kuptim të përgjithshëm, të pacaktuar, pasuar ose jo nga *që: sado që, kudo që, sido që*; me përemra lidhorë të pacaktuar: *kushdo që, cildo që, çfarëdo që* dhe ndërtohen kryesisht me mënyrën lidhore: *Sado që e vështirë të jetë e vërteta, ajo patjetër do të arrijë në zemrën e njerëzve.* (f. 599)¹⁵³ E gjejmë sifjalinë lejore me kuptim përgjithësues edhe te Domi (1970).

(1) *Ata kishin, sipas tij, psikologjinë e bujkut,..... , prandaj kërkon ta ketë diellin mbi çaçkë të kokës, si në Tropik, gjithë ditën e ditës, **megjithëse të bren kryet si ndonjë morr.*** (J. Xoxa, Lulja e kripës 1, 1980, 298)

(2) *Eh ç’burrë është! Si e pi rakinë! **Dy okë t’i japësh, s’do t’ia dijë!*** (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 39)

3.5.5.12. *sifjalia rrjedhimore*

¹⁵³ “Veçori tjetër e këtyre fjalive është se ndërtohen kryesisht me mënyrën lidhore dhe, më rrallë, me mënyrën dëshirore, të cilat, bashkë me mjetin lidhës, i japin fjalisë kuptimin e përgjithshëm, të pacaktuar. Fjalitë lejore përgjithësuese më të shumtën nuk e kanë kryefjalën të shprehur. Kur ajo shprehet, vihet pas kallëzuesit.” (G.A., 2002, f.598-599)

Mund të flitet për përdorim me kuptim përgjithësues edhe në sifjalinë rrjedhimore. Folja në këtë sifjali është kryesisht në mënyrën lidhore e dëftore, koha e tashme dhe e pakryer, veta e dytë njëjës:

(1) .. është kaq i shpejtë, **sa të vjen të thuash** se fluturon me krahë e godet atje ku s'ë presim. (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 270)

(2) Por veçanërisht në shtëpinë ku rrinte Agush Tomorrica kjo zhuzhitje ishte e madhe dhe shurdhuese, **sa nuk të linte të dëgjoje asnjë tingull dhe zë tjetër**. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 64)

(3) Mos i mbani fëmijët ulur. “Lodhini” më mirë para se t'i hipni në avion, **kështu do e keni më të lehtë** t'i vini në gjumë gjatë udhëtimit, sidomos nëse do flenë. (Shekulli, 18 korrik 2011)

3.5.5.13. *sifjali të përziera* (të përbëra komplekse¹⁵⁴)

Po sjellim më poshtë një shembull të periudhës së përzierë ku kemi disa prej sifjalive me kuptim përgjithësues (*kryefjalore, kohore, kundrinore, shkakore* etj.):

Të të thërrasin për të kontribuar në lindjen e një medieje është privilegj, një proces krijues që shkon deri në ezaurim, po në çastin më të parë kur ti sheh përmes valëve të transmetimit pjesë edhe nga angazhimi yt, sesi përçohet në më të parën herë zëri dhe figura nën një logo të re në çdo familje shqiptare brenda e jasht kufijve, sesi lidhet pandashëm emri dhe imazhi yt me një familje të re televizive, e kupton se çdo lindje është e bukur, sepse rilind dhe ti me të. (Mapo, 23 korrik 2011)

3.5.6. *Struktura sintaksore me kuptim përgjithësues*

M. Galmiche (1985) thekson: «L. Kupferman (1976, 161-164) shënon se në praninë e disa prej kallëzuesorëve mbiemërorë, rimarrja e togfjalëshit emëror të veçantë të lloji *le*

¹⁵⁴ I emërton të tilla, *të përbëra komplekse*, M. Çeliku në veprën “Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde”, ILAR, Tiranë 2016, f. 334.

N (emri i shquar, numri njëjës) apo *les N* (emrat e shquar, numri shumës), me anë të strukturës *c'est*¹⁵⁵ është krejtësisht e mundur, edhe pse, shton ai, grupi *être-adj. (jam-mbiemër)* shfaq për pasojë një farë autonomie krahasuar më sintagmën emërore. Kjo veçori është e ilustruar në shembujt e mëposhtëm: *L'Histoire de Paul, c'est absurde / Historia e Polit, kjo është absurde (ky fakt, kjo gjë)... »*¹⁵⁶

Dhe në gjuhën angleze takohen struktura të tilla *jam-mbiemër* + it, ndërtime që përdoren për të shprehur qëndrime, ide: *A është e mundur të programosh njëkompjuter për të folur? (Is it possible to programme a computer to speak?)*¹⁵⁷

Edhe në gjuhën shqipe mendojmë se thuajse në të gjitha ndërtimet e tipit *jam + mbiemër femëror*¹⁵⁸/ndajfolje (*është e vështirë/është vështirë, është e lehtë/është lehtë, është e pamundur* etj.), edhe në ndërtim mungesor të tyre, pa këpujën *jam*, kur ndiqen nga një sifjali kryefjalore me kuptim përgjithësues, kemi struktura sintaksore me kuptim përgjithësues:

(1) *Ai nuk erdhi në dhomën time, po nga toni i bisedës me gruan në korridor, nuk ishte e vështirë të kuptoj se ishte tërë nerva.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 269)

¹⁵⁵ Strukturat *c'est* apo *ça* në gjuhën frënge kanë si veçori kuptimin përgjithësues.

¹⁵⁶ L. Kupferman (1976 ; 161-164) note qu'en présence de certains prédicats adjectivaux, la reprise des SN spécifiques du type *le N* ou *les N* par *c'est* — est tout à fait possible, bien que, ajoute-t-il, le groupe — *Etre-adj.* manifeste alors une certaine autonomie par rapport au SN. Cette propriété est illustrée par des exemples comme: (10) *L'histoire de Paul, c'est absurde...*” *artikull i cituar*, f. 4

¹⁵⁷ “You can also use ‘be possible to’ with ‘it’ as the subject to say that something is possible. You usually use this expression to say that something is possible for people in general, rather than for an individual person.

It is possible to reach Tunheim on foot.

Is it possible to programme a computer to speak?”

(Ju gjithashtu mund të përdorni 'është e mundur' me 'ai' si subjekt për të thënë se diçka është e mundur. Ju zakonisht përdorni këtë shprehje për të thënë se diçka është e mundur për njerëzit në përgjithësi, sesa për një individ në veçanti.

Është e mundur për të arritur Tunheim në këmbë.

A është e mundur të programosh një kompjuter për të folur?) COLLINS COBUILD ENGLISH GRAMMAR, London 1990, f. 239

¹⁵⁸ Në G.A. (1995) veçohet rasti i përdorimit të mbiemrit në gjininë femërore kur *mbiemri* i referohet jo një emri, por mbarë një fjalië a thënieje më të gjatë, duke parakuptuar emrin gjë a punë ose përmrin dëftor *kjo, ajo*. (f. 162)

Sifjalia kryefjalore të *kuptoje*, në shembullin (1) është sifjali me kuptim përgjithësues. Veta e dytë njëjës e foljes shënon referentin përgjithësues. Nëse folja do të ishte në vetën e parë, atëherë sifjalia nuk do të ishte me kuptim përgjithësues dhe ky fakt do të ndryshonte dhe interpretimin e sifjalisë kryesore dhe strukturës sintaksore **nuk ishte e vështirë**, nga përgjithësuese në strukturë sintaksore të individualizuar: *Ai nuk erdhi në dhomën time, po nga toni i bisedës me gruan në korridor, nuk ishte e vështirë të kuptoja se ishte tërë nerva.*

(2) **Është vështirë** të luftosh kundër shansit tënd të keq, sidomos në kumar, ku ai nuk varet nga ti, as nga zotësia jote. (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 292)

(3) **Ishte lehtë** të thoshe: ia mori të dashurin shoqes, ishte kaq i përhapur ky sport, por këtu ishte tjetër gjë. (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 143)

(4) Pastaj **ishte e palogjikshme** të mos i besojë Islam Bylykbashit që ishte ndeshur sy ndër sy me këtë Nezhën... (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 58)

(5) **Nuk është vështirë** të merret me mend. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 102)

Por kemi raste të strukturave sintaksore të lartpërmendura me kuptim përgjithësues edhe kur sifjalia kryefjalore nuk është sifjali me kuptim përgjithësues:

(6) Kola ia kishte nisur një kënge. Erën e kishte pas dhe mund të këndonte. **E pabesuar** se si këndonte. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 93)

(7) **Është e kuptueshme** që kjo gjuhë e dyzuar e eposit do të sillte diskutimin e autorsisë. (I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, 2002, 107)

Mendojmë se rastet e mësipërme kontrastojnë dukshëm me shembullin në vazhdim, rasti i strukturës sintaksore me kuptim të individualizuar: *Veç të vinte tha me vete. Ishte i sigurt se, në mos krejt pezmatimi, gjysma e tij do të tretej.* (I. Kadare, *E penguara*, 2009, 117)

Shënim: Mendojmë se në disa prej rasteve të mësipërme sikur humbet mëvetësia kuptimore e sifjalisë kryesore (**është vështirë, është e pamundur**). Këto struktura sintaksore mund të shihen si pjesë përbërëse e

një togu kallëzuesor, duke luajtur rolin e foljeve gjysmëndihmëse me vlerë modale për foljen e sifjalisë kryefjalore e cila është dhe kryefjalë për to, p. sh.: **është e pamundur të dëgjohet = nuk mund të dëgjohet; nuk është vështirë të merret me mend. = mund të merret me mend** etj.

3.6. Fjali e togje gramatikisht të palidhura

Kuptimi përgjithësues vihet re shpesh edhe në fjalitë e togjet e palidhura gramatikisht me kuptime modale e emocionale të ndryshme. I gjejmë ato në të gjitha stilet, por më tepër në letërsinë artistike. Zakonisht, folja e fjalive gramatikisht të palidhura me kuptim përgjithësues është në mënyrën dëftore, kryesisht koha e tashme dhe e ardhme, në mënyrën lidhore, veta e dytë njëjës e shumës, si dhe veta e parë shumës. Kuptimin përgjithësues e kemi ndeshur si në ndërtime njëkryepërbërëse, ashtu dhe në ato dykryepërbërëse.¹⁵⁹

M. Çeliku (1980) veçon: “Një përdorim jashtëzakonisht të madh ka fjalia “ku ta dish” duke qenë kuptimisht sinonimike me fjalitë “nuk dihet” “nuk mund ta dish” “ku i dihet”. Fjalia ku ta dish, funksionon si e pavarur si pjesë kryesore ose e varur dhe si fjali e ndërmjetme.” (f. 36)

3.6.1. Fjali të ndërmjetme me kuptim përgjithësues

¹⁵⁹ “Fjalitë e ndërmjetme të mirëfillta ngërthejnë një rreth pak a shumë të përcaktuar tipash strukturorë e semantikë. Ato mund të dalin në formën e një fjalie dyshe (dykryegjymtyrëshe) të thjeshtë e të zgjeruar ose të një fjalie njëshe, me vetë të caktuar, me vetë të pacaktuar, me vetë përgjithësuese ose pavetore.” M. Domi, “Sintaka e gjuhës shqipe” II, Tiranë 1970, f. 152

Fjalitë e ndërmjetme, duke pasur vlerë të plotë kallëzuesore dhe duke qenë me po të njëjtat veçori si dhe fjalitë e tjera,¹⁶⁰ bartin një kuptim të caktuar dhe interesi ynë është përqendruar në kumtin përgjithësues të tyre. Fjalitë e ndërmjetme me kuptim përgjithësues i kemi hasur në të dy tipat ndërtimorë të tyre: 1) *pa mjete lidhëse*; 2) *me mjete lidhëse*. Përsa i takon vendit në fjali, i kemi gjetur në të tria pozicionet: në fillim, në mes e në fund të saj.

Shembujt e mëposhtëm të fjalive të ndërmjetme me kuptim përgjithësues po i rendisim, së pari, sipas tipit ndërtimor:

a) pa mjete lidhëse:

(1) *Kështu, duam s' duam*, bota e ardhshme u përkiste të vdekurve. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 15)

(2) *Rakia*, vetë i dytë, **do të thoni ju**, nuk shkon. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 15)

(3) **Të mendosh** që, në këtë çast, ka njerëz që thonë:.. (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 165)

b) me mjete lidhëse:

(4) **Që thoni ju**, ajo drekë te Shahin Gjoni shkoi për qejf,... . (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 14)

(5) **Që ta dini ju**, ky Sinan Thana është ai ullishtaku që më priti me përshesh me dhallë në një helmetë gjermani. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 40)

(6) *Kjo tregonte se ai kishte vrarë trutë mbi këtë çështje dhe se, ku ta dish*, mund të kishte vënë në mend të shkruante edhe ndonjë libër...(J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 77)

¹⁶⁰ Shih për më tepër G.A. (sintaksa), f. 640.

(7) *E, siç e kuptoni*, zbuluesi i vërtetë i jodit nuk është askush tjetër përveçse... një mace. (V. Haxhistasa, J. Xhemalaj, *Kimia* 8, 2008, 60)

Së dyti, sipas vendndodhjes, i kemi gjetur fjalitë e ndërmjetme me kuptim përgjithësues në të tria pozicionet: në fillim, në mes e në fund:

Kur ç'të shohësh, pa mbushur ende sarandat, i harroni fare mallkimet e betimet dhe ... (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 112); *Po do ti*, që ta marrë vesh i paudhi e të na dërgojë në shtëpi *Lefter Llukën*, (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 45); *Këndojnë gjelat e parë*, ata që, *siç besohet*, dëbojnë fantazmat. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 64); *Ai të paguan vetëm mbledhjen e të ka caktuar dhjetë kuintalë në ditë*, vra veten ti, *po deshe*, që të marrësh mëditjen prej tri-katër kacidhesh. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 426); *Se sokohe, që thoni ju*, Shpati ka qenë plot me të tillë dhe atëherë zinin drerë me brirë degë-degë e i bënë kurban. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 24); *Edhe këto biseda ishin larg nga bisedat lirike, apo si mund t'i quajmë ndryshe*. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 328).

Foljet që kemi ndeshur më tepër në fjalitë e ndërmjetme me kuptim përgjithësues janë: them, di, kryesisht në të tashmen e mënyrës dëftore e lidhore. Siç e përmendëm dhe më lart, Çeliku veçon fjalinë “ku ta dish”.

Kështu, *duam s'duam*, bota e ardhshme u përkiste të vdekurve. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 1, 1980, 15); *Epo, ç'a t'i thuash?* *Pati djalë e vogël sëmure*... (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 511); *E që thua ti*, në atë kohë na paska plasur një rrebesh i madh. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 21); *Ku ta dish*, edhe mund të ketë vdekur. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 223); *Ku ta dish*, mund të kem mendime, që s'jam në gjendje t'i dalloj. (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 224); *Ku ta dish*: Ato që ju peshkatarët e Naforës quani ngjala të egra, mund të jenë ngjallat femra... (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 254).

3.6. 2. Fjali të ndërkallura me kuptim përgjithësues

Edhe këto fjali mund të përdoren me kuptim përgjithësues. Folja e fjalive të ndërkallura është në vetën e dytë njëjës ose të parë shumës, kryesisht mënyra dëftore, koha e tashme, por edhe mënyra urdhërore:

(1) *Çdo gjë që ndërtohet, vjen dita dhe rrëzohet, - **po ta lësh të rrëzohet**.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 148)

(2) *Sigurisht që fakti se partitë politike më shumë luftojnë për vota (**siç e pamë dhe në zgjedhjet e fundit**), nëpërmjet të cilave vinë në pushtet, nuk është karakteristikë vetëm e partive tona.* (Mapo, 19 korrik 2011)

(3) *Në Ksamil, mund të parkosh, - **nëse e thua popullorçe** – ku të ta dojë zemra, gjë e rrallë në Shqipëri.* (Shekulli, 18 korrik 2011)

3.6.3. Togje të ndërmjetme me kuptim përgjithësues

“Në disa raste është e vështirë të dallosh fjalët e togjet e ndërmjetme të tipit foljor nga fjalitë e ndërmjetme. Vihet re një numër i madh rastesh në kapërcyell. Shumë fjali të ndërmjetme kanë marrë ose po marrin tiparet e fjalëve e togjeve të ndryshme.” (G.A., 2002, 374).

E takojmë më së shumti dukurinë në foljet dua, them të mënyrës dëftore e lidhore:

*Do t'u vinte, ndoshta, keq për të. Për herë të parë në jetë, **por ç'e do**, do të ishte vonë.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 22); *Unë jam për Allamanjë, more Dhaskal, unë, **po ç'e do** që ky padishahu ynë s'e ndezi edhe një herë luftën përtej Tunës.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 181); *Kishte ngritur dhe atë urë, një çerek ore në këmbë , **të thuash**.* (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 146); *Ec e ec , qe se gjejnë në qoshe të një dere një mace, **të thuesh** tue cofë.* (Përralla shqiptare, f.162)

Shumë e përdorur është folja them dhe në ndërtimin thua se, në formën e paraqitur analitike, por dhe në formën sintetike.

Ai turfulloi përsëri, **thua se** donte të shkundte kujtimet. ... (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 303); Si të gjithë të dashuruarve, atyre u pëlqente të riktheheshin te dita e parë e njohjes së tyre, **thua se** donin të rizbulonin apo ndoshta të ndreqnin atje diçka. (I. Kadare, *Përbindëshi*, 1991, 57); Gargujt po bënin veri mbi kurorën e një ulliri, **thuase** rrekeshin të largonin andej me krahët e tyre erën e rëndë të barutit. ... (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 435).

3.6.4. Shprehje me kuptim përgjithësues

Çeliku, siç e përmendëm edhe më lart, gjen përdorime me kuptim përgjithësues edhe në fjalitë e ndërmjetme dhe mendon se ato “kanë shërbyer herë-herë si burim për përfitim të disa konstrukteve të qëndrueshme predikative e jopredikative.”¹⁶¹, që shprehin mohim apo pamundësi apo “që funksionojnë si rrethanorë, si edhe ndonjë pjesëz etj.”¹⁶²

Shembuj:

Për natë ia ndake bukën mbas punës së bame, kështu që në pak kohë nxuni nusja me punue e me vjeftë që ç’ke me te. (Përralla shqiptare, f. 198); *Pastaj ata “u pajtuan”, ajo i dha dorën dhe ai, sa të hapësh e të mbyllësh sytë*¹⁶³, u gjend bri saj. ... (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 509); ... *ata sollën dhurëti të çmuara, rroba të mëndafshta e putire të argjendta, të fala shumë e bekime edhe më shumë, premtime sa të duash*,... (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare* 4, 1982, 62); *Nëse je si shumica e njerëzve me halle, e di që ç’ke me të.* (Mapo, 19 korrik 2011).

Veçojmë këtu disa shprehje me kuptim përgjithësues pohore nga ndërtimi, por kuptimisht mohore:

¹⁶¹ M. Çeliku, “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980, f. 36

¹⁶² Po aty, f. 37

¹⁶³ J. Thomaj në “Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në gjuhën shqipe”, S. F., 1969/1, f. 27, i konsideron *frazeologjizma me strukturë fjalie* shprehjet e dhëna.

Ç'e do një libër që s'flet për zemra, dashuri, të puthura? ... (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 418); *Ç't'i bësh zemrës sime të butë, pa ... ju doni lënë pa bukë fare,* ... (J. Xoxa, *Lulja e kripës 1*, 1980, 436).

Raste të veçanta të shqipes janë dhe ndërtimet me dy mohime që japin një pohim me kuptim përgjithësues: *Italia kishte kapitulluar, këtë s'kishte njeri që s'e dinte, po cili ishte statusi i Shqipërisë? (e dinte kushdo, secili prej nesh)* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 11).

Me kuptim përgjithësues janë dhe shembujt në vazhdim, rast i shprehjeve popullore:

Që luhej muzikë, këtë po e merrte vesh edhe bufi. (e dinte kushdo, secili prej nesh). (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 30); - *Dëgjon! Në Kthellë s'të gjen as dreqi.* (nuk të gjen askush). (P. Marko, *Nata e Ustikës*, 1999, 42).

Mund të konsiderojmë si rast të kuptimit përgjithësues edhe konstruktin (lokucion lidhëzor bashkërenditës) parafjalë e rasës kallëzore **në** + foljen **dua**: **në daç**¹⁶⁴ (**në + dua**, mënyra dëshirore, koha e tashme, veta e dytë njëjës)¹⁶⁵:

Kooperativa e parë për të cilën luftova, është ajo e Ullishtasit, në Shpat të Dytë, vend i ëmbël, në daç për misër, në daç për duhan. (Dh. Shuteriqi, *Vepra letrare 4*, 1982, 12); *Në daç konteksti, në daç nxitimi, në daç formula gati konspirative, nuk të lejojnë ta konsiderosh më shumë se cinike ftesën.* (Mapo, 19 korrik 2011)

3.7. Fushat e përdorimit të kuptimit përgjithësues

3.7.1. Përdorimi i kuptimit përgjithësues sipas stileve

Në G.A. (1996, 2002) veçohet: “Fjalitë me vetë të përgjithësuar përdoren në të gjitha stilet e gjuhës letrare, natyrisht me kufizimet e tyre sipas tipareve strukturore. Fjalitë

¹⁶⁴ Sjell shembull ku i njeh vlerën përgjithësuese këtij ndërtimi M. Çeliku në “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980, f. 37.

¹⁶⁵ G.A. (1995) njeh lidhëzën foljore **daç** dhe e klasifikon atë si bashkërenditëse veçuese. (Shih f. 397 – 406).

me folje në mënyrën urdhërore i gjejmë kryesisht në stilin e letërsisë artistike; fjalitë me folje në mënyrën lidhore përdoren gjerësisht në stilin publicistik; ato me folje në mënyrën dëftore në të gjitha stilet.” (f. 385)

Edhe korpusi e konfirmon këtë pohim.

Shfaqet gjerësisht kuptimi përgjithësues në stilin e letërsisë artistike, ku kemi hasur larushi si nga pikëpamja sintaksore, ashtu dhe nga ajo morfologjike. Në gjuhën e D. Agollit, M. Kutelit, P. Markos, J. Xoxës, etj., më tepër se tipar i ligjërimit rrëfimtari apo përshkrues, kuptimi përgjithësues shfaqet si karakteristikë e ligjërimit meditativ e filozofik, p. sh.:

(1) *Milo Shinit iu mjegullua vështrimi. “Sa ëmbël është të luftosh për Dheun tënd, nën kryezotin tënd Skënderbenë!” – tha me vete.* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 244)

(2) *Shpesh, kur plas tufani dhe errësohet jeta, të duket sikur s’do të dalë kurrë më dielli. Pastaj tufani shkon, dielli del, jeta qesh e ngazëlluar. Kështu do të qeshë jeta dhe në Arbëri.* (M. Kuteli, *Tregime...*, 2005, 240)

(3) *E dini se ndonjëherë shoku të prish më tepër punë se një i panjohur? I panjohuri në përgjithësi është objektiv ndaj një të panjohuri tjetër. As thur intriga, as mban hatër. Ndërsa ka shokë që edhe mund të të thurin intriga, edhe mund të të mbajnë me hatër. Të dyja këto shfaqje janë të dëmshme.* (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 229)

Shembujt e mësipërm i takojnë gjuhës së prozës artistike, por mund të themi që kuptimin përgjithësues e takojmë dhe te poezia:

(4)

PESHA E FATIT ¹⁶⁶

Na shtypi fati e na bani krymba

¹⁶⁶ “Vepra”, Migjeni, Slloveni 2002, f. 37

ne kensit dykambësh që zbuluem hy'n

edhe aq ma tepër e ngatarruem ny'n...

shpirtënt tonë skyftera deshën të bahen pëllumba.

.....

Të vërtetat dhe rrenat? – Xhevahir e çmuem.

Me ta kur të dësh e shet dhe e blen botën.

Por mos mendo se me ta do t'ia ndreqish rrotën..

Gjithashtu, kuptimin përgjithësues e kemi ndeshur, me një denduri më të paktë se në letërsinë artistike, dhe në stilin politiko-shoqëror. Nga publicistika e vjelë mund të themi se dukuria gjen përdorim në të gjitha llojet e shkrimeve, por më tepër e ndeshim te reportazhi dhe disa lloje të tjera që do t'i paraqesim në vijim.

Përsa i takon stilit tekniko-shkencor, nuk kemi ndeshur të njëjtën denduri të përdorimeve me kuptim përgjithësues në secilin prej tyre, në stilin teknik dhe atë shkencor, kështu që do t'i shohim të veçuara, do të ndajmë gjuhën e veprës shkencore nga gjuha e veprimtarisë shkencore dhe prodhimit. Raste më të rralla të përdorimeve me kuptim përgjithësues kemi hasur në stilin shkencor, dituror. Aty gjejmë rëndom shumësin shkencor, ndërsa në stilin teknik kemi një shfaqje të gjerë të përdorimeve me kuptim përgjithësues (pothuajse 8 herë më tepër se stili dituror), madje mund të flasim për përdorimin më të dendur nga të gjitha stilet e lartpërmendura.

Përdorime me kuptim përgjithësues hasim dhe në stilin juridik-administrativ. Megjithatë, J. Thomai (1999, 242) e konsideron këtë stil me karakter të përcaktuar.

Në shembullin (5) përfituesit nga ligji janë *deputetët* (çdo deputet, çdokush që gëzon të drejtën për të qenë deputet):

(5)

Art. 26.¹⁶⁷

Deputetët, për sa kohë vazhdon periudha parlamentare, nuk mund të ndiqen ose të arrestohen për çështje penale (komunale ose politike) pa lejen e Parlamentit, veçse kur kapen në ngjarje të dukshme; në këtë rast, autoritetet gjyqësore janë të detyruara të lajmësojnë Parlamentin brenda 24 orëve nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

3.7.2. Sentencat popullore me kuptim përgjithësues

I hasim dendur përdorimet me kuptim përgjithësues në sentencat popullore për vetë natyrën e tyre si të vërteta gjithëkohore dhe gjithënjëzore. Folja që bart kuptimin përgjithësues shfaqet më së shumti në kohën e tashme dhe të bie në sy mbizotërimi i mënyrës dëftore e urdhërore. Gramatika praktike (1998, 394) bën fjalë për përdorime të shpeshta me kuptim përgjithësues në fjalët e urta, në proverba, në thëniet e njerëzve të shquar. Nuk janë të pakta rastet që kemi ndeshur në literaturën faktike të vjelë.

Shembujt në vazhdim janë raste të gurrës popullore, nxjerrë nga vepra “Gur i randë n’vend të vet” (2004), e studiuesit Sh. Haxhihyseni:

Arën në faqe, grun budallaqe, mikun fukara, s’ke ç’i do. (f. 106); Bane djalë në rini, e ke vlla në pleqni. (f. 106); Bani shyqyr, asaj që ke (f.111); Kemi shumë shokë, por pak me kokë. (f.115); Mik të ri kërko, mikun e vjetër mos harro. (f. 115); Fjala të nalton, fjala të poshtnon. (f. 131).

Shembuj të sentencave popullore i kemi ndeshur dhe në letërsinë artistike:

Mos u mundo ta vësh hardhucën në bisht. (D. Agolli, Zhurma e erërave të dikurshme, 2006, 17); Ma do buza, po s’ma lë hunda (D. Agolli, Zhurma e erërave të

¹⁶⁷ “STATUTI THEMELTAR I MBRETËRISË SHQIPTARE”, Tiranë 1997 (botimi i dytë), 41 faqe, (f. 6)

dikurshme, 2006, 22); “Kur kujton qenin, bëj gati shkopin..”, - tha Maji me vete. (J. Xoxa, *Lulja e kripës* 2, 1981, 540); “Ku të shpie (të çon) mushka?!” në kuptimin “A e sheh sa gabim po vepron?!” (*Panorama*, 24 korrik, 2011); ... kur s’ke pulën, ha sorrën, (I. Kadare, *Darka e gabuar*, 2009, 58); Po të përzihesh me krunde, pulat të hanë! (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 2006, 128).

Sentencat popullore gjejnë përdorim të gjerë në ligjërimin e thjeshtë, madje vihen re dhe raste të përshtatmërisë së tyre me situatën ligjërimore ku sërish ruhet kuptimi përgjithësues: *Më thuaj me kë je, të të them ç’të hash.* (*Panorama*, 24 korrik 2011)

3.7.3. Fjalë të mençura të personaliteteve të fushave të ndryshme me kuptim përgjithësues

Kemi ndeshur shpesh përdorime me kuptim përgjithësues dhe në fjalët e mençura të personaliteteve nga fusha të ndryshme. Le të shohim disa shembuj:

(1) “**Vdekja të çon te jeta, ashtu si dhe jeta të çon te vdekja. Kjo hyrje dalje, ose dalje hyrja është jetëvdekja, ose vdekjejeta jonë. Në pafundësi...**”¹⁶⁸

Dritëro Agolli

(2) “**Shëndetin, hirin dhe hijeshinë mund të ma falë vetëm Zoti; emrin e mirë më duhet ta formoj vetë.**”¹⁶⁹

Gjergj Fishta

(3) “**Porta e Lartë me dashuri e me mirësi nuk të jep gjë kurrë.**”¹⁷⁰

¹⁶⁸ Moikom Zeqo, *Liriku i tokës, Demoni i fjalës*, 1996, f. 10

¹⁶⁹ Tonin Çobani, *Miti dhe antimiti fishtjan* (dhjetë ese), 1999, f. 31. Kjo thënie është shkëputur nga letra që Gj. Fishta i dërgon at Pal Dodajt, më 5.12.1909. Vlerën përgjithësuese kjo thënie e bart jasht kontekstit të gjerë, kur bëhet si e vërtetë e secilit prej nesh. Në kontekst të gjerë thënia është e personalizuar. Ka raste kur thënie të caktuara janë me kuptim përgjithësues jasht kontekstit të tyre të gjerë dhe brenda tij jo dhe e anasjellta, p. sh. “Robin e zotit kurr **mos e shaj!** Ujit turbull **mos i bje!** Idhnimin e mbramjes, - tha plaku, - **lene** për në mjes e idhnimin e mjesit **lene** për në mbramje.”, (Përralla shqiptare, f. 132), Duket që këto fjali kanë kuptim përgjithësues, por kur njohim kontekstin e gjerë vihet në dyshim kjo sepse është një dialog mes plakut të mençur dhe mërgimtarit dhe këshillat mund të merren të personalizuara, të drejtuara një **Ti**-je konkrete.

¹⁷⁰ agim.poeticforum.com

Sami Frashëri

(4) “*Sulltanët të kanë pritur gjithmonë me muzikë e të kanë vrarë pas shpine me thikë.*”¹⁷¹

Isa Boletini

(5) “*Dhe që pasardhësit e tyre, shqipëtarët, janë një racë, që nuk të lejojnë pa të drejtë t’ua thyesh arrat në kokë, duket në faktin, që, përgjatë pushtimit otoman, për gati 5 shekuj rresht, ata – të cilët në kohët e mëvonshme, ishin shumica myslimanë, - kanë bërë jo më pak se 54 kryengritje kundër Turqisë.*”¹⁷²

Gjergj Fishta

Për Kostaq Cipun:

(6) “*Profesori im i shqipes në Lice ishte njeri me kulturë të gjerë letrare dhe si do ta shihni, kishte dhe disa tipare jo të zakonshme. Po ta karakterizojë shkurt, do të thoshe që të afronte duke të larguar.*”¹⁷³

Dhimitër Shuteriqi

(7) “*Padyshim në një njëqind vjetor, jubile kaq i veçantë çdo njeri ka një tronditje emocionale. Të duket që figura që përkujtohet është tashmë në paradhomën e patriarkëve, në lidhje me pavdekësinë. Kostaq Cipoja është një i tillë...*”¹⁷⁴

Moikom Zeqo

3.7.4. Tekste udhëzuese me kuptim përgjithësues

Në tekstet udhëzuese vëmë re rëndom përdorime me kuptim përgjithësues, ndoshta kjo lidhet dhe me natyrën dhe qëllimin e këtyre teksteve për të qenë “pronë” e të gjithëve.

Në vazhdim po ju paraqesim shembuj të të gjitha llojeve që kemi hasur.

*3.7.4.1. Manuale përdorimi*¹⁷⁵

¹⁷¹ Po aty.

¹⁷² Tonin Çobani, *Miti dhe antimiti fishtjan* (dhjetë ese), 1999, f. 42. Thënia është shkëputur nga fjalimi i Gj. Fishtës në Romë 26.2.1940, fragment i të cilit është botuar në veprën e cituar.

¹⁷³ Robert Cipo, “Prof. KOSTAQ CIPO”, monografi, 2003, f. 251.

¹⁷⁴ Robert Cipo, po aty, f. 293 – 294.

¹⁷⁵ Mendojmë se kuptimi përgjithësues ndeshet në të gjitha manualët e përdorimit.

Udhëzues për përdorimin e kartës SIM¹⁷⁶

Karta SIM shërben për t'u lidhur me rrjetin PLUS. Ajo mban në kujtesën e saj informacione të regjistruara si dhe kodet PIN dhe PUK që **ju** mundësojnë **të lidheni** me rrjetin GSM dhe të përdorni shërbimet e PLUS.

Për termat e përdorimit të shërbimeve **referojuni** kushteve të përgjithshme të planit **tuaj** tarifor.

Nëse karta SIM humbet apo dëmtohet, atëherë duhet **të telefononi** menjëherë Shërbimin e Kujdesit për Klientin PLUS në numrat 140, 144, 139, nga aparati celular, ose në numrat 066140, 066144, 066139 nga një operator tjetër kombëtar, për **të çaktivizuar** kartën (në këtë rast do t'ju kërkohet Bar Code Personal, si dhe disa të dhëna të tjera që vërtetojnë se numri **ju** përket **juve**). Në rast se karta SIM humbet apo dëmtohet, **ju mund ta zëvendësoni** atë nëpërmjet një procedure shumë të thjeshtë pranë dyqaneve të Plus, duke ruajtur kështu të njëjtin numër celulari.

3.7.4.2. Receta gatimi

Në recetat e gatimit ndeshim në përdorimin e dy formave të foljes: formës veprore dhe formës joveprore. Për rastin e parë, forma veprore e foljes, mendojmë se vepruesi është një veprues përgjithësues, një **ne/ju** që përfshin e përfaqëson secilin prej nesh:

(1) SALLATË BOSTANI ME KREM ORIZI

Përgatitja:

Në një texhere **ziejmë** qumështin, **hedhim** sheqerin dhe miellin e orizit. E përziejmë deri sa të marrë trajtë kremoze dhe e **lemë** të ftohet. Në pjatë **vendosim** bostanin e prerë. Afër tij, **vendosim** tasin me kremi e orizit. Sipër kremit **hedhim** frutat e pyllit. Shërbehet e ftohtë me verë të ëmbël rozë. (Panorama, 24 korrik 2011)

Për rastin e dytë, kur folja është e formës joveprore, duket se vëmendja nuk është te vepruesi, por te veprimi. Kështu, vepruesi nuk merr rëndësi, duket sikur kemi të bëjmë

¹⁷⁶ Ky fragment është shkëputur nga "Udhëzues për përdorimin e kartës SIM", f. 5 -6.

me veprues të pacaktuar dhe që nuk na intereson se cili është, por rasti i kalimit të foljes nga forma joveprore në formën veprore duket sikur lejon interpretim përgjithësues. Vërejmë shembullin (2):

(2) *SUPË ME ORIZ*¹⁷⁷

*Pasi është përgatitur lëngu i mishit ose i peshkut, kullohet. Vihet të ziejë në zjarr të ngadalshëm orizi i pastruar dhe i larë, por kokrra të mos shpërthehet. Pastaj kullohet dhe hidhet në lëngun e mishit të valuar ku lihet të ziejë deri sa masa të arrijë trashësi mesatare. Hidhet lëng kripe e majdanoz ose kopër e grirë hollë dhe kur e **hedhim** në pjatë, i **shtojmë** gjalp të freskët.*

3.7.4.3. Eksperimente

Në tekstet mësimore kemi ndeshur kuptimin përgjithësues në rastet e përdorimit të vetës së parë shumës mënyra dëftore dhe vetës së dytë shumës mënyra urdhërore. Ky përdorim njihet dhe nga G.A. (2002, 385): “Në tekstet mësimore përdoren fjali me kuptim të përgjithësuar që e kanë foljen në vetën e parë shumës të dëftores e të lidhores së tashme dhe në vetën e dytë shumës të mënyrës urdhërore.”.

(1) Në një gotë kimike **hidhni** pak oksid bakri CuO me ngjyrë të zezë. **Shtoni** në të me pipetë tretësirë të holluar të acidit sulfurik H_2SO_4 . **Përzijeni duke e tundur** provëzën. Oksidi i bakrit CuO vepron me acidin sulfurik H_2SO_4 dhe jep sulfatin e bakrit CuSO_4 .¹⁷⁸

(2) Në një gotë kimike **hedhim** deri në $\frac{1}{2}$ e vëllimit, tretësirë acidi klorhidrik HCl . Në të **shtojmë** një copë natriumi me madhësinë e kokës së shkrepësës. **Vendosim** një hinkë mbi gotë. Ç’**vërejmë**?¹⁷⁹

Ndërkohë mund të themi që nuk mungojnë dhe rastet kur ndeshim të dyja vetat në të njëjtin eksperiment si p. sh.:

(3) Në një gotë kimike ku **keni hedhur** paraprakisht nitratin argjendi AgNO_3 , **shtojmë** tretësirë të acidit klorhidrik HCl¹⁸⁰

¹⁷⁷ “Si të gatujmë”, Evgjëni Harizi, EDFA, 2000, f. 344

¹⁷⁸ Kimia 8, Mediaprint 2008, f. 40.

¹⁷⁹ Po aty, f. 50.

¹⁸⁰ Po aty, f. 43.

3.7.5. Shenjat e horoskopit

Gjejmë kuptimin përgjithësues dhe në parashikimin që bëhet për shenjat e horoskopit. Folja i takon vetës së dytë numër shumës, kryesisht mënyra urdhërore, por nuk mungon dhe përdorimi i mënyrës lidhore paraprirë nga foljet modale *mund/duhet*. Kuptimi përgjithësues shtrihet edhe te përemrat, caktuesorët etj.

UJORI

Duhet të bëni maksimumin për ***të përfituar*** sa më shumë nga kjo ditë e mirë. ***Dëgjoni*** zemrën për çdo zgjedhje që duhet të bëni. Dikush në punë do ***ju*** kërkojë ***të realizoni*** disa ndryshime, por ***ju duhet të mendoheni*** mirë. (Mapo, 23 korrik 2011)

3.7.6. Lojëra, sudokë

Në lojëra e sudokë kuptimin përgjithësues e gjejmë rëndom në folje të vetës së dytë numër shumës, mënyra urdhërore.

Plotësoni tabelën me numrat e dhënë!

Ngjyrosni pjesën me pikë dhe ***zbuloni*** figurën.

Gjeni figurën ***duke bashkuar*** pikat.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1 – 9. (Mapo, 27 korrik 2011)

3.7.7. Këshilla, ide

Kuptimin përgjithësues në këtë nëngrup e gjejmë në vetën e dytë shumës. Foljet janë kryesisht të mënyrës urdhërore, të mënyrës lidhore paraprirë nga foljet modale *mund/duhet* dhe mënyrës dëftore.

Nëse ***keni*** shtëpi plazhi ***mund t'i jepni*** një prekje verore ambienteve të brendshme. Por edhe ***ju*** që pas pushimeve ***do t'u riktheheni*** shtëpive në qytet, ***mund të shtoni*** emocione nga kujtimet e bukura që keni kaluar në plash.

Jepini një transformim plazhi tavolinës. ***Hiqni*** menteshat, ***pritni*** pjesët e sipërme të tavolinës për të vendosur një pllakë xhami. Brenda boshllëkut të krijuar ***vendosni*** letër

dekorative, rërë dhe guacka të bukura. **Ngjitni** me kujdes pastaj xhamin me pjesën e tavolinës.

Sillni në shtëpi kujtimet e plazhit të grumbulluara nëpër vazo..... (Panorama, 17 korrik 2011)

3.7.8. Në reklama

Te reklamat hasim përdorimin e vetorëve dhe caktuesorëve të vetës së dytë numër shumë. Foljet janë kryesisht të mënyrës urdhërore.

(1) **ERJONI NDËRTIM**

JU FTON TË JETONI ATY KU ËSHTË MË E MIRA PËR JU! (Panorama, 28 korrik 2011)

(2) Ky është interesi më i lartë. **Përfitoni!**

Oferta verore Bankës Emporiki **ju** mundëson depozitat më të mira në treg me përfitim maksimal/ **Përfitoni** interesat më të larta me://

Shuma minimale për të hapur këtë depozitë është 100.000 LEK/ (Panorama, 24 korrik 2011)

(3) ... **zgjidhni** shkollën “Harry Fultz” për vlerat... **Regjistrohuni** tani!

WELCOME TO HARRY FULTZ UNIVERSITY FAIR 2010 (Mapo, 23 korrik 2011)

3.7.9. Në sondazhe

Më poshtë po sjellim një rast të sinonimisë sintaksore. Vëmë re përdorimin e formës veprore dhe joveprore të foljes. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me përdorime me kuptim përgjithësues.

Mendoni se ia vlen **të bëni** pushimet e verës në Shqipëri?

Pushimet, ia vlen **të bëhen** në Shqipëri? (Shekulli, 18 korrik 2011)

3.7.10. Në titujt e librave, përrallave, tregimeve, artikujve etj.

Më poshtë po ju paraqesim disa prej titujve ku mendojmë se ka përdorime me kuptim përgjithësues:

Tituj librash, tregimesh, poezish:

“Si të shkruajmë ese”, CDE, përgatitur nga Bardhyl Musai (udhëzues praktik)

“Të jetosh në ishull”, B.Blushi (roman)

“Kismetin e gjen përpara” (Përralla shqiptare, f. 116)

“Kanga që s’kuptohet”, Migjeni (poezi)

Tituj të artikujve të revistës “Psikologji”¹⁸¹:

Si të lidhim miqësi të reja

Skllavëria e bixhozit... Ç’është, si të shpëtojmë!

A e dini se...

Tituj e nëntituj të artikujve të gazetave:

Të kontrollohet gjuha që përdorim nëpër tavolina. (Panorama, 8 nëntor 2011)

Po përgatiteni për pushime? Do të merrni me vete dhe fëmijët? Po mendoni të shkoni me avion? Atëherë nuk do jenë pushime, të paktën jo për ju! (Shekulli, 18 korrik 2011)

Të gjitha rrugët të çojnë te frigoriferi. (Panorama, 24 korrik 2011)

3.7.11. Në gjuhën e folur

Kuptimi përgjithësues takohet jo vetëm në gjuhën e shkruar, por edhe në gjuhën e folur. Rasti në vazhdim, një intervistë e D. Agollit, dëshmon për këtë fakt.

Dialog për letërsinë dhe artin

¹⁸¹ Në gazetën “PANORAMA”, 8 nëntor 2011.

Më 15 shtator 1993 në apartamentin e Dritëro Agollit në Tiranë përjetova një pasdite të paharruar. Duke pirë kafe pa sheqer, si dhe raki, gjysmë seriozisht e gjysmë me shaka folëm për **poezinë** dhe **artin**. Biseda e regjistruar në magnetofon është një dëshmi e fragmentuar, një mënyrë e veçantë të shprehuri dhe të arsyetuar lirshëm. Duke e zbardhur këtë shtjellim idesh bëj të mundur një komunikim.

Moikom Zeqo, 20 qershor 1994

Zeqo: - Këtu, në studion tënde. Dritëro, ka shumë piktura dhe libra. **Të ngjan se poezia** është e padukshme.

Agolli: - **Poezinë** e bën të dukshme **leximi**.

Zeqo: - E bën diçka më shumë se sa **leximi alfabetik**.

Agolli - Padyshim. **Poezia** është lexim i alfabetit të shpirtit.

Zeqo: -Flitet shumë për **universalitetin e poezisë**.

Agolli: -**Poeti** është simbol i krijuesit **të artit në përgjithësi**. **Rapsodi parahomerik** është simbol i Homerit, ashtu si Homeri është simbol jo vetëm i artit të fjalës, por edhe i arteve të tjera. Bile Homeri është edhe simbol **i romancierëve të ardhshëm**, që në kohën e tij nuk ekzistonin.

Zeqo: - Pra, simbol i simboleve!

Agolli. - Në **art** ka gjithmonë simbole të simboleve.

Zeqo; - Në këtë mbretëri apo univers të simboleve **poeti** është një demiurg.

Agolli: - **Ta quash poetin** demiurg është mënyrë e përsëritur përgjithësimi. **Poetët** janë të çuditshëm, se bëjnë atë, që nuk e bëjnë **njerëzit e rëndomtë**. **Të rëndomtit** e ndiejnë këtë, po nuk identifikohen dot me **poetët**. Vetëm u afrohen. Vetëm i shijojnë **krijimet**, të mrekulluar prej **tyre**. Këtu nis **admirimi për poetët**....¹⁸²

¹⁸² Moikom Zeqo, *Liriku i tokës, Demoni i fjalës*, 1996, f. 39

Kreu IV

PËRFUNDIME

Monografia jonë ka objekt studimi *kuptimin përgjithësues*, një kategori e njohur në gjuhësinë shqiptare, por që deri më sot i është kushtuar pak vëmendje.

Disa nga gjuhëtarët tanë, në gramatika shkollore apo artikuj shkencorë, në mënyrë të fragmentuar, konstatojnë dhe analizojnë kuptimin përgjithësues të njësi të veçanta leksiko-gramatikore. Kostaq Cipo (1952) i njeh *kuptim përgjithësues emrit të shquar në njëjës e shumës*, si dhe *vetës së dytë njëjës* (si subjekt të pacaktuar, rast të cilin ne e shohim si kuptim përgjithësues), ndërsa Stefan Prifti (1958) bën dallimin që ka një *kryefjalë me kuptim përgjithësues* nga një kryefjalë me kuptim të caktuar, si dhe sheh përdorime të *foljes njëvetore me kuptim të përgjithshëm*. Shaban Demiraj (1969) njeh përdorimin e *emrit të përgjithshëm, të shquar e të pashquar, me kuptim përgjithësues*; M. Domi (1970) trajton *sifjalinë e varur lejore dhe kryefjalore përgjithësuese*. Çeliku (1971) njeh funksion përgjithësues të *mbaresës shquese dhe nyjës joshquese një tek emrat e shquar e të pashquar*, funksion përgjithësues të *foljes në funksion njëkryepërbërësi në fjalitë e thjeshta e sifjalitë*, funksion përgjithësues të *disa ish-trajta të shkurtra të përemrave dhe të fjalitë njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar* (1974). Remzi Përnaska (1983) trajton rastin e *kundrinorit të përgjithësuar*, ndërsa Ludmila Buxheli (2011) konsideron një *veprues me kuptim të përgjithshëm ose gjenerik* argumentin (për folje njëvetore të tipit *flihet, rrohet, jetohet* etj.). Padyshim, duke qenë sintetizim i gjithë dijes gjuhësore shqiptare, më gjerë kuptimin përgjithësues e gjejmë në Gramatikën e Akademisë, 1 (1995), 2 (1997, 2002).

1. Cili është koncepti ynë për *kuptimin përgjithësues*?

Kuptimi përgjithësues i një fjale është të përfaqësohet e llojit prej saj, në kontekste gjuhësore e forma të caktuara gramatikore. Kuptimi përgjithësues i kundërvihet kuptimit të individualizuar, të veçuarit të një sendi unik të llojit, të dallueshëm nga të tjerët.

Kuptimin përgjithësues e gëzojnë *emrat, përemrat, foljet* dhe *disa mbiemra*. Njësia leksiko-gramatikore që shërben për të emërtuar tërë llojin, ose veprime, gjendje a ide që i takojnë llojit është njësi me kuptim përgjithësues. Ajo mund të referojë: a) një anëtar, përfaqësues i llojit, që bëhet i tillë bazuar në një ose më shumë karakteristika të përbashkëta të tij me llojin të cilit i përket. Ai bart vlerat e tiparet e klasës dhe njëkohësisht përfaqëson çdo individ të saj. Ky anëtar, përfaqësues i çdo individi të llojit, është i ndryshëm nga një element i veçantë i llojit, është i ndryshëm nga një element specifik, individual dhe i kundërvihet një individi konkret të klasës që gëzon disa tipare të veçanta, dalluese; b) veprime, gjendje a ide në përgjithësi që i referohen individëve/sendeve që përfaqësojnë llojin, klasën, në kundërvënie këto me një gjendje, veprim a ide të veçantë, referuar individëve/sendeve specifike.

2. Në punimin e pranishëm *kuptimi përgjithësues* është hetuar e analizuar përmes një qasjeje tridisciplinore: gramatikore, semantike e pragmatike. Këto tri disiplina gjuhësore kanë ndihmuar njëra-tjetrën për analizimin e fakteve gjuhësore dhe arritjen e konkluzioneve.

Përgjithësimi në gjuhën shqipe nuk mbështetet dukshëm në kritere formale gramatikore. Nuk ekzistojnë forma të specializuara që të na japin *kuptimin përgjithësues*. (Frëngjishtja, për të saktësuar ambiguitetin individualizues/përgjithësues ka elemente formale, si ndërtimi i tipit *Art (nyje) + N (emër), c'est (kjo) + SV (sintagmë foljore)* ose *ça + SV: Macja është e dashur. Le chat est affectueux (spécifique); Macja është e dashur. Le chat, c'est affectueux (générique).*) Kuptimi përgjithësues duket si një kuptim gramatikor i pamarkuar formalisht mjaftueshëm, por nyjat joshqese dhe mbaresat shqese, krahas kuptimeve të tjera gramatikore, mund të shprehin dhe kuptim përgjithësues në kontekste të caktuara:

[*Një libër i mirë e gjen tregun vetë.*
Libri i mirë e gjen tregun vetë.
Librat e mirë e gjejnë tregun vetë.]

Për këtë arsye, *përgjithësimi* është parë nga ne si një *kategori gramatikore-semantike*. Për shqyrtimin e kategorisë së përgjithësimit lind nevoja e analizave semantike e gramatikore, ku rolin

më të rëndësishëm në shmangien e ambiguitetit *kuptim përgjithësues/kuptim i individualizuar* në një përdorim të caktuar, e zë konteksti gjuhësor. Vetëm në strukturën përdorimore mund të përcaktohet nëse një njësi leksikore a ndërtim i caktuar përdoret me *kuptim përgjithësues a kuptim të individualizuar*. Konteksti lejon ose përjashton interpretimin përgjithësues. Për këtë arsye, që në titull të punimit, *kuptimin përgjithësues* e kemi quajtur *kuptim përgjithësues kontekstor*.

3. Klasa leksikore kryesore që njeh rëndom përdorime me kuptim përgjithësues në situata e kontekste të caktuara gjuhësore është *klasa e emrave*.

Klasa e emrave ndahet në dy grupe: *emra që referojnë* – *emra që nuk referojnë (emra të llojit)*. *Emrat që referojnë* emërtojnë ose një tërësi ose një individ të caktuar që përfaqëson veten ose tërë klasën. Ata bartin *kuptim të tërësisë, përgjithësues a të individualizuar*. *Emrave që referojnë* i kundërvihen *emrat që nuk referojnë, emrat e llojit*. *Emrat që nuk referojnë (emrat e llojit)* përdoren si emërtim abstrakt i një klase me cilësitë e karakteristikat e veta, kanë kuptimin e llojit të veçantë në përjasje me klasat, por nuk marrin përsipër të përfaqësojnë çdo individ të klasës. Përmes tyre përfaqësohet tërësia e tipareve të sendeve të njëjta të një klase. *Emrat e llojit* janë një tërësi që bashkohen nga tiparet e tyre të përbashkëta. *Emrat e llojit* kanë paraqitjen e tyre formale: ata janë vetëm në *trajtë të pashquar, me një zero*. Por emri i pashquar i pamarkuar nuk është vetëm *emër i llojit*. Ai është *emër që referon* kur: a) paraprihet nga disa fjalë përcaktuese, si: numërorë, përemra dëftorë e pyetës, sepse fjalët përcaktuese luajnë rol individualizues të ngjashëm me atë të nyjës shquese; b) në situata thirrmore, në funksionin e thirrorit, sepse personi të cilit i drejtohem i është i njohur. Individualizimi bëhet me anë të situatës.

Emri i llojit takohet në këto raste: kur emri me një zero përdoret si: emër përfaqësues në fjalorë, si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror; si përcaktor kallëzuesor; si përcaktor me drejtim në rasën rrjedhore i një emri të pashquar, në përbërës të tipit: *mish viçi, këngë dasme, vaj ulliri* etj.; në fjali mohore; në funksionin e ndajshimit; kur tregon një sasi të pacaktuar lënde/sendesh: *pi ujë, blej djathë, vriste lepuj, pinte cigare* etj.; kur tregojnë llojin, klasën, sidomos në ndërtime me kundërvënie; kur paraprihen zakonisht nga folja *jam* dhe tregojnë profesion; në ndërtimet me krahasim, kryesisht në njëjës etj.

Emri i llojit mund të jetë edhe i markuar, paraprirë nga nyja joshquese *një*. Ky është një përdorim i veçantë i emrave paraprirë nga nyja shquese *një*, e cila mund të hiqet, pa cenuar aspak fjalinë. *Emri i llojit* në këtë rast fiton një vlerë shtesë, *vlerë intesifikuese*.

Emri që referon mund të referojë individë/sende në tërësi, të individualizuar a specifike ose në mënyrë të përgjithësuar. *Emri i trajtës së shquar*, si në *numrin njëjës*, edhe në *numrin shumës* mund të përdoret si *emër me kuptim përgjithësues*. Në këto raste emri del si përfaqësues i klasës së cilës i përket, nëpërmjet tij/tyre përfaqësohet tërë klasa. *Emri i pashquar me një joshquese*, ndonëse me dënduri më të vogël përdorimi se emri i shquar, njeh përdorime me kuptim përgjithësues. Kështu, paradigma e *emrit me kuptim përgjithësues* për gjuhën shqipe është: a) emër njëjës + mbaresë shquese; b) njëjës joshquese *një* + emër njëjës; c) emër shumës + mbaresë shquese. Këtë paradigmë e gjejmë edhe në gjuhën frënge, ndërsa në gjuhën angleze është tipike nyja zero për të dhënë referentin përgjithësues.

Trajta e shumësit të emrit me kuptim përgjithësues (rasti c i paradigmes më lart) dallon nga trajta e shumësit të individualizuar sepse: *shumësi përgjithësues* referon sende/individë që kanë tipare të klasës dhe bëhen përfaqësues të tyre, ndërsa *shumësi i individualizuar* tregon një shumicë që i referohet disa individëve/sendeve në mënyrë të individualizuar; shumësi përgjithësues mund të ndërkëmbehet me trajtat e tjera të emrit me kuptim përgjithësues. Trajta e njëjësit mund të përdoret në vend të shumësit pa cenuar kuptimisht fjalinë, sepse në rastin e emrave me kuptim përgjithësues kuptimi mbi numrin zhduket, ndërsa shumësi i individualizuar nuk mund të ndërkëmbehet me trajtat e tjera të njëjësit, sikurse shumësi me kuptim përgjithësues, sepse cenohet kuptimisht fjalia.

Ndërkohë që, këmbimi i dy trajtave të njëjësit me kuptim përgjithësues nuk është gjithmonë i mundur. Zëvendësimi i *trajtës së shquar njëjës* me *trajtën e pashquar njëjës me njëjën një* kushtëzohet nga faktorë semantikë, pragmatikë e gramatikorë.

Zëvendësimi i *trajtës së shquar* me të *pashquarën* e saj duket se është i mundur në rastin kur emri është në funksion kryefjale dhe ndonjëherë i vështirë të realizohet kur emri është në funksion të kundrinorit të drejtë. Të njëjtën gjë do të thonim për këmbimin e anasjelltë, d.m.th. kur trajta e *pashquar* zëvendësohet me *trajtën e shquar*. Në këtë rast na duhet një kontekst më i gjerë gjuhësor për të shmangur ambiguitetin.

Përdorime me kuptim përgjithësues kemi te *emrat konkretë* dhe *emrat abstraktë*; nuk mungojnë madje dhe raste të *emrave të lëndës* me kuptim përgjithësues, ndërsa emra të veçantë, si *njeriu*, *bota*, *njerëzia* i gjejmë përgjithësisht si emra me kuptim përgjithësues. Në këtë përdorim këta emra dalin zakonisht në trajtë të shquar.

Përdorimet me kuptim përgjithësues nuk janë kufizuar vetëm tek emrat e përgjithshëm. Edhe *emrat e përveçëm* njohin përdorime të tilla, kur përdoren për të emërtuar një kategori të caktuar njerëzish, një klasë frymorësh që bashkohen nga tiparet që karakterizojnë emrin e përveçëm, i cili e ka humbur tashmë funksionin për të treguar një frymor të vetëm, të veçantë. Emrat e përveçëm me kuptim përgjithësues shfaqin të njëjtën paradigme si emrat e përgjithshëm, por në raste të caktuara trajta e njëjësit të shquar dhe të pashquar duket e pamundur të ndërkëmbehet me trajtën e shumësit të shquar me kuptim përgjithësues.

Për sa i takon funksionit të *emrave me kuptim përgjithësues* në fjali, mund të themi se ata kryejnë çdo funksion që i njihet emrit, pra, funksion të *kryefjalës*, *kundrinorit*, *përcaktorit* e *rrethanorit*. Në gjuhën shqipe, njihen dhe përdorime të *mbiemrit të emëruar* me kuptim përgjithësues.

4. *Emrat me kuptim përgjithësues*, qoftë në trajtë të pashquar, qoftë në trajtë të shquar janë *kuptimisht të caktuar*. Pavarësisht pacaktueshmërisë/caktueshmërisë formale, emrat me kuptim përgjithësues janë semantikisht të caktuar. Si nga folësi, edhe nga dëgjuesi njihet klasa të cilën shenjon *emri me kuptim përgjithësues*.

5. Sipas nesh, duhet dalluar dhe *kuptimi përgjithësues i kufizuar*, më i ngushtë. Këtë e gjejmë te *përbërësit emërorë*, ku emri shoqërohet me një përcaktor a sifjali përcaktore. Ky është *koncepti i nënklasës* apo *nënllojit* të emrit me kuptim përgjithësues. Përcaktorët, me çfarëdo që të shprehen ata, të tipit të veçuar a të paveçuar, kufizojnë emrin deri në nivelin e nënllojit. Këta përbërës, me *emra të nënklasës me kuptim përgjithësues*, i interpretojmë si *përbërës emërorë me kuptim përgjithësues të kufizuar*. Ata i takojmë në të njëjtat funksione sikurse edhe emrat me kuptim përgjithësues.

6. Kuptimi përgjithësues shtrihet edhe në klasën e *përemrave*.

Përemrat vetorë mund të përdoren me kuptim përgjithësues në të gjitha vetat (përveç vetës së parë njëjës), kur individi i shprehur nga vektori bëhet përfaqësues i të tërëve, secilit prej nesh. Ai është i

dallueshëm nga një individ i caktuar që referon një person apo një grup. Vetori specifik i shqipes që njih përdorime me kuptim përgjithësues është vetori i *vetës së dytë njëjës*. Vetori i *vetës së tretë, njëjës a shumës*, njih raste të rralla të përdorimit me kuptim përgjithësues në gjuhën shqipe. E takojmë atë në raste të përdorimit anaforik, kur rimerr një emër me kuptim përgjithësues ose kur është i shoqëruar nga një ndajshim me kuptim përgjithësues, i veçuar ose jo. Raste të përdorimeve me kuptim përgjithësues kemi hasur edhe te *pronorët e emëruar*. Vetori me kuptim përgjithësues mund të kryejë në fjali rolin e një kryefjale a një kundrinori.

Përdorime me kuptim përgjithësues njohin dhe *trajtat e shkurtra të përemrave vetorë (caktuesorët)*, në rasën dhanore e kallëzore, veta e dytë njëjës dhe veta e parë dhe e dytë shumës. Trajtë e shkurtër e një përdorimi të veçantë është *dhanorja etike (plotësi etik)*. Mendojmë se dhanorja etike, krahas raportit të afriës dhe të gjallërisë, gëzon edhe kuptim përgjithësues. Evidentohet ajo veçanërisht në rastet e vetës së parë numër shumës, më rrallë në vetën e dytë njëjës, para foljeve të mënyrës habitore, në të gjitha kohët e saj.

Interpretime me karakter përgjithësues lejojnë dhe *përemrat pronorë* të vetës së parë shumës dhe vetës së dytë numër njëjës e shumës, *përemrat e pacaktuar kushdo, secili/secila, askush, asnjëri, kurrkush, të gjithë*, përemrat që formohen prej këtij të fundit dhe tregojnë frymorë, etj., në rastet e një përdorimi joanaforik ose kur i referohen një vepruesi me kuptim përgjithësues, *përemrat dëftorë*, veçanërisht *ai, ajo*, sidomos në rastin e proverbeve (rast i njohur dhe në gramatikën angleze), *vetvetorë e lidhorët që, i cili/e cila*, në rastet kur përcakton referent përgjithësues, dhe përemrat lidhorë të pacaktuar *kush, cili, sa, çfarë*, të cilët janë të zbërthyeshëm në dy përemra (= *ai që*).

7. *Mbiemrat* (jo çdo mbiemër) janë një tjetër klasë fjalësh që përdoren me kuptim përgjithësues. Mbiemra të tillë janë: a) mbiemra cilësorë: *një libër interesant = mund të tregojë një libër që u intereson njerëzve (çdo njeriu); një muzikë argëtuese = një muzikë që argëton njerëzit (çdo njeri)*; mbiemri emërton cilësi të objektit që shpreh emri; b) mbiemra prejfoljorë me prapashtesën –*shëm*, të tipit *i kapshëm (nga çdo njeri), i ngrënshëm (nga njerëzit, nga secili prej nesh)*. Të tillë mbiemra e ruajnë lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes përkatëse dhe mund të marrin një veprues përgjithësues; c) sinonimikë me një sifjali përcaktore, ose me një folje të formës joveprorë; d) mbiemra që kanë kuptim jovepror dhe në rast zëvendësimi me strukturë tjetër

kërkojnë një veprues që, në një kontekst të caktuar, mund të jetë secili prej nesh, pra, një veprues përgjithësues; e) kryejnë në fjali funksionin e përcaktorit, përcaktorit kallëzuesor dhe të pjesës emërore të kallëzuesit.

8. Emrat, përemrat apo përbërësit emërorë me kuptim përgjithësues shoqërohen në fjali nga *folje-kallëzues me kuptim përgjithësues*. *Folja me kuptim përgjithësues* tregon gjendje a veprime që i takojnë llojit, që u përkasin gjithë anëtarëve të një klase. Si vetë të përgjithësuar tradita jonë gjuhësore njeh kryesisht *vetën II njëjës* (rasti i fjalive njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar), por folja-kallëzues e fjalive me kuptim përgjithësues, përveç rastit të fjalive njëkryepërbërëse, sipas nesh, duhet parë në secilën prej vetave, në njëjës e shumës. Përdorime me kuptim përgjithësues njohin foljet në të gjitha mënyrat: *dëftore* (në të gjitha kohët më të përdorshme të saj: *e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë, e kryer, e ardhme, e ardhme e së shkuarës*), *lidhore* (kryesisht në të tashme, të pakryer, të kryer), *habitore* (*e tashme*), *dëshirore* (*e tashme*) dhe *urdhërore*.

Koha tipike e foljeve me kuptim përgjithësues është *koha e tashme*, por përdorime të tilla, siç mund të vihen re edhe më lart, i gjejmë edhe në të shkuarën e në të ardhmen.

Mënyra lidhore, koha e tashme dhe *veta II njëjës* janë mjetet gramatikore tipike të shprehjes së kuptimit përgjithësues të foljes në gjuhën shqipe.

Foljen me kuptim përgjithësues e takojmë sa në *formën veprorë*, aq edhe në *formën joveprorë* të saj. Rastet kur kemi përdorim të formës joveprorë të foljes vetore me kuptim përgjithësues janë jo të pakta në gjuhën shqipe. Rastet më të shpeshta i gjejmë në foljet joveprorë (me mbaresë), mënyra dëftore apo lidhore, koha e tashme dhe e pakryer, veta e dytë njëjës, por edhe në vetën e parë shumës, ndërsa rastet më të rralla i kemi ndeshur në folje të formës joveprorë formuar me pjesëzën u, koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore dhe e tashme e mënyrës lidhore.

Përdorim me kuptim përgjithësues njohin edhe disa folje të formës joveprorë, si: *dihet, njihet, besohet, merret me mend, kuptohet* etj. të cilat mendojmë se kanë një veprues përgjithësues, të pashprehur fonetikisht. Këto folje që dalin vetëm në formën e vetës së tretë njëjës, në mënyrën dëftore dhe lidhore, i gjejmë më shumë në stilin dituror dhe përgjithësisht si pjesë kryesore të fjalisë së përbërë kryefjalore.

Format e pashtjelluara të foljes njohin, gjithashtu, përdorime me kuptim përgjithësues dhe kjo falë tipareve të tyre foljore. Format e pashtjelluara të foljes shprehin një veprim si proces, çka lejon edhe kuptimin përgjithësues ose jo në varësi të kontekstit ku gjen përdorim. Format e pashtjelluara të foljes kanë një veprues (i njëjtë ose jo me formën e shtjelluar në fjali) që mund të jetë i individualizuar ose përgjithësues. Përdorime me kuptim përgjithësues i gjejmë në të gjitha trajtat e formave të pashtjelluara: *përcjellore, pjesore e gerund* dhe në *formën paskajore*: atë letrare për të punuar, dhe paskajoren gege me punue (këtë të fundit kryesisht në funksion kryefjale).

9. Kuptimin përgjithësues e kemi hasur edhe në *struktura* të tipit *jam + mbiemër femëror/ndajfolje* (*është e vështirë/është vështirë, është e lehtë/është lehtë, është e pamundur* etj.), edhe në ndërtim mungesor të tyre, pa këpujën *jam*, kur ndiqen nga një sifjali kryefjalore me kuptim përgjithësues. Në të kundërt, kur sifjalia kryefjalore është me kuptim të individualizuar, edhe struktura e mësipërme ka të njëjtin kuptim të individualizuar. Struktura e lartpërmendur me kuptim përgjithësues takohet edhe në gjuhën angleze (*jam-mbiemër + it*), edhe në atë frënge.

10. Në gjuhën shqipe hasim rëndom fjali që kumtojnë veprime në përgjithësi, pra, *fjali me kuptim përgjithësues*. Për përkufizimin e fjalisë me kuptim përgjithësues i jemi referuar Y. Kurodas (1973, 188): "E quaj një fjali përgjithësuese, nëse ideja që shpreh ajo ka të bëjë me një gjendje të caktuar të gjërave në përgjithësi, gjërave të zakonshme apo të gjërave që ndodhin shpesh..."

Për sa i takon trajtimin të këtyre fjalive në letërsinë gjuhësore shqiptare, duhet thënë se aty-këtu, në gramatika a artikuj përmendet ndonjë rast i këtij përdorimi. Vend të veçantë dhe trajtim më të plotë zënë *fjalitë njëkryepërbërëse me vetë të përgjithësuar*, nëngrup i fjalive njëkryepërbërëse, por ky koncept duhet zgjeruar se kuptimin përgjithësues e takojmë në të gjitha llojet e fjalive: sa në *fjalitë e thjeshta* (pohore e mohore; dëftore, pyetëse, nxitëse e dëshirore), aq dhe në *fjalitë e përbëra*, qofshin këto *bashkërenditëse* (sindetike e asindetike) apo *nënrenditëse*, sa në sifjalitë kryesore të tyre, aq dhe në sifjalitë e varura (kryefjalore, përcaktore, kundrinore, kohore, kushtore, shkakore, qëllimore, lejore, rrjedhimore, etj.), dhe kjo si për fjalitë me strukturë njëkryepërbërëse, ashtu edhe për *fjalitë dykryepërbërëse*.

Për fjalitë e përbëra me nënrenditje me kuptim përgjithësues duam të veçojmë se disa prej tyre janë vënë re edhe më parë nga studiuesit tanë (si *kryefjalore, përcaktore, vendore, kushtore e*

lejore), disa të tjera (si *kundrinore, kallëzuesore, kohore, shkakore, qëllimore, krahasore e rrjedhimore*) janë evidentuar prej nesh.

11. Kuptimi përgjithësues konstatohet edhe në *fjalitë e togjet e palidhura gramatikisht* me kuptime modale e emocionale të ndryshme. I gjejmë ato në të gjitha stilet, por më tepër në letërsinë artistike. Zakonisht, folja e fjalive gramatikisht të palidhura me kuptim përgjithësues është në mënyrën dëftore, kryesisht koha e tashme dhe e ardhme, në mënyrën lidhore, veta e dytë njëjës e shumës, si dhe veta e parë shumës.

Foljet me përdorim më të dendur në fjalitë e ndërmjetme me kuptim përgjithësues janë: *them, di*, kryesisht në të tashmen e mënyrës dëftore e lidhore. Edhe *fjalitë e ndërkallura* njohin përdorime me kuptim përgjithësues. Folja e fjalive të ndërkallura është në vetën e dytë njëjës, kryesisht mënyra dëftore, koha e tashme, por nuk mungon dhe përdorimi i mënyrës urdhërore.

12. *Kuptimin përgjithësues* e gjejmë në *gjuhën e folur* dhe në *gjuhën e shkruar*, në të gjitha stilet e gjuhës, por, sigurisht, jo me të njëjtën denduri. Kemi parë të shfaqet gjerësisht në *stilin e letërsisë artistike*, ku kemi hasur larushi si nga pikëpamja sintaksore, ashtu dhe nga ajo morfologjike. Në gjuhën e D. Agollit, M. Kutelit, J. Xoxës, I. Kadaresë, P. Markos etj., më tepër se tipar i ligjërimit rrëfimtari apo përshkrues, kuptimi përgjithësues shfaqet si karakteristikë e ligjërimit meditativ e filozofik. Kuptimi përgjithësues nuk haset vetëm te gjuha e prozës artistike, por edhe te gjuha e poezisë.

Gjithashtu, kuptimin përgjithësues e kemi ndeshur, me një denduri më të paktë se në letërsinë artistike, dhe në *stilin politiko-shoqëror*. Nga publicistika e vjelë mund të themi se dukuria gjen përdorim në të gjitha llojet e shkrimeve, por më tepër e ndeshim te reportazhi. Raste më të rralla të përdorimeve me kuptim përgjithësues kemi hasur në *stilin shkencor, dituror*, ndërsa në *stilin teknik* kemi një shfaqje të gjerë të përdorimeve me kuptim përgjithësues, madje këtu më dendur nga të gjitha stilet e lartpërmendura.

Takojmë rëndom përdorime me kuptim përgjithësues në *sentencat popullore*. Mençuria popullore, eksperiencia e gjatë e popullit e filozofia jetësore vjen e koncentruar në një këshillë mbarënjëzore e gjithëkohore. Të njëjtën denduri përdorimi gjejmë dhe në thëniet e njerëzve të shquar, *tekstet udhëzuese* (si *receta gatimi, eksperimente mësimore, manuale përdorimi, lojëra* etj.) te shenjat e

horoskopit, titujt e librave, artikujve e gazetave, reklamat, sondazhet, dhe kjo duket se buron nga vetë misioni e qëllimi i këtyre teksteve, të jenë pjesë e gjithsecilit, që është dhe karakteristika thelbësore e kuptimit përgjithësues.

CONCLUSIONS

Our monograph studies the generalized meaning, a popular category in the Albanian linguistics, but very little attention has been paid to it up to recently.

In school grammars or scientific articles, in a fragmented way, some of our linguists notice and analyze generalized meaning in particular lexical – grammatical units. Kostaq Cipo (1952) recognizes the *generalized meaning of the definite noun in singular and plural*, and the *second person singular* (as an indefinite subject, a case in which we notice it as a generalized meaning), whereas Stefan Prifti (1958) distinguishes *a subject with a generalized meaning* from a subject with a definite meaning, and also notices uses of the *one – person verb with a generalized meaning*. Shaban Demiraj (1969) recognizes the use of *general noun, definite and indefinite with a generalized meaning*; M. Domi (1970) deals with the *contrast subordinate clause* and the *generalized subject*. Çeliku (1971) recognizes the generalized function of the *definite suffix and the indefinite article a/an* in the definite and indefinite nouns, the generalized function of the *verb* in simple sentences, the generalized function of *some ex - short forms of pronouns* and the *sentences with a generalized person* (1974). Remzi Përnaska (1983) deals with the case of the *generalized object*, whereas Ludmila Buxheli (2011) regards the argument (for one – person verbs as *is slept, is lived*, etc) an *actor with generalized or generic meaning*. Obviously, being a synthesis of all the Albanian linguistic knowledge, we encounter the generalized meaning in the Academy Grammar, 1 (1995), 2 (1997, 2002).

1. Which is our concept about the *generalized meaning*?

The generalized meaning of a word is *representing its kind in particular grammatical forms and linguistic contexts*. The generalized meaning opposes the individualized meaning, selecting an object which is unique of its kind and distinguished from the others.

Nouns, pronouns, verbs and some adjectives have generalized meaning. The lexical – grammatical unit which serves to nominate all the kind or actions, states or ideas which belong to the kind is a generalized meaning unit. It can refer to: a) a member, representative of its kind which is such based on one or more similar characteristics to the kind it belongs to. It holds the values and the features of the class and simultaneously it represents every of its individuals. This member,

representative of every individual of its kind, is different from a particular element of its kind, it's different from a specific, individual element and opposes a concrete individual of the class which has some particular distinctive features; b) actions, states or ideas in general which refer to individuals/objects which represent the kind, class, differing from a particular state, action or idea referring to particular individuals/objects.

2. In this work, *the generalized meaning* has been explored and analyzed through a three – disciplinary approach: grammatical, semantic and pragmatic. These three linguistic disciplines have helped each other to analyze linguistic facts and come to conclusions.

In the Albanian language, *generalization* is not clearly supported in formal grammatical criteria. There are no specialised forms which give us the *generalized meaning*. (French has formal elements to specify the individualised/generalized ambiguity, as the type *Art (conjunction) + N (noun), c'est (this) + SV (verbal syntagm) ose ça + SV: The cat is loveable. Le chat est affectueux (spécifique); The cat is loveable. Le chat, c'est affectueux (générique)*. The generalized meaning seems like a grammatical meaning which has not been marked formally enough, but the indefinite articles and the definite suffixes, apart from other grammatical means, can also express generalized meaning in certain contexts:

A good book finds its own market.
The good book finds its own market.
Good books find their own market.

For this reason, *generalization* is considered as a *semantic - grammatical category* by us. To analyse the generalization category we need to make semantic and grammatic analyses, where the linguistic context plays the most important role in avoiding the ambiguity of *generalized meaning/individualized meaning* in a particular use. Only when we use structures, we can establish whether a lexical unit or a certain construction is used with a *generalized or an individualized meaning*. The context allows or excludes generalized interpretation. Because of this reason, from the very title of our work, we have called *generalized meaning* as *contextual generalized meaning*.

3. The main lexical class which in particular linguistic contexts is often used with generalized meaning, is the *class of nouns*.

The class of nouns is divided into two groups: *nouns which refer* - *nouns which do not refer* (*nouns of the kind*). *The nouns which refer* nominate whether a whole or a particular individual who represents him/herself or the whole class. They hold the *meaning of a whole, generalized or individualized*. *The nouns which refer* oppose the *nouns which do not refer, the nouns of the kind*. The nouns which do not refer (*nouns of the kind*) are used as an abstract nomination of a class with its own characteristics and qualities, they have the meaning of the particular kind approaching the classes, but they do not represent every individual of the class. The whole of the features of similar objects of a class is represented by them. *The nouns of the kind* have their formal appearance: they are only *indefinite, with no article*. But the unmarked indefinite noun is not only a *noun of the kind*. It is a *noun which refers* when: a) is preceded by some definitive words, as: numbers, demonstrative or interrogative pronouns, because the definitive words play an individualized role, similar to the one of the definite article; b) in exclamations, in the role of the exclamation, because the person who we are referring to is familiar. Individualization is made by means of the situation.

The noun of the kind is encountered in these cases: when the noun with no article is used as: a representative noun in dictionaries, as part of the verb; as a determiner aiming the dative case of an indefinite noun, in compounds like: *calf meat, wedding songs, olive oil, etc*; in negatives; when we refer to an indefinite quantity of objects/items: *drink water, buy cheese, hunt rabbits, smoke cigars, etc*; when they reflect the kind, class, especially in opposing constructions; when they are usually preceded by the verb *to be* and reflect the profession; in comparisons, mainly in singular, etc.

The noun of the kind may even be marked, preceded by the indefinite article *a/an*. This is a particular use of nouns preceded by the definite article *the* which can be omitted without altering the sentence. *The noun of the kind* gains an additional value, an *intensifying value*.

The noun which refers can refer to individuals/objects in general, individualized or specified or in a generalized way. *The definite noun, singular and plural*, can also be used as a *noun with a generalized meaning*. In these cases the noun represents the class it belongs to and the whole class is represented by it/them. *The indefinite noun with an indefinite article*, though less frequently than the definite noun, has generalized meaning uses. Thus, the paradigm of the *generalized meaning noun* in the Albanian language is: a) singular noun + definite suffix; b)

indefinite article *the* + singular noun; c) plural noun + definite suffix. This paradigm can be found in French, whereas in English no article is typical to give the generalized referent.

The plural of the generalized meaning noun (case c of the paradigm above) differs from the plural of the individualized one because: *generalized plural* refers to objects/individuals that have the class' features and become their representatives, whereas the *individualized plural* reflects a majority which refers to some individuals/objects in an individualized way; the generalized plural can be exchanged with other forms of the generalized meaning noun. The singular form can be used instead of the plural without altering the meaning of the sentence, because in the case of generalized meaning nouns, the meaning of the number may disappear, whereas the individualized plural cannot be exchanged with other singular forms, just as the generalized meaning plural because the meaning of the sentence can be altered.

Meanwhile the exchange of the two singular forms of generalized meaning is not always possible. Substituting the *definite singular* with the *indefinite singular a/an article* is conditioned by semantic, pragmatic and grammatical factors.

Substituting definite with indefinite articles seems possible in case the noun functions as a subject and sometimes it is difficult when the noun is an object. We would say the same thing about reverse exchange, when the definite articles substitute the indefinite ones. In this case we require a broader linguistic context to avoid ambiguity.

Uses of generalized meaning are encountered in *concrete* and *abstract nouns*; there are also cases of *material nouns* with generalized meaning, whereas particular nouns as *man*, *world*, *mankind* are generally encountered as generalized meaning nouns. In this use these nouns usually come with definite articles.

Generalized meaning uses are not restricted just to common. Even *proper nouns* are used like this when nominating a specific category of people, human class joined by features which characterize the proper noun, which has now lost its function of showing a single, particular human. Proper nouns with a generalized meaning reflect the same paradigm as common nouns, but in certain cases the definite and indefinite singular seems impossible to be exchanged with the generalized meaning definite plural.

Regarding the function of *generalized meaning nouns* in sentences, we can say they accomplish all functions a noun has, thus the function of a *subject, object, determiner*. In Albanian we encounter even uses of the adjective(*gerund*) with a generalized meaning.

4. *Generalized meaning nouns*, whether definite or indefinite are *meaningfully defined*. Despite the formal/informal indefiniteness, generalized meaning nouns are semantically defined. The speaker as well as the listener know the class that the *generalized meaning noun* marks.

5. According to us, we should distinguish even the *limited generalized meaning*. We encounter this in the *noun components*, where the noun is accompanied by a determiner or a determining clause. This is the *concept* of the generalized meaning noun's *subclass or sub kind*. Whatever the determiners are expressed by, separate or inseparable, they limit the noun up to the sub kind level. These components, with *generalized meaning subclass nouns*, are interpreted as *noun components with limited generalized meaning*. They are encountered with the same functions as the generalized meaning nouns.

6. Generalized meaning is also found in the *pronouns'* class.

Personal pronouns can be used with generalized meaning in all subjects (apart from the first person singular), when the individual expressed by the pronoun represents all of us. He/she is distinguished by a particular individual who refers an individual or a group. The specific Albanian personal pronoun which recognizes generalized meaning uses, is also the personal pronoun of the *second person singular*. The personal pronoun of the third person, singular or plural, recognizes rare cases of the generalized meaning uses in the Albanian language. We encounter it in cases of anaphoric use, when it gets a generalized meaning noun or when it is accompanied by a generalized meaning apposition, separate or not. Cases of generalized meaning uses are encountered even in *nounal personal pronouns*. The *generalized meaning personal pronoun* can act as a subject or an object in a sentence. Generalized meaning uses recognize even *short forms in personal pronouns (determiners)*, in accusative and dative, second person singular and first and second person plural. Short form of a particular use is the *ethical accusative (ethical complement)*. We think that the ethical accusative, despite closeness and excitement, also has generalized meaning. It is evident

particularly in the cases of the first person plural, less frequently in the second person singular, before the verbs expressing surprise, in all its tenses..

Generalized interpretations allow even *possessive adjectives/pronouns* of the first person plural and the second person singular or plural, *indefinite pronouns whoever/whichever, nobody, no one, everybody*, pronouns created by the last one and reflect living things, etc, in cases of *non anaphoric use* or when we refer to *an actor with generalized meaning, demonstrative pronouns, especially that* in case of proverbs (known even in the English grammar), *reflexive and relatives who/that/which*, in the cases when they establish a generalized referent, and the indefinite relative pronouns *who, which, what* which can be divided into two pronouns (= *the one who*).

7. *Adjectives* (not all adjectives) are another class of words which are used with generalized meaning. Such adjectives are: a) quality adjectives: *an interesting book = it can show a book which people find interesting (everybody); entertaining music = music which entertains people (everybody)*; the adjectives reflects qualities of the object expressed by a noun; b) verbal adjectives with the suffix *-shëm(ible/able)*, such as *i kapshëm(reachable) (by everyone), edible (by people,everyone of us)*. Such adjectives preserve their direct relation to the lexical meaning of the respective verb and can get a generalized actor; c) synonymous to a determining sentence, or an intransitive verb; d) adjectives which have intransitive meaning and in case they are substituted with another structure, they require an actor which can be any of us at a particular context, thus a generalized actor; e) they act as a determiner in the sentence, a verb or the nounal part of the verb.

8. Nouns, pronouns or nounal components with generalized meaning are accompanied by *generalized meaning verbs* in sentences. *The generalized meaning verb* reflects a state or action which belong to the kind, which belong to all the members of a class. As a generalized person, our linguistic tradition mainly recognizes the *second person singular* (the case of one-component generalized meaning sentences), but according to us, the verb of generalized meaning sentences, apart from the case of one-component sentences, should be seen in each of the persons, singular and plural. Verbs in all moods recognize generalized meaning uses: *indicative* (in all its most used tenses: *present, past, future*), *subjunctive* (mainly *present, past*), *expressing surprise* (*present*), *wishes* (*present*) and *imperative*.

The typical generalized meaning verb tense is *the present tense*, but these uses, as you may have noticed above, are found in the past and in the future

The subjunctive mood, present tense, and second person singular are the typical grammar means of expressing generalized meaning verbs in Albanian.

The generalized meaning verb can be found in *active* and *passive*. There are a lot of cases when we use the passive with generalized meaning in the Albanian language. The most frequent cases are found in passive verbs, indicative or subjunctive, present and past, second person singular, but even in the first person plural; whereas the less frequent cases are found in passive verbs created with the particle u, past tense of the indicative mood and present tense of the subjunctive.

Some intransitive verbs are also used with generalized meaning, for eg: *it is known, recognized, believed, thought, understood*, etc which are thought to have a generalized actor, phonetically unexpressed. These verbs which come only in the third person singular, indicative and subjunctive, are mostly found as the main part of the compound subject sentence.

The non-finite forms of the verb also have generalized meaning uses and that's thanks to their verbal features. The non-finite forms of the verb express an action as a process, which allows or not even the generalized meaning depending on the context it is used in. The non-finite forms of the verb have an actor (similar or not to the finite form in the sentence) which may be individualized or generalized. Generalized meaning uses are found in all non-finite forms: participle, gerund and infinitive: the literary to work and another dialectical one (acting as the subject).

9. We have encountered the generalized meaning even in *structures* like *to be + feminine adjective/adverb* (*it's hard/it hardly, it's easy/ it easily, it's impossible*, etc) even when they are missing, without *to be*, when followed by a generalized meaning sentence. On the contrary, when the main sentence has individualized meaning, even the above mentioned structure has the same individualized meaning. The above mentioned structure with generalized meaning is encountered in English (*to be – adjective + it*) and in French.

10. In Albanian we occasionally encounter sentences which express actions in general, thus, *generalized meaning sentences*. To define the generalized meaning sentence we refer to Y. Kuroda-s (1973, 188): "I call it a generalized sentence if the idea it expresses refers to a particular state of things in general, the usual things or the things which often occur..."

According to the treatment of these sentences in the Albanian linguistic literature, we should say that in grammars or articles there are times when cases of this use are mentioned. A particular place and a thorough treatment go to the *one-component sentences with generalized subject*, a sub group of one component sentences but this concept should be expanded as we encounter the generalized meaning in all kinds of sentences: in *simple sentences* (affirmative, negative, indicative, interrogative), and in *compound sentences*, whether *coordinative* (sidentical and asidentical) or *subordinate*, as in their main sentences, clauses (subjective, determinative, object, time, conditional, causative, purpose, consequence etc) for one main component sentence as well as for two main component sentences.

According to the generalized meaning compound subordinate sentences we want to highlight that some of them have previously been noticed by our researchers (as *subject, determining, place, conditional and permission*) and some others (as *object, verbal, time, causative, comparative and consequence*) have been noticed by us.

11. The generalized meaning is noticed even in *grammatically un joined sentences and collocations* with various modal and emotional meanings. We encounter them in all styles, nut mostly in the artistic literature. Usually, the verb in the generalized meaning grammatically un joined sentences is in the indicative mood, mainly the present and the future tense, in the conjunctive mood, second person singular and plural and the first person plural.

The most frequently used verbs in generalized meaning sentences are: *tell, know*, mainly in the present tense of the indicative and conjunctive mood. Even in *non defining* sentences we notice the generalized meaning. The verb in the non defining sentences is in the second person singular, mainly in the indicative mood, present tense, but we also notice the use of the imperative.

12. *The generalized meaning* is encountered in the *spoken and written language, in all language styles*, but obviously not that frequently. It appears widely in the *artistic literature style*,

where we have encountered a variety in the syntax and morphological viewpoint. In the language of D. Agollit, M. Kutelit, J. Xoxës, I. Kadaresë, P. Markos etc, more than a feature of the narrative or descriptive speech, the generalized meaning appears as a characteristics of the meditative and philosophical speech. The generalized meaning is not only encountered in the language of the artistic prose, but also in the language of poetry.

We have also encountered the generalized meaning, though less frequently used, than in the artistic literature, even in the *social – political style*. From publicity we can say that this phenomenon is used in all kinds of writings, mostly in reports. Less frequent cases of using generalized meaning are encountered in the *scientific style*, whereas in the *technical style* we widely notice generalized meaning uses, more frequently than all the above mentioned styles.

We often encounter generalized meaning uses in *folk sentences*. Folk wisdom, the long experience of the people and the life philosophy comes concentrated in a comprehensive and all - time advice. The same frequency of use is encountered in the famous quotes, *guidebooks*, (*cooking tips, learning experiments, manuals of use, games, etc*) in the *star signs, book titles, newspaper articles, advertisements, surveys*, and this seems to come from the mission and the aim of these texts, to be part of everyone, which is the essential characteristics of the generalized meaning.

BIBLIOGRAFIA

Agalliu, F. (1988). *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë.

Agalliu, F. (1965). *Rreth disa çështjeve të sintaksës*. Në: Mësuesi.

- Agalliu, F. (1970/4). *Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe*. Në: Studime filologjike.
- Akademia e Shkencave. (1975). *Fjalor i termave të gjuhësisë (shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht)*. Tiranë.
- Akademia e Shkencave. (1976). *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II* Tiranë.
- Akademia e Shkencave. (1980). *Aleksandër Xhuvani*. Tiranë.
- Akademia e Shkencave. (1980). *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Tiranë.
- Akademia e Shkencave. (1988). *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*. Tiranë.
- Akademia e Shkencave. (1995). *Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (Morfologjia)*. Tiranë.
- Akademia e Shkencave. (2002). *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2 (Sintaksa)*. Tiranë.
- Belluscio, G. & Rrokaj, Sh. (2011). *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë” (shqip – italisht – frëngjisht – anglisht)*. Tiranë: Arbëria.
- Benveniste, E. (1996). *Problèmes de linguistique générale*. Gallimard.
- Buchholz, O. & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig.
- Buxheli, L. (2011). *Foljet njëvetore në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Çeliku, M. (1973). *Mbi trajtimin e fjalive njëkryegjymytyrëshe në klasën e shtatë*. Në: Mësuesi.
- Çeliku, (1971/1). *Kontribut për dy probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*. Në: Studime filologjike.
- Çeliku, M. (1974/10). *Tipet kryesore të fjalive njëkryegjymytyrëshe në gjuhën shqipe*. Në: Lëndët e shkencave shoqërore në shkollë. Tiranë.
- Çeliku, M. (1977,1980). *Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe (leksione)*. Elbasan.

- Çeliku, M. (2006). *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*. Tiranë: ShBLU, ribotim.
- Çeliku, M. (2008, 2016). *Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standard (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)*. Tiranë: ILAR.
- Çeliku, M. (2009). *Institucione, autorë, vepra, intervista*. Tiranë.
- Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, (vështrim i ri teorik). Tiranë.
- Çeliku, M., Karapinjalli, M., Stringa, R. (1998). *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë: Toena.
- Charaudeau, P. (1992). *Grammaire du Sens et de l'Expression*. Paris: Hachette.
- Cipo, K. (1949). *Gramatika shqipe*. Tiranë.
- Cipo, K. (2015). *Gramatikë e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Cipo, K. (1952). *Sintaksa*. Tiranë.
- Cipo, R., (2003) Prof. KOSTAQ CIPO, monografi. Tiranë.
- Çobani, T. (1999). *Miti dhe antimiti fishtjan (dhjetë ese)*. Enti Botues: Lisitian.
- Çomski, N. (2011). *Strukturat sintaksore*, përkthim nga Blerta Topalli, Dituria.
- Dauti, L. (2017). *Hyrje në gjuhësi teksti*. Tiranë: ILAR.
- Demiraj, Sh. (1973). *Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa I)*. Tiranë.
- Demiraj, Sh. (1969/4). *Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe*. Studime Filologjike.
- Demiraj, Sh. (1971/1). *Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe*. Në: Studime Filologjike.
- Demiraj, Sh. (1972). *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Dhima, Th. (2005). *Gjuha shqipe, sintaksa*. Tiranë.

Dhima, Th. (2012). *Kundrinori në sintaksën e Cipos dhe disa probleme që lidhen me të*. Elbasan.

Dhima, Th. (2013). *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe*. Tiranë.

Domi, M. (1954). *Gramatika e gjuhës shqipe (pjesa e dytë, sintaksa)*. Tiranë.

Domi, M. (1968). *Gramatika e gjuhës shqipe*. (për shkollat pedagogjike), pjesa e dytë, Tiranë.

Domi, M. (1970). *Sintaka e gjuhës shqipe II*. Tiranë.

Elezi, D. (1959). *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*.

English Grammar (1990). Great Britain: COLLINS Publishers.

Fabb, N. (1994). *Sentence Structure*. ROUTLEDGE.

Floqi, S. (1964). *Puna shkencore t'u përgjigjet më mirë kërkesave të shkollës*. Në: Mësuesi.

Floqi, S. (1968/3). *Konstrukte tautologjike në shqipen e sotme*. Studime Filologjike.

Gawron, J. M. & Peters S. (1990). *Anaphora and quantification in situation semantics*. CSLI, Lecture Notes Number 19

Georges, K. (1985). *Dénomination et relations dénominales*. In: Languages, 19^e année, n°76.

Georges, K. (1985). *Du côté de la généricité verbale : les approches quantificationnelles*. In: Languages, 20^e année, n°79.

Georges, K. (1994). *Qu'est-ce qui est (in)défini?* In: Faits de langues, n°4.

Georges, K. (1997). *Sens, référence et existence: que faire de l'extra-linguistique?* In: Languages, 31^e année, n°127.

Greenbaum, S. & Quirk, R. (1990). *A student's grammar of the English language*. England: Longman.

Haxhillazi, P. (1969/2). *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe*. Studime Filologjike.

Jackendoff, R. (2002). *Foundations of language*. USA.

- Karapinjalli, M. (2001). *Kërkime dhe studime në fushën e gjuhës shqipe*. Elbasan: Sejko.
- Lloshi, Xh. (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë: Albas.
- Maurice, G. (1985). *Sur les déterminants dans les expressions figées*. In: Languages, 20^e année, n°79.
- Memushaj, R. (2008). *Hyrje në gjuhësi*. Tiranë: Toena.
- Michel, G. (1985). *Phrases, syntagmes et articles génériques*, In: Langages, 20^e année, n°79, pp. 2;
- Ogden, K. & Richards, I. A. (1923). *The Meaning of Meaning*. Londër,
- Palmer, F. R. (1976). *Semantics (a new outline)*, Cambridge University Press,
- Përnaska, R. (1983/4). *Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe*. Në: Studime Filologjike.
- Përnaska, R. (1982/4). *A janë përemra 'trajtat e shkurtra të përemrave vetorë' në shqipen e sotme?* Në: Studime filologjike.
- Përnaska, R. *Gjuhësi... .. gjuhësore* I. Maluka.
- Plangarica, T. (2013). *Hyrje në studimin e kuptimit, Semantikë dhe pragmatikë, cikël leksionesh*. Elbasan.
- Pougeoise, M. (1998). *Dictionnaire de grammaire et des difficultés grammaticales*. Armand Colin.
- Prifti, S. (1958). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Prishtinë.
- Prifti, S. (1965). *Mendim për tri çështjet e sintaksës...* Në: Mësuesi.
- Robins, R.H., (2007). *Historia e Gjuhësisë*. Dituria.
- Sadiku, E. *Midis gramatikës dhe pragmatikës*. Botime 2L-2P.
- Teichmann,E. (2010). *Hapa në Universin e Ligjëritimit*. Tiranë.
- Tesniere, L. (1959). *Elements de syntaxe structural*. Paris: Klincksieck. Librairie C.

Thomai, J. (1999). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: ShBLU.

Thomaj, J. (1969/1). *Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në gjuhën shqipe*. Në: Studime Filologjike.

Totoni, M. (1970/2). *Si duhet kuptuar njësia themelore sintaksore?* Në: Studime Filologjike.

Totoni, M. (1974/10). *Shënime sqaruese për librin e gjuhës të klasës VII*. Në: *Lëndët e shkencave shoqërore në shkollë*. Tiranë.

Totoni, M.; Bubani, L.; Dako, N.; Bobrati, S. (1971). *Libri i gjuhës shqipe për klasën VII*. Tiranë.

Universiteti i Shkodrës dhe Universiteti i Elbasanit. (1998). *Gjuha dhe ligjërimi në shkollë* (materiale të konferencës gjuhësore mbajtur në Shkodër)

Universiteti i Tiranës. (1973). *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*. Tiranë.

Yule, G. (1996). *Pragmatics*. Oxford University Press.

Zufferey, S. & Moeschler, J. (2012). *Initiation à l'étude du sens. Sémantique et pragmatique*. Auxerre, Sciences Humaines Editions.

www.home.uni-osnabrueck.de

www.linguistes.com

www.shoqeriajone.com

agim.poeticforum.com

<https://www.um.es/lincoing/jv/UNIT1>

LETËRSIA KRYESORE E SHFRYTËZUAR

Agolli, D. (2006). *Zhurma e erërave të dikurshme*. Tiranë: Onufri.

Akademia e Shkencave (1973). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*.

- Frashëri, S. (1962). *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*. Tiranë: ShBLSh.
- Harizi, E. (2000). *Si të gatuajmë*. EDFA.
- Haxhistasa, V. & Xhemalaj, J. (2008). *Kimia 8*. Tiranë: Mediaprint.
- Haxhihyseni, Sh. (2004). *Gur i randë n'vend të vet*. Elbasan: Sejko.
- Jorgaqi, N. (2000). *Antologji e mendimit estetik shqiptar*. Tiranë: Dituria.
- Kadare, I. (1991). *Përbindëshi*. Tiranë.
- Kadare, I. (2002). *Autobiografia e popullit në vargje*. Tiranë: Onufri (botimi i tretë).
- Kadare, I. (2009). *Darka e gabuar*. Tiranë: Onufri (botimi i tretë)
- Kadare, I. (2009). *E penguara*. Tiranë: Onufri.
- Kongoli, F. (1994). *Kufoma*. MÇM.
- Kuteli, M. (2005). *Tregime të moçme shqiptare*. Tiranë.
- Marko, P. (1999). *Nata e Ustikës*. Tiranë: Mësonjëtorja.
- Marko, P. (2000). *Qyteti i fundit*. Tiranë: OMSCA
- Migjeni (2002). *Vepra*. Slloveni.
- Noli, F. (1989). *Vepra 4*. Tiranë.
- Përralla shqiptare*. Tiranë.
- STATUTI THEMELTAR I MBRETËRISË SHQIPTARE, Tiranë 1997 (botimi i dytë).
- Shuteriqi, Dh. (1982). *Vepra letrare 4*. Tiranë.
- Trebesina, K. (1992). *Legjenda e asaj që iku*. Tiranë: A. Z. Çajupi.
- Udhëzues për përdorimin e kartës SIM
- Xoxa, J. (1980). *Lulja e kripës. vëll. 1*, Tiranë.

Xoxa, J. (1981). *Lulja e kripës*, vëll. 2. Tiranë.

Zeqo, M. (1996). *Liriku i tokës, Demoni i fjalës*. Tiranë:Toena.

(2011, Korrik). *Mapo*.

(2011, Korrik). *Panorama*.


(2011, Korrik). *Shekulli*.

(2011, Nëntor). *Panorama*.

Shtojca


VETA PËRGJITHËSUESE NË FJALITË NJËKRYEPËRBËRËSE

■ Veta II njëjës ■ Veta I shumës ■ Veta I shumës



LIDHORJA ME KUPTIM PËRGJITHËSUES

■ Lidhore ■ Lidhore paraprirë nga mund/duhet



MËNYRAT E FOLJES ME KUPTIM PËRGJITHËSUES

■ Mënyra dëftore ■ Mënyra lidhore ■ Mënyra habitore
■ Mënyra dëshirore ■ Mënyra urdhërore

